



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

FAKULTETI I BIZNESIT DHE EKONOMISË

DISERTACIONI I TEMËS SË DOKTORATËS

**TEMA: NDIKIMI I BORXHIT PUBLIK NË RRITJEN EKONOMIKE NË
VENDET EVROPIANE NË TRANZICION**

Kandidati:

Msc.Kestrim Avdimetaj

Udhëheqësi Shkencor:

Prof.Dr.Besnik Fetai

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	10
1.1. OBJEKTIVAT KRYESORE TË HULUMTIMIT	14
1.2. PYETJET KËRKIMORE	14
1.3. HIPOTEZAT E HULUMTIMIT	16
1.4. METODOLOGJIA PER KONFIRMIMIN E HIPOTEZAVE	16
1.5. KUFIZIMET E HULUMTIMIT.....	17
1.6. ORGANIZIMI I STUDIMIT.....	18
2. STRUKTURA E BORXHIT PUBLIK NË VENDET EVROPIANE NË TRANZICION	
22	
2.1. PASQYRË MAKROEKONOMIKE E VENDEVE EVROPIANE NË TRANZICION.....	22
2.1.1. <i>Vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore</i>	22
2.1.2. <i>Vendet e Ballkanit Perëndimor</i>	37
2.2. STRUKTURA E BORXHIT PUBLIK TEK VENDET NË TRANZICION TË EVROPËS QENDRORE	
50	
2.3. STRUKTURA E BORXHIT PUBLIK TEK VENDET NË TRANZICION TË EVROPËS LINDORE	55
2.4. STRUKTURA E BORXHIT PUBLIK TEK VENDET NË TRANZICION TË BALLKANIT	
PERËNDIMOR.....	61
2.5. STRUKTURA E BORXHIT PUBLIK NË KOSOVË	66
2.5.1. <i>Të dhënat për Borxhin Publik në Kosovë (2010-2013)</i>	66
2.5.2. <i>Rritja e Borxhit Publik në Kosovë</i>	69
2.5.3. <i>Të dhënat për Borxhin Publik në Kosovë (2013-2018)</i>	70
2.5.4. <i>Karakteristikat e Portofolit të Borxhit Shtetëror të Kosovës 2016-2017</i>	84
2.5.5. <i>Borxhi Ndërkombëtar në Kosovë</i>	87
2.5.6. <i>Garancitë Shtetërore në Kosovë</i>	90
2.5.7. <i>Indikatorët e Rrezikut në Kosovë</i>	93
2.5.8. <i>Përmbledhje e përgjithshme rreth karakteristikave të Borxhit Publik të Kosovës</i>	94
2.6. KRAHASIMI I VENDEVE NË TRANZICION TË EVROPËS QENDRORE ME VENDET E	
EVROPËS LINDORE, SI DHE ME VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR	95
2.7. PËCAKTIMI I PRAGUT OPTIMAL TË BORXHIT PUBLIK TEK VENDET EUROPIANE NË	
TRANZICION.....	97
(EVROPA QENDRORE, EVROPA LINDORE, SI DHE VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR).....	97

2.8.	INDIKATORËT E BORXHIT	100
2.9.	INDIKATORËT E EKSPOZIMIT	101
2.10.	BARRA E BORXHIT PUBLIK.....	102
2.11.	INDIKATORË TË LIDHUR ME PBB-NË.....	103
3.	RISHIKIMI I LITERATURËS.....	104
3.1.	ASPEKTI TEORIK.....	104
3.1.1.	<i>Teoria Klasike mbi Borxhin Publik</i>	106
3.1.2.	<i>Teoria Neo-Klasike e Borxhit Publik</i>	108
3.1.3.	<i>Teoria Keynesiane e Borxhit Publik</i>	109
3.2.	EVIDENCA EMPIRIKE NË VENDET E ZHVILLUARA	110
3.3.	EVIDENCA EMPIRIKE NË VENDET NË ZHVILLIM	133
3.4.	PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME	142
4.	METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	145
4.1.	METODOLOGJIA	145
4.2.	SPECIFIKIMI I MODELIT TË REGRESIONIT TË THJESHTË LINEAR.....	147
4.3.	VLERËSIMI I METODËS (OLS)	148
4.4.	MODELI POOLED OLS.....	148
4.5.	MODELET FIXED DHE RANDOM EFFECT	149
	MODELI RANDOM EFFECTS.....	153
4.6.	MODELI HAUSMAN TAYLOR-IV	155
4.7.	HAUSMAN TEST.....	158
4.7.1.	<i>Zgjedhja mes Fixed Effects, Random Effects dhe Hausman-Taylor-IV</i>	158
4.8.	METODA E PËRGJITHSHME E MOMENTEVE (GMM METHOD)	159
	VLERËSUESI I METODËS GMM.....	162
4.9.	MODELET THRESHOLD.....	169
4.10.	TË DHËNAT DHE STRATEGJIA E VLERËSIMIT	173
4.11.	VLERËSIMI I MODELEVE	174
5.	REZULTATET EMPIRIKE.....	176
5.1.	MODELET EKONOMETRIKE PËR VENDET NË TRANZICION TË EVROPËS QENDRORE ..	178
5.1.1.	<i>Të dhënat nga hulumtimi empirik</i>	178
5.1.2.	<i>Rezultatet empirike</i>	179
5.2.	MODELET EKONOMETRIKE PËR VENDET NË TRANZICION TË EVROPËS LINDORE.....	182

5.2.1.	<i>Të dhënat nga hulumtimi empirik.....</i>	182
5.2.2.	<i>Rezultatet empirike</i>	183
5.3.	MODELET EKONOMETRIKE PËR VENDET NË TRANZICION TË BALLKANIT PERËNDIMOR	186
5.3.1.	<i>Të dhënat nga hulumtimi empirik.....</i>	186
5.3.2.	<i>Rezultatet Empirike.....</i>	187
5.4.	PËRCAKTIMI I PRAGUT TË BORXHIT PUBLIK TEK VENDET NË TRANZICION TË EVROPËS QENDRORE.....	190
5.4.1.	<i>Të dhënat nga hulumtimi empirik.....</i>	190
5.4.2.	<i>Rezultatet empirike</i>	191
5.5.	PËRCAKTIMI I PRAGUT TË BORXHIT PUBLIK TEK VENDET NË TRANZICION TË EVROPËS LINDORE	192
5.5.1.	<i>Të dhënat nga hulumtimi empirik.....</i>	192
5.5.2.	<i>Rezultatet empirike</i>	192
5.6.	PËRCAKTIMI I PRAGUT TË BORXHIT PUBLIK TEK VENDET NË TRANZICION TË BALLKANIT PERËNDIMOR	193
5.6.1.	<i>Të dhënat nga hulumtimi empirik.....</i>	193
5.6.2.	<i>Rezultatet empirike</i>	194
5.7.	LIDHJA MES BORXHIT PUBLIK DHE INVESTIMEVE PUBLIKE	195
5.7.1.	<i>Të dhënat nga hulumtimi empirik.....</i>	195
5.7.2.	<i>Rezultatet empirike</i>	196
6.	PËRFUNDIMI.....	199
6.1.	REKOMANDIMET.....	206
7.	LITERATURA	207
A.	BURIMET NGA RAPORTET FINANCIARE.....	229
B.	BURIME TJERA NGA INTERNETI.....	230
APPENDIX 1.....		232
APPENDIX 2.....		249
APPENDIX 3.....		266
APPENDIX 4.....		281

LISTA E FIGURAVE

Figura 2.1: Rritja vjetore e Produktit te Brendshëm Bruto për vendet në Tranzicion të Evropës Qendrore (e shprehur në përqindje).....	24
Figura 2.2: Produkti Brendshëm Bruto për koke banori për vendet në Tranzicion të Evropës Qendrore.....	25
Figura 2.3: Eksporti tek vendet në Tranzicion të Evropës Qendrore (Në % të PBB-së)	26
Figura 2.4: Shpenzimet e Konsumit Final tek vendet në Tranzicion të Evropës Qendrore (Në % të PBB-së).....	27
Figura 2.5: Kursimet Bruto tek vendet në Tranzicion të Evropës Qendrore (Në % të PBB-së)	28
Figura 2.6: Bilanci i Llogarisë Korente tek vendet në Tranzicion të Evropës Qendrore (Në % të PBB-së).....	29
Figura 2.7: Shpenzimet Qeveritare tek vendet në Tranzicion të Evropës Qendrore (Në % të PBB-së)	30
Figura 2.8: Rritja vjetore e Produktit te Brendshëm Bruto për vendet në Tranzicion të Evropës Lindore (e shprehur në përqindje).....	31
Figura 2.9: Produkti Brendshëm Bruto për koke banori për vendet në Tranzicion të Evropës Lindore	32
Figura 2.10: Eksporti tek vendet në Tranzicion të Evropës Lindore (Në % të PBB-së).....	33
Figura 2.11: Shpenzimet e Konsumit Final tek vendet në Tranzicion të Evropës Lindore (Në % të PBB-së).....	34
Figura 2.12: Kursimet Bruto tek vendet në Tranzicion të Evropës Lindore(Në % të PBB-së)	34
Figura 2.13: Bilanci i Llogarisë Korente tek vendet në Tranzicion të Evropës Lindore	35
Figura 2.14: Shpenzimet Qeveritare tek vendet në Tranzicion të Evropës Lindore (Në % të PBB-së)	36
Figura 2.15: Parashikimet e rritjes ekonomike, 2017-2020 (I shprehur në përqindje)	42
Figura 2.16: Ballkani Perëndimor , 2017-2020 (I shprehur në përqindje).....	43
Figura 2.17: Rritja vjetore e Produktit te Brendshëm Bruto për vendet e Ballkanit Perëndimor (e shprehur në përqindje).....	44
Figura 2.18: Produkti Brendshëm Bruto për koke banori për vendet e Ballkanit Perëndimor.	45
Figura 2.19: Eksporti tek vendet e Ballkanit Perëndimor (Në % të PBB-së).....	46

Figura 2.20: Shpenzimet e Konsumit Final tek vendet e Ballkanit Perëndimor (Në % të PBB-së)	47
Figura 2.21: Kursimet Bruto Final tek vendet e Ballkanit Perëndimor (Në % të PBB-së)	48
Figura 2. 22: Bilanci i Llogarisë Korente tek vendet e Ballkanit Perëndimor (Në % të PBB-së)	48
Figura 2.23: Shpenzimet Qeveritare në vendet e Ballkanit Perëndimor (Në % të PBB-së) .	49
Figura 2.24: Borxhi Publik (i shprehur ne përqindje të PBB-së) i Estonisë 1995-2017	51
Figura 2.25: Borxhi Publik (i shprehur ne përqindje të PBB-së) i Lituanisë 1995-2017	51
Figura 2.26: Borxhi Publik (i shprehur ne përqindje të PBB-së) i Letonisë 1995-2017	52
Figura 2.27: Borxhi Publik (i shprehur ne përqindje të PBB-së) i Sllovenisë 1995-2017 ...	52
Figura 2.28: Borxhi Publik (i shprehur ne përqindje të PBB-së) i Çekisë 1995-2017	53
Figura 2.29: Borxhi Publik (i shprehur ne përqindje të PBB-së) i Polonisë 1995-2017	53
Figura 2.30: Borxhi Publik (i shprehur ne përqindje të PBB-së) i Kroacisë 1995-2017	54
Figura 2.31: Borxhi Publik (i shprehur ne përqindje të PBB-së) i Bullgarisë 1995-20	56
Figura 2.32: Borxhi Publik (i shprehur ne përqindje të PBB-së) i Bjellorusisë 1995-2017.	57
Figura 2. 33: Borxhi Publik (i shprehur ne përqindje të PBB-së) i Hungarisë 1995-2017 ...	57
Figura 2.34: Borxhi Publik (i shprehur ne përqindje të PBB-së) i Moldavisë 1995-2017	58
Figura 2.35: Borxhi Publik (i shprehur ne përqindje të PBB-së) e Rumanisë 1995-2017	59
Figura 2.36: Borxhi Publik (i shprehur ne përqindje të PBB-së) i Sllovakisë 1995-2017	59
Figura 2.37: Borxhi Publik (i shprehur ne përqindje të PBB-së) i Ukrainës 1995-2017	60
Figura 2.38: Borxhi Publik (i shprehur ne përqindje të PBB-së) i Shqipërisë 1995-2017	62
Figura 2.39: Borxhi Publik (i shprehur ne përqindje të PBB-së) i Bosnjës dhe Hercegovinës 1995-2017	62
Figura 2.40: Borxhi Publik (i shprehur ne përqindje të PBB-së) i Maqedonisë 1995-2017 ...	63
Figura 2.41: Borxhi Publik (i shprehur ne përqindje të PBB-së) i Serbisë 1995-2017	64
Figura 2.42: Borxhi Publik (i shprehur ne përqindje të PBB-së) i Malit të Zi 1995-2017	64
Figura 2.43: Borxhi Publik (i shprehur ne përqindje të PBB-së) i Kosovës 1995-2017	65
Figura 2.44: Stoku i Borxhit Publik në Kosovë të shprehura në Milion 2010 – Qershor 2013	67
Figura 2.45: Portofoli i Borxhit Publik në Kosovë 2010 – Qershor 2013	67
Figura 2.46: Portofoli i Borxhit të Jashtëm i ndarë sipas valutës në Kosovë 2010 – Qershor 2013	68
Figura 2.47: Portofoli i Borxhit të Jashtëm i ndarë sipas llojit të interesit në Kosovë 2010 – Qershor 2013	68
Figura 2.48: Trendi i Borxhit të Përgjithshëm në Kosovë i shprehur në Milion (2013-2018).	71

Figura 2.49:Trendi i Borxhit të Përgjithshëm në Kosovë i shprehur në Përqindje (2013-2018)	72
Figura 2.50:Raporti i Borxhit të Përgjithshëm në Kosovë (Borxhi Ndërkombëtar dhe Borxhi i Brendshëm) i shprehur në Milion(2013-2018)	72
Figura 2.51:Nën-Huazimet nga Borxhi i Jashtëm, të shprehura në Milion (2013-2018)	73
Figura 2.52:Portofoli i Borxhit sipas valutës në Kosovë(Borxhi i Përgjithshëm, EUR,SDR), të shprehura në Milion (2013-2018)	74
Figura 2.53:Portofoli I Borxhit sipas Valutës në Kosovë (Borxhi I Ndërkombëtar,EUR,SDR), të shprehura në Milion (2013-2018)	75
Figura 2.54:Portofoli I Borxhit sipas Valutës në Kosovë (Borxhi I Ndërkombëtar,EUR,SDR), të shprehura në Milion (2013-2018)	75
Figura 2.55:Portofoli I Borxhit sipas Interesit (i Përgjithshëm, Fiks,dhe Variabil) në Kosovë, të shprehura në Milion (2013-2018)	76
Figura 2.56:Portofoli I Borxhit sipas Interesit (Borxhi Ndërkombëtar, Fiks,dhe Variabil) në Kosovë, të shprehura në Milion (2013-2018)	77
Figura 2.57:Portofoli I Borxhit sipas Interesit (Borxhi I Brendshëm, Fiks,dhe Variabil) në Kosovë, të shprehura në Milion (2013-2018)	78
Figura 2.58:Stoku i Borxhit Ndërkombëtar në Kosovë (2013-2018), i shprehur në Milion...	79
Figura 2.59:Borxhi Ndërkombëtar i shprehur si përqindje e PBB-së (2013-2018)	80
Figura 2.60:Borxhi Ndërkombëtar sipas Kreditorëve në Kosovë (2013-2018), i shprehur në Milion	81
Figura 2.61:Emetimet e Reja në Kosovë (2013-2018), të shprehur në Milion	82
Figura 2.62:Stoku i Borxhit në Kosovë (2013-2018), të shprehur në Milion	83
Figura 2.63:Borxhi i Brendshëm në Kosovë (% E BPV-Së) (2013-2018), të shprehur në Milion	83
Figura 2.64.Krahasimi i Borxhit Publik të Brendshëm dhe Ndërkombëtar për vitin 2016 dhe 2017 në Kosovë	86
Figura 2.65:Tërheqjet sipas kreditorëve në Kosovë	87
Figura 2.66:Garancitë Shtetërore (% e BPV-së) 2014-2018	91
Figura 2.67:Garancitë Shtetërore 2014-2018	91
Figura 2.68:Garancitë Shtetërore 2014-2018	92
Figura 2.69: Borxhi Publik (i shprehur ne përqindje të PBB-së) tek vendet në tranzicion të Evropës Qendrore 1995-2017	95

Figura 2.70: Borxhi Publik (i shprehur ne përqindje të PBB-së) tek vendet në tranzicion të Evropës Lindore 1995-2017	95
Figura 2.71: Borxhi Publik (i shprehur ne përqindje të PBB-së) tek vendet në tranzicion të Ballkanit Perëndimor 1995-2017	96

LISTA E TABELAVE

Tabela 2.1: Parashikimet e rritjes ekonomike, 2017-2020	41
Tabela 2.2: Borxhi Publik tek vendet ne Tranzicion te Evropës Qendrore (i shprehur ne milion)	50
Tabela 2.3: Borxhi Publik tek vendet ne Tranzicion te Evropës Lindore (i shprehur ne milion)	55
Tabela 2.4: Borxhi Publik tek vendet ne Tranzicion te Ballkanit Perëndimor (I shprehur ne milion)	61
Tabela 2.5:Të dhënat për Borxhin Publik në Kosovë të shprehura në Milion (2010-2013)...	66
Tabela 2.6:Portofoli i Borxhit të Përgjithshëm në Kosovë të shprehura në Milion (2013-2018)	70
Tabela 2.7:Portofoli i Borxhit sipas Valutës në Kosovë, të shprehura në Milion (2013-2018)	73
Tabela 2.8:Portofoli i Borxhit sipas Interesit në Kosovë, të shprehura në Milion (2013-2018)	76
Tabela 2.9:Stoku I Borxhit Ndërkombëtar në Kosovë (2013-2018), i shprehur në Milion	79
Tabela 2.10:Borxhi Ndërkombëtar sipas Kreditorëve në Kosovë (2013-2018), i shprehur në Milion	80
Tabela 2.11:Stoku i Borxhit të Brendshëm në Kosovë (2013-2018), i shprehur në Milion ...	82
Tabela 2.12:Krahasimi i indikatorëve të Borxhit Publik për vitin 2016 dhe 2017 në Kosovë	84
Tabela 2.13:Tërheqjet sipas kreditorëve në Kosovë	87
Tabela 2.14:Shërbimi i Borxhit Ndërkombëtar sipas kreditorëve	88
Tabela 2.15:Marrëveshjet Financiare Ndërkombëtare efektive në TM1 2018.....	89
Tabela 2.16:Stoku i borxhit ndërkombëtar dhe borxhi i zotuar i pa-disbursuar.....	89
Tabela 2.17:Garancitë Shtetërore 2014-2018	90
Tabela 2.18:Indikatorët e Rrezikut	93

Tabela 5. 1:Përshkrimi statistikor i variablave ekzogjene dhe endogjene në vendet e Evropës Qendrore	179
Tabela 5. 2:Rezultatet nga analiza e regresionit në vendet e Evropës Qendrore.....	179
Tabela 5. 3:Përshkrimi statistikor i variablave ekzogjene dhe endogjene në vendet e Evropës Lindore	183
Tabela 5. 4:Rezultatet nga analiza e regresionit në vendet e Evropës Lindore	183
Tabela 5. 5:Përshkrimi statistikor i variablave ekzogjene dhe endogjene në vendet e Ballkanit Perëndimor	187
Tabela 5. 6:Rezultatet nga analiza e regresionit në vendet e Ballkanit Perëndimor.....	187
Tabela 5. 7:Përcaktimi i pikës kthye (Turning Point) tek vendet në tranzicion të Evropës Qendrore	191
Tabela 5. 8:Përcaktimi i pikës kthye (Turning Point) tek vendet në tranzicion të Evropës Lindore	192
Tabela 5. 9:Përcaktimi i pikës kthye (Turning Point) tek vendet në tranzicion të Ballkanit Perëndimor	194

1. HYRJE

Debate dhe opinione të shumta ndërmjet autorëve të qasjes neoklasike, si dhe modeleve të rritjes endogjene kanë ndikuar në nxitjen e teorisë së rritjes ekonomike. Trajtimi studimor i tezës së Doktoratës më titull “*NDIKIMI I BORXHIT PUBLIK NË RITJEN EKONOMIKE NË VENDET EVROPIANE NË TRANZICION*”, paraqet interes të veçantë teorik dhe praktik. Së pari, studimi do të ofrojë një analizë për borxhin publik dhe karakteristikat e tij. Së dyti, studimi do të ofrojë evidencë empirike se si ndikon rritja eventuale e borxhit publik në rritjen ekonomike në vendet Evropiane që janë në tranzicion. Qëllimi kryesor i këtij studimi është të analizojë rritjen ekonomike të këtyre vendeve, me konkretisht të sqarojë lidhjen në mes të borxhit publik dhe rritjes ekonomike. Përmes këtij trajtimi shkencor do të mundohem që të paraqes dhe të identifikojë prapun (threshold), ose më mirë të themi kufirin optimal se deri në cilën shkallë të rritjes borxhi publik do të ketë impakt pozitiv në rritjen ekonomike të vendeve evropiane që janë në tranzicion, si dhe të caktojë prapun ku mbi të cilin rritja e borxhit publik do të afektojë negativisht në rritjen ekonomike.

Çka është shumë me rëndësi që duhet të potencohet gjatë këtij studimi është dallimi në mes të vendeve në tranzicion të evropës, sepse pragu i ndikimit të borxhit publik ndryshon, do të thotë tek vendet në tranzicion të Evropës Qendrore, pragu ose kufiri i rritjes së borxhit publik është shumë më i lartë se sa tek vendet tjera në tranzicion të Evropës, si p.sh vendet e Evropës Lindore ose ato të Ballkanit Perëndimor. Ekzaminimi dhe vlerësimi im do të hedhë njohuri mbi problemin aktual të borxhit duke identifikuar lidhjet e mundshme në mes të kufirit të borxhit publik dhe rritjes ekonomike të këtyre vendeve. Arsyshmëria e këtij studimi është sepse përmes tij do të sqarohet pragu i rritjes së borxhit publik, dhe identifikimi i pikës kthyes (turning point) që nënkupton se deri në cilin kufi borxhi publik do të jap efekt pozitiv, ose në të kundërtën do të afektojë negativisht në rritjen ekonomike të vendeve evropiane në tranzicion. Marrëdhëniet midis borxhit publik dhe rritjes ekonomike janë bërë temë shumë e rëndësishme në mesin e shumë kërkuesve shkencor, të cilët kanë studiuar se si ndikon rritja eventuale e borxhit publik tek vendet në përgjithësi. Trajtimi i borxhit publik është në fokusin kryesor në mesin e shumë autorëve, me theks të veçantë pas krizës financiare të viteve 2008-2009.

Sipas të dhënave dhe teorive të shumta që kemi vëzhguar dhe studiuar shohim se borxhi publik mund të ketë dimensione të ndryshme në raport me rritjen ekonomike tek vendet në tranzicion. Shume qasje dhe shkolla e potencojnë se rritja e borxhit publik mund të ndikojë negativisht në rritjen ekonomike të vendeve në tranzicion, sepse mund të krijojë një çrregullim makroekonomik me pasoja të cilat e pamundësojnë në një formë ose formën tjetër rritjen ekonomike. Duke ju referuar teorisë klasike mbi përdorimin e borxhit publik shohim se shteti nuk posedon ndonjë rol të caktuar mbi ekonominë. Këta ekonomistë kanë mendime se funksionet e shtetit duhet të minimizoheshin, dhe qeveria duhej vetëm të ruante ligjin dhe rendin e brendshëm, si dhe mbrojtjen nga agresioni i jashtëm. Me konkretisht shteti nuk ka nevojë të ndërhyj në ekonomi, mirëpo vetëm të plotësoj kushtet e duhura për zhvillimin ekonomik, si dhe të përcaktojë bazën ligjore.

Ata kishin më shumë besim në individualizmin, dhe mendonin se interesi individual çon në rritjen e interesit të përgjithshëm. Gjithashtu disa përfaqësues të kësaj qasje ekonomike e cilësonin borxhin publik si një nga burimet më të tmerrshme që u krijua, dhe i cili ndikon drejtpërdrejtë për të goditur një komb, do të thotë rritja e borxhit publik ndikon negativisht në sistemin ekonomik. Gjithashtu edhe nga studimet empirike të bëra shohim se vendet në tranzicion nuk kanë një stabilitet të plotë dhe qëndrueshmëri ekonomike, prandaj rritja e borxhit publik mund të afektojë negativisht në rritjen ekonomike, sidomos nëse vazhdon rritja e borxhit publik edhe në periudhat afat-gjata. Debati i shkollës klasike është kritikuar kryesisht për dy arsye. Së pari çdo shpenzim i qeverisë nuk është gjithmonë jo-produktiv, si dhe huamarrja publike (borxhi publik) nuk mund të jetë gjithmonë barrë e ekonomisë.

Në anën tjetër kemi shume teori dhe studime të caktuara të cilat i japin një rëndësi të lartë nivelit të përdorimit të borxhit publik, si dhe ndikimit të tij në rritjen ekonomike. Duke e cilësuar që jo çdo here borxhi publik mund të ndikojë negativisht në rritjen ekonomike. Teoria keynesiane thekson se konsiderata tradicionale se buxheti i pa balancuar me shpenzime të larta, si dhe rritja e shpejtë e borxhit publik mund të afektojë negativisht në stabilitetin ekonomik të vendeve ka filluar gradualisht të bie si teori. Duke i hapur rrugë një koncepti të ri ekonomik që potencon se borxhi i lartë publik është një aset kombëtar, dhe nuk mund të cilësohet si detyrim. Duke ju referuar kësaj qasje ekonomike vërejmë se niveli i ulët i borxhit publik mund të çojë në rritjen ekonomike, por negativisht mund të ndikojë niveli i lartë i borxhit publik mbi rritjen ekonomike.

Një nder arsyt kryesore e cila me ka nxitur dhe motivuar në të njëjtën kohë të trajtojë ndikimin e borxhit publik mbi rritjen ekonomike ka qenë definimi i pragut optimal të përdorimit të borxhit publik tek vendet në tranzicion të Evropës, duke filluar nga vendet e Evropës Qendrore, Evropës Lindore, si dhe vendet e Ballkanit Perëndimor. Me konkretisht për të përcaktuar kufirin e borxhit publik në raport me PBB-në, qe tregon deri në cilën masë vendet mund të shfrytëzojnë borxhin publik dhe prape të kenë rritje ekonomike. Sepse edhe me lartë vumë re shumë debate dhe teori të cilat kundërshtojnë njëra tjetrën në raport me përdorimin e borxhit publik, mirëpo asnjëra nuk na jap fakte shkencore se cili mund të jetë kufiri optimal i përdorimit të borxhit publik. Përfundimisht disa vendeve të cilat e kanë të rregulluar me ligje çështjen e ngarkesës së borxhit publik në raport me PBB-në.

Ose nëse i referohemi traktatit të maastrichtit i cili potencon se vendet e unionit evropian nuk mund të kenë ngarkese me të lartë të borxhit publik se sa 60% e PBB-së, ku edhe pse një qeshtje e tillë nuk është respektuar fare, sepse nëse i analizojmë të dhënat nga raportet e bankës botërore për vendet e UE-së shohim se shumica e këtyre vendeve e kanë tejkaluar disa herë kufizimin prej 60% të borxhit publik në raport me PBB-në. Të dhënat nga e kaluara tregojnë se as kufizimet e aplikuara, e as ato të zbatuara formale për shpenzimet publike nuk kanë pasur sukses. Shumë shembuj në kohë të ndryshme dhe në shtete të ndryshme, tregojnë se gjenerata e tanishme nuk është e gatshme ta lëshojë rastin që ta ngarkojë gjeneratën e ardhshme.

Gjithashtu një çështje tjetër mjaft e rëndësishme e këtij studimi i cili trajton ndikimin e borxhit publik në rritjen ekonomike të vendeve në tranzicion të Evropës është ndikimi shkencor i cili e bënë mjaft atraktiv dhe interesant këtë tezë për tu lexuar. Sepse përmes këtij studimi ne do të përcaktojmë saktësisht pragu e borxhit publik duke filluar prej vendeve në tranzicion të Evropës Qendrore, vendeve në tranzicion të Evropës Lindore, si dhe vendeve në tranzicion të Ballkanit Perëndimor. Çka nënkupton se deri në cilin kufi këto vende mund të shfrytëzojnë borxhin publik dhe prape të kenë rritje ekonomike, si dhe definimin e pikës kthyesë që ndryshe njihet si “ turning point” ku tejkalimi i mundshëm i kësaj pike mund të ndikojë negativisht në rritjen ekonomike të vendeve në tranzicion të Evropës. Ku edhe sipas studimeve empirike shohim se shumë studiues e kanë përcaktuar pragu e borxhit publik si p.sh Mencinger, Aristovnik, Verbic (2015) të cilët definojnë se pragu optimal i përdorimit të borxhit publik tek vendet e zhvilluara sillet prej 90% deri në 94%, ndërsa tek vendet në zhvillim është 44% deri në 45%.

Gjithashtu Checherita dhe Rother (2010) përcaktuan pragun e borxhit publik prej 90% deri në 100% të PBB-së. Reinhart dhe Rogoff (2010) krijuan një debat të madh kur botuan gjetje që tregonin se rritja e raportit të borxhit publik mbi 90% të PBB-së mund të ndikojë negativisht në rritjen ekonomike. Përdorimi efikas dhe efektiv i borxhit publik mund të ndikojë drejtpërdrejtë në nxitjen ekonomike të një vendi, duke mbështetur projektet kapitale publike të cilat mund të jenë në fusha dhe dikastere të ndryshme si : turizëm, arsim, shëndetësi, infrastrukturë e tjera. Duke u nisur nga këto dëshmi që borxhi publik mund të afektojë në rritjen ekonomike është e nevojshme menaxhimi sa më adekuat i tij. Nëse vendet dhe qeveritë e tyre kanë mundësi ta administrojnë borxhin publik, mund të posedojnë një indikator mjaft të fuqishëm të nxitjes dhe zhvillimit ekonomik (Checetti, 2011, Nautet, 2011).

Duke ju referuar publikimeve të shumë institucioneve në lidhje me përdorimin e borxhit publik të tilla si FMN, potencohet se nuk është e rëndësishme vetëm përcaktimi i nivelit të borxhit publik (pragut optimal), sepse shumë vende sipas të dhënave shohim që e shfrytëzojnë në nivele të larta dhe prap prosperojnë zhvillim ekonomik të tilla si (Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vendet e Evropës Qendrore). Mirëpo kemi disa nga vendet të cilat ende janë në zhvillim e sipër dhe përdorimi i lartë i borxhit publik mund të shkaktojë çrregullim ekonomik dhe deficit fiskal.

Qeveritë gjithmonë kanë tendencë të marrin më shumë borxh, sepse përmes kësaj forme mundohet të ndikohet gjatë periudhave të zgjedhjeve, me konkretisht të fitohet besimi i votuesve. Prandaj investitorët zakonisht matin nivelin e rrezikut duke krahasuar borxhin me prodhimin e përgjithshëm ekonomik të një vendi, të njohur si Bruto Produkti i Brendshëm. Raporti i borxhit ndaj PBB-së jep një tregues të saktë se sa ka gjasa vendi të paguajë borxhin e saj. Investitorët e huaj zakonisht nuk shqetësohen deri sa raporti i borxhit ndaj PBB-së të arrijë në nivel ose pikë kritike (pragu optimal), momentin që duket se borxhi po i afrohet nivelit kritik, investitorët zakonisht fillojnë të kërkojnë një normë më të lartë të interesit. Ata duan kthim më të madh për rrezikun më të lartë. Ku me konkretisht gjatë këtij studimi do të definohet saktësisht niveli i pragut optimal të raportit të borxhit publik në vendet Evropës Qendrore, Lindore, si dhe vendet e Ballkanit Perëndimor.

1.1.Objektivat Kryesore të Hulumtimit

Duke qenë kështu, punimi në fjalë mundohet të skanojë gjendjen, të analizoj dhe të jap përfundime dhe rekomandime. Si objektiva kryesore të punimit janë si në vijim:

- Të identifikojë strukturën e përgjithshme të Borxhit Publik në vendet të cilat janë pjesë e Trajtimit Shkencor ;
- Të jap një pasqyrë të shkurtër në lidhje me vendet të cilat janë në Tranzicion të Evropës Qendrore, Evropës Lindore, si dhe vendet e Ballkanit Perëndimor
- Të trajtojë ndikimin e Borxhit Publik në Rritjen Ekonomike në vendet Evropiane në Tranzicion ;
- Të caktojë prapun ose kufirin e rritjes së Borxhit Publik mbi të cilin efekti i tij do të jetë negativ tek vendet në Tranzicion të Evropës Qendrore;
- Të caktojë prapun ose kufirin e rritjes së Borxhit Publik mbi të cilin efekti i tij do të jetë negativ tek vendet në Tranzicion të Evropës Lindore;
- Të caktojë prapun ose kufirin e rritjes së Borxhit Publik mbi të cilin efekti i tij do të jetë negativ tek vendet në Tranzicion të Ballkanit Perëndimor.

1.2.Pyetjet Kërkimore

Duke u bazuar në thelbin e temës e cila trajtohet në këtë punim, dhe ajo çfarë është thënë në përkufizimin e problemit, disa pyetje mund të ndihmojnë realizimin dhe të kuptuarit më mirë të punimit të tezës së Doktoratës.

Për sa i përket temës së propozuar me titull “NDIKIMI I BORXHIT PUBLIK NË RRITJEN EKONOMIKE NË VENDET EVROPIANE NË TRANZICION”, mund të themi se është një temë mjaft e gjerë e cila në vete ngërthen një mori të pyetjeve kërkimore që duhet t'u jepet përgjigje në këtë studim. Sepse janë shumë grupe të interesit të cilat kanë nevojë për informata të hollësishme në lidhje me Borxhin Publik.

Ata të cilët menaxhojnë me institucionet qeveritare kanë nevojë të kenë informata shtesë se si do të ndikon rritja eventuale e Borxhit Publik në Rritjen Ekonomike. Në vijim do të paraqes pyetjet hulumtuese të tezës së Doktoratës:

1. Si ndikon Rritja e Borxhit Publik mbi pragun 75% deri më 85% tek vendet në Tranzicion të Evropës Qendrore ?
2. Si ndikon Rritja e Borxhit Publik mbi pragun 65% deri më 75% tek vendet në Tranzicion të Evropës Lindore ?
3. Si ndikon Rritja e Borxhit Publik mbi pragun 55% deri më 65% tek vendet në Tranzicion të Ballkanit Perëndimor ?
4. A mund të ndikojë Borxhi Publik në rritjen ekonomike të vendeve në Tranzicion të Evropës përmes Investimeve Publike ?

Pyetjeve hulumtuese do t'ju japim përgjigje nëpërmjet hipotezave duke përdorur metodat dhe teknikat e sofistikuara ekonometrike. Me konkretisht përmes modeleve ekonometrike të tilla si: metoda e katrorëve të vegjël që ndryshe njihet si OLS, Fixed Effect, Random Effect, GMM, si dhe qasjet threshold ku do të bëhet i mundur përcaktimi dhe definimi i pragut optimal të borxhit publik tek vendet në tranzicion të Evropës. Me qëllim që t'ju jap përgjigje pyetjeve hulumtuese më poshtë kam parashtruar disa Konstatime dhe Hipoteza të cilat do të vërtetohen pastaj tek pjesa empirike përmes modeleve dhe metodave që i potencova me lartë. Gjatë hartimit të këtij punimi do të përdori një metodologji gjithëpërfshirëse, duke zbatuar metoda të ndryshme kërkimore-shkencore, të cilat janë realizuar kryesisht nëpërmjet leximit të literaturës, vëzhgimit, dhe mendimit kritik nga ku informacionet janë zgjedhur sipas vlefshmërisë së tyre nga autorë të ndryshëm të huaj dhe vendor.

1.3.Hipotezat e Hulumtimit

Me qëllim që t'ju jap përgjigje pyetjeve hulumtuese janë parashtruar hipotezat si në vijim.

Në këtë punim doktrate do të parashtrojmë këto hipoteza:

HIPOTEZA 1: Rritja e Borxhit Publik në vendet e Evropës Qendrore mbi pragun 75% deri në 85% ndikon negativisht në rritjen ekonomike në raport me PBB-në.

HIPOTEZA 2: Rritja e Borxhit Publik në vendet e Evropës Lindore mbi pragun 65% deri në 75% ndikon negativisht në rritjen ekonomike në raport me PBB-në.

HIPOTEZA 3: Rritja e Borxhit Publik në vendet e Ballkanit Perëndimor mbi pragun 55% deri në 65% ndikon negativisht në rritjen ekonomike në raport me PBB-në.

HIPOTEZA 4: Borxhi Publik ka gjasa të ndikon pozitivisht në rritjen ekonomike përmes Investimeve Publike në raport me PBB-në.

1.4.Metodologjia per konfirmimin e Hipotezave

Për të realizuar me sukses disertacionin e Doktoratës, si dhe për ti mbështetur hipotezat e vendosura me lartë do të përdori një metodologji gjithëpërfshirëse, duke zbatuar metoda të ndryshme kërkimore-shkencore, të cilat janë realizuar kryesisht nëpërmjet leximit të literaturës, vëzhgimit, dhe mendimit kritik nga ku informacionet janë zgjedhur sipas vlefshmërisë së tyre nga autorë të ndryshëm të huaj dhe vendor, si dhe subjekteve tjera që janë pjesë e kërkimit, apo kanë qenë të kyçur në situata nga të cilat është synuar të nxirren përfundime, si dhe të arrihet deri te zgjidhja e problemit. Disa nga metodat kryesore të cilat do të përdoren gjatë punimit janë: metoda narrative, metoda krahasuese, si dhe metoda ekonometrike. Metoda narrative na mundëson analiza të ndryshme të treguesve të ndryshëm dhe duke bërë sintetizimin e rezultateve dhe dhënies së përgjigjeve të hulumtimit shkencor. Me shfrytëzimin e metodës narrative do të fitohet njohuri për gjendjet, raportet dhe dinamikën e ndryshimeve që e determinojnë problematikën që është objekt studimi.

Metoda narrative do të na ndihmojë që të zbulojmë komponentët përbërëse të dukurive të studiuara, pastaj do të vërtetohen raportet kuantitative dhe do të shihet ndikimi i tyre në tërësi. Metoda krahasuese është një ndër metodat që më së shumti përdoret gjatë analizave të treguesve të ndryshëm makroekonomik në periudha të ndryshme. Rezultate më të sakta do të arrijmë nëse krahasohen treguesit financiar të një periudhe, të shteteve apo entiteteve, në periudha të ndryshme kohore me qëllim që ti gjejmë shkaqet dhe arsyet e devijime dhe shmangie të të dhënave të prezantuara.

Ndërsa metodën ekonometrike do të përdori për qëllime empirike, me konkretisht nëpërmjet metodës ekonometrike do të bëjë testimin e të dhënave në modelin ekonometrik, si dhe do të ju jap përgjigje të gjitha konstatimeve të vendosura në këtë punim. Ekonometria është aplikimi i metodave statistikore në të dhënat ekonomike për të dhënë përmbajtje empirike në marrëdhëniet ekonomike. Metodatat ekonometrike përdorin ekonometrinë teorike dhe të dhënat e botës reale për vlerësimin e teorive ekonomike, zhvillimin e modeleve ekonometrike, analizimin e historisë ekonomike dhe parashikimin e tyre. Krahas metodës ekonometrike do të përdori disa nga teknikat me të përdorura të tilla si : OLS, Pooled OLS, Metodatat Fixed dhe Random Effect, Vlerësuesi i Husman-Taylor, si dhe metoda GMM.

1.5.Kufizimet e Hulumtimit

Si çdo studim tjetër shkencor, edhe ky studimka disa kufizime të caktuara. Objekt i studimit në këtë punim është analizimi i ndikimit të borxhit publik në rritjen ekonomike të vendeve evropiane në tranzicion. Duke ju referuar këtyre parametrave për disa nga vendet e evropiane në tranzicion shohim që nuk ka edhe shumë të dhëna për indikatorët makroekonomik, si p.sh tek vendet e Ballkanit Perëndimor.

Gjatë testimit të të dhënave në modelin ekonometrik, nuk kam pasur mundësi të inkuadroje të gjitha variablat të cilat lidhen me borxhin publik dhe rritjen ekonomike, të tilla si: investimet publike, investimet e huaja direkte, normat e interesit, si dhe instrumentet e politikës fiskale. Andaj i sugjeroje autorët e tjerë që kjo pjesë shkencore të mbështetet edhe me hulumtime tjera paraprake të cilat kanë në fokus ndikimin e borxhit publik në rritjen ekonomike të vendeve evropiane në tranzicion, si dhe përcaktimin e pragut optimal.

1.6.Organizimi i Studimit

Në **Kapitullin e Parë** të këtij studimi do bëjë një vlerësim të përgjithshëm, dhe mbi gjitha hyrës mbi borxhin publik dhe rritjen ekonomike. Teza e këtij studimi e cila trajton ndikimin e borxhit publik në rritjen ekonomike në vendet evropiane në tranzicion do të paraqet një rëndësi të veçantë si në aspektin praktik, po ashtu edhe në atë teorik. Çka është shumë më rëndësi që duhet të potencohet gjatë këtij kapitulli është dallimi në mes të vendeve në tranzicion të Evropës, sepse pragu i ndikimit të borxhit publik ndryshon. Ku më konkretisht tek vendet në tranzicion të Evropës Qendrore, pragu ose kufiri i rritjes së borxhit publik është shumë më i lartë se sa tek vendet tjera në tranzicion të Evropës, si p.sh vendet e Evropës Lindore ose ato të Ballkanit Perëndimor. Ekzaminimi dhe vlerësimi gjatë këtij kapitulli do të hedhë njohuri mbi problemin aktual të borxhit duke identifikuar lidhjet e mundshme në mes të raportit të borxhit publik dhe rritjes ekonomike të këtyre vendeve.

Në **Kapitullin e Dytë** të disertacionit të doktoratës do punojmë strukturën e borxhit publik në vendet evropiane në tranzicion. Ku fillimisht do të shqyrtojmë një pasqyrë makroekonomike të vendeve evropiane në tranzicion ekonomik, duke filluar nga vendet në tranzicion të Evropës Qendrore, Evropës Lindore, si dhe atyre të Ballkanit Perëndimor. Tek ky raport do të mundohem ti paraqes nëpërmjet figurave dhe grafikëve disa nga parametrat kryesor të studimit të tilla si : produkti i brendshëm bruto, eksporti, shpenzimet e konsumit, kursimet bruto, bilanci i llogarisë aktuale, si dhe shpenzimet qeveritare. Tek vendet e Evropës Qendrore, duke ju referuar të dhënave të prezantuara nga (Figura 2.1) do shohim lëvizjen e trendit të lakores së produktit të brendshëm bruto i shprehur në përqindje nga viti 1995 deri në vitin 2017 për vendet e Evropës Qendrore në tranzicion. Gjithashtu edhe tek vendet në tranzicion të Evropës Lindore mund të shohim rezultate të ndryshme në raport me vendet e tjera për sa i përket PBB-së për koke banori. Më konkretisht nëpërmjet Figurës. 8 shohim një shumëllojshmëri të rezultateve, rritja e PBB-së tek vendet e Evropës Lindore ka qenë e ndryshme nga vendi në vend. Rritje me të theksuar kanë shënuar Bjellorusia, Ukraina, Sllovakia, si dhe Moldavia.

Në (Figurën 2.17) do të paraqitet produkti i brendshëm bruto i shprehur në përqindje tek vendet e Ballkanit Perëndimor. Sipas rezultateve të paraqitura nga ky grafikon shohim se përqindja e PBB-së tek vendet e Ballkanit Perëndimor ka qenë mjaft e ndryshueshme gjatë periudhës 1995-2017. Gjithashtu në kapitullin e dytë të disertacionit të doktoratës do të paraqesim strukturën e borxhit publik në vendet në tranzicion të Evropës (Evropës Qendrore, Lindore, si dhe vendet e Ballkanit Perëndimor). Të gjitha rezultatet do të vendosen në tabela dhe grafikona, të shprehura në vlera monetare dhe në përqindje për të gjitha vendet me radhe. Ku në Tabelën 2.2 do të pasqyrohet struktura e borxhit publik tek vendet në tranzicion të Evropës Qendrore i shprehur në vlera monetare, në Tabelën 2.3 do të vërejmë strukturën e borxhit publik tek vendet në tranzicion të Evropës Lindore, si dhe në Tabelën 2.4 do të vendosen të dhënat në lidhje me strukturën e borxhit publik tek vendet e Ballkanit Perëndimor. Gjithashtu tek ky kapitull në mënyrë të veçantë do të paraqesim edhe strukturën e borxhit publik për Kosovën, duke u bazuar kryesisht nga të dhënat e Bankës Qendrore, si dhe Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës. Këtu do të trajtojmë borxhin publik të Kosovës 2010-2018, karakteristikat e portofolit të borxhit shtetëror të Kosovës 2016-2017, borxhi ndërkombëtar të Kosovës, garancitë shtetërore në Kosovë, si dhe indikatorët e rrezikut.

Në **Kapitullin e Tretë** të shtjellojmë rishikimin e literaturës, në aspektin teorik si dhe në atë empirik nëpërmjet studimeve me kredibilitet të lartë shkencor, duke filluar nga hulumtimet të cilat trajtojnë ndikimin e borxhit publik në rritjen ekonomike të vendeve të zhvilluara, si dhe ato tek vendet në zhvillim e sipër. Për çdo studim dhe hulumtim shkencor është i domosdoshëm rishikimi i literaturës, sepse përmes rishikimit bëhet i mundur një vështrim i përgjithshëm mes informatave të cilat i posedojmë dhe i atyre që nuk i njohim. Gjithashtu rishikimi na ndihmon të krijojmë një pasqyrë të caktuar se si duhet të zhvillohet dhe organizohet studimi duke u bazuar tek metodat, mënyrat e organizimit, gjetjet, kontributet shkencore e tjera. Mirëpo gjatë analizimit të literaturës empirike në lidhjen me borxhin publik dhe rritjen ekonomike kam vërejtur një mungesë mjaft të madhe të provave empirike për të hetuar, dhe konfirmuar disa nga konstatimet dhe gjetjet empirike tek vendet në tranzicion të Evropës. Tek rishikimi i literaturës fillimisht do të vlerësojmë qasjen teorike, duke filluar nga teoria klasike, teoria neo-klasike, si dhe teoria moderne mbi borxhin publik. Pastaj me një vështrim mjaft kritik dhe shkencor do të analizohet evidenca empirike e borxhit publik tek vendet e zhvilluara, si dhe evidenca empirike e borxhit publik tek vendet në zhvillim, ose më mirë të themi në tranzicion.

Në **Kapitullin e Katërt** të këtij studimi do të shtjellojmë metodologjinë e përdorur. Për të realizuar këtë hulumtim shkencor, si dhe për ti mbështetur konstatimet të cilat janë ngritur në fillim do të përdori metoda dhe modele të avancuara shkencore. Gjatë hartimit të këtij punimi do të përdorim një metodologji gjithëpërfshirëse, duke zbatuar metoda të ndryshme kërkimore-shkencore, të cilat janë realizuar kryesisht nëpërmjet leximit të literaturës, vëzhgimit, dhe mendimit kritik nga ku informacionet janë zgjedhur sipas vlefshmërisë së tyre. nga autorë të ndryshëm të huaj dhe vendor.

Si dhe subjekteve tjera që janë pjesë e kërkimit, apo kanë qenë të kyçur në situata nga të cilat është synuar të nxirren përfundime, si dhe të arrihet deri te zgjidhja e problemit. Me konkretisht për testimin e hipotezave do te përdorim metodat ekonometrike të tilla si : OLS, Fixed Effects, Random Effects, Hausman-Taylor, GMM, ndërsa përcaktimi i pragut të borxhit publik do të bëhet duke u bazuar në qasjen “threshold”, e cila përpunon të dhënat përmes metodës “bootstrapping”. Pra intervalet e besimit (CI) të pikës së kthimit të borxhit gjenerohen përmes “bootstrapping” bazuar në një shpërndarje normale, që ndryshe njihet si “threshold”, ku me konkretisht në këtë studim paraqet pragun e përdorimit te borxhit publik. Burim i të dhënave do të jenë Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar, ndërsa periudha e analizës do të jetë nga viti 1995 deri në vitin 2017.

Ndërsa në **Kapitullin e Fundit** të disertacionit të doktoratës do ti paraqesim në mënyrë te detajuar gjetjet dhe rezultatet kryesore të këtij studimi. Me konkretisht nëpërmjet rezultateve të fituara nga analiza e regresionit (Ols, Fixed Effects, Random Effects, Hausman-Taylor, Gmm), si dhe përdorimit të qasjes “threshold” do ti testojmë hipotezat e ngritura. Arsyeja e shumëllojshmërisë së përdorimit të këtyre modeleve ekonometrike është sepse rezultatet e fituara duhet të pasqyrojnë një besueshmëri të lartë statistikore. Rezultatet që do të fitohen me poshtë nëpërmjet Tabelave 5.2, 5.4, dhe 5.6 do të tregojnë modelet dhe qasjet ekonometrike tek vendet në tranzicion të Evropës Qendrore, Evropës Lindore, si dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor. Për më tepër Testi-Sargan bën identifikimin e kufizimeve në prani të hetero-skedasticitetit me t-vlerën e shoqëruar e cila shqyrton vlefshmërinë e variablave instrumentale të pranuar si instrumente të shëndetshme për të gjitha ekuacionet e vlerësuar. Prandaj, rezultatet nga vlerësuesi GMM vërtetojnë konstatimin se variablat instrumentale nuk lidhen me grupin e mbetjeve. Si rezultat, testet Arellano - Bond testi AR (1) dhe AR (2) me t-vlera të shoqëruara refuzohen në rendin e parë, ndërsa ato pranohen në rendin e dytë, i cili konfirmon se nuk ka auto korrelacion në rendin e dytë midis termit të gabimeve.

Pjesë e rëndësishme e këtij studimi do të jetë pika e kthyesë e raportit të borxhit publik ndaj PBB-së. Rezultatet tregojnë se pika e kthyesë e efektit të borxhit publik ndaj PBB-së varion nga një interval tek një tjetër, dhe se bashku formojnë piken e kthimit (Turning Point). Një rritje e raportit të borxhit publik ndaj PBB-së mbi këtë prag do të ketë një efekt negativ në rritjen ekonomike të vendeve në tranzicion të Evropës Qendrore, ndërsa rritja e borxhit deri me një pikë të caktuar dhe nën këtë interval mund të ndikojë pozitivisht në rritjen ekonomike.

Në këtë pjesë ne do të testojmë **Hipotezën e Parë: Rritja e Borxhit Publik në vendet e Evropës Qendrore mbi pragun 75% deri në 85% ndikon negativisht në rritjen ekonomike në raport me PBB-në.** Gjithashtu këto rezultate do të krahasohen edhe me studimet tjera të cilat kanë trajtuar ndikimin e borxhit publik mbi rritjen ekonomike (Kumar dhe Woo (2010), Checherita dhe Rother (2010), Reinhart dhe Rogoff (2010), Mencinger, Aristovnik, Verbic (2015), Cecchetti et al. (2011). Gjithashtu tek kjo pjesë e kapitullit të rezultateve ne do të mundohemi të përcaktojmë pragun e borxhit publik edhe tek vendet në tranzicion të Evropës Lindore, duke u bazuar në qasjen “threshold” e cila përpunon të dhënat përmes metodës “bootstrapping”. Nëpërmjet këtyre rezultateve ne do të mundohemi të testojmë **Hipotezën e Dytë: Rritja e Borxhit Publik në vendet e Evropës Lindore mbi pragun 65% deri në 75% ndikon negativisht në rritjen ekonomike në raport me PBB-në.**

Në kuadër të vendeve në tranzicion të Evropës, tek ky kapitull në fund do të testohen edhe vendet e Ballkanit Perëndimor. Ku do të mundohemi të përcaktojmë pragun e borxhit publik tek vendet në tranzicion të Ballkanit Perëndimor, duke u bazuar në qasjen “threshold” e cila përpunon të dhënat përmes metodës “bootstrapping”. Nëpërmjet këtyre rezultateve ne do të mundohemi të testojmë **Hipotezën e Tretë : Rritja e Borxhit Publik në vendet e Ballkanit Perëndimor mbi pragun 55% deri në 65% ndikon negativisht në rritjen ekonomike në raport me PBB-në.** Si dhe në pjesën e fundit të këtij kreu ne do të shpjegojmë lidhjen në mes të borxhit publik dhe investimeve publike, me konkretisht duke specifikuar se si mund të ndikojë rritja e borxhit publik tek investimet publike në vendet në tranzicion. Andaj duke u bazuar në rezultatet që do dalin nga kjo pjesë, ne do të mundohemi të testojmë **Hipotezën e Katërt : Borxhi Publik ka gjasa të ndikon pozitivisht në rritjen ekonomike përmes Investimeve Publike në raport me PBB-në.** Testimi i kësaj hipoteze do të behet duke u bazuar në studimin e bërë nga (Checherita dhe Rother, 2010, Tanzi(2002).

2. STRUKTURA E BORXHIT PUBLIK NË VENDET EVROPIANE NË TRANZICION

2.1. Pasqyrë Makroekonomike e vendeve Evropiane në Tranzicion

2.1.1. Vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore

Shtetet e Evropës Qendrore dhe Lindore kishin normat më të shpejta të rritjes së produktivitetit të faktorëve të prodhimit sipas studimeve dhe literaturës aktuale. Ndërkohë që Republika Çeke dhe Hungaria kishin normat më të ulëta të rritjes ekonomike. Studimi i vetëm i cili ka përfshirë periudhën e krizës dhe pasojat e menjëhershme të saj është nga Dombi (2013a). Studimi tregon se për 10 shtete të Evropës Qendrore dhe Lindore gjatë viteve 1996-2012, ku burim kryesor i rritjes ekonomike ka qenë akumulimi i kapitalit. Rezultatet megjithatë janë të ndryshme gjatë viteve 1996-2007 dhe vitet e krizës ekonomike 2008-2012. Dombi (2013a) gjen gjithashtu dallime të dukshme midis një grupi të përbërë nga vendet e Vishegradit¹ dhe Sllovenisë, si dhe një grup vendesh më pak të zhvilluara, të përbërë nga Bullgaria, Rumania dhe shtetet baltike. Këto dallime ishin sa i përket rritjes ekonomike, dhe normës së zhvillimit ekonomik duke u bazuar në rritjen e produktivitetit të faktorëve të prodhimit.

Disa nga problemet dhe sfidat ekonomike të vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore (CEECs) mendohet që e kanë zanafillën shumë të hershme. Sipas vlerësimeve të Maddison (2001), Bruto Produkti i Brendshëm për kokë banori në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore (përfshirë Rusinë) qëndroi në 47.7% të nivelit të përgjithshëm ekonomik, autori në fjalë përfshiu 12 vende Evropiane Perëndimore, duke përfshirë Italinë, por duke përfshirë Spanjën dhe Portugalinë. Deri në vitin 1870 Bruto Produkti i Brendshëm për kokë banori ra në 41.8% të nivelit të përgjithshëm të Evropës Perëndimore, sipas statistikave ekonomike gjithashtu gjatë viteve në vazhdim ka pasur tendenca të rënies graduale të BPP-së me konkretisht në vitin 1913 tek këto vende ishte 41.3%. Duke u nisur nga këto fakte shohim se vendet e Evropës Qendrore dhe asaj Lindore vazhdimisht kanë pasur rënie të vazhdueshme të rritjes ekonomike, jo vetëm nga aplikimi dhe zbatimi i sistemit socialist ekonomik, por edhe nga disa praktika jo të përshtatshme të kopjimit të disa njohurive në formë të inovacioneve të cilat nuk rezultuan me sukses gjatë implementimit të tyre në këto vende (Maddison, 2001 Barro, 1991, Falcetti, Raiser, dhe Sanfey, 2002, Kolodko, 2000).

¹Shënim : The Visegrad Group, Visegrad Four, or V4 is a cultural and political alliance of four Central European nations – the Czech Republic, Hungary, Poland and Slovakia, that are members of the European Union (EU).


Gjithashtu ka edhe shumë faktorë të tjerë të cilat kanë përcaktuar ndryshe hendekun në mes të vendeve të Evropës Qendrore asaj Lindore². Gjatë shekujve të fundit rajoni ka kaluar nëpër procese të ndryshme paralele dhe afatgjata, të cilat kulmuan me shfaqjen e sistemeve të pjekura demokratike- kushtetuese, si dhe zhvillimin e ekonomive urbane bazuar në mënyrat para-kapitaliste (dhe pastaj kapitaliste) të prodhimit dhe shkëmbimit të mallrave dhe shërbimeve në tregjet ndërkombëtare. Strukturat shoqërore në Evropën Qendrore Perëndimore kanë evoluar në përputhje me rrethanat, duke krijuar jo vetëm një klasë kapitaliste (ose sipërmarrëse), por edhe shtresa të ndryshme profesionale të specializuara (duke përfshirë specialistë, ekonomist, inxhinierë etj). Zhvillimi dhe rritja ekonomike është një term shumë i gjerë. Andaj për ta analizuar një fenomen të tillë jo vetëm që duhet të specifikuar treguesit kryesor ekonomik të një vendi, por nevojitet edhe trajtimi i karakteristikave të faktorëve strukturor si dhe atyre institucional. Në rrjedhën e zhvillimit ekonomik të vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore një numër i konsiderueshëm i e karakteristikave cilësore besohet të kenë pësuar ndryshime radikale.

Specifikat dhe detajet e zhvillimeve të vendeve gjatë periudhave të tranzicionit (dhe post tranzicionit) dallojnë nga vendi në vend, jo vetëm për shkak të dallimeve në disa karakteristika objektive të matshme, por edhe për shkak të dallimeve nga disa faktorë si p.sh: institucional, social, kulturor, historik, si dhe atyre politik. Shumë studime dhe punime kanë reflektuar në mënyrë të mençur aspektin e shumë ndryshimeve ekonomike në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore: këtu përfshihen emra të tillë të tillë si (Kornai, 1998, 2000, 2006, Kolodko, 2000, Nuti dhe Portes, 1993) si dhe shumë autorë të tjerë. Për me tepër duhet potencuar se këto studime shkencore janë bërë duke i përdorur modelet empirike të cilat synojnë të shpjegojnë ecurinë e rritjes ekonomike të vendeve në tranzicion, duke iu referuar faktorëve të ndryshëm të cilët kanë pasur influencë të madhe. Disa modele të tilla janë iniciuar nga Barro (1991) të cilat kanë qenë të frymëzuara nga teoria e rritjes endogjene, ku është analizuar regresioni linear për një variabël të varur p.sh PBB-në për kokë banori në raport me ndonjë variabël tjetër të pavarur të tilla si p.sh: inflacioni, papunësia. Gjithashtu tek këto modele mund të përfshihen edhe disa variabla të tjera (shpjeguese) siç janë : besimet fetare të popullsisë, ose përbërja etnike e tyre.

²Shenim: In the post-WWII period the relative decline of CEECs was halted; by 1950, their per capita GDP edged up slightly to 42.3% of the West European level. By 1973 the per capita GDP of CEECs is estimated to have been close to 41% of the West European level – back to its 1913 level.

Në vazhdim do të mundohem që ti paraqesim disa nga indikatorët kryesor makroekonomik të cilët pasqyrojnë drejtpërdrejtë rritjen ekonomike të vendeve evropiane në tranzicion, me konkretisht tani do të ndalemi tek vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, e pasuar pastaj edhe me vendet e Ballkanit Perëndimor. Duke filluar nga rritja vjetore e bruto produktit të brendshëm, bruto produktin e brendshëm të shprehur për kokë banori, eksportin, shpenzimet e konsumit final, kursimet bruto, balancën e llogarisë aktuale, si dhe shpenzimet qeveritare. Te gjithë indikatorët e përmendur do të analizohen duke u bazuar në shfrytëzimin e të dhënave të Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar. Ndërsa pasqyrimi i tyre do të bëhet duke e përdorur analizën e trendit në formë të grafikoneve, me qëllim që të japim një pasqyrë të hollësishme makroekonomike të vendeve evropiane në tranzicion.


Figura 2.1: Rritja vjetore e Produktit të Brendshëm Bruto për vendet në Tranzicion të Evropës Qendrore (e shprehur në përqindje)



Burimi: Kalkuluar nga Autori, dhe Banka Botërore

Duke ju referuar të dhënave të prezantuara nga (Figura 2.1) shohim lëvizjen e trendit të lakores së produktit të brendshëm bruto të shprehur në përqindje nga viti 1995 deri në vitin 2017 për vendet e Evropës Qendrore në tranzicion. Rezultatet tregojnë se trendi i rritjes së PBB-së ka qenë i ndryshëm në raport me vendeve. Ajo çka vërehet është se pjesa më e madhe e vendeve të Evropës Qendrore nga viti 2008 deri në vitin 2010 kanë pasur trend negativ të rritjes ekonomike, përjashtimisht Polonisë ku gjatë kësaj kohe shënoje trend pozitiv të PBB-së.

Figura 2.2: Produkti Brendshëm Bruto për koke banori për vendet në Tranzicion të Evropës Qendrore




Burimi: Kalkuluar nga Autori, dhe Banka Botërore

Duke ju referuar të dhënave të nxjerra nga Banka Botërore për indikatorët kryesor makroekonomik mund të shohim lëvizjen e PBB-së për kokë banori gjatë periudhës 1995 deri në vitin 2017. Nëse i referohemi rezultateve nga (Figura 2.2) shohim dallime të shumta në mes të shteteve në tranzicion të Evropës Qendrore.

Rritje me të madhe të PBB-së për kokë banori ka pasur Çekia gjatë periudhës 1995 deri në 2017 që ishte (36,327), e pasuar nga Sllovenia ku PBB-ja për kokë banori në vitin 2017 ishte (34,868), Lituania me (32,997), Estonia me (31,742), si dhe Polonia ku PBB-ja për kokë banori në vitin 2017 shënoje vlerën (29,122).

Ndërsa sipas të dhënave shohim se Letonia dhe Kroacia kanë pasur një rritje më të ngadalshme të PBB-së për kokë banori gjatë viteve 1995 deri në vitin 2017. Me konkretisht Letonia në vitin 2017 kishte produktin e brendshëm bruto për kokë banori në vlerën prej (28,198), ndërsa Kroacia PBB-në gjatë vitit 2017 e kishte (26,288). Çka duhet të theksohet është se të gjitha vendet kishin rritje të vazhdueshme të PBB-së për kokë banori, përjashtimisht gjatë viteve 2008-2010 ku shënuan rënie të konsiderueshme.

Figura 2.3: Eksporti tek vendet në Tranzicion të Evropës Qendrore (në % të PBB-së)




Burimi: Kalkuluar nga Autori, dhe Banka Botërore

Sipas të dhënave nga Banka Botërore nëpërmjet (Figurës 2.3) shohim eksportin e shprehur në përqindje të PBB-së tek vendet në Tranzicion të Evropës Qendrore, ku mund të vërejmë se deri në vitin 2003 pjesa më e madhe e këtyre vendeve kanë pasur një normë të ulët të eksporteve. Ndërsa prej vitit 2010 e tutje vërehet një rritje e konsiderueshme e eksporteve tek këto vende.

Ku prej tyre shihet se Estonia ka pasur një rritje mjaft të madhe të eksportit të shprehur në përqindje të PBB-së ku vlera ishte 86.54 përqind në vitin 2011, e pasuar nga Lituania ku në vitin 2013 eksporti shënoje vlerën prej 84.06 përqind të PBB-së. Sllovenia në vitin 2017 me 82.21 përqind të PBB-së, Çekia me 79.45 përqind, si dhe Letonia me 60.47 përqind.

Ndërsa një rritje më të ngadaltë të eksportit në raport me produktin e brendshëm bruto kanë pasur vendet si Polonia dhe Kroacia. Ku sipas të dhënave shohim se Polonia eksportin në përqindje të PBB-së në vitin 2017 e kishte 54.29 përqind, ndërsa Kroacia me 51.09 përqind. Sipas këtyre rezultateve shohim se vlera e eksportit ka shënuar rritje graduale nga viti 2003, përjashtimisht viteve 2009 dhe 2010 ku pjesa dërmuese e vendeve të Evropës qendrore kishin rënie të konsiderueshme të përqindjes së eksporteve.

Figura 2.4: Shpenzimet e Konsumit Final tek vendet në Tranzicion të Evropës Qendrore (në % të PBB-së)




Burimi: Kalkuluar nga Autori, dhe Banka Botërore

Nga të dhënat të cilat janë marrë nëpërmjet Bankës Botërore, konkretisht tek data baza e të dhënave për indikatorët makroekonomik mund të shohim lëvizjen e trendit të shpenzimeve të konsumit final për vendet në Tranzicion të Evropës Qendrore. Sipas rezultateve të paraqitura nga (Figura 2.4) nuk vërejmë edhe shume ndryshime të shpenzimeve të konsumit final për këto vende. Kryesisht rritje me e madhe e shpenzimeve qeveritare është shënuar nga fillimi i vitit 2008.

Një rritje mjaft të lartë të shpenzimeve të konsumit final në përqindje të PBB-së ka shënuar Lituania, ku në vitin 2017 vlera arriti në 79.86% përqind, e pasuar pastaj nga Letonia ku shpenzimet e konsumit final në përqindje të PBB-së në vitin 2010 arritën 79.86 përqind, Kroacia dhe Polonia me 76.92 përqind.

Ndërsa një rritje me të ulët të shpenzimeve të konsumit final në krahasim me vendet e lartë përmendura kishin Sllovenia, Estonia, si dhe Çekia. Ku me konkretisht shohim se Sllovenia shpenzimet e konsumit final në vitin 2017 kishte 71.06 përqind të PBB-së, Estonia me 71.58 përqind, si dhe vendi me përqindjen me të vogël të shpenzimeve të konsumit final në raport me PBB-në kishte Çekia, ku gjatë vitit 2017 vlera e tyre ishte 66.45 përqind.

Figura 2.5: Kursimet Bruto tek vendet në Tranzicion të Evropës Qendrore (në % të PBB-së)




Burimi: Kalkuluar nga Autori, dhe Banka Botërore

Duke ju referuar rezultateve të paraqitura nëpërmjet (Figurës 2.5) shohim lëvizjen e trendit të kursimeve bruto tek vendet në Tranzicion të Evropës Qendrore duke filluar nga viti 1995 deri në vitin 2017. Lakoret të cilat pasqyrojnë kursimet bruto tek këto vende janë mjaft të ndryshme nga njëra tjetra. Nga viti 2008 deri në fillimin e vitit 2010 shohim se pjesa e madhe e vendeve të Evropës Qendrore kanë pasur një rënie të lehtë të kursimeve bruto, ndërsa rritja me e theksuar shihet të jete pas vitit 2010 e tutje.

Sipas të dhënave shohim në vitin 2017 prin Çekia, ku kursimet bruto në përqindje të PBB-së ishin 27.44 përqind, e pasuar nga Estonia me 27.05 përqind, Sllovenia me 25.76 përqind, si dhe Kroacia me 25.01 përqind të PBB-së. Ndërsa vendet si Letonia, Polonia, dhe Lituania shënuan një përqindje me të ulët të kursimeve bruto në raport me PBB-në gjatë viteve të fundit të analizës me konkretisht gjatë vitit 2017. Ku Letonia në vitin 2017 kishte kursimet bruto 20.07 përqind, Polonia 19.74 përqind, si dhe Lituania me 18.31 përqind.

Figura 2.6: Bilanci i Llogarisë Korente tek vendet në Tranzicion të Evropës Qendrore (në % të PBB-së)




Burimi: Kalkuluar nga Autori, dhe Banka Botërore

Përmes rezultateve të paraqitura nëpërmjet (Figurës 2.6) shohim lëvizjen e trendit të bilancit të llogarisë korente të shprehur në përqindje të PBB-së tek vendet në tranzicion të Evropës qendrore.

Duke u bazuar në të dhënat e nxjerra nga Banka Botërore, shohim rezultate mjaft të diversifikuara në raport mes vendeve. Letonia ka shënuar një bilanc negativ të llogarisë shtetërore, ku rënia me e theksuar ka qenë nga viti 2005 deri në vitin 2007 ku bilanci i llogarisë shënojë vlerën me të lartë negative gjatë kësaj periudhe në raport me vendet e tjera që është -20.80 përqind e PBB-së, mirëpo një kthesë të madhe e bëri në vitin 2009 ku gjendja e llogarisë arriti vlera pozitive që ishte 7.90% përqind.

Gjithashtu një bilanc negativ të llogarisë ka shënuar edhe Estonia, ku vlerat negative me të theksuara kanë qenë gjatë vitit 2007, dhe që ishin -15.75% përqind e PBB-së, e pasuar pastaj nga Lituania ku trendi i rënies me i theksuar ishte nga vitit 2005 deri në vitin 2007, ku vlerat shënuan -15% përqind. Siç e shohim një pjese e vendeve gjatë viteve 2005 deri në vitin 2008 kanë pasur një rënie të llogarisë shtetërore, përjashtimisht nga vendet si : Sllovenia me 7.14 përqind në vitin 2017, Kroacia me 5.43 përqind, Çekia me 0.89 përqind, si dhe Polonia me 0.17 përqind.

Figura 2.7: Shpenzimet Qeveritare tek vendet në Tranzicion të Evropës Qendrore (në % të PBB-së)




Burimi: Kalkuluar nga Autori, dhe Banka Botërore

Nëpërmjet (Figurës 2.7) vërejmë lëvizjen e trendit të shpenzimeve qeveritare në përqindje të PBB-së në vendet në Tranzicion të Evropës Qendrore. Duke u bazuar në rezultatet më lartë shohim se një pjesë e vendeve në Tranzicion të Evropës Qendrore nga viti 1995 deri në vitin 1999 kanë pasur një rritje të shpejtë të shpenzimeve qeveritare rreth 20 deri në 25 përqind të PBB-së. Rezultatet tregojnë se nuk ka edhe shume dallime të shpenzimeve qeveritare në përqindje të PBB-së në raport mes vendeve njëra me tjetrën.

Çka mund theksojmë është se Estonia në vitin 2017 kishte shpenzimet qeveritare me 20.30 përqind të PBB-së, e pasuar nga Kroacia që kishte 19.50 përqind, Republika e Çekisë me 19.09 përqind, Sllovenia me 18.27 përqind pastaj Polonia me 17.68 përqind. Sipas analizës shohim se Lituania në raport me vendet e tjera të Evropës Qendrore kishte shpenzimet qeveritare me te ulëta, ku në vitin 2017 ato ishin 16.50 përqind në përqindje të PBB-së. Ajo që mund të shohim nga këto rezultate është se të gjitha vendet që janë pjesë e kësaj statistike vazhdimisht gjatë viteve kanë zbritur nivelin e shpenzimeve qeveritare të paraqitura në përqindje të PBB-së.

Figura 2.8: Rritja vjetore e Produktit të Brendshëm Bruto për vendet në Tranzicion të Evropës Lindore (e shprehur në përqindje)




Burimi: Kalkuluar nga Autori, dhe Banka Botërore

Rritja vjetore e produktit brendshëm bruto tek vendet në tranzicion të Evropës Lindore e shprehur në përqindje, dhe është paraqitur nëpërmjet grafikut me lartë. Me konkretisht nëpërmjet Figurës. 8 shohim një shumëllojshmëri të rezultateve, rritja e PBB-së tek vendet e Evropës Lindore ka qenë e ndryshme nga vendi në vend. Rritje me te theksuar kanë shënuar Bjellorusia, Ukraina, Sllovakia, si dhe Moldavia.

Sipas këtyre të dhënave të nxjerura nga Banka Botërore shohim se nga viti 2008 deri në fillim të vitit 2010 shumica e vendeve kanë shënuar vlera negative për sa i përket PBB-së, si p.sh Ukraina ku në vitin 2009 PBB-ja në përqindje ishte -14.76 përqind, Moldavia -6 përqind, Sllovakia -5.91 përqind.

Ndërsa nga viti 2012 e tutje pjesa dërmuese e vendeve të Evropës Lindore kishin shënuar vlera pozitive të rritjes së PBB-së, ku Rumania gjatë vitit 2017 kishte PBB-në në përqindje 7.26 përqind, e pasuar nga Moldavia qe kishte 4.50 përqind, Hungaria me 3.99 përqind, Bullgaria 3.81 përqind, Sllovakia 3.40 përqind, Ukraina 2.52 përqind, si dhe Bjellorusia me 2.42 përqind.

Figura 2.9: Produkti Brendshëm Bruto për koke banori për vendet në Tranzicion të Evropës Lindore



Burimi: Kalkuluar nga Autori, dhe Banka Botërore


Sipas të dhënave nga Banka Botërore nëpërmjet (Figurës 2.9) vërejmë se Sllovakia ka një ritëm të rritjes shumë të lartë të PBB-së për kokë banori në raport me vendet në tranzicion të Evropës Lindore.

Ku ngritja dhe hovi me i lartë i rritjes së PBB-së për kokë banori ishte nga fillimi i vitit 2003 deri në vitin 2017 ku vlera ishte (31, 616). Ritmin e rritjes së PBB-së për kokë banori po thuajse të ngjashëm e kishte edhe Hungaria me (28, 107) në vitin 2017, e pasuar nga Rumania me (26,656).

Pastaj një rritje të PBB-së jo aq të lartë mirëpo stabile ka shënuar Bullgaria, ku PBB-ja për kokë banori në vitin 2017 ishte (20,947), si dhe Bjellorusia që PBB-në për kokë banori në vitin 2017 kishte (18,836).

Ndërsa tek disa vende të tjera në Tranzicion të Evropës Lindore vërejmë PBB-në për kokë banori shumë me të ulët në raport me vendet e tjera te trajtuara. Të tilla si Ukraina që kishte PBB-në për kokë banori (8,666) në vitin 2017, si dhe Moldavia me (5,967).

Figura 2.10: Eksporti tek vendet në Tranzicion të Evropës Lindore (në % të PBB-së)




Burimi: Kalkuluar nga Autori, dhe Banka Botërore

Nga (Figura 2.10) shohim lëvizjen e trendit të lakorës së eksportit për vendet në tranzicion të Evropës Lindore, ku këtyre vendeve ju prin Sllovakia, ku në vitin 2017 vlera e eksportit në % të PBB-së arriti 96.30 përqind. Gjithashtu sipas të dhënave shohim se një rritje mjaft të lartë të eksporteve ka shënuar edhe Hungaria, ku në vitin 2017 kishte rreth 90.09 përqind të PBB-së. Ndërsa vendet e tjera kishin një ritëm me të ulët të eksporteve në raport me PBB-në, ku Bullgaria në vitin 2017 kishte eksportet në % të PBB-së 67.37 përqind, e pasuar pastaj nga Bjellorusia që kishte 67.04 përqind, si dhe Ukraina me 47.95 përqind. Ndërsa vendet si Moldavia dhe Rumania kanë shënuar vlerat me të ulëta të eksporteve në % të PBB-së, me konkretisht Moldavia në vitin 2017 kishte 43.46 përqind, si dhe Rumania me 41.43 përqind.

Nëse i referohemi literaturës ekonomike vërejmë se eksporti luan një rol shumë të madh sa i përket zhvillimit ekonomik të vendeve. Mirëpo shumë autorë kanë trajtuar dhe analizuar rritjen ekonomike të vendeve në zhvillim dhe atyre të zhvilluara, ku potencojnë se ekziston një dallim në mes të tyre. Sepse në shumicën e rasteve vendet që janë në zhvillim dhe ato në tranzicion nuk kanë instaluar politika të mirëfillta ekonomike që i tërheqin dhe stimulojnë eksportin në raport me importin. P.sh kemi rastin e Kinës investimet e huaja direkte kanë qenë posaçërisht të rëndësishme për ndërtimin e sektorit të fortë të eksportit.


Figura 2.11: Shpenzimet e Konsumit Final tek vendet në Tranzicion të Evropës Lindore (në % të PBB-së)



Burimi: Kalkuluar nga Autori, dhe Banka Botërore

Nëpërmjet (Figurës 2.11) mund të vërejmë shpenzimet e konsumit final të shprehura në përqindje të PBB-së tek vendet në tranzicion të Evropës Lindore. Sipas rezultateve shohim se Moldavia ka pasur shpenzimet me të larta të konsumit final ku në vitin 2017 ishin 104.95 përqind, e pasuar nga Ukraina me 86.91 përqind, Sllovakia 73.86 përqind, Hungaria 69.64 përqind, si dhe Bjellorusia 69.48 përqind.


Figura 2.12: Kursimet Bruto tek vendet në Tranzicion të Evropës Lindore (në % të PBB-së)



Burimi: Kalkuluar nga Autori, dhe Banka Botërore

Sipas të dhënave nga Banka Botërore në (Figurën 2.12) shohim lëvizjen e trendit të kursimeve bruto në raport me PBB-në. Rezultatet janë mjaft të diversifikuara, ku mund të shohim se Bjellorusia në vitin 2017 kishte kursimet bruto në % të PBB-së 28.61 përqind, e pasuar nga Bullgaria me 26.50 përqind, Hungaria 25.80 përqind, Sllovakia 22.32 përqind, Rumania 21.26 përqind, Ukraina 19 përqind, si dhe vendi me përqindjen me të ulët të kursimeve bruto në raport me PBB-në është Moldavia me 18.67 përqind.

Figura 2.13: Bilanci i Llogarisë Korente tek vendet në Tranzicion të Evropës Lindore




Burimi: Kalkuluar nga Autori, dhe Banka Botërore

Përmes rezultateve të paraqitura nëpërmjet (Figurës 2.13) shohim lëvizjen e trendit të bilancit të llogarisë korente të shprehur në përqindje të PBB-së tek vendet në Tranzicion të Evropës qendrore, ku vërejmë se rezultatet janë mjaft të ndryshme nga vendi në vend.

Duke ju referuar gjithmonë trendit në grafikun me lartë shohim se Ukraina kishte pasur bilancin e llogarisë shtetërore me vlera pozitive në raport me PBB-në që në vitin 2007 ishte rreth 10.66 përqind, dhe që ishte me e larta në krahasim me vendet e tjera të Evropës Lindore.

Të gjitha vendet në përgjithësi kishin vlera negative të bilancit të llogarisë shtetërore, sidomos nga fillimi i vitit 2006 deri në fund të vitit 2009. Disa nga vendet filluan një ngritje të lehtë të bilancit të llogarisë shtetërore. Si p.sh Bullgaria në vitin 2017 kishte 6.65 përqind të PBB-së, Hungaria pastaj më 3.17 përqind të PBB-së, Bjellorusia me -1.58 përqind, Sllovakia me -2.03 përqind, Rumania -3.18 përqind, si dhe Moldavia me -6.91 përqind të PBB-së, që në raport me vendet e tjera të Evropës Lindore kishte vlerat negative me te theksuara.

Figura 2.14: Shpenzimet Qeveritare tek vendet në Tranzicion të Evropës Lindore (në % të PBB-së)



Burimi: Kalkuluar nga Autori, dhe Banka Botërore

Duke ju referuar (Figurës 2.14) që trajton shpenzimet qeveritare në vendet në tranzicion të Evropës Lindore, mund të shohim divergjenca të ndryshme në raport mes vendeve.

Sipas trendit që paraqet shpenzimet qeveritare në përqindje të PBB-së shohim se në vitet e para të analizës pjesa e madhe e këtyre vendeve kanë pasur një përqindje mjaft të lartë të shpenzimeve qeveritare, ku rritja më e theksuar ka qenë tek Moldavia gjatë vitit 1997 ku shpenzimet qeveritare arritën vlerën 28 përqind të PBB-së, gjithashtu një rritje të lartë të shpenzimeve qeveritare ka shënuar edhe Ukraina gjatë vitit 1997 më 27.40 përqind.

Ndërsa tani mund të vërejmë nivele më optimale të shpenzimeve qeveritare në raport me PBB-në, ku siç shihet Ukraina prin gjatë vitit 2017 me 20.44 përqind, e pasuar pastaj me një ritëm po thuajse të njëjtë edhe Hungaria me 20.07 përqind, Sllovakia më 19.15 përqind, Moldavia me 18.60 përqind, Bullgaria me 15.61 përqind, Rumania me 15.04 përqind, si dhe Bjellorusia me 14.60 përqind.

2.1.2. Vendet e Ballkanit Perëndimor

Rruga e ekonomive në tranzicion e vendeve të Ballkanit Perëndimor në gjysmën e fundit të shekullit XX ka qenë ndryshe nga ajo që jemi mësuar ta shohim. Pas ndarjes së Jugosllavisë në vitin 1990 për shkak të luftës në zhvillim e sipër, këto vende ishin shumë të izoluar. Vendet e Ballkanit Perëndimor pas vitit 1992 u përballën me një krizë e mëtejshme ekonomike, si dhe një qëndrueshmëri jo të duhur për shkak të ndikimit të luftërave dhe situatës ekonomike të trashëguar nga Jugosllavia.

Procesi i Tranzicionit që filloi në vitet e 90-ta të shekullit XX, shkaktoi rënien e Sistemit Socialist në Evropën Qendrore dhe Lindore Kornai (1998, 2000, 2006), Kolodko (2000), Nuti dhe Portes (1993). Gjatë 15 viteve të fundit vendet e Ballkanit Perëndimor kanë pësuar një shndërrim rrënjësor ekonomik, dhe shumë prej tyre nuk njihen po të krahasohen me pozicionin ku ndodheshin në kapërcyell të shekullit. Pas viteve “90 të dominuara nga konflikti, këto vende nisën rrugën e rindërtimit dhe reformimit të tërësishëm të ekonomive të tyre. Ato u hapën ndaj tregtisë globale dhe u shndërruan në vende të orientuara gjithnjë e më shumë drejt eksporteve; ato zgjeruan rolin e sektorit privat, çmontuan ato rregullore që pengonin zhvillimin e sipërmarrjeve, dhe filluan të ndërtojnë institucionet e nevojshme për të mbështetur sistemin e ekonomisë së tregut.

Në disa raste sistemet bankare u ngritën tërësisht nga zeroja, të ndihmuara nga kapitali dhe përvoja e huaj. Këto përpjekje rezultuan në një rritje të fuqishme ekonomike, rritje të ndjeshme në të ardhurat dhe standardet e jetesës, si dhe përmirësimin e qëndrueshmërisë makroekonomike. Megjithatë, në mesin e viteve 2000 procesi i transformimit strukturor filloi të ngadalësohet sepse i shërbeu interesave personal si edhe lodhjes nga reformat dhe kësaj nuk ka përfunduar ende. Rritja ekonomike në Ballkanin Perëndimor në kohën e krizës globale financiare ishte më shumë rezultat i likuiditetit të gjerë global dhe hyrjeve të paqëndrueshme të kapitaleve, se i progresit të vërtetë në reformën ekonomike. Provë e qartë e dobësisë së modelit ekonomik rajonal mund të jetë niveli tejet i lartë i papunësisë, që në shumë vende, madje edhe në kulmin e bumit të parakrizës ishte në masën mbi 20 përqind (FMN, Raport i Posaçëm për Ballkani Perëndimor, faqe 3-5, 2015).

Jo të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor kanë shënuar rritjen e njëjtë ekonomike, në kuadër të kësaj pjese do të mundohem që ti paraqesim disa nga karakteristikat kryesore makroekonomike të këtyre vendeve. Shpërbërja e RFSJ, dhe futja e Kosovës në administrimin e dhunshëm të Serbisë e ka shkatërruar sistemin ekonomik dhe atë bankar edhe ashtu të pa qëndrueshëm që e kishte Kosova në kuadër të ish shtetit Jugosllav. Sistemi bankar në Kosovë gjatë viteve të fundit është transformuar krejtësisht, i drejtuar nga sistemi bankar me pronësi shtetërore në ish Jugosllavi, në një sistem bankar me pronësi private pas çlirimit. Në të njëjtën kohë, si rrjedhojë e zhvillimit të saj ekonomik. Në anën tjetër Shqipëria në këtë periudhë ka qenë plotësisht e izoluar, për shkak se ajo kishte filluar procesin e tranzicionit nga komunizmi në një vend kapitalist (Banka Botërore, Raport për vendet e Ballkanit Perëndimor).

Gjithsesi në dekadën e parë të periudhës së tranzicionit në vendet e Ballkanit Perëndimor reformat dhe metodat nuk kanë qenë të përdorura në mënyrë paqësore, por më së shumti etiketohen dhe ngulfatën me luftërat dhe konfliktet etnike, duke vënë në skenë zhvillimin ekonomik të këtyre vendeve, me të jashtëzakonshme për Shqipërinë, që përveç krizës piramidale që kishte, menaxhonte për të kapur trendin e rritjes ekonomike gjatë vitit 1990. Shumica e vendeve kanë kaluar nëpër një proces të reformave të rëndësishme strukturore d.m.th. për të krijuar një sistem të mjedisit i cili është i orientuar nga tregu dhe paraqitet me krijimin e reformave bankare, reformat në politikën fiskale, si dhe iniciimin e reformave industriale (Lavigne 1999).

Në Maqedoni i ashtuquajtur i procesi catching-up³ ka filluar pas vitit 2001, me nënshkrimin e Programit të Stabilizim-Asocimit me BE-në. Trendi solid i progresit ekonomik do të ndalet gjatë krizës financiare në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, e cila karakterizohet me një trend negativ të rritjes ekonomike. Ky nuk ishte rasti tek Shqipëria, e cila kishte reduktuar në mënyrë të duhur procesin e rritjes ekonomike. Dallimi në aspektin e zhvillimit ekonomik qëndroi për Serbinë, e cila krahas vendeve të tjera që kanë shkuar përmes një procesi të ristrukturimit si në planin makroekonomik po ashtu dhe atij mikroekonomik, Serbia aplikojë politika në mënyrë që ekonomia të jetë e strukturuar ashtu që t'iu përgjigjet kërkesës dhe ofertës së tregut. Reformat e vërteta dhe të thella për të rritur zhvillimin e mëtejshëm ekonomik në vendet e Ballkanit Perëndimor kanë filluar pas vitit 2000 (FMN, Raport i Posaçëm për Ballkani Perëndimor, faqe 5-6, 2015).

³ Shënim: The Republic of Macedonia, the first country from the West Balkan's region that in April 2001 signed the Stabilization and Association Agreement (SAA) with the European Union.

Sfida kryesore me të cilën rajoni do të ballafaqohet në të ardhmen është përfundimi i procesit të transformimit strukturor që ka filluar dy dekada më parë. Procesi mbresëlënës i reformave, i lindur nga hiri i sistemit socialist përgjithësisht mbeti në vend rreth mesit të viteve 2000 dhe tani ka mbetur i papërfunduar, viktimë kjo e lodhjes nga reformat, e gjendjes së vështirë të ekonomisë politike, e interesave vetjake pasurore, që janë intensifikuar dhe sofistikuar, si dhe nga diziluzionimi nga mënyra e zbatimit të disa reformave. Procesi i anëtarësimit në BE—që me argumente pro ose kundër mund të konsiderohet si katalizatori kryesor për reformat tek Shtetet e Reja Anëtare – mbeti një perspektivë e largët për shumicën e vendeve të Ballkanit Perëndimor (FMN, Raport i Posaçëm për Ballkani Perëndimor, faqe 7, 2015).

Rajoni i Ballkanit Perëndimor vijoi të zgjerohet në vitin 2017, me një rritje ekonomike prej 2.6 përqind. Kjo normë e parashikuar e rritjes ekonomike të rajonit është më pak optimiste krahasuar me nivelin e pritshëm prej 3.2 përqind në kohën e publikimit të Raportit të pranverës dhe gjithashtu më i ulët se niveli prej 2.9 përqind i arritur në 2016 për disa arsye. Rritja ekonomike në vendet e Ballkanit Perëndimor është forcuar në rreth 3.5 përqind. Parashikimet për rritjen ekonomike të shumicës së vendeve të rajonit për vitin 2018 janë rishikuar me rritje. Kosova dhe Shqipëria pritet të kenë një rritje ekonomike prej 4 përqind këtë vit.

Parashikimi i rritjes ekonomike të Malit të Zi u rishikua me rritje me 1 pikë përqindje, duke arritur në 3.8 përqind, megjithëse dhe kjo vlerë është përsëri më e ulët se viti i kaluar. Bosnje-Herzegovina vijon të ketë rritje të qëndrueshme në rreth 3.2 përqind. Pas ngadalësimit që pësoi vitin e kaluar si rezultat i kushteve të motit, ekonomia e Serbisë e ka rimarrë veten duke arritur një rritje ekonomike prej 3.5 përqind. Me rikthimin e besimit tek investitorët, edhe Maqedonia përjetoi forcim të rritjes ekonomike në 2.5 përqind. Rritja e investimeve publike dhe konsumit stimuloi rritjen ekonomike. Mbështetur në reformat tatimore dhe përshpejtimin e ritmeve të rritjes ekonomike, të ardhurat e larta nga tatimet krijuan hapësirë fiskale, të cilën disa vende nxituan ta shfrytëzojnë për shpenzime korrente dhe investime kapitale. Rritja e investimeve publike është shenjë e mirëpritur, por për të qenë e suksesshme ajo duhet të mbështetet nga përmirësimi i efikasitetit dhe efektivitetit të shpenzimeve publike.

Rritja e madhe e shpenzimeve sociale të pashenjësuar dhe pagave të sektorit publik ka patur efekt të menjëhershëm në ritmet e rritjes ekonomike në disa vende për shkak të rritjes së shpejtë të konsumit dhe kredisë për individë. Por këto efekte janë të përkohshme dhe të kushtueshme: në periudhë afatgjatë ato shkaktojnë rritje të vulnerabilitetit fiskal. Në gjysmën e parë të vitit 2018 u krijuan mbi 90,000 vende pune, kryesisht në sektorët e industrisë dhe shërbimeve. Por reagimi i përgjithshëm i tregut të punës ndaj rritjes ekonomike ishte më i ngadaltë nga sa pritej, duke reflektuar në këtë mënyrë natyrën e përkohshme të stimujve të udhëhequr nga konsumi, si dhe nga rritja e inaktivitetit në tregun e punës.

Rënia e papunësisë në disa vende ka ardhur për shkak të inaktivitetit dhe emigracionit dhe jo si rezultat i hapjes së vendeve të reja të punës. Deformimet strukturore në tregjet e punës manifestohen në nivelin e lartë të pabarazive rajonale dhe gjinore në rezultatet e tregut të punës. Përmirësimi i stimujve për rritjen e pjesëmarrjes në forcën e punës do t'i japë shtysë jo vetëm krijimit të vendeve të reja të punës por edhe rritjes ekonomike (Banka Botërore, raport i rregullt ekonomik për Ballkanin Perëndimor nr.14, faqe 8-10, 2018). Vendet me ritme më të larta të rritjes ekonomike e nxitën rritjen kryesisht nëpërmjet investimeve dhe eksporteve. Rritja e investimeve private çoi në një rritje më të lartë ekonomike. Por për të mbështetur rritjen ekonomike nevojiten më shumë investime në sektorët e tregtueshëm.

Ndërkohë që konkurrenca ndërmjet tregjeve në zhvillim po bëhet më e ashpër, stabiliteti politik, një mjedis rregullator dashamirës ndaj biznesit, infrastruktura cilësore dhe një forcë pune e kualifikuar janë disa nga faktorët që do të ndikojnë në thithjen e investitorëve. Meqenëse kreditimi udhëhiqet kryesisht nga kredia për individë, krijimi i një sektori financiar më të diversifikuar dhe që favorizon rritjen ekonomike do të ndihmonte gjithashtu në tërheqjen e investitorëve vendas dhe të huaj. Rritja e nivelit të eksporteve përbën gjithashtu domosdoshmëri për garantimin e rritjes ekonomike afatgjatë. Disbalancat e jashtme kanë vijuar të jenë të larta, por të qëndrueshme. Bosnje-Hercegovina, Maqedonia dhe Serbia kanë përjetuar rritje të shpejtë të eksporteve të tyre.

Por rritja e konsumit dhe projektet e mëdha infrastrukturore i kanë dhënë hov rritjes së importeve. Rritja e qëndrueshme e nivelit të eksporteve do të ndihmojë në ruajtjen e stabilitetit makroekonomik, nxitjen e rritjes ekonomike dhe uljen e varfërisë. Mbështetja mund të vijë edhe nga integrimi rajonal:

Meqënëse shumica e eksporteve të vendeve të Ballkanit Perëndimor nuk konkurrojnë me njëra-tjetrën, integrimi rajonal në zinxhirët e vlerës të Bashkimit Evropian mund të sjellë përfitime domethënëse – dhe pa kompensime. Plani Shumëvjeçar i Veprimit (MAP) për krijimin e një zone ekonomike rajonale është një hap në drejtimin e duhur. Perspektiva pozitive e rritjes ekonomike ndeshet me rreziqe të jashtme dhe të brendshme. Shtrëngimi i mundshëm i kushteve të financimit në tregjet ndërkombëtare të kapitalit përbën një rrezik me ndikim negativ, veçanërisht në vendet që kanë disbalanca të jashtme dhe fiskale.

Duke qenë se tregjet e brendshme të bonove të qeverisë shpesh nuk janë të mirëzhvilluara, vendet e Ballkanit Perëndimor janë të ekspozuara ndaj rritjes së normave të interesit në tregjet ndërkombëtare. Rritja e fortë ekonomike e vendeve të rajonit varet gjithashtu nga stabiliteti politik në vend dhe rajon, i cili përcakton shpejtësinë e reformave strukturore. Zbutja e këtyre rreziqeve të jashtme dhe të brendshme kërkon angazhim maksimal në procesin e konsolidimit fiskal dhe përshejtimin e reformave strukturore (Banka Botërore, raport i rregullt ekonomik për Ballkanin Perëndimor nr.14, faqe 10-12, 2018).

Tabela 2.1: Parashikimet e rritjes ekonomike, 2017-2020

Vendet	2016	2017	2018	2019	2020
Shqipëria	3.4	3.8	4.0	3.6	3.5
Bosnjë dhe Her.	3.1	3.0	3.2	3.4	3.9
Kosova	3.4	3.7	4.0	4.5	4.5
Maqedonia	2.4	0.0	2.5	2.9	3.2
Mali i Zi	2.9	4.3	3.8	2.8	2.5
Serbia	2.8	1.9	3.5	3.5	4.0
Ballkani Perëndimor	2.2.	2.4	3.5	3.5	3.8


Burimi: Raport i Rregullt Ekonomik për Ballkanin Perëndimor Nr.14

Rritja ekonomike në shumicën e vendeve të rajonit për 2018 do të jetë më e lartë krahasuar me një vit më parë. Parashikimi i rritjes ekonomike për Serbinë, vendin me ekonominë më të madhe në rajon, është rishikuar me rritje në 3.5 përqind, e mbështetur nga rritja e investimeve publike dhe private. Rritja ekonomike në Kosovë dhe Shqipëri pritet të arrijë në 4 përqind. Në Kosovë, kjo rritje është nxitur nga rimëkëmbja e konsumit, shtimi i investimeve në infrastrukturë dhe eksporte më të larta të shërbimeve.

Shqipëria po përfiton nga dyfishimi i prodhimit të energjisë elektrike nga burime hidrike si rezultat i reshjeve të shumta të shiut, sezoni i suksesshëm turistik që i dha shtysë eksportit të shërbimeve dhe rimëkëmbja e industrisë përpunuese. Bosnje dhe Herzegovina vijon të ketë një rritje të qëndrueshme ekonomike prej 3.2 përqind, e nxitur kryesisht nga konsumi dhe rritja e investimeve publike. IRJ e Maqedonisë pritet të përjetojë një rikuperim të rritjes ekonomike në 2.5 përqind, mbështetur nga rritja e besimit të investitorëve.


Ndonëse rritja ekonomike e Malit të Zi parashikohet të jetë pak më e ulët se në vitin e kaluar, ajo vijon të mbetet e fortë në 3.8 përqind, 1 pikë përqindjeje (pp) më e lartë nga sa ishte parashikuar më parë, për shkak të investimeve në sektorin e energjisë dhe turizëm dhe përsheptimit të punimeve për ndërtimin e autostradës Bar-Boljare (Banka Botërore, raport i rregullt ekonomik për Ballkanin Perëndimor nr.14, faqe 12-13, 2018).

Figura 2.15: Parashikimet e rritjes ekonomike, 2017-2020 (i shprehur në përqindje)



Burimi: Raport i Rregullt Ekonomik për Ballkanin Perëndimor Nr.14

Figura 2.16: Ballkani Perëndimor , 2017-2020 (i shprehur në përqindje)



Burimi: Raport i Rregullt Ekonomik për Ballkanin Perëndimor Nr.14


Një rritje e mundshme në rreziqet e jashtme dhe të brendshme rrezikon perspektivën pozitive të rritjes ekonomike. Në faktorët e jashtëm, rreziku kryesor është shtrëngimi i kushteve të financimit për tregjet në zhvillim e lidhur kjo me normalizimin e politikës monetare në Evropë, krizat në disa tregje kryesore në zhvillim dhe pasiguria në lidhje me proteksionizmin global. Përveç kësaj, stabiliteti politik në rajon, debatet aktuale në BE dhe pikëpyetjet rreth qëndrueshmërisë së rritjes ekonomike të BE-së, jo vetëm që ngrenë shqetësime, por edhe rrisin pasigurinë e brendshme në vendet e rajonit. Këto rrjedhin kryesisht nga mundësitë për vonesa ose dalje nga kornizat të reformave të konsolidimit strukturor ose fiskal të shkaktuara nga zgjedhjet që do zhvillohen së shpejti në disa vende të rajonit dhe nga ngjarje të tjera politike.

Faktorë të tjerë, siç janë rreziqet e pazbutura të fatkeqësive natyrore (sidomos nga përmbytjet dhe thatësi, shiko RRE # 13, Banka Botërore) dhe rreziqet politike, gjithashtu rrisin pasigurinë e përgjithshme. Një shtrëngim i mundshëm i kushteve të financimit në tregjet ndërkombëtare të kapitalit është një rrezik me ndikim negativ në rritjen ekonomike, veçanërisht në vendet me disbalanca të jashtme ose fiskale. Siç është raportuar më lart, borxhi PPG është rritur ndjeshëm pas krizës financiare globale dhe mbetet i lartë në disa vende të Ballkanit Perëndimor (Banka Botërore, Raport i Rregullt Ekonomik për Ballkanin Perëndimor Nr.14, Faqe 36-37, 2018).

Edhe pse deficitet e jashtme përgjithësisht janë përmirësuar që nga kriza financiare globale, vetëm Serbia dhe Shqipëria kanë ulur disbalancat e jashtme dhe ato fiskale. Ndërsa deficitet e jashtme shpesh kanë pasur rënie të vogla, në vitin 2018 vulnerabiliteti fiskal u rrit në krahasim me vitin 2007. Rritja e deficiteve binjake, i jashtëm dhe ai fiskal, është shenjë paralajmëruese për nevojë për rifinancim. Në kushtet kur shpesh tregjet e brendshme të obligacioneve të qeverisë janë të pazhvilluara, vendet e Ballkanit Perëndimor janë shumë të ekspozuar ndaj rritjes së normës së interesit në tregjet ndërkombëtare.

Shtërngimi i kushteve të financimit në tregjet ndërkombëtare - nga ndryshimet në tregjet të reja për shkak të ngjarjeve në Turqi ose Argjentinë ose nga normalizimi i politikës monetare në vendet e zhvilluara - mund të krijojë nevojën për konsolidime të mëdha fiskale, të cilat mund të kenë ndikime të rënda negative në aktivitetin ekonomik. Efektet e përhapjes së mundshme të ndryshimeve nga tregjet e reja në vendet e Ballkanit Perëndimor mund të jenë të vogla, duke pasur parasysh lidhjet minimale të sektorit financiar dhe pjesën e lartë të investimeve IHD (Banka Botërore, Raport i Rregullt Ekonomik për Ballkanin Perëndimor Nr.14, Faqe 37-38, 2018).


Figura 2.17: Rritja vjetore e Produktit të Brendshëm Bruto për vendet e Ballkanit Perëndimor (e shprehur në përqindje)



Burimi: Kalkuluar nga Autori, dhe Banka Botërore

Në (Figurën 2.17) është paraqitur produkti i brendshëm bruto i shprehur në përqindje tek vendet e Ballkanit Perëndimor. Sipas rezultateve të paraqitura nga grafikoni me lartë shohim se përqindja e PBB-së tek vendet e Ballkanit Perëndimor ka qenë mjaft e ndryshueshme gjatë periudhës 1995-2017. Nëse ndalemi dhe e analizojmë vitin e fundit, do të thotë vitin 2017 shohim se produkti i brendshëm bruto i shprehur në përqindje në Malin e Zi ishte 4.7% përqind, pastaj në Kosovë 4.2% përqind, e pasuar nga Shqipëria me 3.8 përqind, Bosnja dhe Hercegovina me 3.19 përqind. Ndërsa Serbia dhe Maqedonia shënuan përqindjen me të ulët të PBB-së gjatë vitit 2017 në kuadër të vendeve të Ballkanit Perëndimor, me konkretisht Serbia PBB-në kishte 1.8 përqind, dhe Maqedonia me 0.24 përqind.


Figura 2.18: Produkti Brendshëm Bruto për kokë banori për vendet e Ballkanit Perëndimor.



Burimi: Kalkuluar nga Autori, dhe Banka Botërore

Duke ju referuar (Figurës 2.18) që paraqet rritjen ekonomike të vendeve të Ballkanit Perëndimor përmes PBB-së për kokë banori, mund të vërejmë rezultate mjaft interesante dhe produktive. Sipas rezultateve të paraqitura shohim se rritja me e theksuar tek vendet e Ballkanit Perëndimor ka qenë nga fillimi i vitit 2005. Sipas lakorës tek grafiku me lartë shohim se Mali i Zi ka pasur rritjen me të lartë të produktit i brendshëm bruto në kuadër të vendeve të Ballkanit Perëndimor nga viti 1995 deri në fund të vitit 2017 që ishte rreth (19,351), e pasuar nga Serbia me (15,428), Maqedonia me (15,290), Bosnja dhe Hercegovina me (13,107), Shqipëria (12,943), si dhe Kosova vendi i cili ka shënuar vlerën me të ulët të bruto produktit vendor në kuadër të vendeve ballkanike, dhe që vlera e PBB-së arriti (10,737).

Figura 2.19: Eksporti tek vendet e Ballkanit Perëndimor (në % të PBB-së)




Burimi: Kalkuluar nga Autori, dhe Banka Botërore

Sipas rezultateve të paraqitura nga (Figura 2.19) shohim se lakorja që paraqet eksportin ka ndryshime në raport mes vendeve të Ballkanit Perëndimor. Ku mund të vërejmë se të gjitha vendet kanë pasur një rënie të lehtë të eksporteve të shprehura në raport me PBB-në gjatë viteve 2008 dhe 2009. Nëse ndalemi dhe e analizojmë vitin 2017 si vit bazë shohim se rritje me të lartë të eksportit në % të PBB-së ka shënuar Maqedonia me 55.40 përqind, e pasuar nga Serbia me 52.45 përqind të vlerës së PBB-së, Mali i Zi me 41.05 përqind të PBB-së, Bosnja dhe Hercegovina me 38.87 përqind.

Ndërsa Shqipëria dhe Kosova kishin përqindjen me të ulët të eksporteve nga radha e vendeve të Ballkanit Perëndimor, do të thotë Shqipëria në vitin 2017 kishte vlerën e eksportit në % të PBB-së 31.52 përqind, si dhe Kosova me 26.64 përqind të vlerës së PBB-së. Teoria e tregtimit ndërkombëtarë dhe politikës së rregullimit të tregtisë ndërkombëtare është një nga degët më të vjetra të ekonomisë botërore në përgjithësi. Elemente të ekzistimit të tregtisë ndërkombëtare dokumentohen qysh në Greqinë Antike e gjerë në kohën e sotme element pa të cilën nuk mund të paramendohet jeta në ditët e sotme. Gjatë historisë së ekzistimit të ekonomisë ndërkombëtare vende të ndryshme në periudha të ndryshme kanë pasur qasje të ndryshme ndaj eksportit gjë që ndikon në paraqitjen e fazave të dallueshme të zhvillimit të politikës ndërkombëtare të eksportit.

Figura 2.20: Shpenzimet e Konsumit Final tek vendet e Ballkanit Perëndimor (në % të PBB-së)



Burimi: Kalkuluar nga Autori, dhe Banka Botërore


(Figura 2.20) tregon lëvizjen e lakorës së shpenzimeve të konsumit final ose më mirë të themi konsumin përfundimtar tek vendet e Ballkanit Perëndimor gjatë periudhës kohore 1995 deri në vitin 2017. Në fillim të periudhës kohore të kësaj analize shohim se të gjitha vendet kanë pasur nivele me të larta të shpenzimeve të konsumit.

Sipas rezultateve shohim se Bosnja dhe Hercegovina ka pasur normën me të lartë të shpenzimeve të konsumit në kuadër të vendeve të Ballkanit Perëndimor, ku rritja me e theksuar ka qenë gjatë vitit 1999 me 138.53 përqind e PBB-së.

Nëse e analizojmë vitin e fundit, do të thotë vitin 2017 mund të vërejmë se Bosnja dhe Hercegovina kishte 98.84 përqind, e pasuar nga Kosova që shpenzimet e konsumit final i kishte 97.51 përqind, Mali i Zi me 92.92 përqind, Serbia me 87.81 përqind, si dhe Maqedonia me 80.71 përqind të shpenzimeve të konsumit final në raport me PBB-në.

Për ndryshe nëse i referohemi literaturës ekonomike shohim që konsumi përfaqëson shpenzimet e konsumatorëve privat për mallra konsumi, pra për mallra që përdoren për të nxjerr dobi në periudhën e tashme.


Figura 2.21: Kursimet Bruto Finale tek vendet e Ballkanit Perëndimor (në % të PBB-së)



Burimi: Kalkuluar nga Autori, dhe Banka Botërore

Nëpërmes (Figurës 2.21) kemi mundësi të vërejmë trendin e lakorës së kursimeve bruto në vendet e Ballkanit Perëndimor. Sipas të dhënave të paraqitura shohim se shumica e vendeve të Ballkanit Perëndimor nuk kanë pasur një trend pozitiv për sa i përket kursimeve bruto që janë të kalkuluar në përqindje të PBB-së për kokë banori. Nëse e analizojmë vitin e fundit të periudhës hulumtuese shohim se Maqedonia kishte kursimet bruto me 32.44 përqind të PBB-së, Kosova me 23.34 përqind, Shqipëria me 16.76 përqind. Ndërsa vendet si Bosnja dhe Hercegovina, Serbia, dhe Mali i Zi kishin përqindjen me të ulët të kursimeve bruto në raport me PBB-në që sillesh rreth 14% përqind.


Figura 2. 22: Bilanci i Llogarisë Korente tek vendet e Ballkanit Perëndimor (në % të PBB-së)



Burimi: Kalkuluar nga Autori, dhe Banka Botërore

Bilanci i pagesave është përmbledhje e të dhënave statistikore për të gjitha transaksionet ekonomike midis rezidentëve (banorëve) të vendit raportues dhe rezidentëve (banorëve) të pjesës tjetër të botës, gjatë një periudhe të caktuar kohore. Periudha e zakonshme e raportimit, për të gjitha të dhënat statistikore, është një vit. Megjithatë, disa shënime statistikore që reflektojnë në bilancet e pagesave, janë të publikuara në periudha të rregullta kohore, në çdo muaj dhe në çdo tre muaj përçdo vend. Kjo pasqyrë nxjerr në shesh se sa një vend ka eksportuar dhe importuar produkte dhe shërbime dhe, nëse vendi ka marrë hua, prej nga i ka marrë dhe ku ka dhënë hua, për pjesën e mbetur të botës. Nëse i referohemi vitit 2017 në (Figurën 2.22), vërejmë se Mali i Zi kishte llogarinë aktuale me vlera mjaft negative që ishte me e larta në kuadër të vendeve të Ballkanit Perëndimor më 15.71 përqind e PBB-së, e pasur nga Shqipëria që kishte -7.53 përqind, Kosova me -6.19 përqind, Serbia -5.68 përqind, Bosnja dhe Hercegovina -4.71 përqind, si dhe Maqedonia me -0.8 përqind.

Figura 2.23: Shpenzimet Qeveritare në vendet e Ballkanit Perëndimor (në % të PBB-së)



Burimi: Kalkuluar nga Autori, dhe Banka Botërore

Nëpërmjet (Figurës 2.23) kemi paraqitur shpenzimet qeveritare të shprehura në përqindje të PBB-së në vendet e Ballkanit Perëndimor gjatë periudhës kohore 1995-2017. Sipas rezultateve të paraqitura shohim se nuk ka edhe shume dallime të vlerës së shpenzimeve qeveritare në kuadër të këtyre vendeve. Nëse i referohemi vitit 2017 shohim se Bosnja dhe Hercegovina ka pasur nivelin më të lartë të shpenzimeve qeveritare më 20.32 përqind të PBB-së, e pasuar pastaj nga Mali i Zi më 18.39 përqind të PBB-së, Serbia më 15.92 përqind të PBB-së, Maqedonia më 14.90 përqind të PBB-së, Kosova me 13.44 përqind të PBB-së, si dhe Shqipëria me nivelin më të ulët të shpenzimeve qeveritare në kuadër të vendeve të Ballkanit Perëndimor që është 13.44 përqind.

2.2.Struktura e Borxhit Publik tek vendet në Tranzicion të Evropës Qendrore

Tabela 2.2: Borxhi Publik tek vendet ne Tranzicion te Evropës Qendrore (i shprehur në miliard)


Vitet	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Estonia	996	964	1,011	1,746	1,924	2,108	2,035	1,987	2,064
Lituania	7,529	10,150	11,629	13,264	13,551	14,827	15,940	15,515	16,614
Letonia	6,677	8,323	8,704	9,086	8,893	9,669	8,953	10,092	10,807
Sllovenia	12,527	13,907	17,204	19,404	25,505	30,220	32,087	31,753	31,859
Republik a Qeke	49,827	59,063	62,299	71,784	67,102	65,589	67,952	64,945	68,515
Polonia	165,26 5	193,16 8	190,15 4	214,84 1	222,12 0	202,97 3	216,51 7	228,83 2	240,76 8
Kroacia	21,904	25,548	28,238	30,399	34,960	36,350	37,210	37,269	38,080

Burimi: Kalkuluar nga Autori, dhe Countryeconomy.com

Në (Tabelën 2.2) është paraqitur struktura e borxhit publik tek vendet në tranzicion të Evropës Qendrore i shprehur në vlera monetare. Nëse ndalemi dhe e analizojmë vitin e fundit (2017) sipas të dhënave të paraqitura në tabelën me lartë shohim se Polonia ka shënuar vlerën me të lartë të borxhit publik në raport me vendet e tjera të Evropës Qendrore, ku në vitin 2017 arriti vlerën 240.76 Miliard.

Gjithashtu një rritje të theksuar të borxhit publik ka shënuar edhe Republika e Çekisë ku në vitin 2017 borxhi publik ishte 68.51Miliard, e pasuar pastaj nga Kroacia ku borxhi publik në vitin 2017 arriti vlerën prej 38.08Miliard, Sllovenia me 31.85 Miliard. Ndërsa vendet si Letonia, Lituania, dhe Estonia kishin vlerat me të ulëta të përdorimit të borxhit publik në kuadër të vendeve në tranzicion të Evropës Qendrore, ku Lituania borxhin publik në vitin 2017 kishte 16.61Miliard, Letonia 10.80Miliard, si dhe Estonia me vlerën me të ulët të përdorimit të borxhit publik me 2.06Miliard.


Figura 2.24: Borxhi Publik (i shprehur në përqindje të PBB-së) i Estonisë 1995-2017



Burimi: Kalkuluar nga Autori, dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar

Sipas të dhënave nga (Figura 2.24) mund të vërejmë borxhin publik të Estonisë (në përqindje të PBB-së). Nëse i referohemi viteve të analizës, do të thotë nga viti 1995 deri në vitin 2017 shohim se rritja me e lartë e përdorimit të borxhit publik të Estonisë ka qenë nga fillimi i vitit 2007 e tutje, ku me e larta shihet të jetë në vitin 2014 me 10.37 përqind të PBB-së.


Figura 2.25: Borxhi Publik (i shprehur në përqindje të PBB-së) i Lituanisë 1995-2017



Burimi: Kalkuluar nga Autori, dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar

Sipas të dhënave nga (Figura 2.25) mund të vërejmë borxhin publik të Lituanisë (në përqindje të PBB-së). Nëse i referohemi viteve të analizës, do të thotë nga viti 1995 deri në vitin 2017 shohim se rritja me e lartë e përdorimit të borxhit publik të Lituanisë ka qenë nga fillimi i vitit 2009 e tutje, ku me e larta shihet të jetë në vitin 2015 me 42.78 përqind të PBB-së.


Figura 2.26: Borxhi Publik (i shprehur në përqindje të PBB-së) i Letonisë 1995-2017



Burimi: Kalkuluar nga Autori, dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar

Nga të dhënat e paraqitura nëpërmjet (Figurës 2.26) mund të vërejmë borxhin publik të Letonisë (në përqindje të PBB-së). Nëse i referohemi viteve të analizës, do të thotë nga viti 1995 deri në vitin 2017 shohim se rritja me e theksuar e përdorimit të borxhit publik të Letonisë ka qenë nga fillimi i vitit 2008 e tutje, ku me e larta vërehet te jetë në vitin 2010 me 40.34 përqind të PBB-së.


Figura 2.27: Borxhi Publik (i shprehur në përqindje të PBB-së) i Sllovenisë 1995-2017



Burimi: Kalkuluar nga Autori, dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar

Duke ju referuar (Figurës 2.27) mund të vërejmë borxhin publik të Sllovenisë (në përqindje të PBB-së). Sipas rezultateve të paraqitura në figurën me lartë, do të thotë nga viti 1995 deri në vitin 2017 shohim se rritja me e shpejtë e përdorimit të borxhit publik të Sllovenisë ka qenë nga fillimi i vitit 2009 e tutje, ku me e larta vërehet te jetë në vitin 2015 me 83.15 përqind të PBB-së.


Figura 2.28: Borxhi Publik (i shprehur në përqindje të PBB-së) i Çekisë 1995-2017



Burimi: Kalkuluar nga Autori, dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar

Nga të dhënat e paraqitura nëpërmjet (Figurës 2.28) mund të shohim borxhin publik të Çekisë (në përqindje të PBB-së). Nëse i referohemi viteve të analizës, do të thotë nga viti 1995 deri në vitin 2017 shohim se rritja e përdorimit të borxhit publik në republikën e Çekisë ka qenë në mënyrë graduale. Mirëpo rritja më e theksuar ka qenë nga fillimi i vitit 2009 e tutje, ku me e larta shihet te jetë në vitin 2013 me 44.91 përqind të PBB-së.

Figura 2.29: Borxhi Publik (i shprehur në përqindje të PBB-së) i Polonisë 1995-2017




Burimi: Kalkuluar nga Autori, dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar

Në (Figurën 2.29) mund të shohim lëvizjen e trendit të përdorimit të borxhit publik të Polonisë (në përqindje të PBB-së) nga viti 1995 deri në vitin 2017.

Rrija e borxhit publik ka gjatë kësaj periudhe kohore në Poloni ka qene ne formë konstante, mirëpo rritja me e theksuar e përdorimit të borxhit publik ka qenë në vitin 2013 me 55.97 përqind të PBB-së.

Figura 2.30: Borxhi Publik (i shprehur në përqindje të PBB-së) i Kroacisë 1995-2017



Burimi: Kalkuluar nga Autori, dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar.

Sipas rezultateve të paraqitura më lartë në Figurën (2.30) nga burimi i FMN-së shohim borxhin publik të Kroacisë (të vendosur në përqindje të PBB-së) gjatë periudhës kohore 1995 deri në vitin 2017.

Përqindja e përdorimit të borxhit publik në Kroaci është rritur nga viti në vit, sidomos nga viti 2009 e tutje, ku rritja ka qenë shumë e shpejtë. Çka vlen të theksohet është se rritja me e lartë e përdorimit të borxhit publik ka qenë në vitin 2015 me 86.67 përqind të PBB-së, dhe nëse krahasohet me vitet në fillim të periudhës analizuese është disa herë me lartë si p.sh në vitin 1995 ku borxhi publik në Kroaci ishte 27.92 përqind e PBB-së.

2.3.Struktura e Borxhit Publik tek vendet në Tranzicion të Evropës Lindore

Tabela 2.3: Borxhi Publik tek vendet ne Tranzicion te Evropës Lindore (i shprehur në miliard)

Vitet	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Bullgaria	5,109	5,856	6,284	7,005	7,147	11,619	11,871	14,246	13,247
Bellorusi a	11,885	15,871	25,679	18,872	20,952	22,984	26,908	23,054	25,764
Hungaria	76,065	78,602	72,416	77,170	78,558	79,150	83,349	86,861	90,534
Moldavia	1,266	1,335	1,462	1,750	1,778	2,164	2,625	2,576	
Rumania	27,436	36,934	44,187	49,446	53,429	58,489	59,494	62,911	64,647
Sillovakia	23,237	27,842	30,847	37,926	40,600	40,725	41,295	42,053	43,230
Ukrahina	29,778	41,643	43,242	51,310	54,783	70,030	65,015	68,475	


Burimi: Kalkuluar nga Autori, dhe Countryeconomy.com

Në (Tabelën 2.3) është paraqitur struktura e borxhit publik tek vendet në tranzicion të Evropës Lindore i shprehur në vlera monetare. Nëse ndalemi dhe e analizojmë vitin e fundit të kësaj analize do të thotë vitin 2017 nëpërmjet të dhënave të paraqitura në tabelën me lartë shohim se Hungaria ka shënuar vlerën me të lartë të borxhit publik në raport me vendet e tjera të Evropës Lindore, ku në vitin 2017 arriti vlerën 90.53 Miliard.

Siç e vërejmë edhe Ukraina në vitin 2016 kishte një ngarkesë mjaft të madhe të përdorimit të borxhit publik që sillej rreth 68.47Miliard. Gjithashtu një rritje të borxhit publik ka shënuar edhe Rumania ku në vitin 2017 borxhi publik arriti vlerën 64.91Miliard.

E pasuar pastaj nga Sllovakia ku borxhi publik në vitin 2017 arriti vlerën prej 43.23Miliard. Ndërsa vendet si Bjellorusia dhe Bullgaria kishin shënuar nivelin me të ulët të përdorimit të borxhit publik në kuadër të vendeve të Evropës Lindore gjatë vitit 2017, ku sipas të dhënave nga tabela shohim se Bjellorusia kishte 25.76 Miliard, si dhe Bullgaria me 13.24Miliard.

Figura 2.31: Borxhi Publik (i shprehur në përqindje të PBB-së) i Bullgarisë 1995-20




Burimi: Kalkuluar nga Autori, dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar

Duke ju referuar (Figurës 2.31) mund të vërejmë borxhin publik të Bullgarisë (në përqindje të PBB-së) sipas të dhënave në nxjerra nëpërmjet Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Sipas rezultateve të paraqitura në figurën me lartë, do të thotë nga viti 1995 deri në vitin 2017 shohim se rritja me e shpejtë e përdorimit të borxhit publik në Bullgari ka qenë nga fillimi i vitit 1995 deri në vitin 1999, ku me e larta vërehet të jetë në vitin 1996 me 140 përqind të PBB-së, që është me të vërtetë një ngarkesë mjaft e madhe e përdorimit të borxhit publik.

Ndërsa nga fillimi i vitit 2002 e tutje përqindja e ngarkesës së borxhit publik në Bullgari ka filluar të bie nga viti në vit. Ku me konkretisht në vitin 2015 borxhi publik në përqindje të PBB-së arriti vlerën prej 26.3 përqind që është dukshëm me i ulët në krahasim me vitet e më hershme.


Figura 2.32: Borxhi Publik (i shprehur në përqindje të PBB-së) i Bjellorusisë 1995-2017



Burimi: Kalkuluar nga Autori, dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar

Nga të dhënat e paraqitura nëpërmjet (Figurës 2.32) mund të shohim borxhin publik të Bjellorusisë (në përqindje të PBB-së). Nëse i referohemi viteve të analizës, do të thotë nga viti 1995 deri në vitin 2005 vërejmë se borxhi publik në Bjellorusi ishte mjaft i ulët në raport me PBB-në që sillej prej 10% deri në 16%. Ndërsa sipas rezultateve më të lartë shohim se rritja me e theksuar e ngarkesës së borxhit publik në Bjellorusi ka qenë nga fillimi i vitit 2006 e tutje, ku me konkretisht vlera e përdorimit të borxhit publik në vitin 2017 në Bjellorusi arriti mbi 50% përqind të PBB-së, dhe nëse krahasohet me vitet e më hershme është dukshëm më e lartë.

Figura 2. 33: Borxhi Publik (i shprehur në përqindje të PBB-së) i Hungarisë 1995-2017




Burimi: Kalkuluar nga Autori, dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar

Sipas rezultateve të paraqitura me lartë në (Figurën 2.33), nga burimet e FMN-së shohim borxhin publik të Hungarisë (të vendosur në përqindje të PBB-së) gjatë periudhës kohore 1995 deri në vitin 2017.

Përqindja e përdorimit të borxhit publik në Hungari ka qenë shumë e lartë gjatë viteve të para të kësaj analize, ku rritja me e theksuar ishte vërejtur në vitin 1995 më 84.46 përqind të PBB-së, e cila pastaj ka filluar të bie gjatë viteve në vazhdim deri në vitin 2001 ku vlera e përdorimit të borxhit publik në Hungari ka qenë me e ulëta gjatë këtyre viteve me 51 përqind të PBB-së. Ndërsa nga viti 2002 e tutje prape ka filluar rritja graduale e ngarkesës së borxhit publik, ku në vitin 2015 arriti vlerën prej 75.33 përqind të PBB-së.


Figura 2.34: Borxhi Publik (i shprehur në përqindje të PBB-së) i Moldavisë 1995-2017



Burimi: Kalkuluar nga Autori, dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar

Nga të dhënat e paraqitura nëpërmjet (Figurës 2.34) mund të shohim borxhin publik të Moldavisë (në përqindje të PBB-së). Nëse i referohemi viteve të analizës, do të thotë nga viti 1995 deri në vitin 2017 rritja me e theksuar e përdorimit të borxhit publik në Moldavi ka qenë nga fillimi i vitit 1997 deri në fund të vitit 1999, ku siç shihet në vitin 1998 borxhi publik arriti vlerën prej 160 përqind të PBB-së. Ndërsa nga viti 2000 e tutje vlera e borxhit publik në raport me PBB-në ka filluar të bie vazhdimisht nga viti në vit.


Figura 2.35: Borxhi Publik (i shprehur në përqindje të PBB-së) e Rumanisë 1995-2017



Burimi: Kalkuluar nga Autori, dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar

Duke ju referuar (Figurës 2.35) mund të vërejmë borxhin publik të Rumanisë (në përqindje të PBB-së) nëpërmjet të dhënave të nxjerra nga Fondi Monetar Ndërkombëtar. Sipas rezultateve të paraqitura në figurën me lartë, do të thotë nga viti 1995 deri në vitin 2017 shohim së rritja me e shpejtë e përdorimit të borxhit publik në Rumani ka qenë nga fillimi i vitit 2009 e tutje, ku me e larta vërehet të jetë në vitin 2014 më 40.5 përqind të PBB-së, që është me të vërtetë një ngarkesë mjaft e madhe e përdorimit të borxhit publik nëse krahasohet me vitet e para të periudhës analizuese.

Figura 2.36: Borxhi Publik (i shprehur në përqindje të PBB-së) i Sllovakisë 1995-2017




Burimi: Kalkuluar nga Autori, dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar

Sipas rezultateve të paraqitura nëpërmjet (Figurës 2.36) mund të vërejmë borxhin publik të Sllovakisë (në përqindje të PBB-së) nëpërmjet të dhënave të nxjerra nga Fondi Monetar Ndërkombëtar.

Sipas rezultateve të paraqitura në figurën me lartë, do të thotë nga viti 1995 deri në vitin 2017 shohim se rritja me e shpejtë e përdorimit të borxhit publik në Sllovaki ka qenë nga fillimi i vitit 2009 e tutje, ku me e larta vërehet të jetë në vitin 2013 me 54.9 përqind të PBB-së. Ndërsa vlera me ulët e përdorimit të borxhit publik në Sllovaki ka qenë gjatë viteve 1995 deri në vitin 2000 që sillej rreth 20 përqind e PBB-së.

Figura 2.37: Borxhi Publik (i shprehur në përqindje të PBB-së) i Ukrainës 1995-2017



Burimi: Kalkuluar nga Autori, dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar

Rritja e ngarkesës së borxhit publik në Ukrainë ka qenë me cikle të ndryshme nga viti në vit. Me konkretisht nëse i referohemi rezultateve të paraqitura në (Figurën 2.37) mund të shohim borxhin publik të Ukrainës të shprehur në përqindje të PBB-së gjatë periudhës kohore 1995 deri në vitin 2017.

Rritja me e theksuar e përdorimit të borxhit publik në Ukraine ka qenë nga fillimi i vitit 2008 e tutje, ku në vitin 2015 borxhi publik në përqindje të PBB-së arrin vlerën 80.08 përqind e PBB-së, e cila shihet të jetë me e larta në raport me vitet e tjera të analizës së borxhit publik në Ukrainë.

2.4.Struktura e Borxhit Publik tek vendet në Tranzicion të Ballkanit Perëndimor

Tabela 2.4: Borxhi Publik tek vendet ne Tranzicion te Ballkanit Perëndimor (i shprehur në miliard)


Vitet	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Shqipëria	5,181	5,193	5,507	5,957	6,775	7,176	7,566	7,860	
Bosnja dhe Hercegovina	4,431	5,530	5,775	5,816	6,094	6,278	6,651	6,736	6,349
Maqedonia	1,590	1,707	2,124	2,553	2,768	3,255	3,457	3,844	3,951
Serbia	10,999	12,850	15,572	18,336	20,955	23,936	25,457	25,289	
Mali i Zi	1,308	1,407	1,586	1,809	1,972	2,191	2,513	2,625	
Kosova	249	260	253.6	283.4	476.2	582.8	748.9	852.7	996.4

Burimi: Kalkuluar nga Autori, dhe Countryeconomy.com

Në (Tabelën 2.4) kemi paraqitur strukturën e borxhit publik tek vendet ne tranzicion te Ballkanit Perëndimor të shprehura në vlera monetare. Nëse ndalemi dhe e analizojmë vitet e fundit të kësaj analize do të thotë vitin 2016-17 nëpërmjet të dhënave të paraqitura në tabelën me lartë shohim se Serbia ka shënuar vlerën me të lartë të borxhit publik në raport me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, ku në vitin 2016 arriti vlerën 25.2 Miliard. Siç e vërejmë edhe Shqipëria në vitin 2016 kishte një ngarkesë mjaft të madhe të përdorimit të borxhit publik në kuadër te vendeve të Ballkanit Perëndimor që sillej rreth 7.8Miliard, e pasuar pastaj edhe nga Bosnja dhe Hercegovina që borxhin publik në vitin 2016 e kishte rreth 6.7Miliard, pastaj Maqedonia me 3.8Miliard, dhe Mali i Zi me 2.6Miliard.

Nga rezultatet me lartë shohim se Kosova është vendi me borxhin publik me te ulët në kuadër te vendeve të Ballkanit Perëndimor, ku në vitin 2017 vlere ishte 996.4Milion.


Figura 2.38: Borxhi Publik (i shprehur në përqindje të PBB-së) i Shqipërisë 1995-2017



Burimi: Kalkuluar nga Autori, dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar

Duke ju referuar (Figurës 2.38) mund te vërejmë borxhin publik të Shqipërisë (në përqindje të PBB-së) nëpërmjet të dhënave të nxjerra nga Fondit Monetar Ndërkombëtar. Sipas rezultateve të paraqitura në figurën me lartë shohim se rritja me e theksuar e përdorimit të borxhit publik në Shqipëri ka qenë nga viti 1996 deri në vitin 1998, ku borxhi publik kishte arritur vlerën mbi 80 përqind të PBB-së. Ndërsa nëse i analizojmë vitet e fundit të analizës shohim se borxhi publik prape është rritur në Shqipëri, ku në vitin 2015 arriti vlerën prej 73.32 përqind të PBB-së.

Figura 2.39: Borxhi Publik (i shprehur në përqindje të PBB-së) i Bosnjës dhe Hercegovinës 1995-2017




Burimi: Kalkuluar nga Autori, dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar

Rritja e ngarkesës së borxhit publik në Bosnje dhe Hercegovine ka qenë me cikle të ndryshme nga viti në vit. Me konkretisht nëse i referohemi rezultateve të paraqitura në (Figurën 2.39) mund të shohim borxhin publik të Bosnjës dhe Hercegovinës të shprehur në përqindje të PBB-së gjatë periudhës kohore 1995 deri në vitin 2017.

Ku vërejmë se rritja me e theksuar e përdorimit të borxhit publik ka qenë në vitin 1999 më 56.04 përqind të PBB-së, pastaj nga viti 2000 deri në vitin 2007 ka rënë përqindja e përdorimit të borxhit publik në mënyre shumë të shpejt. Ndërsa nga viti 2008 e tutje është rritur prap përqindja e borxhit publik të shprehur në raport me PBB-në, ku në vitin 2015 ishte 44.74 përqind.


Figura 2.40: Borxhi Publik (i shprehur në përqindje të PBB-së) i Maqedonisë 1995-2017



Burimi: Kalkuluar nga Autori, dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar

Nga të rezultatet e paraqitura në (Figurën 2.40) e shohim borxhin publik të Maqedonisë të shprehur në përqindje të PBB-së gjatë periudhës kohore 1995-2017. Sipas të dhënave shohim se rritja me e theksuar në Maqedoni ka qenë gjatë viteve 2000-2002, ku borxhi publik arriti vlerën mbi 40 përqind të PBB-së. Ndërsa nga fillimi i vitit 2003 e deri në vitin 2008 ngarkesa e borxhit publik në Maqedoni ka filluar të bie, ku pas vitit 2008 shohim prape një rritje të shpejt të përdorimit të borxhit publik, ku me e theksuar është në vitin 2015 me 37.95 përqind e PBB-së.


Figura 2.41: Borxhi Publik (i shprehur në përqindje të PBB-së) i Serbisë 1995-2017



Burimi: Kalkuluar nga Autori, dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar

Nga të dhënat e paraqitura nëpërmjet (Figurës 2.41) mund të shohim borxhin publik të Serbisë (në përqindje të PBB-së). Nëse i referohemi viteve te analizës, do të thotë nga viti 1995 deri në vitin 2017 vërejmë se rritja me e theksuar e përdorimit të borxhit publik në Serbi ka qenë nga fillimi i vitit 1998 deri në fund të vitit 2000, ku siç shihet në vitin 2000 borxhi publik arriti vlerën prej 224 përqind të PBB-së. Ndërsa nga viti 2001 e tutje vlera e borxhit publik në raport me PBB-në ka filluar te bie vazhdimisht deri në vitin 2010, ku shihet prape një rritje graduale e ngarkesës së borxhit publik në Serbi. Ku sipas rezultateve me lartë shohim se në vitin 2015 arriti vlerën prej 77.25 përqind të PBB-së.


Figura 2.42: Borxhi Publik (i shprehur në përqindje të PBB-së) i Malit të Zi 1995-2017



Burimi: Kalkuluar nga Autori, dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar

Në (Figurën 2.42) është paraqitur borxhi publik në Malin e Zi i shprehur në përqindje të PBB-së gjatë periudhës kohore 1995-2017. Sipas rezultateve të paraqitura në figurën me lartë shohim se rritja me e theksuar e përdorimit të borxhit publik në Malin e Zi ka qenë në vitin 2002 ku arriti vlerën prej 75.73 përqind të PBB-së, mirëpo pastaj ka filluar te bie gradualisht deri në vitin 2009. Ndërsa nëse i analizojmë vitet e fundit te analizës shohim se borxhi publik prape është rritur në Malin e Zi , ku në vitin 2015 arriti vlerën prej 67.23 përqind të PBB-së.

Figura 2.43: Borxhi Publik (i shprehur në përqindje të PBB-së) i Kosovës 1995-2017



Burimi: Kalkuluar nga Autori, dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar

Sipas rezultateve me lartë shohim se Kosova është njëra nga vendet me borxhin publik me të ulët në kuadër të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Në (Figurën 2.43) mund të shohim trendin e borxhit publik në Kosovë vetëm gjatë periudhës kohore 2006-2015, sepse gjatë viteve të më hershme nuk kemi të dhëna si pasojë e luftës së fundit, si dhe ndarjes së Kosovës nga Serbia. Sipas të dhënave shohim se rritja më e theksuar e përdorimit të borxhit publik në Kosovë ka qenë në vitin 2006 më 28.67 përqind të PBB-së, dhe pastaj ka pasur një rënie graduale deri në vitin 2015. Nga viti 2015 e tutje prape ka filluar rritja e ngarkesës së borxhit publik në Kosovë, mirëpo çka duhet të potencohet, se edhe pse është duke u rritur vazhdimisht prape Kosova është njëra nga vendet me përqindjen më të ulët të përdorimit të borxhit publik në rajon si dhe me gjerë.

2.5.Struktura e Borxhit Publik në Kosovë

2.5.1. Të dhënat për Borxhin Publik në Kosovë (2010-2013)

Tabela 2.5:Të dhënat për Borxhin Publik në Kosovë të shprehura në Milion (2010-2013)

	2010	2011	2012	Qershor 2013
Borxhi i jashtëm	260.42	253.6	336.6	331.26
Niveli Qendror	260.42	253.55	336.46	331.09
Nën-huazimet	0	0.05	0.14	0.17
Garancionet Shtetërore	0	0	0	0
Komunat	0	0	0	0
Borxhi i brendshëm	0	0	73.31	113.15
Niveli Qendror	0	0	73.31	113.15
Komunat	0	0	0	0
Gjithsej Borxhi Publik	260.42	253.6	409.92	444.4
Gjithsej Borxhi Publik si % e PBB-së	6.22%	5.51%	8.44%	8.59%


Burimi: Ministria e Financave Raportet për Borxhin Publik

Punuar nga Autori

Sipas të dhënave të paraqitura në (Tabelën 2.5) mund të shohim të dhënat kryesore për borxhin publik të Kosovës gjatë periudhës (2010-2013), të dhëna këto të cilat janë të shprehura në vlera monetare. Duke ju referuar këtyre rezultateve vërejmë se borxhi i jashtëm publik ka qenë në vitin 2010 (260.42Milion Euro), ndërsa në vitin 2011 shihet një zvogëlim i shumës së borxhit të jashtëm publik në Kosovë që ishte (253.6Milion Euro). Ndërsa rritja më theksuar e borxhit të jashtëm publik në Kosovë ka qenë nga fillimi i vitit 2012 e tutje, ku në këtë vit ishte (336.46Milion Euro), me një ulje të vogël në vitin 2013 më (331.26Milion Euro). Gjithashtu sipas të dhënave që janë paraqitur tek tabela më lartë shihet edhe pjesëmarrja e borxhit të brendshëm publik, ku në vitin 2010 dhe në vitin 2011 pjesëmarrja ishte zero. Ndërsa në vitin 2012 borxhi publik i brendshëm në Kosovë ishte (73.31Milion Euro). Vlen të theksohet se rritja me e lartë e borxhit të brendshëm në Kosovë ishte nga viti 2013 ku sipas të dhënave shihet të jetë (113.15Milion Euro) (Ministria e Financave, Raportet për Borxhin Publik 2010-2013).

Sipas Tabelës kemi edhe kategorinë e nën-huazimeve, ku në vitin 2011 ishte (0.05), në vitin 2012 (0.14), si dhe në vitin 2013 shënojë vlerën me të lartë prej (0.17).

Figura 2.44:Stoku i Borxhit Publik në Kosovë të shprehura në Milion 2010 – Qershor 2013




Burimi: Ministria e Financave Raportet për Borxhin Publik

Punuar nga Autori.

Duke ju referuar Figurës 2.44 shohim stokun e borxhit publik të Kosovës gjatë periudhës kohore nga viti 2010 deri në vitin 2013. Sipas të dhënave shohim se pjesëmarrja ka qenë shumë e lartë e borxhit të jashtëm në raport me borxhin e brendshëm. Ku në vitin 2013 borxhi i jashtëm ishte mbi 300 milion në raport me borxhin e brendshëm që kishte vlerën rreth 100 milion.

Figura 2.45:Portofoli i Borxhit Publik në Kosovë 2010 – Qershor 2013




Burimi: Ministria e Financave Raportet për Borxhin Publik.

Punuar nga Autori.

Sipas Figurës 2.45 mund të vërehet portofolin e borxhit publik të Kosovës nga viti 2010 deri në vitin 2013 i shprehur në përqindje të PBB-së. Ku sipas rezultateve shohim se borxhi i jashtëm ishte rreth 75% e PBB-së, ndërsa borxhi i brendshëm i Kosovës ishte rreth 25% e PBB-së.

Figura 2.46:Portofoli i Borxhit të Jashtëm i ndarë sipas valutës në Kosovë 2010 – Qershor 2013




Burimi: Ministria e Financave Raportet për Borxhin Publik

Punuar nga Autori

Figura 2.46 tregon portofolin e borxhit të jashtëm të ndarë sipas valutave gjatë periudhës kohore 2010-2013. Ku sipas të dhënave të prezantuara në këtë grafik shohim se 77% e borxhit të jashtëm është në valutën Euro, ndërsa vetëm 23% është i shprehur në valutën SDR.

Figura 2.47:Portofoli i Borxhit të Jashtëm i ndarë sipas llojit të interesit në Kosovë 2010 – Qershor 2013



Burimi: Ministria e Financave Raportet për Borxhin Publik⁴

Punuar nga Autori.

⁴ Shënim: Kalkulimi i Grafikave dhe i Tabelave është bërë nga vetë Autori, duke i shfrytëzuar të dhënat nga Ministria e Financave nëpërmjet Raporteve për Borxhin Publik.

Ndërsa Figura 2.47 tregon portofolin e borxhit të jashtëm të ndare sipas llojit të interesit gjatë periudhës kohore 2010-2013. Ku sipas të dhënave të prezantuara në këtë grafik shohim se 66% e borxhit të jashtëm është borxh fikse, ndërsa vetëm 34% është borxh variabil.

2.5.2. Rritja e Borxhit Publik në Kosovë

Borxhi publik i Kosovës gjatë këtij viti ka shënuar rritje, por megjithatë mbetet i ulëti krahasuar me vendet e rajonit. Sipas raportit “Të dhënat tre-mujore mbi Borxhin e Përgjithshëm, tremujori i katërt 2017”, prezantuar nga Ministria e Financave, deri në fund të kësaj periudhe, borxhi publik ka arritur në 996.42 milionë euro nga 852.74 milionë euro sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Shprehur në përqindje, ky borxh ka arritur 16.63 për qind të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB). Borxhi ndërkombëtar në fund të vitit 2017 arriti në 422.15 milionë euro, ku 365.18 milionë euro shfrytëzohen nga qeveria për nevojat e nivelit qendror, ndërsa 56.97 milionë euro është borxh i nën-huazuar. Më së shumti borxh ndërkombëtar Kosova për vitin 2017 i ka Fondit Monetar Ndërkombëtar në shumën prej 160.77 milionë euro, ndjekur nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim në vlerë prej 158.32 milionë euro, kurse pjesën tjetër e përbënë KfW-ja me 54.81 milionë euro, Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim me 41.12 milionë euro dhe UniCredit me 7.04 milionë euro.

Ndryshe, sipas Ligjit për Borxhet Publike, në asnjë rast shuma e papaguar e borxhit të përgjithshëm, nuk duhet të tejkalojë dyzet për qind të PBB-së. Në rast se borxhi e tejkalon këtë përqindje, atëherë Qeveria duhet t’i paraqesë Kuvendit strategjinë për të kthyer Borxhin e Përgjithshëm nën pragun dyzet për qind (TM4 i vitit 2017 i Borxhit Publik nga Ministria e Financave). Ndonëse Republika e Kosovës ende ka një shkallë relativisht të ulët të ngarkesës me borxhin publik, dinamika dhe struktura e tij si dhe dobësitë e theksuara në menaxhimin e borxhit, veçanërisht lidhur me përgatitjen dhe zbatimin e projekteve dhe shfrytëzimin e destinuar të tyre, shtrojnë nevojën për përmirësimin e organizimit institucional dhe rritjen e kapaciteteve absorbuese në nivel të Qeverisë, MF-së dhe zbatuesve të projekteve. Borxhi publik, veçanërisht komponenti i tij i brendshëm, ka arritur një intensitet dhe dinamikë dukshëm më të lartë sesa GDP-ja, ndaj PBSH-së, përkatësisht strategjia e menaxhimit të tij duhet patjetër të zhvillojë edhe komponentin afatmesëm dhe afatgjatë të implikimeve të tij në konfiguracionin e tij makroekonomik, në qëndrueshmërinë fiskale dhe efekteve në rritjen ekonomike e mirëqenien sociale (Menaxhimi i Borxhit Publik në Kosovë, Riinvest).

2.5.3. Të dhënat për Borxhin Publik në Kosovë (2013-2018)

Tabela 2.6:Portofoli i Borxhit të Përgjithshëm në Kosovë të shprehura në Milion (2013-2018)

	2013	2014	2015	2016	2017	2018TM1
Borxhi Ndërkombëtar	323.76	326.35	371.17	373.77	422.15	415.98
Niveli Qendror	321.73	316.54	339.87	323.93	365.18	358.55
Nën-huazimet	2.03	9.81	31.3	49.83	56.97	57.43
Komunat	0	0	0	0	0	0
Borxhi i brendshëm	152.51	256.52	377.78	478.97	574.27	612.49
Niveli Qendror	152.51	256.52	377.78	478.97	574.27	612.49
Komunat	0	0	0	0	0	0
Gjithsej Borxhi i Përgjithshëm	476.27	582.87	748.95	852.74	996.42	1.028.47
Garancitë Shtetërore	0	10	10	20	44	44
Gjithsej Borxhi i Përgjithshëm	8.94%	10.65%	13.07%	14.58	16.63	16.15%
(%PBV-Së)						


Burimi: Vlerat e PBB-së për 2009-2016 janë marrë nga ueb faqja e Agjencionit të Statistikave të Kosovës, për vitin 2017 dhe 2018 janë nga Ligji i Buxhetit për vitet përkatëse.

Punuar nga Autori.

Në rezultatet e paraqitura në (Tabelën 2.6) shohim portofolin e borxhit të përgjithshëm në Kosovë të shprehura në vlera monetare gjatë periudhës (2013-2018). Vlerat e PBB-së për 2009-2016 janë marrë nga ueb faqja e Agjencionit të Statistikave të Kosovës, për vitin 2017 dhe 2018 janë nga Ligji i Buxhetit për vitet përkatëse. Tabela është e përberë nga disa pjesë të cilat ndërtojnë Borxhin e Përgjithshëm të Kosovës të tilla si: Borxhi Ndërkombëtar, Borxhi i Brendshëm, si dhe Borxhi i Përgjithshëm. Duke ju referuar të dhënave me lartë shohim se borxhi ndërkombëtar në vitin 2013 ishte (323.76Milion), pastaj me një rritje të lehtë në vitin 2014 më (326.35Milion), përsëri shënon rritje në vitin 2015 (371.17Milion)dhe 2016 më (373.77Milion). Ndërsa rritja me e theksuar dhe me e lartë e borxhit të jashtëm shihet të jetë gjatë viteve 2017 dhe 2018, ku në vitin 2017 shënojë vlerën prej (422.15Milion) dhe 2018 (415.98Milion).

Gjithashtu sipas rezultateve të dhëna në tabelën me lartë shohim edhe strukturën e borxhit të brendshëm të Kosovës gjatë periudhës 2013-2018. Ku në vitin 2013 borxhi i brendshëm ishte prej (152.51Milion), në vitin 2014 (256.52Milion), në vitin 2015 shënon një rritje me të lartë që ishte (377.78Milion), 2016 me (478.97Milion), 2017 me (574.27Milion), si dhe rritja me e theksuar e Borxhit të Brendshëm në Kosovë është shënuar në vitin 2018 më (612.49Milion). Njëkosishtë në Tabelë është paraqitur edhe struktura e borxhit të përgjithshëm në Kosovë gjatë periudhës 2013-2018. Ku shihet se nga viti në vit ka pasur vazhdimisht rritje të nivelit të borxhit publik. Rritja me e theksuar shihet të jetë nga viti 2016 ku borxhi i përgjithshëm publik shënojë vlerën prej (852.74Milion), pastaj në vitin 2017 me (996.42Milion), si dhe rritja me e lartë e shënuar ndonjëherë në Kosovë e borxhit publik është në vitin 2018 me (1.028.47Miliard) vlerë kjo e cila vazhdon të rritet tutje (Agjensioni i Statistikave të Kosovës 2013-2018)

Figura 2.48:Trendi i Borxhit të Përgjithshëm në Kosovë i shprehur në Milion (2013-2018)




Burimi: Vlerat e PBB-së për 2009-2016 janë marrë nga ueb faqja e Agjencionit të Statistikave të Kosovës, për vitin 2017 dhe 2018 janë nga Ligji i Buxhetit për vitet përkatëse.

Punuar nga Autori.

Nëpërmjet Figurës 2.48 mund të vërejmë trendin e borxhit të përgjithshëm të Kosovës gjatë periudhës kohore 2013-2018. Sipas rezultateve shohim se borxhi publik në Kosovë është rritur në mënyrë graduale nga viti 2013, çka do të thotë se çdo vit kemi pasur një rritje të caktuar të borxhit publik. Ku niveli më i lartë i borxhit publik vërehet të jetë nga viti 2018 e tutje.


Figura 2.49:Trendi i Borxhit të Përgjithshëm në Kosovë i shprehur në Përqindje (2013-2018)



Burimi: Vlerat e PBB-së për 2009-2016 janë marrë nga ueb faqja e Agjencionit të Statistikave të Kosovës, për vitin 2017 dhe 2018 janë nga Ligji i Buxhetit për vitet përkatëse. Punuar nga Autori.

Ndërsa nga Figura 2.49 vërejmë trendin e borxhit publik të Kosovës të shprehur në përqindje nga viti 2013 deri në vitin 2018. Ku shohim se rritja me e lartë është paraqitur në vitin 2017 me 16.63% në raport me PBB-në.

Figura 2.50:Raporti i Borxhit të Përgjithshëm në Kosovë (Borxhi Ndërkombëtar dhe Borxhi i Brendshëm) i shprehur në Milion(2013-2018)




Burimi: Vlerat e PBB-së për 2009-2016 janë marrë nga ueb faqja e Agjencionit të Statistikave të Kosovës, për vitin 2017 dhe 2018 janë nga Ligji i Buxhetit për vitet përkatëse. Punuar nga Autori.

Duke ju referuar Figurës 2.50 në këtë pjesë të studimit vërejmë raportin e borxhit të përgjithshëm të Kosovës nga viti 2010 deri në vitin 2013.

Me konkretisht këtu shohim strukturën e borxhit të ndërkombëtar si dhe borxhin e brendshëm të Kosovës. Ku nëse i analizojmë vitet e fundit shohim se pjesëmarrja e borxhit të brendshëm ka qenë me e lartë se sa e borxhit ndërkombëtar në Kosovë, si p.sh në vitin 2018 borxhi i brendshëm arrin vlerën afër 600Milion, ndërsa borxhi ndërkombëtar sillet rreth 300 Milion.

Figura 2.51:Nën-Huazimet nga Borxhi i Jashtëm, të shprehura në Milion (2013-2018)



Burimi: Vlerat e PBB-së për 2009-2016 janë marrë nga ueb faqja e Agjencionit të Statistikave të Kosovës, për vitin 2017 dhe 2018 janë nga Ligji i Buxhetit për vitet përkatëse Punuar nga Autori

Figura 2.51 na tregon nën-huazimet nga borxhi i jashtëm gjatë periudhës kohore 2013-2018. Ku sipas rezultateve shohim se kategoria e nën-huazimeve nga borxhi i jashtëm është rritur në mënyrë shumë të shpejt nga viti 2013 deri në tremujorin e parë të vitit 2018 me rreth 60 milion.

Tabela 2.7:Portofoli i Borxhit sipas Valutës në Kosovë, të shprehura në Milion (2013-2018)

Vitet	2013	2014	2015	2016	2017	TM1-2018
Borxhi I Përgjithshëm	476.27	582.87	748.95	852.74	996.42	1,028.47
EUR	402.34	506.15	650.92	758.85	856.91	889.63
SDR	73.93	76.73	98.03	93.89	139.51	138.84
Borxhi Ndërkombëtar	323.76	326.35	371.17	373.77	422.15	415.98
EUR	249.83	249.63	273.14	279.88	282.64	277.14


SDR	73.93	76.73	98.03	93.89	139.51	138.84
Borxhi i Brendshëm	152.51	256.52	377.78	478.97	574.27	612.49
EUR	152.51	256.52	377.78	478.97	574.27	612.49

Shënim: Te pozicioni i SDR⁵ është paraqitur vlera neto e ekspozuar, e cila nënkupton shumën e ekspozuar duke përjashtuar komponentin Euro. Burimi: Agjencioni i Statistikave të Kosovës, Ministria E Financave, si dhe Ligji i Buxhetit.

Punuar nga Autori.

Nga Tabela 2.7 mund të shohim portofolin e borxhit sipas valutës në Kosovë gjatë periudhës kohore nga viti 2013 deri në vitin 2018. Duke ju referuar strukturës së tabelës vërejmë borxhin e përgjithshëm në Euro dhe SDR nga viti 2013 deri në vitin 2018, pastaj borxhin ndërkombëtar në Euro dhe SDR, si dhe në fund borxhin e brendshëm të shprehur në Euro dhe SDR.

Figura 2.52: Portofoli i Borxhit sipas valutës në Kosovë (Borxhi i Përgjithshëm, EUR, SDR), të shprehura në Milion (2013-2018)




Burimi: Agjencioni i Statistikave të Kosovës, Ministria E Financave, si dhe Ligji i Buxhetit.

Punuar nga Autori

Me konkretisht në Figurën 2.52 vërejmë portofolin e borxhit në Kosovë sipas kategorisë së borxhit të përgjithshëm të shprehur në Euro dhe SDR. Sipas rezultateve shohim se pjesëmarrja më e madhe e borxhit të përgjithshëm ka qenë e shprehur në valutën Euro gjatë periudhës kohore 2013-2019.

⁵Shënim: SDR është një 'shportë' monedhash e cila përbëhet nga monedhat si në vijim: EUR, USD, GBP, JPY dhe CNY. Vlera e SDR përcaktohet në bazë të një mesatare e cila është e tërhequr nga vlerat e monedhave të përmendura më lartë. Kjo shportë rishikohet çdo pesë vite nga Bordi Ekzekutiv i FMN-së.

Figura 2.53:Portofoli i Borxhit sipas Valutës në Kosovë (Borxhi Ndërkombëtar,EUR,SDR), të shprehura në Milion (2013-2018)




Burimi: Agjencioni i Statistikave të Kosovës, Ministria E Financave, si dhe Ligji i Buxhetit.

Punuar nga Autori

Gjithashtu edhe në Figurën 2.53 është paraqitur portofoli i borxhit në Kosovë sipas kategorisë së borxhit ndërkombëtar të shprehur në Euro dhe SDR. Sipas rezultateve shohim se pjesëmarrja me e madhe e borxhit të përgjithshëm ka qenë e shprehur në valutën Euro gjatë periudhës kohore 2013-2019.

Figura 2.54:Portofoli i Borxhit sipas Valutës në Kosovë (Borxhi Brendshëm,EUR,SDR), të shprehura në Milion (2013-2018)



Burimi: Agjencioni i Statistikave të Kosovës, Ministria E Financave, si dhe Ligji i Buxhetit

Punuar nga Autori

Figura 2.54 paraqet borxhin e brendshëm gjatë periudhës 2013-2018. Ku vërehet se pjesëmarrja e borxhit të brendshëm ka qene e shprehur vetëm në valutën Euro dhe jo në valuta të tjera.

Tabela 2.8:Portofoli i Borxhit sipas Interesit në Kosovë, të shprehura në Milion (2013-2018)

Vitet	2013	2014	2015	2016	2017	TM1-2018
Borxhi I Përgjithshëm	476.27	582.87	748.95	852.74	996.42	1,028.47
Fiks	370.54	481.14	621.21	738.78	835.65	868.72
Variabil	105.73	101.73	127.74	113.96	160.77	159.74
Borxhi Ndërkombëtar	323.76	326.35	371.17	373.77	422.15	415.98
Fiks	218.03	224.62	243.43	259.81	261.38	256.23
Variabil	105.73	101.73	127.74	113.96	160.77	159.74
Borxhi I Brendshëm	152.51	256.52	377.78	478.97	574.27	612.49
Fiks	152.51	256.52	377.78	478.97	574.27	612.49

Shënim: Te pozicioni i SDR është paraqitur vlera neto e ekspozuar, e cila nënkupton shumën e ekspozuar duke përjashtuar komponentin Euro.


Burimi: Agjencioni i Statistikave të Kosovës, Ministria E Financave, si dhe Ligji i Buxhetit.

Punuar nga Autori.

Nga Tabela 2.8 mund të vërejmë portofolin e borxhit sipas interesit në Kosovë gjatë periudhës kohore nga viti 2013 deri në vitin 2018.

Duke ju referuar strukturës së tabelës shohim borxhin e përgjithshëm të shprehur nëpërmjet kategorive Fiks dhe Variabil, pastaj borxhin ndërkombëtar në Fiks dhe Variabil, si dhe në fund borxhin e brendshëm të shprehur në këto të njëjta kategori.

Figura 2.55:Portofoli i Borxhit sipas Interesit (i Përgjithshëm, Fiks,dhe Variabil) në Kosovë, të shprehura në Milion (2013-2018)




Burimi: Agjencioni i Statistikave të Kosovës, Ministria E Financave, si dhe Ligji i Buxhetit.

Punuar nga Autori

Nëpërmjet Figurës 2.55 vërejmë borxhin e përgjithshëm të Kosovës sipas interesit të shprehur në kategorinë e borxhit fiks dhe atij variabil. Ku sipas rezultateve shohim se pjesëmarrja me lartë e borxhit të përgjithshëm është e shprehur në kategorinë e borxhit fiks.

Figura 2.56:Portofoli i Borxhit sipas Interesit (Borxhi Ndërkombëtar, Fiks,dhe Variabil) në Kosovë, të shprehura në Milion (2013-2018)




Shënim: Te pozicioni i SDR është paraqitur vlera neto e ekspozuar, e cila nënkupton shumën e ekspozuar duke përjashtuar komponentin Euro.

Burimi: Agjencioni i Statistikave të Kosovës, Ministria e Financave, si dhe Ligji i Buxhetit.

Punuar nga Autori.

Ndërsa nga Figura 2.56 shohim portofolin e borxhit ndërkombëtar sipas interesit, i shprehur në borxhin Fiks dhe Variabil në Kosovë. Ku vërejmë se pjesëmarrja e borxhit ndërkombëtar është pothuajse e balancuar në raport mes borxhit fiks dhe atij variabil.

Figura 2.57: Portofoli i Borxhit sipas Interesit (Borxhi i Brendshëm, Fiks, dhe Variabil) në Kosovë, të shprehura në Milion (2013-2018)



Shënim: Te pozicioni i SDR është paraqitur vlera neto e ekspozuar, e cila nënkupton shumën e ekspozuar duke përjashtuar komponentin Euro

Burimi: Agjencioni i Statistikave të Kosovës, Ministria E Financave, si dhe Ligji i Buxhetit.

Punuar nga Autori

Figura 2.57 paraqet borxhin e brendshëm sipas interesit gjatë periudhës 2013-2018.

Ku vërehet se pjesëmarrja e borxhit të brendshëm në Kosovë ka qenë e shprehur vetëm në borxhin fiks.

Tabela 2.9:Stoku I Borxhit Ndërkombëtar në Kosovë (2013-2018), i shprehur në Milion

	2013	2014	2015	2016	2017	TM1-2018
Borxhi Ndërkombëtar	323.76	326.35	371.17	373.77	422.15	415.98
Qeveria Qendrore	321.73	316.54	339.87	323.93	365.18	358.55
Borxhi I Nën-Huazuar	2.03	9.81	31.3	49.83	56.97	57.43
Borxhi Ndërkombëtar(% e PBB-Së)	6.08%	5.86%	6.39%	6.25%	6.75%	6.26%


Shënim: Borxhi Ndërkombëtar ndryshon nëpër vite dhe tre-mujor edhe si rrjedhojë e ndryshimit të kursit valutor.

Burimi: Vlerat e PBB-së për 2009-2016 janë marrë nga ueb faqja e Agjencionit të Statistikave të Kosovës, për vitin 2017 dhe 2018 janë marrë nga Ligji i Buxhetit për vitet përkatëse.

Punuar nga Autori

Duke ju referuar Tabelës 2.9 mund të shohim stokun e borxhit ndërkombëtar të Kosovës gjatë periudhës kohore 2013-2018. Me konkretisht sipas tabelës vërejmë strukturën e borxhit ndërkombëtar të shprehur nëpërmjet kategorisë se nivelit qendror dhe borxhit të nën-huazuar.

Figura 2.58:Stoku i Borxhit Ndërkombëtar në Kosovë (2013-2018), i shprehur në Milion




Burimi: Vlerat e PBB-së për 2009-2016 janë marrë nga ueb faqja e Agjencionit të Statistikave të Kosovës, për vitin 2017 dhe 2018 janë marrë nga Ligji i Buxhetit për vitet përkatëse

Punuar nga Autori.

Nëpërmjet Figurës 2.58 mund të shohim stokun e borxhit ndërkombëtar të shprehur nga niveli qendror dhe borxhi i nën-huazuar.

Sipas rezultateve shohim se stoku i borxhit ndërkombëtar është i shprehur në një nivel mjaft të lartë nga niveli qendror në raport me borxhin e nën-huazuar të kësaj kategorie.

Figura 2.59: Borxhi Ndërkombëtar i shprehur si përqindje e PBB-së (2013-2018)



Burimi: Vlerat e BPV-së për 2009-2016 janë marrë nga ueb faqja e Agjencionit të Statistikave të Kosovës, për vitin 2017 dhe 2018 janë marrë nga Ligji i Buxhetit për vitet përkatëse.

Punuar nga Autori.

Ndërsa duke ju referuar Figurës 2.59 mund të shohim borxhin ndërkombëtar të shprehur në përqindje të PBB-së gjatë periudhës kohore 2013-2018. Nga rezultatet vërejmë së rritja e borxhit ndërkombëtar si % e PBB-së ka qenë më e lartë në vitin 2015 me rreth 6%, si dhe në vitin 2017 me 6.5% në raport me PBB-në.

Tabela 2.10: Borxhi Ndërkombëtar sipas Kreditorëve në Kosovë (2013-2018), i shprehur në Milion


Kreditori	2013	2014	2015	2016	2017	TM1-2018
BRNZH	203.66	192.33	180.99	169.65	158.32	152.65
ANZH	12.37	20.84	28.86	36.02	41.12	41.57
FMN	105.73	101.73	127.74	113.96	160.77	159.74
KFW	2	9.46	30.62	47.64	54.81	54.78
UNI-CREDIT	-	2	2.96	6.49	7.04	7.04
BIZH	0	0	0	0	0.1	0.2
TOTAL	323.76	326.35	371.17	373.77	422.15	415.98

Burimi: Vlerat e BPV-së për 2009-2016 janë marrë nga ueb faqja e Agjencionit të Statistikave të Kosovës, për vitin 2017 dhe 2018 janë marrë nga Ligji i Buxhetit për vitet përkatëse.

Punuar nga Autori.

Sipas të dhënave të paraqitura në Tabelën 2.10 shohim borxhin ndërkombëtar sipas kreditorëve në Kosovë gjatë periudhës kohore 2013-2018. Nga tabela shohim pjesëmarrjen e kreditorëve si p.sh BRNZH, ANZH, FMN, KFW. Sipas rezultateve shohim se BRNZH dhe FMN kanë pasur një nivel mjaft të lartë të kreditimit në kuadër të borxhit ndërkombëtar të Kosovës, ku në vitin 2018 pjesëmarrja e kreditimit nga BRNZH ishte rreth 152.65 Milion, si dhe e FMN-së më 159.74 Milion.

Figura 2.60: Borxhi Ndërkombëtar sipas Kreditorëve në Kosovë (2013-2018), i shprehur në Milion



Burimi: Vlerat e BPV-së për 2009-2016 janë marrë nga ueb faqja e Agjencionit të Statistikave të Kosovës, për vitin 2017 dhe 2018 janë marrë nga Ligji i Buxhetit për vitet përkatëse.

Punuar nga Autori

Tabela 2.11:Stoku i Borxhit të Brendshëm në Kosovë (2013-2018), i shprehur në Milion


Borxhi I Brendshëm Neto	2013	2014	2015	2016	2017	TM1-2018
Emetimet e Reja	79.2	104.01	121.26	101.19	95.3	38.22
Stoku i Borxhit	152.51	256.52	377.78	478.97	574.27	612.49
Borxhi I Brendshëm (% E PBB-së)	2.86%	4.61%	6.51%	8.00%	9.18%	9.22%

Burimi: Vlerat e BPV-së për 2009-2016 janë marrë nga ueb faqja e Agjencionit të Statistikave të Kosovës, për vitin 2017 dhe 2018 janë marrë nga Ligji i Buxhetit për vitet përkatëse.

Punuar dhe Llogaritur nga Autori

Në tabelën 2.11 është paraqitur stoku i borxhit të brendshëm të Kosovës gjatë periudhës kohore 2013-2018. Borxhi i brendshëm neto është në përbërje të disa kategorive si p.sh: emetimet e reja, stoku i borxhit, si dhe paraqitja e borxhit të brendshëm në përqindje të PBB-së. Nëpërmjet rezultateve shohim se pjesëmarrja e emetimeve të reja është e ulët në raport me stokun e borxhit, ku p.sh në vitin 2018 emetimet e reja ishin rreth 95.3 milion, ndërsa stoku i borxhit ishte rreth 574.27 milion.

Figura 2.61:Emetimet e Reja në Kosovë (2013-2018), të shprehur në Milion




Burimi: Agjencioni i Statistikave të Kosovës si dhe Ligji i Buxhetit.

Punuar nga Autori

Figura 2.61 tregon emetimet e reja në Kosovë gjatë periudhës kohore 2013-2018, ku sipas rezultateve vërehet se pjesëmarrja e tyre ka qene e ulët në raport me stokun e borxhit.

Figura 2.62:Stoku i Borxhit në Kosovë (2013-2018), të shprehur në Milion




Burimi: Agjencioni i Statistikave të Kosovës si dhe Ligji i Buxhetit

Punuar nga Autori

Figura 2.62 tregon stokun e borxhit të Kosovës të shprehur në vlera monetare gjatë periudhës kohore 2013-2018. Nga rezultatet shohim se stoku i borxhit ka shënuar rritje të vazhdueshme nga viti 2013 e tutje, ku në vitin 2018 shënojë vlerën prej 574.27 milion.

Figura 2.63:Borxhi i Brendshëm në Kosovë (% E PBB-Së) (2013-2018), të shprehur në Milion



Burimi: Agjencioni i Statistikave të Kosovës si dhe Ligji i Buxhetit.

Punuar nga Autori

Ndërsa Figura 2.63 tregon stokun e borxhit të Kosovës të shprehur në përqindje të PBB-së gjatë periudhës kohore 2013-2018. Nga rezultatet shohim se stoku i borxhit ka shënuar rritje të vazhdueshme nga viti 2013 e tutje.

2.5.4. Karakteristikat e Portofolit të Borxhit Shtetëror të Kosovës 2016-2017

Tabela 2.12:Krahasimi i indikatorëve të Borxhit Publik për vitin 2016 dhe 2017 në Kosovë

		Borxhi Publik 2016			Borxhi Publik 2017		
		Ndërkombëtar	Brendshëm	Totali	Ndërkombëtar	Brendshëm	Totali
Shuma (në mil EUR)		373.8	479.0	852.7	421.2	574.2	996.42
Borxhi si % e BPV		6.2	7.9	14.58	6.7	9.2	16.63
Kosto e Borxhit	Pagesat e interesit si % e BPV	0.2	0.1	0.3	0.2	0.1	0.3
	Mesatarja e peshuar e normave të interesit (%)	2.9	1.4	2.1	3.0	1.0	1.8
Risku i rifinancimit	Borxhi që maturon në 1vit (% e totalit)	15.7	57.2	39.0	13.7	46.9	32.9
	Borxhi që maturon në 1vit (% e BPV)	1.0	4.5	5.5	0.8	4.3	4.7
Risku i normave të interesit	KMR (vite)	5.8	1.3	3.3	4.9	1.8	3.1
	Borxhi që ri-fiksohet në 1vit (% e totalit)	34.8	57.2	47.4	42.3	46.9	45.0
	Borxhi me normë fikse (% e totalit)	69.5	100.0	86.6	61.9	100.0	83.9
Risku i normave të këmbimit valutor	Borxhi ndërkombëtar (% e borxhit total)			46.7			42.3
	Borxhi në EURO/ (% e borxhit total)			87%			84%

Burimi: Qeveria e Kosovës (Ministria e Financave) Programi i Borxhit Shtetëror 2019-2021

Punuar nga Autori

Struktura e borxhit të përgjithshëm shtetëror përbëhet prej borxhit ndërkombëtar, borxhit të brendshëm dhe garancioneve shtetërore. Bazuar në të dhënat e fundit të vitit 2017, borxhi i tërësishëm shtetëror ishte 996.42 milion euro. Prej tyre 574.27 ishin borxh i brendshëm dhe 422.15 ishin borxh ndërkombëtar. Garancionet ishin në shumën e tërësishme prej 44 milionë euro me rritjen e shënuar gjatë vitit 2017. Në vitin 2017, përqindja e total borxhit ndaj PBB-së ka shënuar rritje prej afërsisht 1.8% në krahasim me vitin e kaluar duke arritur në 16.63%, që është brenda kufizimit prej 40% siç përcaktohet në Ligjin për Borxhin Publik. Nga ana tjetër kosto e shërbimit të borxhit në total nuk ka pësuar ndryshime relevante. Raporti i pagesave të interesit ndaj PBB-së ka qëndruar në nivelin e njëjtë me vitin paraprak.


Mesatarja e peshuar e interesit ka shënuar një rënie të lehtë në borxhin e brendshëm dhe një ngritje poashtu të lehtë në borxhin ndërkombëtar, duke reflektuar rënie në total prej 0.3% krahasuar me vitin paraprak. Treguesit e riskut të rifinancimit kanë shënuar zhvillime pozitive. Përqindja e borxhit të brendshëm që duhej të rifinancohej brenda vitit, ishte identifikuar si çështje për vëmendje shtesë në programin e kaluar. Me marrjen e masave për zgjatjen e maturitetit të portofolit vendor ky tregues është zvogëluar në 47%, apo 10 % më e ulët nga viti i kaluar, duke ruajtur kufizimin brenda përcaktimeve të PBSH 2018-2020 me 32.9% (Qeveria e Kosovës, Ministria e Financave- Programi i Borxhit Shtetëror 2019-2021).

Koha mesatare e maturimit (KMM) e borxhit të brendshëm ka pasur poashtu rritje dhe është në përputhje me PBSH 2018-2020, ku përcaktohet se ky tregues duhet të jetë më i madh se 1 vit. KMM e portofolit të borxhit të brendshëm sipas fund vitit 2017 ishte 1.8 vite. Deri në fund të vitit 2018 ky tregues pritet të arrijë në 2.3 vite si rezultat i një strukture të planifikuar të borxhit vendor me maturitete më të gjata, përfshirë edhe paraqitjen e instrumenteve të reja. Përqindja e borxhit me normë fikse të interesit është zvogëluar, në raport me normat variabile të interesit. Borxhi me normë variabile është rritur mirëpo vazhdon të qëndrojë brenda kufizimit prej 30% të përcaktuar në PBSH 2018-2020. Është synim i përgjithshëm i menaxhimit të borxhit që borxhi i jashtëm të kontraktohet me norma fikse, mirëpo meqenëse Kosova tanimë është vend ANZH i Përzierl⁶, ekspozimi ndaj ecurisë së normave në tregun ndërkombëtar është i pashmangshëm.

⁶Shënim: Vendet që konsiderohen IDA-Blend janë subjekt i kreditimit të butë me norma të ulëta të kamatës dhe maturitete afatgjata mirëpo edhe i kreditimit jokoncesional më bazë në ecurinë e tregjeve.

Në linjë me objektivën e zhvillimit të tregut vendor, borxhi i brendshëm ka shënuar rritje, duke u zvogëluar borxhi ndërkombëtar si përqindje e totalit për afër 2%. Adaptimi i Euros si valutë vendore ka kontribuar në zvogëlimin e riskut valutor. Kështu, 84% e borxhit të përgjithshëm është i denominuar në euro. Për shkak se ky tregues ka shënuar rënie në krahasim me vitin paraprak, përqindja prej 16% e borxhit total e denominuar në valuta tjera qëndron brenda kufizimit prej 30% të caktuar në PBSH 2018-2020. Marrë parasysh vlerësimet e mësipërme, mund të shohim se objektivat e caktuara në programin e kaluar janë përmbushur me sukses. Megjithatë, në funksion të zhvillimit të mëtejshëm të tregut të brendshëm shitja me pakicë e obligacioneve mbetet synim për t'u realizuar në vitet e ardhshme (Qeveria e Kosovës, Ministria e Financave- Programi i Borxhit Shtetëror 2019-2021).

Figura 2.64. Krahasimi i Borxhit Publik të Brendshëm dhe Ndërkombëtar për vitin 2016 dhe 2017 në Kosovë



Burimi: Qeveria e Kosovës (Ministria e Financave) Programi i Borxhit Shtetëror 2019-2021

Punuar nga Autori

Nëpërmjet Figurës 2.64 është bërë krahasimi i borxhit publik të brendshëm si dhe atij ndërkombëtar për vitin 2017 në Kosovë. Ku sipas rezultateve shohim se totali i borxhit në Kosovë në vitin 2017 ishte 852.7 milion (4.58% e PBB-së). Ndërsa borxhi i brendshëm ishte rreth 479 milion (7.9% e PBB-së), ndërsa borxhi ndërkombëtar ishte në një nivel më të ulët në raport me borxhin e brendshëm ku në vitin 2017 shënoje vlerën prej 373.9 milion (6.2% e PBB-së).

Tabela 2.13: Tërheqjet sipas kreditorëve në Kosovë


Kreditori	2013	2014	2015	2016	2017	TM1 2018
ANZh	4.42	7.37	6.53	7.01	7.95	0.71
FMN	0	0	35.64	35.62	100.38	0
UniCredit	0	2.00	0.96	3.54	0.55	0
KfW	1.86	7.46	22.49	22.47	13.40	0.04
BIZh	0	0	0	0	0.10	0.10
Total	6.28	16.83	65.62	68.64	108.34	0.85

Burimi: Të dhënat tre-mujore mbi Borxhin e Përgjithshëm në Kosovë TM1 (2018)

Punuar nga Autori

2.5.5. Borxhi Ndërkombëtar në Kosovë

Figura 2.65: Tërheqjet sipas kreditorëve në Kosovë



Burimi: Të dhënat tre-mujore mbi Borxhin e Përgjithshëm në Kosovë TM1 (2018). Punuar nga Autori

Duke ju referuar të dhënave të publikuara nga Ministria e Financave nëpërmjet raportit tre-mujor mbi Borxhin e Përgjithshëm të Kosovës mund ti shohim tërheqjet sipas kreditorëve në Kosovë nga viti 2013 deri në vitin 2018. Sipas (Figurës 2.65) mund të shohim disa nga kreditorët kryesorë gjatë kësaj periudhe kohore. FMN (Fondi Monetar Ndërkombëtar) ka kredituar me një përqindje me të lartë në krahasim me kreditorët e tjerë të Kosovës, ku gjatë vitit 2015 ishte (35.64%) dhe kishte shënuar rritje shumë të shpejtë në vitin 2017 me (100.38%), e pasuar nga KfW

(Agjencia Gjermane për Rindërtim) ku sipas tërheqjeve të kreditorëve në Kosovë në vitin 2015 ishte (7.46%), 2016 kishte shënuar një rritje me të lartë me (22.49%). Ndërsa sipas të dhënave nga ky raport të publikuar nga Ministria e Financave të Kosovës tërheqjet e kreditorëve të tjerë të Kosovës kishin një përqindje me të ulët që sillet rreth (0.10% deri në 13.40%).

Tabela 2.14: Shërbimi i Borxhit Ndërkombëtar sipas kreditorëve

Kreditori	Shërbimi i Borxhit	2013	2014	2015	2016	2017	TM1 2018
BNRZh	Kryegjë	11.34	11.34	11.34	11.34	11.34	5.67
Interes	8.94	8.46	7.98	7.50	7.03	3.33	
ANZh	Kryegjë	0	0	0	0	0	0
Interes	0.07	0.1	0.19	0.26	0.34	0.06	
FMN	Kryegjë	2.7	10.7	16.21	49.21	41.06	0
Interes	1.10	1.10	1.41	1.77	2.59	0.71	
UniCredit	Kryegjë	0	0	0	0	0	0
Interes	0	0.07	0.02	0.08	0.07	0.02	
KfW	Kryegjë	0	0	1.33	5.45	6.24	0.07
Interes	0.13	0.54	0.91	1.68	1.98	0	
Total	24.28	32.37	39.38	77.29	70.63	9.86	

Burimi: Të dhënat tre-mujore mbi Borxhin e Përgjithshëm në Kosovë TM1 (2018)

Punuar nga Autori

Nëpërmjet të dhënave financiare të paraqitura në (Tabelën 2.14) shohim llojet e kreditorëve në Kosovë gjatë viteve 2013- 2018 të tillë si (BNRZH, ANZH, FMN, UNI-CREDIT, KfW). Gjithashtu në këtë tabelë janë të vendosura edhe rubrika e kryegjësë dhe interesit. Ku sipas të dhënave shohim tek FMN se Kryegjëja është rritur vazhdimisht nga viti 2013 që ishte (2.7) në (41.06) në vitin 2018.

Po ashtu edhe norma e interesit të paguar për këto fonde të (FMN-së) nga ana e institucioneve të Kosovës ka shënuar ngritje nga (1.10) në vitin 2013 deri në (2.59) në vitin 2017. Ndërsa kreditorët e tjerë të paraqitur në tabelën paraprake vendosen me një pjesëmarrje me të ulët. Ndërsa totali i shërbimit të borxhit që përfshijnë Kryegjënë dhe Interesin në vitin 2013 ishte (24.28), 2014 (32.37), 2015 (39.38), 2016(77.29), 2017 (70.63) (Borxhin i Përgjithshëm në Kosovë TM1, 2018)

Tabela 2.15:Marrëveshjet Financiare Ndërkombëtare efektive në TM1 2018

Emri i Kredisë	Kreditori	OB Zbatuese	Huazim Direkt/Nën-huazim	Data e Marrëveshjes	Valuta e Marrëveshjes	Shuma në Marrëveshje	Statusi
Projekti për Konkurrueshmëri dhe Gatishmëri për Eksport	ANZh	MTI	Huazim Direkt	2.8.18	EUR	14.30	Ratifikuar
Financimit Shtesë për Projektin për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural	ANZh	MBPZHR	Huazim Direkt	2.8.18	EUR	20.80	Ratifikuar

Burimi: Të dhënat tre-mujore mbi Borxhin e Përgjithshëm në Kosovë TM1 (2018)

Punuar nga Autori

Tabela 2.16:Stoku i borxhit ndërkombëtar dhe borxhi i zotuar i pa-disbursuar

Kreditori	Borxhi i Ratifikuar Aktual (A)	Borxhi i Disbursuar (B)	Borxhi i Pa-disbursuar (C=A-B)	Borxhi i pakthyer (D=B-E)	Kthimi i Borxhit (E)	Borxhi i pa-disbursuar si % e BPV	Borxhi i disbursuar (pakthyer) % e BPV
IBRD	381.21	381.21	0.00	152.65	228.56	0%	2.30%
IDA	145.86	41.57	104.29	41.57	0.00	1.57%	0.63%
FMN	287.38	287.38	0.00	159.74	119.84	0%	2.41%

KfW	71.00	67.86	3.14	54.78	13.07	0.05%	0.82%
UniCredit	7.04	7.04	0.00	7.04	0.00	0%	0.11%
OFID, IsDB, SFD	44.80	0.20	44.60	0.20	0.00	0.67%	0%
EBRD	68.90	0.00	68.90	0.00	0.00	1.04%	0%
EIB	42.00	0.00	42.00	0.00	0.00	0.63%	0%
NATIXIS Franca	66.00	0.00	66.00	0.00	0.00	0.99%	0%
Borxhi Ndërkom bëtar	1,114.18	785.25	328.94	415.98	361.48	4.95%	6.26

Burimi: Të dhënat tre-mujore mbi Borxhin e Përgjithshëm në Kosovë TM1 (2018)

Punuar nga Autori

2.5.6. Garancitë Shtetërorenë Kosovë

Tabela 2.17:Garancitë Shtetërore 2014-2018

Përshkrimi	2014	2015	2016	2017	TM1 2018
Garancitë Shtetërore	10.00	10.00	20.00	44.00	44.00
BERZh Garancia për Linjën Kreditore të FSDK	10.00	10.00	10.00	10.00	10.00
BERZh Garancia për Tafikun Urban Prishtinë	0	0	10.00	10.00	10.00
BERZh – Garancia për Linjën e Dytë Kreditore për FSDK	0	0	0	24.00	24.00
Garancitë Shtetërore (% e BPV-së)	0.18%	0.17%	0.33%	0.70%	0.66%


Burimi: Të dhënat tre-mujore mbi Borxhin e Përgjithshëm në Kosovë TM1 (2018).

Punuar nga Autori

Në (Tabelën 2.17) mund të vërejmë Garancitë Shtetërore nga periudha kohore 2014 deri në tremujorin e parë të vitit 2018. Sipas këtyre të dhënave shohim garancitë e BERZH (Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim) për linjën kreditore të FSDK-së, garancia për trafikun urban në Prishtinë, si dhe garancia për linjën e dytë kreditore për FSDK-në.


Gjithashtu në tabelën e lartë cekur janë vendosur Garancitë Shtetërore (në% PBB-së) nga viti 2014 deri në vitin 2018, ku në vitin 2014 përqindja e garancive shtetërore në raport me PBB-në ishte (0.18%), 2015(0.17%), 2016 (0.33%), 2017(0.70%), si dhe në vitin 2018 (0.66%).

Figura 2.66:Garancitë Shtetërore (% e PBB-së) 2014-2018



Burimi: Të dhënat tre-mujore mbi Borxhin e Përgjithshëm në Kosovë TM1 (2018)

Figura 2.67:Garancitë Shtetërore 2014-2018




Burimi: Të dhënat tre-mujore mbi Borxhin e Përgjithshëm në Kosovë TM1 (2018)

Punuar nga Autori

Nëpërmjet (Figurës 2.66) dhe (Figurës 2.67) mund ti vërejmë lëvizjen e trendit të Garancive Shtetërore të Kosovës gjatë viteve 2014 deri në vitin 2018, si dhe strukturën organizative të tyre.

Ndërsa tek (Figura 2.49) mund të shohim Garancitë Shtetërore të shprehura në (% e PBB-së) 2014-2018 në Kosovë.

Figura 2.68:Garancitë Shtetërore 2014-2018



Burimi: Të dhënat tre-mujore mbi Borxhin e Përgjithshëm në Kosovë TM1 (2018)

Punuar nga Autori

Duke ju referuar rezultateve të prezantuara tek Figura 2.68 mund të vërejmë garancitë shtetërore gjatë periudhës kohore nga viti 2014 deri në vitin 2018.

Sipas të dhënave shohim kredituesin BERZh për garancinë për linjën kreditore të FSDK-së, pastaj BERZh për garancinë për trafikun urban në Prishtinë, si dhe BERZh për garancinë për linjën e dytë kreditore për FSDK-në.

2.5.7. Indikatorët e Rrezikut në Kosovë

Tabela 2.18: Indikatorët e Rrezikut

	2013	2014	2015	2016	2017	TM1 2018
Borxhi/BPV % (R)	8.94	10.65	13.07	14.58	16.63	16.15
Borxhi Ndërkombëtar (R)	6.08%	5.86%	6.39%	6.25%	6.75%	6.26%
Borxhi i Brendshëm (R)	2.86%	4.61%	6.51%	8.00%	9.18%	9.22%
Mesatarja e baraspeshuar e interesit	2.62%	2.64%	2.58%	2.09%	1.88%	1.86%
Borxhi Ndërkombëtar	3.15%	3.20%	2.97%	2.96%	2.84%	2.94%
Borxhi i Brendshëm	1.50%	1.92%	2.19%	1.40%	1.17%	1.13%
Koha mesatare deri në maturim për Borxhin	9.24	5.20*	4.76	4.82	5.16	5.22
Borxhi Ndërkombëtar (vite)	13.42	7.79*	7.52	7.73	8.07	8.25
Borxhi i Brendshëm (muaj)	4.28	8.13	11.73	15.46	20.18	20.52
Borxhi/Borxhi i Përgjithshëm	100%	100%	100%	100%	100%	100%
Borxhi Ndërkombëtar	67.98%	56.00%	49.55%	43.83%	42.37%	40.45%
Borxhi i Brendshëm	32.02%	44.00%	50.44%	56.17%	57.63%	59.55%

Burimi: Të dhënat tre-mujore mbi Borxhin e Përgjithshëm në Kosovë TM1 (2018).

Punuar nga Autori


2.5.8. Përmbledhje e përgjithshme rreth karakteristikave të Borxhit Publik të Kosovës

Nëpërmjet këtij studimi shkencor i cili trajton ndikimin e borxhit publik mbi rritjen ekonomike të vendeve evropiane në tranzicion, jemi munduar që krahas vendeve të analizuara në kuadër të vendeve evropiane në tranzicion, të trajtojmë me një fokus te veçantë edhe borxhin publik të Kosovës. Ku sipas tabelave dhe figurave me lartë kemi pasur mundësi të vërejmë strukturën e borxhit publik të Kosovës, si dhe karakteristikat kryesore të tij. Nga të dhënat shohim se Kosova posedon borxhin publik me të ulët në kuadër të vendeve të Ballkanit Perëndimor, ky nivel është dukshëm me i ulët se sa niveli optimal i propozuar nga ana hipotezave në fillim të këtij studimit. Ku me konkretisht sipas Hipotezës së Tretë potencohet që tejkalimi i borxhit publik mbi pragun optimal prej 55% deri në 65% të PBB-së mund të ndikojë negativisht mbi rritjen ekonomike të vendeve të Ballkanit Perëndimor, përfshirë edhe Kosovën. Gjithashtu niveli i borxhit publik të Kosoves është me i ulët edhe se sa niveli i propozuar nga ana e “Traktatit të Maastrichtit”, i cili potencon se vendet e UE-së nuk kanë të drejte të rrisin nivelin e përdorimit të borxhit publik më shumë se 60 përqind e PBB-së.

Për t’iu dhënë epilog disa prej këtyre dilemave të ngritura nga rezultatet e më sipërme, do të ju referohemi disa të dhënave të publikuara nga ana e drejtorisë së thesarit në Ministrinë e Financave të Kosoves. Ku vërejmë se borxhi publik i Kosoves nga 2009 e tutje është rritur në mënyrë graduale, duke e ruajtur stabilitetin e vendit. Borxhi publik i Kosoves përbëhet nga borxhi i jashtëm dhe i brendshëm, borxhi i brendshëm janë letrat me vlerë, nga 6 muaj deri në 10 vjet maturim, letrat me vlerë kanë qenë një histori suksesi. Borxhi ndërkombëtar ka filluar nga viti 2009 dhe përbën 33 për qind të portofolit të përgjithshëm. Sipas të dhënave të fundit të publikuara nga ana e raporteve të institucioneve shtetërore, borxhi publik i Kosoves ka arritur vlerën në 1 miliardë 208 milionë euro. Sfida kryesore është sepse niveli i shfrytëzimit të këtyre mjeteve ka qenë i ulët, shpeshherë i papranueshëm, dhe kjo ka të bëjë me kuadro profesionale, procedurat e prokurimit, shpronësimet, si dhe proceset buxhetore. Nga të dhënat e fundit janë 480 milion vlera e kredive të aprovuara, por të cilat nuk janë shfrytëzuar. Kosova është vendi i rrallë sepse borxhi publik duhet të kalojë me 2 të 3 në Kuvendin e Kosovës (Ismaili, 2019, Drejtor i Thesarit në Ministrinë e Financave, KS). Këto mundën me qenë disa nga arsyejet pse borxhi publik i Kosoves është me i ulët në raport me vendet e Ballkanit Perëndimor.


2.6.Krahasimi i vendeve në Tranzicion të Evropës Qendrore me vendet e Evropës Lindore, si dhe me vendet e Ballkanit Perëndimor

Figura 2.69: Borxhi Publik (i shprehur ne përqindje të PBB-së) tek vendet në tranzicion të Evropës Qendrore 1995-2017




Burimi: Kalkuluar nga Autori, dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar

Figura 2.70: Borxhi Publik (i shprehur ne përqindje të PBB-së) tek vendet në tranzicion të Evropës Lindore 1995-2017



Burimi: Kalkuluar nga Autori, dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar

Figura 2.71: Borxhi Publik (i shprehur ne përqindje të PBB-së) tek vendet në tranzicion të Ballkanit Perëndimor 1995-2017



Burimi: Kalkuluar nga Autori, dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar

Duke ju referuar rezultateve të paraqitura nëpërmjet (Figurës 2.69, Figurës 2.70, si dhe Figurës 2.71) mund ti vërejmë dallimet si dhe ti krahasojmë vendet në tranzicion të Evropës Qendrore me vendet e Evropës Lindore, si dhe me vendet e Ballkanit Perëndimor për sa i përket përdorimit të borxhit publik. Sipas të dhënave nga Fondi Monetar Ndërkombëtar të paraqitura nëpërmjet figurave me lartë shohim se vendet e Evropës Qendrore kanë një nivel më të lartë të përdorimit të borxhit publik të shprehur në përqindje të PBB-së në raport me vendet e tjera në tranzicion të Evropës, si p.sh me vendet e Evropës Lindore.

Gjithashtu vlen të potencohet se edhe vendet në tranzicion të Evropës Lindore kanë një ngarkesë më të lartë të përdorimit të borxhit publik në krahasim me vendet e Ballkanit Perëndimor. Ndërsa tek vendet e Ballkanit Perëndimor mesatarja e përdorimit të borxhit publik në përqindje të PBB-së është më ulët se sa vendet e tjera në tranzicion të Evropës Qendrore dhe Lindore. Nga kjo mund të kuptojmë se ekzistojnë dallime në aspektin e përdorimit të borxhit publik në mes vendeve në tranzicion të Evropës, ato të cilat janë me të zhvilluara ekonomikisht kanë ngarkesë më të lartë të borxhit publik, mirëpo prapë kanë mundësi për rritje ekonomike, në krahasim me vendet e tjera të cilat çdo rritje e mundshme e borxhit publik mbi vlerat optimale mund të sjell pasoja negative për zhvillimin dhe stabilitetin ekonomik.

2.7.Përcaktimi i Pragut Optimal të Borxhit Publik tek vendet Europiane në Tranzicion (Evropa Qendrore, Evropa Lindore, si dhe Vendet e Ballkanit Perëndimor)

Një nder çështjet shumë me rëndësi gjatë trajtimit të borxhit publik mbi rritjen ekonomike të vendeve evropiane në tranzicion është definimi i pragut, ose më mirë të themi përcaktimi i pragut optimal të borxhit publik. Përcaktimi i pragut të borxhit publik lidhet mbi përdorimin e nivelit të borxhit publik, i cili nënkupton se deri në cilin nivel optimal vendet evropiane në tranzicion mund të përdorin borxhin publik dhe prape të kenë mundësi për rritje ekonomike.

Si dhe në të kundërtën tejkalimi i këtij pragu do të ndikonte negativisht në rritjen ekonomike të vendeve evropiane në tranzicion. Në mënyrë me konkrete tani do të paraqesim konceptin e ‘pikës kthyes’, e cila paraqet ‘pragun’ e përdorimit të borxhit publik. Përmes definimit të pikës kthyes do të mundohem të identifikojmë pragun (threshold), ose më mirë të themi kufirin optimal se deri në cilën shkallë të rritjes borxhi publik do të ketë impakt pozitiv në rritjen ekonomike.

Nëse e analizojmë literaturën teorike në lidhje me funksionimin e vendeve evropiane mund ti referohemi “Traktatit të Maastrichtit” ku sipas të specifikohet qartë, ndër të tjera, se financat qeveritare të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian nuk duhet të tejkalojnë limitin e deficitit buxhetor prej 3 përqind ndaj produktit të brendshëm bruto (PBB-së), si dhe mund të vërejmë se këto vende nuk kanë të drejtë të rrisin nivelin e përdorimit të borxhit publik me shume se 60 përqind e PBB-së. Arsytet e vendosjes në atë kohë të këtyre limiteve synonin të krijonin një stabilitet të plotë ekonomik, besueshmëri, si dhe uniformitet mes shteteve anëtare dhe atyre që do të donin t’i bashkoheshin Unionit Evropian.

Ndërsa nëse i referohemi këshillit evropian vërejmë se këshilli i vëzhgon financat publike dhe politikat ekonomike të shteteve anëtare dhe mund të japë rekomandime për vende individuale të BE-së, në bazë të propozimeve të Komisionit. Këshilli mund të rekomandojë masa rregulluese dhe mund të sanksionojë vendet e eurozonës që nuk ndërmarrin masa korrigjuese për të zvogëluar deficitin e tepruar dhe nivelet e borxhit. Qeverisja me zonën e euros dhe reformat e mëdha në politikën e ekonomisë diskutohen në Euro Samite, ku takohen krerët e shteteve ose qeverive të anëtarëve të zonës euro (Funksionimi i Bashkimit Evropian, Udhëzues, 2014, fq 8).

Duke u bazuar në të dhënat me lartë nëpërmjet (Figurave, 44, 45, si dhe 46) shohim se një pjesë e madhe e këtyre vendeve evropiane nuk u janë përmbajtur këtyre kufizimeve, dhe kushteve të parapara nëpërmjet “Traktatit të Maastrichtit”, si p.sh Kroacia me borxhin publik mbi 86 përqind të PBB-së, Sllovenia me 83 përqind, Ukraina me 80 përqind, Hungaria me 75 përqind. Gjithashtu tejkalim të kësaj përqindje shohim edhe tek disa nga vendet e Ballkanit Perëndimor si p.sh Serbia me 77 përqind të PBB-së, Shqipëria me 73 përqind, si dhe Mali i Zi me 67 përqind.

Duke ju referuar krizës financiare të vitit 2008, si dhe përshkallëzimeve të problemeve ekonomike brenda eurozonës, disa nga këto vende janë duke u munduar që nëpërmjet infrastrukturës ligjore të përcaktojnë paraprakisht edhe nivelin e përdorimit të borxhit publik, do të thotë një gjë e tillë të jetë e përcaktuar edhe përmes ligjit ose kushtetutës.

Gjatë përcaktimit të pragut të borxhit publik në pjesën empirike të këtij studimi, do të bëjmë dallimin në mes të vendeve në tranzicion të Evropës, sepse pragu i ndikimit të borxhit publik ndryshon. Kjo nënkupton se tek vendet në tranzicion të Evropës Qendrore pragu ose kufiri i rritjes së borxhit publik është shumë me i lartë se sa tek vendet në tranzicion të Evropës Lindore, dhe tek vendet e Ballkanit Perëndimor. Ku pretendohet se tek vendet e Evropës Qendrore pragu optimal i përdorimit të borxhit publik supozohet të jete 70% deri më 80%, ndërsa pragu optimal i përdorimit të borxhit publik tek vendet e Evropës Lindore supozohet të jete nga 60% deri në 70%.

Ndërsa tek vendet e Ballkanit Perëndimor pragu optimal i përdorimit të borxhit publik supozohet që sillet prej 50% deri në 60%. Këto pretendime të ngritura në lidhje me përcaktimin e pragut të borxhit publik janë vendosur duke u bazuar tek shumë studime të bëra në lidhje me ndikimin e borxhit publik mbi rritjen ekonomike, hulumtime këto të bëra në vendet e zhvilluara si dhe në vendet në zhvillim.

Ku disa prej tyre këtyre studimeve pretendojnë se shumica e vendeve të cilat janë në tranzicion nuk kanë një stabilitet të qëndrueshëm ekonomik dhe financiar, andaj efektet e borxhit publik dhe kufiri i rritjes së tij nuk është i njëjtë në të gjitha vendet Evropiane që janë në tranzicion, sepse të disa vende pragu optimal mundet me qenë me i ulët, ndërsa tek disa të tjera me e i lartë.

Me konkretisht nëse i referohemi disa studimeve kredibile të bëra nga Mencinger dhe Aristovnik dhe Verbic (2015), Checherita dhe Rother (2010), Reinhart dhe Rogof (2010) shohim që ekziston dallim i konsiderueshëm në lidhje me përcaktimin e pragut të borxhit publik, ku sipas këtyre studimeve vërejmë se në vendet e zhvilluara pragu optimal i përdorimit të borxhit publik është shume i lartë në krahasim me vendet ne zhvillim, ose me mire të themi ato në tranzicion. Ku sipas rezultateve mesterja e pragut të borxhit publik në 12 vendet e euro zonës sillet prej 90% deri në 100%, ndërsa besueshmëria statistikore e këtij pragu mund të jetë deri në 70% të PBB-së së këtyre vendeve.

Mirëpo sipas rezultateve sugjerohet se nivelet e borxhit publik tek disa nga këto vende tashme e kanë tejkaluar kufirin optimal, dhe kjo situatë mund të ndikojnë negativisht në PBB-në. Meqenëse pika e kthimit (turning point) është një kombinim jo-linear (raport) i dy koeficienteve të vlerësuar, do të thotë variabla e borxhit, dhe variabla e borxhit të vendosur në katror janë të shumëzuara me një skalar ($-\frac{1}{2}$).

Kjo përcakton nivelin optimal të përdorimit të borxhit publik duke e përcaktuar kufirin deri në cilin masë vendet mund të përdorin borxhin publik dhe prap te kenë rritje ekonomike, si dhe përcaktimi i pikës kthyesë që do të thotë tejkalimi i mundshëm mund të sjell pastaj pasoja negative mbi rritjen ekonomike.

Gjithashtu definimin e pragut e shohim edhe në hulumtimin e bërë nga autorët Mencinger, Aristovnik, Verbic, (2015), ku gjetjet nga ky studim tregojnë se pragu optimal i përdorimit të borxhit publik tek vendet e zhvilluara sillet rreth 90% deri në 94%, ndërsa tek vendet ne zhvillim pragu optimal i borxhit publik është 44% deri në 45%, që do të thotë çdo rritje eventuale mbi këto pragje të përcaktuara do të pasqyrojë ndikim negativ në rritjen ekonomike të vendeve të cilat janë të zhvilluara si dhe vendet në zhvillim.

Reinhart dhe Rogoff krijuan një debat të madh kur botuan gjetje që tregonin se rritja e raportit të borxhit publik mbi 90% të PBB-së mund të ndikojë negativisht në rritjen ekonomike. Duke potencuar se zhvillimi i tregtisë mbi bazën e rritjes së borxhit publik duhet të përcaktohet mbi bazën e një pragu, ose kufiri optimal. Tejkalmi i këtij pragu të borxhit publik në mënyrë të vazhdueshme nga ana e qeverive të vendeve është padyshim një shqetësim i madh për momentin, duke pasur parasysh influencën që mund të sjellin recensionet mbi rritjen e nivelit të borxhit publik.

2.8.Indikatorët e Borxhit

Për të studiuar performancën e borxhit publik përdoren tre lloje indikatorësh. Në grupin e parë, përfshihen indikatorë, të cilët masin riskun që gjenerohet mbi borxhin publik nga kushtet aktuale ekonomike. Grupi i dytë vlerëson aftësinë e qeverisë për t'u përballur me kontigjenca të së ardhmes, duke marrë në konsideratë disa rrethana të caktuara të pritshme. Së fundi, ekzistojnë edhe indikatorë financiarë, të cilët tregojnë performancën e tregut të detyrimeve.

Çdo lloj indikator ka një tipar dallues, që e bën të pamundur gjykimin mbi to në mënyrë të ndarë. Së pari, analiza e ekspozimit nënkupton nevojën për të krijuar indikator që masin dhe parandalojnë çdo situatë e cila vë në vështirësi pagimin e borxhit nën rrethana të zakonshme. Këta indikatorë janë zakonisht statik. Ata paraqesin gjendjen mbizotëruese dhe nuk lejojnë ravijëzime të perspektivave afatmesme.

Gjithashtu, është thelbësore të mbikëqyret në mënyrë të vazhdueshme dhe dinamike aftësia paguese e borxhit dhe qëndrueshmëria, si dhe të simulohet performanca dinamike e borxhit në skenarë të kundërt. Për të arritur këtë objektiv, përdoren matës qëndrueshmërie, qëllimi i të cilave është të analizojnë nëse është e mundur për qeverinë të ruajë të njëjtin pozicion fiskal, apo nëse janë të nevojshme rregullime për të mbajtur çdo indikator të pasigurisë nën kontroll.

Dikush mund të mendojë se përcaktimi ose definimi i Borxhit Publik dhe deficitit janë indikatorë të lehtë, por rezulton të ngrejë pyetje të vështira, përgjigjet e të cilave janë shumë të rëndësishme. Për shembull, borxhi i qeverisë kanadeze në vitin 2010 mund të thuhet se ishte 38 për qind e PBB-së, të gjitha këto rrjedhin varësisht se si autoritet qeveritare përcaktojnë nivelin e Borxhit Publik (Dippelsman et al., 2012).

Deficiti i qeverisë federale të SHBA-së në vitin fiskal 2010/2011 ishte 8 për qind e PBB-së, ose 14 për qind varësisht nëse burimi i vlerësimit ishte buxheti i bazuar kryesisht në para të gatshme, ose tek pasqyrat financiare të bazuara në akrualet (Thesari i SHBA, 2011, fq.),

2.9.Indikatorët e Ekspozimit

Për shkak të krizës monetare që kapi disa ekonomi tregu në zhvillim gjatë dekadës së fundit të shekullit XX, studimi dhe analiza e paqëndrueshmërisë fiskale dhe marrëdhënia e tyre me nivelin e borxhit janë kthyer në çështje prioritare për agjendën e politikave ekonomike. Institucionet ndërkombëtare kanë propaganduar rëndësinë e kontrollit të variablave që mund të kërcënojnë qëndrueshmërinë e borxhit. Në këtë kuadër, Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) ka zbatuar një program shumëplanësh në mënyrë që të përcaktojë nëse një vend është i cënueshëm nga këto kriza dhe, nëse po, në çfarë mase. Ekonomitë e tregut në zhvillim, ato ku rritja varet kryesisht nga financimi i jashtëm dhe flukset e tjera të kapitalit, janë veçanërisht tëndjeshme ndaj ndryshimeve të sjelljes së investitorëve, për këtë arsye, FMN në punën e saj i kushtoi vëmendje të veçantë vlerësimit të ekspozimit. Puna më e madhe e kryer nga institucionet ndërkombëtare në lidhje me pasigurinë përfshin përmirësime të cilësisë së të dhënave dhe transparencën (Standarde Ndërkombëtare, Auditimi mbi Borxhin Publik, Faqe 60,2013).

Disponueshmëria e të dhënave të përshtatshme dhe të plota mbi rezervat ndërkombëtare, borxhin e jashtëm dhe flukset e kapitalit rrit aftësinë për të identifikuar ekspozimin, duke i dhënë hartuesve të politikave kohë të mjaftueshme për të marrë masa korrigjuese. Në të njëjtën kohë, FMN-ja ka përmirësuar aftësinë e saj për të analizuar të dhënat themelore nëpërmjet përcaktimit të disa prej vlerave kritike të këtyre indikatorëve, si dhe me kryerjen e testeve të stresit apo duke përdorur modele të sistemeve të lajmërimit paraprak.

Si rrjedhojë, FMN-ja thekson se është thelbësore për çdo vend që të jetë i vetëdijshëm për rëndësinë e indikatorëve të borxhit dhe të performancës fiskale. Indikatorët e ekspozimit përfshijnë sektorin publik, sektorin financiar, familjet dhe firmat. Kur ekonomitë janë nën presion, një çekuilibër në një sektor të caktuar mund të përhapë probleme në sektorë të tjerë të ekonomisë. Kështu, pasiguria në lidhje me deficitin publik mund të sjellë aktivitete spekulative lidhur me kurset e këmbimit, ose të minojë besueshmërinë e bankave që posedojnë tituj të borxhit publik, duke bërë të shpërthejë një krizë në sektorin financiar. Ndër indikatorët që institucionet financiare ndërkombëtare konsiderojnë veçanërisht të rëndësishëm dhe që duhen mbajtur nën vëzhgim janë indikatorët e borxhit si dhe te mirëqenies financiare (Standarde Ndërkombëtare, Auditimi mbi Borxhin Publik, Faqe 61,2013)

Indikatorë të borxhit; duke përfshirë maturimin, skedulet e pagesave, ndjeshmërinë ndaj normave të interesit dhe komponentët e borxhit në monedhë të huaj. Raportet e borxhit të jashtëm ose të eksporteve ndaj PBB-së janë indikator të dobishëm për të përcaktuar rritjen e borxhit dhe mundësitë e pagesave. Në rastin e një borxhi të konsiderueshëm të sektorit publik, lidhja midis borxhit dhe të ardhurave tatimore është gjithashtu e rëndësishme për të matur aftësitë e vendit për pagimin e tij. Indikatorët mbi mjaftueshmërinë e rezervave janë shumë të rëndësishëm për të vlerësuar aftësinë e një vendi për të shmangur krizat e likuiditetit. Lidhja midis rezervave dhe borxhit afatshkurtër është një parametër kyç për të vlerësuar ekspozimin e vendeve me një qasje të konsiderueshme, edhe pse ende të kufizuar - në tregjet e kapitalit.

Indikatorët e mirëqenies financiare përdoren për të vlerësuar pikat e forta dhe dobësitë e sektorit financiar të vendit. Ata përfshijnë kapitalizimin e institucioneve financiare, cilësinë e aktiveve dhe pozicionet jashtë - bilancit, përfitueshmërinë dhe likuiditetin, si dhe ritmin e rritjes së kredive dhe cilësinë e tyre. Ata përdoren për të vlerësuar ndjeshmërinë e sistemit financiar ndaj riskut të tregut, për shembull, luhatja e normave të interesit dhe të kursit të këmbimit transparencën (Standarde Ndërkombëtare, Auditimi mbi Borxhin Publik, Faqe 61-62, 2013).

Duke pasur parasysh efektet e krizës globale 2008 - 2009, qeverive kombëtare iu është dashur të shpëtojnë sektorë të ndryshëm të ekonomisë, duke përfshirë atë financiar, pavarësisht nëse shteti ka apo jo një detyrim ligjor për të siguruar fonde për të përballuar këto kontigjenca, apo thjesht sepse rrethanat e detyrojnë atë të veprojë kështu.

Detyrimet e kushtëzuara mund të çojnë në rritje të mëdha të borxhit publik. Për të përmbushur këto nevoja, institucionet ndërkombëtare, qeveritë dhe sektori akademik, kanë zhvilluar propozime të ndryshme për të adresuar çështjen e menaxhimit të ekspozimit. Indikatorët më të njohur për këtë çështje janë si vijon:

2.10. Barra e Borxhit Publik

Përgjatë shumë fushatave elektorale, kandidatët potencial deklarojnë se do të përpiqen që ta reduktojnë borxhin kombëtar (publik) vit pas vitit me qëllim që ta eliminojnë atë tërësisht për një periudhë të caktuar kohe (zakonisht afatgjatë). Edhe pse shpesh këto pretime merren me dyshim përsëri krijohet një përshtypje se reduktimi i Borxhit Publik është diçka e mirë.

Kjo është çështje shumë e diskutueshme se a duhet të shqetësohemi rreth borxhit kombëtar, dhe a kërkon që ta mendoresh shumë rreth kostove të financimit me borxh dhe se kush i mban ato. Dalloni barra e borxhit të brendshëm nga ajo e borxhit të jashtëm. Tek borxhi i brendshëm (bonot e thesarit të brendshëm) nuk krijohet barrë për brezat e ardhshëm, pasi që pagesa e borxhit nënkupton një transferim të ardhurash nga një grup qytetarësh (ata që nuk mbajnë obligacione) në një grup tjetër (mbajtësit e obligacioneve). Për këtë fenomen një shkrimtar i shekullit XVIII Melon ka potencuar që “dora e djathtë e ushqen të majtën” Musgrave (1985). Borxhi i jashtëm, i cili përdoret për të financuar konsumin vijues paraqet barrë për brezin e ardhshëm, pasi që huadhënësve të huaj së bashku me interesin vijues do të duhej t’u paguajnë gjeneratat e ardhshme. Nëse huaja do të përdorej për të financuar akumulimin e kapitalit, rezultati (barra e borxhit) do të varej prej produktivitetit të projektit, nëse kthimi i projektit është më i vogël se kostot marginale, atëherë paraqitet barrë për gjeneratën e ardhshme, në të kundërtën do të ishte përfitim për atë (Bexheti, Financat Publike, Tetovë 2007).

2.11. Indikatorë të lidhur me PBB-në

Mbas punimit të Blanchard-it (1990), dhe për shkak të vështirësive për të përdorur indikator të tjerë, rëndom vihet re në literaturën e specializuar, që indikator më i përdorur përgjithësisht është rritja e raportit të borxhit publik ndaj PBB-së. Ky indikator mat nivelin e borxhit në lidhje me aktivitetin ekonomik të vendit. Gjatë këtij studimi ne do të përdorim borxhin publik në raport me PBB-në, gjithashtu të gjitha parametrat, ose më mirë të themi variablat tjera kontrolluese gjatë testimeve ekonometrike, do të shprehen në përqindje të PBB-së për vendet evropiane në tranzicion. Ai supozon se të gjitha burimet e PBB-së janë në dispozicion për financimin e barrës së borxhit, fakt i cili nuk është domosdoshmërisht i vërtetë. Megjithatë, ky indikator është i njohur si një nga më të rëndësishmit për të matur shkallën e borxhit, duke kuptuar aftësinë paguese të qeverisë. Gjithashtu, disa indikator të tjerë janë vendosur duke përdorur kriterin e borxhit në raport me PBB-në. Disa prej tyre përpiqen të masin pagesat e interesit apo shumën e borxhit në lidhje me nivelet e ndryshme të ardhurave. Raportet kryesore që përdorin këtë koncept për vlerësimin e borxhit janë të njohur si “indikatorët e borxhit total” (Standarde Ndërkombëtare, Auditimi mbi Borxhin Publik, Faqe 63, 2013).

3. RISHIKIMI I LITERATURËS

3.1.Aspekti Teorik

Huaja publike, krahas tatimeve, taksave dhe kontributeve shfrytëzohet për financimin e funksioneve publike të shtetit. Deri në fillim të krizës së madhe ekonomike (1929-1933), huaja publike konsiderohej vetëm si burim i jashtëzakonshëm i financimit të nevojave të jashtëzakonshme të shtetit, kurse pas recensionit botëror, gjithnjë nën ndikimin e teorisë ekonomike keynesiane, huaja publike fillon të merr formën e burimeve të rregullta, duke u shndërruar kështu edhe në instrument ekonomik të shtetit. Në teorinë ekonomike të shekullit XIX e deri më sot, mendimet për huan publike janë të ndryshme. Përderisa ekonomistët e periudhës më të hershme huan publike e kanë vlerësuar si të pavolitshme me disa përjashtime, ekonomistët bashkëkohorë e arsyetojnë, madje e rekomandojnë edhe si instrument të suksesshëm për vendosjen dhe ruajtjen e baraspeshës dhe stabilitetit ekonomik. Edhe pse mund të definohet në mënyra të ndryshme borxhi publik, në teorinë e financave publike më së shpeshti haset definicioni së huaja publike ose borxhi publik paraqet shumë të parave të huazuara, që shteti ua ka borxh kreditorëve të vetë në momentin e dhënë kohor (Bexheti, 2007).

Borxhi publik, ndonjëherë i referuar edhe si borxhi i qeverisë, përfaqëson borxhin total të papaguar (obligacionet dhe letrat me vlerë të tjera) të një vendi. Borxhi publik shpesh shprehet edhe në raport me Bruto Produktin Vendor (PBB-në) e një vendi. Borxhi publik mund të rritet si jashtë ashtu edhe brenda vendit, me konkretisht borxhi publik i jashtëm i referohet obligimeve të qeverisë në formë të huave ndaj vendeve dhe institucioneve të jashtme, ndërsa borxhi publik i brendshëm përfaqëson detyrimet e qeverisë ndaj huadhënësve vendor. Borxhi publik është një aset i rëndësishëm i burimeve për një qeveri për të financuar shpenzimet publike si dhe për të mbushur hapësirat eventuale në buxhet. Borxhi publik si një përqindje e PBB-së zakonisht përdoret si një tregues i aftësisë së një qeverie për të përmbushur detyrimet e saj në të ardhmen. Dabrowski dhe Marek (2014) argumentojnë se përkufizimet e borxhit publik në vende të veçanta mund edhe të ndryshojnë si rezultat i traditës dhe mënyrës së interpretimit të tij, mirëpo fokusi dhe përmbajtja mbeten të njëjta. Borxhi publik është një instrument mjaft i rëndësishëm ekonomik nëse përdorimi i tij bëhet për qëllime të drejta dhe të duhura. Sepse vendet jo çdo herë mund të kenë rezerva dhe fonde të tepërta për ti financuar dhe mbështetur projektet publike që lidhen drejtpërdrejt me interesin e qytetarëve.

Përmes borxhit publik mundësohet ofrimi dhe shpërndarja e të mirave dhe shërbimeve publike në çdo moment, pa marrë parasysh ekzistimin e fondeve të nevojshme. Për të trajtuar në formë me adekuate mund të themi se borxhi publik përcaktohet se si një vend i detyrohet huadhënësve dhe agjentëve të tjerë ekonomik. Këtu mund të përfshihen individët, bizneset, madje edhe qeveritë e vendeve të huaja. Termi "borxhi publik" përdoret në mënyrë të ndërsjellë me termin "borxhi sovran". Borxhi publik zakonisht i referohet vetëm borxhit kombëtar. Mirëpo nga praktika shohim se disa vende tek kategoria e borxhit publik përfshijnë edhe huamarrjen nga shtetet e ndryshme, provincat, dhe komunat. Prandaj është e udhës që duhet të pasur një kujdes të shtuar kur dëshirojmë të krahasojmë borxhin publik tek vendet e ndryshme, sepse definicionet mund të mos jenë të njëjta. Pavarësisht nga ajo që është potencuar me lartë, borxhi publik është akumulimi i deficiteve buxhetore gjatë viteve. Është rezultat i udhëheqësve të qeverisë që shpenzojnë më shumë mjete monetare, se sa marrin të ardhurat nga vendosja e taksave në forma të ndryshme. Prandaj duke ju referuar kësaj mund të konkludojmë se deficit i buxhetor i një vendi ndikon drejtpërdrejt në borxhin e ti, si dhe anasjelltas (Mishkin dhe Serletis, 2010).

Gjatë analizës së borxhit publik dhe rritjes ekonomike, duhet pasur kujdes që mos të ngatërrohet borxhi publik me borxhin e jashtëm. Borxhi i jashtëm, paraqet vetëm një nënkategori të detyrimeve të një vendi kundrejt vendeve të tjera, të raportuara në pozicionin e investimeve ndërkombëtare. Në borxhin e jashtëm përfshihen vetëm instrumentet financiare me karakter borxhi. Borxhi publik ndikon mbi borxhin e jashtëm, sepse nëse normat e interesit rriten për borxhin publik, ato gjithashtu do të ndikojnë edhe për rritjen e normave të interesit tek borxhi privat. Kjo është njëra nga arsyet që bizneset gjithmonë i bëjnë presion qeverive të tyre për të mbajtur brenda borxhin publik. Në periudha afat shkurtër, borxhi publik është një formë e mirë për vendet që të marrin fonde shtesë dhe pastaj ato ti investojnë në rritjen dhe zhvillimin ekonomik (Mishkin, The Economics Of Money, 7ed). Borxhi publik është një mënyrë e sigurt për të huajt që të investojnë mbi rritjen ekonomike të një vendi duke blerë bono qeveritare. Borxhi publik është tërheqës ndaj investitorëve të rrezikuar, pasi që mbështetet nga vetë qeveria, sepse kur përdoret siç duhet, borxhi publik përmirëson standardin e jetesës në një vend. Kjo mënyrë e përdorimit të borxhit publik i lejon qeverisë të ndërtojë rrugë dhe ura të reja, të përmirësojë arsimimin, krijimin e vendeve të reja të punës, si dhe të sigurojë pensionet.

3.1.1. Teoria Klasike mbi Borxhin Publik

Ekonomistët favorizuan borxhin publik në shekullin e 18-të, duke ju referuar asaj që borxhi publik ka një ndikim pozitiv, ky favorizim ishte si arsye e doktrinës të asaj kohe. Mirëpo në shekullin e 19-të, roli i shtetit ishte i kufizuar brenda kufijve të tije, vetëm me disa funksione minimale në aspektin ekonomik. Kjo ishte pikëpamja e ekonomistëve klasikë që besonin në politikën "Laissez Faire". Këta ekonomistë kishin mendimin se funksionet e shtetit duhet të minimizoheshin, dhe qeveria duhej vetëm të ruante ligjin dhe rendin e brendshëm, si dhe mbrojtjen nga agresioni i jashtëm. Me konkretisht shteti nuk ka nevojë të ndërhyj në ekonomi, mirëpo vetëm t'i plotësoj kushtet e duhura për zhvillimin ekonomik, si dhe të përcaktojë bazën ligjore. Ekonomistët e kësaj shkolle besonin se inkuadrimi i plotë i faktorëve të prodhimit në ekonomi, si dhe inkuadrimi i resurseve aktuale mundëson një konkurrencë të përsosur dhe lëvizshmëri të faktorëve të cilët shpiten në rritjen e prodhimit në treg. Ata kishin më shumë besim në individualizmin, dhe mendonin se interesi vetanak çon në rritjen e interesit kombëtar të përgjithshëm.

Sipas tyre nuk ka nevojë për ndërhyrje të qeverisë në aktivitetet ekonomike të një vendi, edhe nëse ndodh ndonjë fatkeqësi apo ndonjë situatë tjetër e jashtëzakonshme, sepse vetë tregu do të menaxhojë në mënyrë direkte një situatë të tillë, është vetë tregu ai që do të vendoste në ekuilibër kërkesën dhe ofertën. Momentin kur qeveria kryen vetëm funksione të vogla të cilat nuk kanë ndonjë implikim të caktuar në treg, nuk kemi nevojë ti ngrisim shpenzimet publike në kuadër të një vendi sepse kjo mund të shpie në rritjen e të ardhurave publike. Përveç kësaj kjo qasje i referohet se shpenzimet qeveritare të një vendi janë të kota, dhe cilësohen si jo-produktive.

Furnizimi i buxhetit me të hyra është fiks, çdo shumë që transferohet në qeveri do të jetë si rezultat i rritjes së punësimit privat dhe shpenzimeve private, gjithashtu fondet e huazuara do të tërhiqen nga përdorimet produktive dhe do të vendosen në kanale joproduktive. Kështu borxhi publik do të shkaktojë barrë të panevojshme mbi shpatullat e komunitetit Khuperker. S. A. (2003). Studimi i Adam Smith "Pasuria dhe Kombet" sulmuan rrënjët themelore të merkantilizmit, studimi në masë të madhe paraqet një sulm ndaj nacionalizmit dhe shtetit, si dhe rregullim e jetës në të gjitha sferat që karakterizonte sistemin merkantilist.

Ky reagim ndaj sistemit merkantilist krijoi fushëveprimin e përcaktuar të "Laissez-Faire" në lidhje me veprimtarinë dhe aktivitetet e qeverisë së një vendi, të cilat i paraqiti në studimin e tij. Në kapitullin e fundit Smith shprehu pikëpamjet e tij mbi funksionet e shtetit, me konkretisht sipas tij të gjitha sistemet në një vend, si ato të preferencave ose të kufizimeve duhet larguar plotësisht, duke i hapur rrugë një sistemi të thjeshtë dhe të qartë i cili e përcakton vetvetën. Çdo njeri është i akorduar për atë kohë sa ai nuk shkel ligjet e drejtësisë, sipas Smith të gjithë njerëzit duhet të jenë krejtësisht të lirë të ndjekin interesat e tyre, si dhe të përcaktojnë mënyrën e investimit të kapitalit tyre në industri të ndryshme ekonomike të një vendi. Sipas sistemit të lirisë natyrore, sovraniteti ka vetëm tri detyra, të cilat cilësohen si detyra me rëndësi të madhe, të qarta, si dhe të kuptueshme për të gjithë Adam Smith (1954). Ndërsa David Ricardo e cilëson borxhin publik si një nga burimet më të tmerrshme që u krijua, dhe i cili ndikon drejtpërdrejtë për të goditur një komb, do të thotë rritja e huamarrjes publike ndikon negativisht në sistemin ekonomik.

Ricardo bëri modifikime të rëndësishme në argumentet e Adam Smith dhe JB Say, ai theksoi se barrë e rëndësishme që implikon borxhi publik ishte në transferimin e interesit vjetor, i cili ndikon drejtpërdrejtë në humbjen e kapitalit fillestar. Ai ishte i mendimit se prania e borxhit publik nuk ndikon në humbjen e aftësisë së qeverisë për të paguar taksat dhe obligimet. Ricardo thekson se nuk mund të arrihet ndonjë avantazh i madh ekonomik duke tërhequr ose zvogëluar nivelin e përdorimit të borxhit publik. Mirëpo vendosja e taksave dhe normave të larta të interesit mund të çojnë në lëvizjen e kapitalit në vende të tjera.

Teoria e J. S. Mill trajton veprimet e shtetit, ku mënyra e aplikimit të tyre po thuajse është identike me atë të J. Bentham. Duke marrë parasysh funksionet ekonomike të shtetit në librin përmbyllës të "Parimeve të Ekonomisë Politike", Mill përmendi atë që është bërë një përjashtim i famshëm në sundimin e përgjithshëm të 'Laissez-Faire', egziston një mënyrë në teorinë ekonomike për mbrojtjen e industrive fillestare nëpërmjet vendosjes së tarifave në import, të cilat kanë për qëllim mbrojtjen e prodhuesve dhe industrive fillestare nga konkurrenca e jashtme. Do të ishte gabim të klasifikoheshin ekonomistët klasikë si mbrojtës të vrazhdë të 'laissez-faire', qëndrimi i tyre ndaj 'laissez-faire' ishte relativ dhe i kushtëzuar. Mill J. S. thekson se ekonomistët klasikë kanë potencuar një sërë fushash ku ndërhyrja e shtetit ishte padyshim e padëshirueshme, veçanërisht në formimin e çmimeve, rregullimin e industrive, vendosjen e taksave për mallrat ushqimore, si dhe kufizimin e monopoleve.

Teoria klasike kritikohet kryesisht për dy arsye. Së pari çdo shpenzim i qeverisë nuk është gjithmonë jo-produktiv, si dhe huamarrja publike (borxhi publik) nuk mund të jetë gjithmonë barrë e ekonomisë. Dhe së dyti pikëpamja tradicionale lidhur me zhvendosjen e borxhit nuk është e saktë, sepse barra reale e huamarrjes publike duhet të ballafaqohet me periudhën në të cilën kanë ndodhur shpenzimet. Brezat e ardhshëm jo vetëm që do trashëgojnë detyrimet e pagesës së interesit dhe të principalit nga gjenerata e tanishme, por gjithashtu do të trashëgojnë edhe asetet në formën e së drejtës për arkëtimin e normës së interesit dhe të principalit.

3.1.2. Teoria Neo-Klasike e Borxhit Publik

Ekonomistët e Shkollës Neo-klasike ishin një zgjerim i rrjedhës së qasjes klasike, përmes identifikimit të qasjeve dhe metodave të reja. Një zhvillim tjetër shumë i rëndësishëm tek ekonomistët e qasjes neo-klasike ishte shfaqja e “teorisë së mirëqenies”, dhe aplikimi i ideve utilitare në gamën e funksioneve shtetërore.

Hulumtuesi C. Pigou identifikohet veçanërisht me teorinë e mirëqenies, ku në studimin e tij ekonomisë e cilëson si mirëqenie, ai tha se motivi kryesor i studimit ekonomik është të ndihmojë përmirësimin social.

Sa i përket funksioneve të shtetit, ideologjia bazë e qasjes së neoklasikëve ishte se sistemi ekonomik funksionon duke ju përgjigjur udhëzimeve të tregut, ose me konkretisht sistemi ekonomik gjithmonë është i varur nga kërkesa që vjen nga konsumatorët. Nëse kjo përgjigje është jo adekuate atëherë shteti duhet të ndryshojë formën e organizimit të sistemit ekonomik, duke pretenduar ngritjen e interesit të komunitetit në përgjithësi.

Roli i shteteve tek qasja neo-klasike ishte në thelb ishte rol i parimeve plotësuese dhe rregulluse. Neo-klasikët kishin një qëndrim të kundërt ndaj tarifave, mbështetjes së çmimeve, dhe ndihmave qeveritare ose subvencioneve.

Ata pretendonin se shërbimet e shtetit janë mjaft të rëndësishme për rritjen e progresit ekonomik, mirëpo praktikisht nuk kanë pasur ndonjë efekt të caktuar në zhvillimin e industrive. Duke miratuar kështu parimin e neutralitetit të shtetit. Sipas neo-klasikëve shteti duhet bazuar sipas modelit të shpërndarjes së burimeve të përcaktuara nga tregu privat.

Mirëpo mangësitë e burimeve ekonomike në tregun privat ishin sepse justifikonin ndërhyrjen e shtetit, si kur tregjet të ishin të organizuara në linja monopoliste dhe jo konkurruese, atëherë do të kishte një diskrepancë mes tyre. Prandaj vendosja e ndonjë takse mbi monopolin nga shteti u favorizua nga qasja neo-klasike.

3.1.3. Teoria Keynesiane e Borxhit Publik

Kriza ekonomike e krijuar nga depresioni i madh ekonomik i viteve 1930 ishte pjesërisht përgjegjës për zhvillimin e teorisë moderne të borxhit publik. Konsiderata tradicionale se buxheti i pa-balancuar me shpenzime të larta, si dhe rritja e shpejtë e borxhit publik mund të afektojë negativisht në stabilitetin ekonomik të vendeve fillojë gradualisht të bie. Duke i hapur rrugë një koncepti të ri ekonomik që potencon se borxhi i lartë publik është një aset kombëtar, dhe nuk mund të cilësohet si detyrim.

Duke pretenduar se për një sistem të mirëfillt ekonomik rritja e deficiteve buxhetore mund të cilësohet si normale dhe thelbësore. Sulmi i teorisë keynesiane mbi parimet klasike të buxhetit dhe financave publike ishte zgjerimi logjik, në pikëpamjen se ekonomia ka tendencë të ekuilibrit në bazë të punësimit dhe inkuadrimin të plotë të resurseve dhe burimeve aktuale.

Teoria keynesiane mbajti pikëpamjet të cilat pretendojnë të rrisin borxhin publik nëpërmjet efekteve të shumëfishta, duke rritur kështu të ardhurat kombëtare të një vendi. Sipas tyre huamarrja publike është e lidhur ngusht me financimin e deficitit, dhe qeveria përmes autorizimeve duhet të rrisë ofertën në formë të huazimit për të gjitha digasteret në mënyrë që të rritet kërkesa efektive në ekonomi, duke rezultuar kështu me rritjen e punësimit, si dhe rritjen e prodhimit. Kjo teori për dallim nga qasja ose më mirë të themi doktrina klasike nuk bëri asnjë dallim sa i përket shpenzimeve, të tilla si ato produktive dhe ose jo produktive. Keynes potencon se huamarrja për konsum ishte po aq e dëshirueshme sa huamarrja për investime në mallra produktive, sepse rritja e shpenzimeve të konsumit ndikon drejtpërdrejtë në rritjen e investimeve.

Analiza keynesiane arriti kulmin e saj tek zhvillimi i teorisë së "Financave Funksionale" të A. P.Lerner. Ku sipas kësaj teorie shpenzimet qeveritare dhe borxhi publik ishin vetëm instrumente për kontrollimin e shpenzimeve të një vendi.

Këto thjesht ishin mjete për të arritur qëllimin e punësimit të polotë dhe të qëndrueshëm, ku sipas nevojës tatimet dhe shpenzimet duhej të rriteshin ose të uleshin. Teoria e “financave funksionale” konstaton se madhësia absolute e borxhit kombëtar nuk ka rëndësi fare, gjithashtu pagesat e interesit të cilat bëhen për huamarrjen publike nuk paraqesin ndonjë barrë të caktuar për shoqërinë në tërësi Lerner A. P. (1955). Efekti ekonomik i borxhit publik duhet të vlerësohet në aspektin e të cilit rritja eventuale tij mund të ndikoj pozitivisht në gjenerimin e të ardhurave të një ekonomike. Teoria moderne i jep rëndësi shumë të lartë përdorimit të borxhit publik, më tej teoria moderne thekson se rrjedha shtesë e të ardhurave të krijuara nga rritja e shpenzimeve të cilat financohen nga borxhi publik paguan taksat për të shërbyer borxhin.

Në kohën e papunësisë, rritja e borxhit publik kontribuon në sjelljen e kapitalit të ri. Përveç kësaj, teoria moderne gjithashtu thekson se huamarrja publike nxit zhvillimin e burimeve financiare, si dhe nxit krijimin dhe zhvillimin e institucioneve financiare të tilla si : bankat, tregjet e kapitalit, tregjet e parasë, si dhe institucionet financiare- siguruese. J. M. Buchanan e cilësojë këtë teori si një nder teoritë moderne të borxhit publik Buchanan M. (1958). Ku sipas tije kjo teori moderne e borxhit publik bazohet në tri supozime. Krijimi i borxhit publik nuk përfshin ndonjë transferim të barrës reale aktuale, për gjenerimin e ardhshëm b. Analogjia midis borxhit privat dhe borxhit publik është e gabuar c. Ekziston një dallim i mprehtë dhe i rëndësishëm midis borxhit të brendshëm dhe borxhit të jashtëm.

3.2.Evidenca Empirike në vendet e zhvilluara

Gjatë rishikimit të evidencës empirike kam vërejtur që ekziston një numër i konsiderueshëm i studimeve dhe hulumtimeve që kanë trajtuar borxhin publik dhe rritjen ekonomike. Përmes rishikimit në aspektin empirik do të shohim mënyrën se si e kanë trajtuar studiuesit ndikimin e borxhit publik tek rritja ekonomike në vendet e zhvilluara. Shumë nga studimet të cilat do të trajtohen më poshtë posedojnë kredibilitet të lartë shkencor, sepse kanë determinuar se si ndikon rritja eventuale e borxhit publik mbi rritjen ekonomike. Ku disa nga këto studime kanë përcaktuar edhe pragun e borxhit publik, i cili determinon deri në cilën nivel rritja e borxhit publik mund të ndikojë pozitivisht në rritjen ekonomike. Mencinger, Aristovnik, Verbic (2015) në studimin e tyre kanë analizuar rolin dhe ndikimin e borxhit publik në vendet që janë pjesë e organizatës OECD.

Nga të dhënat e prezantuara nga modelet ekonometrike shohim se nëse borxhi publik vendoset në katror, atëherë efekti i tij do të jetë negativ në rritjen ekonomike, duke pasqyruar kështu një lidhje jo-lineare në mes të borxhit publik dhe rritjes ekonomike. Po ashtu sipas këtij studimi shohim se tek vendet e zhvilluara nëse pragu i borxhit publik rritet nga 90 % deri në 94 % atëherë do të ndikojë negativisht në rritjen ekonomike, ndërsa nën prapun 90 % efekti i tij do të jetë pozitiv, duke nxitur kështu zhvillimin dhe rritjen ekonomike. Sipas rezultateve të këtij hulumtimi shohim se ekziston një dallim në mes vendeve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim, me konkretisht tek vendet në zhvillim pragu ose kufiri i rritjes së borxhit publik është 44% deri në 45%, që do të thotë çdo rritje eventuale mbi këtë kufi do të ketë ndikim negativ në rritjen ekonomike, ndërsa deri në këtë prag efekti i tij do të jetë pozitiv.

Checherita dhe Rother (2010) në kërkimet e tyre empirike kanë analizuar ndikimin e borxhit publik në rritjen ekonomike, në një mostër prej dymbëdhjetë vendeve të Eurozonës përmes kanaleve të mëposhtme të tilla si: investimet private, investimet publike, niveli i përgjithshëm i produktivitetit, si dhe normat reale dhe ato nominale të interesit. Sipas rezultateve të analizuara shohim se pika kthyesë e borxhit publik tek 12 vendet eurozonës është nga 90% deri në 100%, si dhe besueshmëria e këtij pragu është rreth 70% e PBB-së. Tek vendet e zhvilluara pragu i përdorimit të borxhit publik, do të thotë kufiri optimal rrjedhë prej 82% deri në 91 %, që nëkupton se rritja eventuale mbi këtë prag mund të ketë pasoja negative në rritjen ekonomike. Është mire të potencohet se kemi disa studime shkencore të cilat japin të dhëna në lidhje me definimin e pragut (threshold) të borxhit publik mbi rritjen ekonomike, si dhe vlerësimin dhe matjen e natyrës së jo-linearitetit të borxhit publik. Siç tregohet edhe nga Herndon dhe Pollin (2014), jo-lineariteti i dukshëm nuk ishte një zbulim i fuqishëm, mirëpo u nxit nga një numër zgjedhjesh dhe gabimesh të veçanta. Cecchetti, Mohanty dhe Zampolli (2011), dhe Woo dhe Kumar (2015) përdorin të gjitha metodat parametrike për të identifikuar jo-linearitetet në marrëdhëniet midis borxhit publik dhe rritjes së BPP-së. Studimi i bërë nga Reinhart dhe Rogoff (2010) shqyrtoj rritjen reale të PBB-së sipas kategorive të veçanta të raportit të borxhit publik ndaj PBB-së, duke treguar se nuk ekziston ndonjë lidhje e fuqishme mes rritjes ekonomike dhe borxhit publik, derisa ky i fundit nuk është mbi 90% të PBB-së. Cecchetti et al. (2011) përdori një metodë “half-parametric break-point” për identifikimin e pragut të borxhit publik. Studimi paraqet një trajektore të drejta lineare me dy segmente, me konkretisht me prapun e panjohur, si dhe me prapun e identifikuar mjaft mire nëpërmjet minimizimit të shumës së mbetjeve të katrorë.

Reinhart dhe Rogoff krijuan një debat të madh kur botuan gjetje që tregonin se rritja e raportit të borxhit publik mbi 90% të PBB-së mund të ndikojë negativisht në rritjen ekonomike. Duke potencuar se zhvillimi i tregtisë mbi bazën e rritjes së borxhit publik duhet të përcaktohet mbi bazën e një pragu, ose kufiri optimal.

Tejkalimi i këtij pragu të borxhit publik në mënyrë të vazhdueshme nga ana e qeverive të vendeve është padyshim një shqetësim i madh për momentin, duke pasur parasysh influencën që mund të sjellin recensionet mbi rritjen e nivelit të borxhit publik.

Puna e studiuesve Reinhart-Rogoff gjithashtu tërhoqi vëmendje të konsiderueshme nga kritikët si Paul Krugman, i cili vuri në dukje problemet e endogjenitetit në hulumtim (duke theksuar që ka rritje të kufizuar të borxhit, ose rritja e ngadaltë ekonomike shpien në rritjen e nivelit të borxhit publik). Frika midis disa ekonomistëve është se shqetësimet në lidhje me borxhin publik mund të çojnë në një shtrëngim të parakohshëm ekonomik.

Sipas këtyre vlerësimeve është paraqitur një prag, ose me mire të themi një kufi optimal i përdorimit të borxhit publik, që është 77% e PBB-së. Çka nënkuptohet se rritja e borxhit publik mbi këtë prag ndikon negativisht mbi rritjen vjetore ekonomike, me një kosto shtese prej 0.017%.

Efekti është edhe më i theksuar në tregjet në zhvillim, ose në vendet në zhvillim e sipër ku pragu i borxhit publik është 64% e PBB-së. Që do të thotë se rritja e borxhit publik mbi këtë prag në këto vende manifestohet negativisht mbi rritjen reale ekonomike vjetore me një kosto prej 0.02%.

Qeveritë e vendeve në kuadër të menaxhimit dhe përdorimit të borxhit publik përdorin instrumente dhe politika të ndryshme qeveritare që të mbajnë borxhin publik në nivelin adekuat dhe optimal në harmoni me zhvillimin ekonomik Melecki (2007) dhe Pinkowski (2017).

Shumë studime shkencore kanë potencuar se vendet të cilat posedojnë nivelin e borxhit publik mbi pragu 100% të PBB-së kanë strategji të tjera të menaxhimit të borxhit publik, në raport me vendet të cilat niveli i ngarkesës së borxhit publik nuk është më i madh se 50 % e PBB-së.

Studimi dhe analizimi i borxhit publik është bërë debat dhe fokus i shume studiuesve ku do në botë, sepse borxhi publik mund të ndikojë drejtpërdrejt në stabilitetin ekonomik të vendeve.

Mund të themi se borxhi publik është bërë objekt studimi, sepse shumë nga vendet e zhvilluara në botë po përballen me nivele të larta të përdorimit të borxhit publik, të cilat kanë arritur pragun prej 110% të PBB-së, në krahasim me periudhën para krizës financiare (2008) ku niveli i i ngarkesës së borxhit publik ishte 70% e PBB-së Pinkowski (2017).

Gjithashtu Reinhart dhe Rogoff potencojnë se analiza e pragjeve të borxhit publik mund të jetë informative, mirëpo nivelet e pragjeve të borxhit duhet të interpretohen me kujdes të shtuar, kjo analizë duhet bazohet në mesataret afatgjata për gati tridhjetë vjet, në mënyrë që devijimet e përkohshme nga mesatarja të mos kenë efekte negative në rritje ekonomike.

Nëse raporti i borxhit publik të një vendi tejkalon pragun për një vit ose dy vite për shkak të një recesioni ekonomik, rritja ekonomike afatgjatë nuk duhet të vuajë si pasoje kësaj Scott (2010).

Ekzistenca e pragjeve të borxhit publik nuk duhet të përjashtojë politikën e stabilizimit fiskal afatshkurtër. Megjithatë, nëse rritja e vazhdueshme e borxhit publik e tejkalon pragun optimal në raport me PBB-në, dhe vazhdon të jetë e tillë edhe gjatë periudhave afat-gjata atëherë mund të ndikojë negativisht në rritjen ekonomike të vendeve.

Shumë nga vendet e zhvilluara që përballen me nivele të larta të borxhit publik duhet të angazhohen në konsolidimin fiskal brenda dekadës së ardhshme, si p.sh shtetet e bashkuara të Amerikës. Vendet e BE-së mund të rrezikojnë perspektivat e tyre të rritjes ekonomike nëse posedojnë nivele shume të larta të borxheve publike.

Reinhart dhe Rogoff (2010) argumentuan se vendet përjetojnë një ngadalësim të theksuar të rritjes ekonomike kur raportet e borxhit publik ndaj PBB-së rriten mbi pragun 90%. Disa studimeve të bëra nga FMN-ja tani përbejnë një sfidë mjaft të madhe ndaj konstatimeve të paraqitura nga Reinhart dhe Rogoff (2010).

Duke përdorur të dhënat për borxhin publik dhe rritjen ekonomike prej vitit 1821 deri në vitin 2012, autorët zbuluan se rritja e PBB-së për kokë banori është më e ngadalshme në vendet me borxhin publik mbi pragun 90% të PBB-së.

Mirëpo kontradiktat sipas FMN-së janë sepse shumë prej këtyre ngadalësimeve ekonomike janë prodhuar nga faktorë që nuk lidhen me nivelet e borxhit publik. Vendet me rritjen e raportit të borxhit publik kanë një rritje më të ngadaltë ekonomike, se sa vendet të cilat borxhit publik është shumë i ulët në raport me PBB-në.

Kjo mund të jetë për shkak se deficitet buxhetore i bëjnë këto vende më të prekshme ndaj paqëndrueshmërisë ekonomike. Nëse i referohemi disa hulumtimeve të fundit të bëra potencohet se rritja e vazhdueshme e nivelit të borxhit publik apo borxhit privat mund të rrezikojë rritjen ekonomike.

Sipas një studimi të bërë nga Schularick (Universiteti i Bonit) dhe Taylor nga (Universiteti i Virxhinias) potencojnë se rritja e shpejtë e kredisë ishte parashikuesi më i mirë i krizës financiare nga viti 1870 deri në vitin 2008. Sipas kësaj dëshmie vendet e euro-zonës mund të krijojnë siguri të lartë ekonomike atëherë kur nivelet e borxhit publik dhe atij privat stabilizohen.

Pinkowski (2017) thekson se krahas nivelit të borxhit ndaj PBB-së, si indikatorë me rëndësi që duhet pasur parasysh në procesin e menaxhimit të borxhit janë edhe pagesat për borxhe ndaj PBB-së, pagesat për interesa ndaj PBB-së, struktura e borxhit, si dhe afati mesatar i maturimit.

Sipas një studimi të bërë Blanchard dhe Maza (2019) potencohet se norma e interesit për të shlyer ngarkesën e borxhit publik mund të jetë më e ulët se sa norma e rritjes ekonomike, andaj sipas tyre rritja eventuale e borxhit publik mund të ndikojë pozitivisht në rritjen ekonomike, si dhe rrisë mirëqenien sociale.

Por këtu ka një rol të rëndësishëm jo vetëm niveli i borxhit, por gjithashtu edhe struktura valutore e tij kur lëvizjet në kursin e këmbimit (duke përfshirë edhe devalvimin), mund të rrisin ndjeshëm barrën e borxhit si dhe të krijojnë një presion të mëtutjeshëm ndaj kursit të këmbimit.

Po ashtu një studim mjaft interesant i bërë nga Krugman dhe Froot (1989) paraqet nevojën e lidhjes së borxhit publik me indikatorë të tjerë ekonomik të tilla si: çmimet e mallrave, eksportet, si dhe produkti i brendshëm bruto. Ndërsa Barro (1995) ka sugjeruar edhe ndërlikimin e emetimit të bondeve me PBB-në, në rastet kur niveli i borxhit publik nuk është i lartë.

Në këtë drejtim, disa studime empirike dhe teorike sugjerojnë së ekziston një nivel i borxhit publik specifik ose "i kujdesshëm", përtej të cilit një vend i caktuar do të ishte më i prekshëm në kuptimin e plotë të fjalës nga efekti i borxhit publik, dhe që mund të konkretizohet atëherë kur rritja e nivelit të borxhit publik mbi këtë kufi mund të ndikonte negativisht në rritjen ekonomike (Fall dhe Fournier, 2015, Woodford, 1990, Desbonnet dhe Kankamge, 2007).

Në veçanti disa studime tjera të bëra nga Garcia dhe Rigobon (2004) dhe Polito dhe Wickens (2011) kombinojnë qasjen sipas vlerës së riskut nëpërmjet vlerësimit të modelit (VARs) që është në korrelacion me indikatorëve makro-ekonomik dhe borxhit publik. Studimet empirike tregojnë se modeli i vlerësuesit (VARs) është përdorur në shumicën e rasteve për të llogaritur probabilitetin e raportit të borxhit publik, nëse ky i fundit do të jetë më i lartë se sa pragu optimal, me anë të simulimeve "Montecarlo".

Njëkosishtë është vepruar edhe tek studimi i Andres, Perez dhe Rojas (2017) të cilët kanë përdorur vlerësuesit "VAR" për të llogaritur probabilitetin e raportit të borxhit publik nëse kalon nga një prag në tjetrin, duke treguar se cilat do të ishin efektet mbi rritjen ekonomike.

Ky studim është zhvilluar me një metodologji gjithëpërfshirëse, duke përdorur të dhënat në formë të serive kohore të Spanjës të cilat trajtojnë korrelacionin në mes të dy variablave siq janë: rreziku i tregut, dhe letrat me vlere afat-shkurtër (bonot gjermane). Nëpërmjet këtij studimi mundohet të ofrohet zgjidhje se cili do të ishte pragu optimal i cili maksimizon vlerën e dy variablave të larte-cekura.

Duke vepruar kështu sipas këtyre studimeve argumentohet se deri ç 'masë probabilitetet kohore të llogaritura në kohë janë në gjendje të parashikojnë saktë dinamikën e stokut të borxhit publik për periudhat e ardhshme.

Dhe kjo me qëllim të kontrollit nëse ato mund të veprojnë si një tregues, ose më mirë të themi një paralajmërues i hershëm i cili tregon nivelin e harmonizimit të nivelit të borxhit publik me disa vlere referuese ose pragje të caktuara, si p.sh kriteret e vendosura nga marrëveshja e "Mastrihtit" që përcakton nivelin optimal të ngarkesës së borxhit publik për vendet e BE-së që është 60% e PBB-së.

Laina (2011) trajtojë lidhjen dinamike në mes të borxhit publik dhe rritjes ekonomike në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, gjatë periudhës kohore 1959- 2010. Metodologjia e përdorur në këtë studim shkencor ishte ajo “SVAR”, dhe testi i shkakësisë “Granger”. Gjetjet kryesore në këtë hulumtim shkencor ishin që ekziston një lidhje në mes të borxhit publik dhe rritjes ekonomike, me konkretisht sipas autorit në fjalë borxhi publik mund të afektojë pozitivisht në rritjen ekonomike në periudhat afat-shkurtra, ndërsa negativisht në periudhat afat-gjata.

Rivero (2017) ka analizuar efektin e borxhit publik tek disa nga vendet e euro zonës, duke përdorur të dhënat nga vendet qendrore dhe periferike të euro zonës. Rezultatet e këtij studimi shkencor sugjerojnë pikëpamje të ndryshme sa i përket përdorimit të borxhit publik, sipas gjetjeve thuhet se borxhi publik gjithmonë ka një tendence të ndikojë negativisht në rritjen ekonomike të vendeve të Euro- Zonës, ndërsa në periudhat afat-shkurtë borxhi publik mund të jep ndikim pozitiv, mirëpo ky pozitivitet është në varësi të vendeve të Euro-Zonës.

Stauskas dhe Ovidijus (2017) analizuan ndikimin e borxhit publik tek Bruto Produkti i Brendshëm në vendet e eurozonës të cilat bëjnë pjesë në Organizatën për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik. Ky studim është bërë duke u mbështetur në modelet inovative ekonometrike në formën e të dhënave të serive kohore panel, me konkretisht i bazuar edhe në metodat që ka përdorur studiuesi Pesaran (2013).

Rezultatet tregojnë një marrëdhënie negative midis rritjes së borxhit publik dhe Bruto Produkti i Brendshëm në periudhën afatgjatë për ekonomitë e OECD-së. Në përgjithësi, literatura teorike favorizon studimin e efekteve të borxhit shumë të lartë në stokun, rritjen ekonomike, si dhe rrezikun e kapitalit, meqenëse tenton të tregojë një lidhje negative midis raportit të borxhit publik dhe Bruto Produktit të Brendshëm Aizenman (2007).

Mirëpo, disa studime të tjera theksojnë se jo vetëm rritja e borxhit publik mund të afektojë në prodhim, por kjo mund të ndryshojë varësisht sipas periudhës kohore. Do të thotë se rritja e borxhit publik në periudhën afat-gjatë mund të nxjerrë jashtë kapitalin, si dhe të reduktojë prodhimin, ndërsa në periudhën afat-shkurtë mund të nxisë kërkesën dhe prodhimin e agreguar Barro (1990), Elmendorf dhe Mankiw (1999), ose Salotti dhe Trecroci (2016).

Gjithashtu duhet potencuar se prania e një pike kthimi, mbi të cilën një rritje e borxhit publik ka një efekt të dëmshëm mbi aktivitetin ekonomik, mirëpo një dukuri e tillë nuk do të thotë që do të jetë e njëjtë edhe tek vendet e ndryshme Ghosh. (2013), Eberhardt dhe Presbitero (2015), Ahlborn dhe Schweickert (2016).

Ndarja "konvencionale" e mësipërme midis efekteve afatshkurtra dhe afatgjata të borxhit publik e shpërfill faktin se recesionet e zgjatura mund të zvogëlojnë prodhimin potencial të ardhshëm, pasi që ato rrisin numrin e punëtorëve të dekurajuar, me humbjen e shkathtësive të lidhura me punën krijohet një efekt negativ në kapitalin organizativ dhe investimet në aktivitete e reja.

Ekzistojnë fakte se recesionet kanë një efekt të përhershëm në nivelin e PBB-së në periudhat e ardhshme Cerra dhe Saxena, (2008), që nënkupton se deficitet fiskale, dhe rritja e borxhit publik mund të kenë një efekt pozitiv në rritjen e prodhimit në periudhën afatshkurtër, po ashtu edhe në atë afatgjatë.

Së fundi, një tjetër fushë e literaturës gjithashtu del nga këndvështrimi "konvencional" dhe krijon një lidhje midis efektit afatgjatë të borxhit publik dhe llojit të shpenzimeve publike që financohen. Devarajan (1996) dhe Aschauer (1989) theksojnë se në periudhat afat-gjatë, ndikimi i borxhit publik në ecurinë e ekonomisë varet nëse shpenzimet publike të financuara nga borxhi qeveritar janë produktive ose joproduktive.

Reinhart dhe Rogoff (2010) dhe Pattillo (2011) paraqesin dëshmi empirike që tregojnë se marrëdhënia përshkruhet nga një model i përmbysur në formën e shkronjës U. Me konkretisht sipas studimeve të bëra nga këta autorë të lartë cekur shohim se rritja e borxhit publik në periudhat afat shkurtra mund të ndikojë pozitivisht në rritjen ekonomike të një vendi. Mirëpo rritja e vazhdueshme e borxhit publik edhe në periudhat më të gjata mund të afektojë negativisht në rritjen ekonomike. Megjithatë, ka studime të tjera empirike të cilat arrijnë përfundime shumë të ndryshme me këto.

Kemi disa prej tyre të cilat nuk gjejnë ndonjë dëshmi për ndonjë efekt të besueshëm mes borxhit dhe PBB-së për kokë banori Lof dhe Malinen (2014), të tjerët zbulojnë një marrëdhënie të kundërt në mes të dy variablave Woo dhe Kumar (2015) ose pretendojnë se marrëdhënia mes tyre është zbutur në mënyrë të rrjedhshme nga cilësia e institucioneve të një vendi (Kourtellos, 2013).

Gjithashtu kemi edhe një punim mjaft interesant që trajton borxhin publik dhe bruto produktin e brendshëm tek vendet e ndryshme të botës Sen (2007), hetimi i marrëdhënies në mes të borxhit publik dhe rritjes ekonomike është bërë tek disa vende si p.sh ; Argjentina, Kolumbia, Venezuela, Meksika, Kina, India, Filipinet, si dhe Tajlanda. Të gjeturat kryesore të këtij studimi tregojnë që rritja eventuale e borxhit publik ndikon negativisht mbi ecurinë e rritjes ekonomike tek vendet e Amerikës Latine dhe vendet e Azisë.

Mistal (2010) ka analizuar efektet e borxhit publik mbi ecurinë e rritjes ekonomike në një mostër e cila përfshin vendet anëtare të BE-së gjatë periudhës kohore 2000 deri në vitin 2010. Sipas rezultateve të fituara nëpërmjet këtij studimi shohim se një rritje e borxhit publik prej 1% në këto vende ka çuar, mesatarisht në një uljen e produktit të brendshëm bruto me 0.3%. Ndërsa rritja ekonomike me 1% rezultoi në një reduktim të borxhit publik, mesatarisht me 0.4%.

Baldaci dhe Kumar (2010) kanë analizuar një mostër prej 31 vendeve gjatë periudhës 1980-2007, të vendeve të zhvilluara po ashtu edhe vendeve të cilat janë në zhvillim, ku trajtuan se si deficit i lartë fiskal dhe shpenzimet publike kanë ndikuar në rritjen e rendimentit të obligacioneve afatgjata. Gjatë trajtimit dhe shqyrtimit të literaturës teorike dhe asaj empirike në lidhje me borxhin publik dhe rritjen ekonomike, shohim se ka studime të ndryshme, mirëpo ka dallime në raport me vendet si p.sh vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim, si dhe në shumicën e rasteve ka mungesë empirike të të dhënave për vendet në tranzicion si p.sh vendet e Ballkanit Perëndimor.

Panizza dhe Presbitero (2014) gjatë një analize empirike potencojnë se ekziston një lidhje jo-lineare në mes të borxhit publik dhe rritjes ekonomike. Afonso dhe Jalles (2013) kanë analizuar rritjen ekonomike nëpërmjet rritjes së produktivitetit në raport me borxhin publik. Kjo analizë është bërë për 155 vende të ndryshme të botës gjatë periudhës 1970 deri në vitin 2008. Autorët konkludojnë se ekziston një efekt negativ në mes të krizave të ndryshme financiare dhe rritjes ekonomike.

Për dukurinë e borxhit publik flet edhe ekonomisti Rosen, sipas të cilit kemi rishpërndarje të barrës së taksave me kalimin e kohës në të gjithë brezat. Këtë qështje në studimin e tij e komenton edhe Barro (1979), që ka argumentuar se kur qeveria merr hua, anëtarët e brezit të vjetër e kuptojnë se trashëgimtarët e tyre do të jenë më keq. Supozojmë se të moshuarit shqetësohen rreth mirëqenies së pasardhësve të tyre, dhe rrjedhimisht nuk duan të ulen nivelet e konsumit të pasardhësve.

Në anën tjetër Rubin dhe Sinai (2007) kanë argumentuar për pasojat e mëdha negative të deficiteve të vazhdueshëm buxhetore që ndodhin shumë papritmas. Gjithashtu kjo mund të shpjegohet kështu: deficit i vazhdueshëm është barrë për më shumë gjenerata, shpenzimet qeveritare bëhen të pakontrollueshme, dhe si rezultat i kësaj shkaktohen probleme ekonomike e sociale, të cilat me vështirësi të mëdha mund të riparohen. Sepse shkaktojnë kosto të mëdha ekonomike të cilat manifestohen me rritjen e papunësisë, si dhe uljen e standardit jetësor.

Gjatë rishikimi në aspektin empirik mund të vërejmë një studim mjaft interesant në aspektin e analizimit të borxhit publik dhe rritjes ekonomike të bërë nga Afonso dhe Alves (2015). Gjatë këtij studimi është analizuar efekti i borxhit publik në rritjen reale të PBB-së për kokë banori gjatë një viti, si dhe janë analizuar normat mesatare të normës së interesit gjatë një periudhe 5- vjeçare. Gjithashtu këta autor janë munduar të përcaktojnë edhe efektin e variablave të tjera të pavarura momentin kur bashkveprojnë me borxhin publik, duke konstatuar efektin e tyre në raport me PBB-në për kokë banori. Në këtë analizë shkencore janë përfshirë 14 shtete të Evropës, gjatë periudhës kohore (1970-2012), një periudhë mbi 43 vjet e analizuar.

Sipas gjetjeve dhe konstatimeve të nxjerra nga Afonso dhe Alves (2015) është ardhur në përfundim se rritja eventuale e nivelit të borxhit publik ndikon negativisht në rritjen ekonomike, si në periudhën afatshkurtër ashtu edhe në atë afatgjatë. Përveç kësaj ata e theksojnë procesin e konvergencës midis vendeve në mostër. Ndërsa gjatë analizës së normave të interesit, konstatojnë se norma e interesit afatshkurtër ka një efekt pozitiv në rritjen ekonomike, gjë që është në kundërshtim me rastin e normës afatgjatë, sepse rritja eventuale e normës afatgjatë të interesit ndikon negativisht në rritjen ekonomike të vendeve në këtë studim.

Gjithashtu gjetjet e tyre argumentojnë se rritja e raportit të borxhit publik, si dhe variablave të tjera që asocohen me borxhin publik (tatimi mbi kapitalin dhe fitimin, kreditë e sektorit privat, shpenzimet qeveritare), ndikojnë negativisht në rritjen ekonomike. Këto variabla që lidhen me borxhin publik është konstatuar që nuk janë të favorshme për rritjen dhe zhvillimin ekonomik. Nga ana tjetër kemi edhe disa parametra të tjerë makroekonomik të tillë si produktiviteti i përgjithshëm i faktorëve të prodhimit, bilanci i llogarisë korente, si dhe urbanizimi janë shembuj të variablave që kontribuojnë pozitivisht në rritjen ekonomike.

Gjetjet kryesore në këtë studim janë përcaktimi i pragut ose kufirit optimal të borxhit publik, ku sipas rezultateve shihet se pragu i borxhit publik gjatë periudhës 5 vjeçare sillet prej 74% deri në 75%, që nënkupton çdo rritje eventuale mbi këtë prag mund të ndikon negativisht në rritjen ekonomike të 12 vendeve Evropiane që janë pjesë e kësaj analize shkencore.

Kumar dhe Woo (Korrik 2010) në studimin shkencor të tyre kanë ofruar dëshmi empirike mbi ndikimin e borxhit fillestar në rritjen ekonomike, analiza është bërë për disa vende me ekonomi të avancuara të tregut, si vende në zhvillim gjatë periudhës kohore 1970-2007.

Nëse e analizojmë si duhet këtë studim shkencor mund të konstatojmë se metodologjikisht studimi mbështetet në literaturën e madhe empirike mbi determinantat dhe përcaktuesit e rritjes ekonomike, mirëpo me një literaturë teorike shumë të kufizuar, e cila lidhet kryesisht me vendet me të ardhura të ulëta për kokë banori, duke paraqitur ndikimin e nivelit të lartë të borxhit publik në rritjen ekonomike.

Në këtë punim shkencor të lartpërmendur janë përdorur një shumëllojshmëri e teknikave dhe metodave ekonometrike, ku përmes tyre autorët janë munduar ti mbështesin konstatimet dhe objektivat e tyre shkencore. Përveç kësaj në këtë studim shqyrtohen jo-linearitetet dhe efektet e pragut ose kufirit optimal të borxhit publik. Vlerësimi i mësipërm plotësohet nga kuadri i kontabilitetit të rritjes i cili lejon një eksplorim të kanaleve të tjera nëpërmjet të cilave borxhi publik mund të ndikojë në rritjen ekonomike.

Sipas rezultateve të bazuara nga metodat ekonometrike, këta autorë sugjerojnë një marrëdhënie të kundërt midis borxhit fillestar dhe rritjes ekonomike. Mirëpo ekzistojnë disa dëshmi të jo-linearitetit tek nivelet e larta të pragut të borxhit publik (mbi 90 për qind të PBB-së) në këtë rast borxhi publik mund të ndikojë negativisht në rritjen ekonomike, duke influencuar kështu ngadalësimin e produktivitetit të punës, kryesisht për shkak të uljes së investimeve dhe rritjes së ngadalshme të stokut të kapitalit për çdo punëtor.

Mesatarisht, një rritje prej 10 për qind të borxhit fillestar shoqërohet me një rënie të investimeve me rreth 0.4 për qind në raport me PBB-në, me një ndikim më të madh tek ekonominë në zhvillim. Ata theksojnë se qeveritë e vendeve duhet të ndërmarrin masa jo vetëm për ta stabilizuar borxhin publik, por edhe për t'i vendosur atë në një trajektore rënëse në periudhat afat të mesëm dhe ato afatgjatë.

Hulumtimi në fjalë bazohet shumë edhe në modelin ekonometrik të Çecherita dhe Rother (2010) i cili konstaton se PBB-ja mund të rritet si pasoje e rritjes së shkallës së produktivitetit të punës. Në këtë studim një sërë variablash janë përjashtuar nga modeli i pranishëm për shkak të mungesës së të dhënave për disa nga vendet evropiane në zhvillim. Mirëpo gjatë testimit autorët konstatuan se vetëm katër variabla kanë ndikim të rëndësishëm në rritjen ekonomike si p.sh: borxhi bruto i qeverisë si pjesë e PBB-së, liria ekonomike, norma nominale e interesit afatshkurtër, investimet fikse qeveritare.

Krahasuar me studimin e Checherita dhe Rother (2010), të cilët zbuluan piken kthyesë ose pragun e borxhit Publik prej 90% deri në 100%, tek studimi Kumar dhe Woo (2010) pika kthyesë ose pragu i borxhit publik është gjetur 50.89%. Një dallim i tillë është argumentuar nga autorët për shkak të dallimit të mostrave si dhe vendeve në fjalë, sepse vendet e zhvilluara dallojnë me vendet në zhvillim për sa i përket pragut ose kufirit të borxhit publik. Këtë mund ta demonstrojmë për Rumaninë, e cila ka një borxh publik të moderuar, rreth 38% të PBB-së në vitin 2012.

Gjithashtu, Egert (2013) në njëfarë mënyre i konfirmon gjetjet e studimit paraprak, autori thekson se pragu përtej të cilit shfaqen efektet negative të rritjes ekonomike sillet prej 50 %, që nënkupton çdo rritje mbi këtë kufi borxhi publik ndikon negativisht në rritjen ekonomike.

Në një studim tjetër mjaft interesant nga autorët Alejandro dhe Jalile (2017) ka hetuar një marrëdhënie jo-lineare dhe mjaft e rëndësishme statistikisht midis raportit të borxhit publik dhe normës së rritjes së PBB-së për kokë banori për vendet e Amerikës Latine. Gjatë këtij studimi është përcaktuar pragu (kufiri optimal) i borxhit publik për vendet e Amerikës Latine, përafërsisht sillet në mes të 64% dhe 71% në të gjitha modelet e përdorura në këtë punim shkencor.

Kjo do të thotë se mesatarisht në vendet e Amerikës Latine, rritja e nivelit të borxhit publik ndaj PBB-së mbi këtë prag do të ketë efekt negativ në rritjen ekonomike, ndërsa deri në këtë prag, do të thotë deri në 64% borxhi publik mund të ndikojë pozitivisht në rritjen ekonomike, duke stimuluar kështu zhvillimin ekonomik të këtyre vendeve. Qka duhet të potencohet është se vendet me demokraci të lartë kanë tendenca më të mëdha të shfrytëzojnë borxhin publik dhe të kenë rritje ekonomike.

Sipas një studimi tjetër shkencor të bërë nga Panizza dhe Presbitero (2013) argumentohet me fakte dhe të dhëna empirike që ekzistojnë mënyra të ndryshme përmes të cilave rritja e borxhit publik mund të dëmtojë rëndë ekonominë e vendeve. Greiner (2012) ka arritur në përfundim se nuk ka një model efikas dhe efektiv që mundë të trajtojë mirë lidhjen në mes të borxhit publik dhe rritjes ekonomike.

Abbas dhe Christensen (2007) potencojnë se ka shumë arsyeje që qojnë në mungesën e të dhënave empirike mbi borxhin publik dhe ndikimin e tij në rritjen ekonomike si p.sh mungesa e data bazave me të dhëna numerike për indikatorët makroekonomik të vendeve, mungesa e të dhënave pamundëson krahasimin e vendeve më njëra-tjetrën, gjithashtu variabla që përfaqëson borxhin publik është një ndryshore ekzogjene, që do të thotë se si e tillë mund të përdoret edhe si matës edhe si kontrollues i rezultateve.

Ndërsa nëse i referohemi teorisë keysiane theksohet se niveli i ulët i borxhit publik mund të çojë në rritjen ekonomike, por negativisht mund të ndikojë niveli i lartë i borxhit publik mbi rritjen ekonomike, dhe kjo mund të karakterizohet me: rritjen e tatimit, rënien e investimeve, si dhe rritjen e shpenzimeve të konsumit. Ndikimi i borxhit publik në rritjen ekonomike është diskutuar në të gjithë botën nga shumë studiues, por literatura që ofrohet për këtë çështje në vendet në zhvillim ka një hendek të madh, si dhe ka një mungesë të analizës empirike.

Kriza financiare në vitin 2008 ka kontribuar në rritjen e borxhit publik, si dhe ka shkaktuar tendosje të konsiderueshme në financat publike. Borxhi publik ndikon në zvogëlimin e rritjes ekonomike nëpërmjet tre kanaleve kryesore: grumbullim i investimeve si rezultat i rritjes së taksave të nevojshme për aneksimin e borxhit, redukon shpenzimet e atyre që nuk i deklarojnë tatimet, si dhe konsiderohet si një politikë efektive në procesin e inkasimit të buxhetit shtetëror.

Ndërsa normat e larta afatgjata do të rrisin koston e kapitalit, duke u përqendruar me shumë në investime publike, dhe më e rëndësishmja duke reduktuar kështu investimet private, e cila në periudhat afatgjata mund të ndikojë negativisht në rritjen ekonomike Elmeskov dhe Sutherland (2012).

Skenari i rastit më të keq janë vende me institucione të dobëta udhëheqëse, të cilat mund të vendosin që t'i rrisin shpenzimet në periudhat afatgjatë, ku inflacioni ka një efekt tejet të dëmshëm në rritjen ekonomike Kumar dhe Woo (2010).

Pikëpamja tradicionale e borxhit publik kryesisht është e bazuar në teorinë neoklasike, e cila nxit modelin e rritjes ekonomike nëpërmjet rritjes së nivelit të borxhit publik për të financuar shpenzimet publike, konsumin publik, si dhe mallrat kapitale Adam dhe Bevan (2005), Cohen (1993), Elmendorf dhe Mankiw (1999), Diamond (1965) Solow (1956).

Në lidhje me studimet teorike mbi borxhin publik, Diamond (1965) përshkruan një model që shqyrton ekuilibrin afatgjatë konkurrues në një model të rritjes ekonomike, dhe pastaj shqyrton efektet e rritjes së borxhit publik tek i njëjti ekuilibër. Autori arrin në përfundimin se taksat kanë të njëjtin ndikim si tek individët që veprojnë gjatë një ekuilibri afatgjatë, gjithashtu edhe tek ekonomia, nëse ato mjete janë përdorur për të financuar borxhin e brendshëm ose të jashtëm. Sipas Feldstein (1985) në qoftë se stoku i kapitalit brenda një ekonomie fillimisht është në një nivel optimal brenda kufirit, mund të themi dhe konkludojmë se është më mirë për të financuar një rritje të përkohshme të shpenzimeve qeveritare përmes borxhit publik, sepse ngarkesa e tepërt e tatimeve varet nga niveli i normës së tatimit.

Ndërsa tjetër gjetje nga Feldstein (1985) në studimin e tij është se nëse kapitali i një ekonomije të një vendi është nën nivelin optimal, atëherë është e preferueshme që shpenzimet qeveritare të financohen përmes taksave dhe tatimeve. Në anën tjetër Martin (2009) përpiket të shpjegojë nivelin e borxhit publik duke pohuar se përcaktuesi vendimtar i ngarkesës se tije është pajtueshmëria në mes familjeve në zëvendësimin e mallrave të ndryshme që influencohen nga rritja e normës së inflacionit, me mallra dhe produkte që nuk influencohen nga rritja eventuale e normës së inflacionit. Pavarësisht nga fakti se mirëqenia dhe standardi jetësor i një ekonomie me borxhe është më e ulët se sa tek vendet me ekonomi që nuk posedojnë borxhe.

Sipas një studimi të bërë nga Wigger (2009) arrin në përfundimin se brezat e ardhshëm do të mund të përfitojnë nga disa skema të caktuara duke emetuar borxh publik, dhe pastaj të investojnë sipas preferencave të tyre në teknologji apo në industri të tjera që mund të nxisin zhvillimin dhe rritjen ekonomike në përgjithësi.

Greiner (2012) në studimin e bërë potencon se ekziston një raport në mes të borxhit të lartë publik, dhe një ritmi të ulët të rritjes ekonomike në periudhat afatgjata. Sipas Greiner (2012) mund të shohim se rritja e vazhdueshme e borxhit publik në nivele me të larta se pragu optimal mund të sjell një rritje të vogël ekonomike në periudhat afatgjata.

Megjithatë sipas një studimi më të ri të autorit Greiner (2013), mund të shohim se nëse ka ngurtësim të supozuar të pagave, konkluzioni është me i ndryshëm me atë të studimit të bërë në 2012, duke potencuar se borxhi publik nuk do të ndikojë në rritjen afatgjatë ekonomike apo në rritjen e nivelit të punësimit, mirëpo rritja e borxhit publik mund të afektojë dhe influencojë vetëm në rritjen e stabilitetit ekonomik të një vendi.

Njëkosishtë lidhur me kanalet përmes të cilave borxhi publik mund të ndikojë në rritjen ekonomike, mund të vërejmë studimin e potencuar me lartë nga Checherita dhe Rother (2012) të cilët kanë analizuar dymbëdhjetë vende të Eurozonës që nga vitit 1970 deri në vitin 2010.

Duke u bazuar nga gjetjet dhe konkluzionet e këtij studimi shohim se kursimet private, investimet publike, si totali i produktivitetit janë kanalet e mundshme ku borxhi publik ka një ndikim jo-lineare në rritjen ekonomike. Ndërsa pragu, ose më mirë të themi kufiri optimal i rritjes së borxhit publik ku mbi të cilin efekti i tij do të jetë negativ, do të thotë duke ndikuar negativisht në rritjen ekonomike sillet nga 90% deri në 100%.

Ndërsa një studim tjetër i bërë nga Baum (2013) mund të shohim ndikimin e borxhit publik mbi rritjen ekonomike të dymbëdhjetë vendeve të Eurozonës gjatë viteve 1990 dhe 2010, si dhe përcaktimin e pragut të përdorimit të borxhit publik. Baum erdhi në përfundimin se ekziston një prag ose kufi i caktuar ku rritja e borxhit publik nga 67% deri në 95 % të këtij pragu rezulton me efekte negative në rritjen ekonomike, duke shkaktuar kështu frenim ose ngecje të zhvillimit ekonomik. Gjithashtu gjetje tjetër në këtë studim që vlenë të theksohet është se rritja eventuale e borxhit publik mbi mesataren ose kufirin 70 % mund të ndikojë edhe tek normat e interesit, sepse normat e interesit janë në presion shumë të lartë të afektimit nëse borxhit publik është me i lartë se 70% e PBB-së.

Gnegne dhe Jawadi (2013) kanë hulumtuar borxhin publik dhe dinamikën e tij për vendet e zhvilluara siç janë Britania e Madhe dhe SHBA-të. Sipas gjetjeve të tyre nga ky studim shohim se lidhja mes borxhit publik dhe rritjes ekonomike mund të parashikohet si një lidhje jo-lineare dhe asimetrike, duke përfunduar kështu se efekti i ndikimit të borxhi publik duhet të bazohet tek kufiri ose pragu i borxhit publik, sepse kjo ndihmon në kuptimin me të lehtë dhe me të saktë të dinamikës së zhvillimit të borxhit publik. Në fakt, disa ngjarje makroekonomike të tilla si ngadalësimi ekonomik, borxhi, kriza financiare, si dhe goditjet e naftës,

Kanë provuar të jenë faktorë të rëndësishëm që lidhen me ndërprerjet strukturore në dinamikën e zhvillimit të borxhit publik. Në një studim të bërë Ghosh et al. (2013) vërehet se ka zbatuar një model stokastik për të vlerësuar qëndrueshmërinë dhe dinamikën e borxhit publik për 32 vende të zhvilluara. Sipas gjetjeve të këtij studimi shihet një lidhje jo-lineare në mes të bilancit primar dhe borxhit publik.

Fincke dhe Greiner (2011) gjatë një hulumtimi shkencor kanë studiuar reagimin e suficitit primar (në përqindje të PBB-së) ndaj ndryshimeve në raportin e borxhit publik në përqindje të bruto produktit të brendshëm për disa nga vendet e Eurozonës. Kur merren parasysh disa vende në këtë studim, shohim se rezultatet e tyre tregojnë se vetëm Irlanda, Portugalia dhe Spanja duket se ndjekin një politikë të qëndrueshme në raport me shfrytëzimin e borxhit publik.

Ndërsa tek Greqia vërejmë refuzimin e përfundimit të një politike të qëndrueshme të borxhit publik, ndërsa për Italinë, rezultatet nuk janë përfundimtare. Duke u bazuar në teorinë keynesiane, një studim mjaft i mirëfillt nga Leão (2013) pohon se nën nivelin e plotë të punësimit, një rritje e shpenzimeve publike mund të zvogëlojë nivelin e raportit të borxhit publik. Duke potencuar një lidhje jo-lineare në mes të shpenzimeve publike dhe borxhit publik.

Sipas studimeve të bëra nga Wahab (2004), dhe Kolluri dhe Wahab (2007) dallojnë marrëdhëniet midis shpenzimeve qeveritare në periudha të ndryshme të rritjes ekonomike (lëvizjet ekspansioniste dhe recesionale) me konkretisht në vendet e OECD dhe Eurozonës. Artikulli i parë sugjeron një marrëdhënie të anasjelltë, ku sipas gjetjeve tregohet se shpenzimet publike janë rritur në mënyrë jo proporcionale gjatë periudhave të rritjes ekonomike, ku të cilat karakterizohen me ekspansione ekonomike, si dhe janë zvogëluar në mënyrë jo proporcionale gjatë periudhave kur ekonomia ishte në recension ekonomik.

Gale dhe Orzag (2003), Barro, (1979), Dotsey (1994) potencojnë disa kanale të caktuara përmes të cilave borxhi i lartë publik mund të ndikojë negativisht në rritjen afatmesme dhe afatgjatë ekonomike, dhe të cilat kanë marrë vëmendje të madhe në literaturën ekonomike, duke e theksuar se rritja eventuale e borxhi publik mund të ndikojë negativisht në akumulimin dhe rritjen e kapitalit nëpërmjet rritjes së normave të interesit në periudhat afatgjata.

Në rastet më ekstreme të një krize borxhi, ose të rritjes të pakontrollueshme të borxhit publik mund të rrjedh ose të shkaktohet ndonjë krizë bankare apo valutore me efekte të zgjeruara Burnside et al., (2001), Hemming et al, (2003). Borxhi i lartë gjithashtu ka të ngjarë të kufizojë hapësirën e veprimeve ciklike të politikave fiskale Aghion dhe Kharroubi (2007), Woo (2009). Gjithashtu një numër shumë i madh i studimeve kanë analizuar ndikimin e borxhit të jashtëm në rritjen ekonomike tek vendet e zhvilluara.

Shumica e këtyre studimeve u motivuan nga hipoteza "borxhi tek borxhi" ku sipas kësaj krijohet një situatë ku barra e shërbimit të borxhit të një vendi është aq e rëndë, sa një pjesë e madhe e prodhimit arrin tek huadhënësit e huaj, dhe rrjedhimisht një proces i tillë ekonomik krijon pengesa për të investuar Krugman (1988) dhe Sachs (1989). Imbs dhe Rancière dhe Pattillo (2009), Poirson dhe Ricci (2002, 2004) gjatë punimeve të tyre shkencore kanë gjetur një efekt jo-lineare në mes të borxhit të jashtëm dhe rritjes ekonomike.

Në të kundërt, Cordella, Ricci dhe Arranz (2005) gjejnë prova gjatë analizës së tyre empirike në lidhje me nivelin e borxhit publik dhe rritjes ekonomike, ku sipas tyre vihet në pah një marrëdhënie jo edhe aq e rëndësishme në mes të borxhit publik dhe rritjes ekonomike, me konkretisht këta autor kanë hetuar një lidhje pa ndonjë korrelacion në mes të niveleve të larta, dhe niveleve të ulëta të borxhit publik, duke potencuar se nuk kanë ndonjë efekt të caktuar mbi rritjen ekonomike.

Durlauf et al (2005) thekson se nëse ndalemi dhe e analizojmë literaturën empirike që mbulon ndikimin e rritjes eventuale të borxhit publik tek rritja ekonomike, mund të shohim disa të meta të regresionit të rritjes që janë bërë shumë të dukshme në këto studime. Gjithashtu vlen të theksohet dhe të potencohet se në këto hulumtime ekzistojnë shumë shqetësime dominuese në lidhje me qëndrueshmërinë e rezultateve dhe gjetjeve shkencore.

Andaj disa studime të caktuara kanë rikthyer rritjen e prodhimit në një sërë përcaktuesish të mundshëm. Mirëpo përdorimi i kësaj qasje gjithnjë e më shumë është vënë në pikëpyetje, kryesisht për shkak se vlerësimet e rezultateve që burojnë janë shpesh të ndjeshme ndaj variablave të tjerë të kushtëzuara Sala-i-Martin (1997) dhe Levine dhe Renelt (1992). Vlen të theksohen disa nga gjetjet kryesore shkencore të Sala-i-Martin (2004) në lidhje me determinantat kryesore të rritjes ekonomike, duke përdorur metodat dhe teknikat mbi regresionet gjithëpërfshirëse tek vendet që janë pjesë e analizës empirike.

Testimi është bërë duke shqyrtuar fuqinë e 67 variablave shpjeguese, si dhe duke bërë identifikimin e 18 variablave që kanë një probabilitet me të lartë të mundësisë së përfshirjes, dhe që mund të afektojnë në rritjen ekonomike. Efekti negativ i borxhit publik mund të jetë shumë më i madh në qoftë se borxhi i lartë publik rrit pasigurinë, apo çon në pritjet e konfiskimit në të ardhmen, ndoshta përmes inflacionit, dhe recensionit financiar Cochrane (2011). Në këtë rast rritja eventuale e borxhit publik mund të ketë efekt negativ edhe në periudhën afatshkurtër, duke ndikuar kështu negativisht në rritjen dhe zhvillimin ekonomik të vendeve.

Ndarja tradicionale midis efekteve afatshkurtra dhe afatgjata të influencës së borxhit publik e shpërfill faktin se recesionet e zgjatura mund të zvogëlojnë prodhimin e ardhshëm potencial, pasi që ato rrisin numrin e punëtorëve të dekurajuar, atëherë ky proces shoqërohet me humbjen e aftësive intelektuale, dhe si e tillë mund të ndikojnë negativisht në zvogëlimin e kapitalit, si dhe uljen e investimeve të reja.

Në këtë rast, menaxhimi i deficiteve fiskale, dhe rritja e borxhit publik mund të kenë një efekt pozitiv në rritjen e prodhimit në periudhën afatshkurtër, si dhe në atë afatgjatë. Në fakt një tjetër studim i bërë nga De Long dhe Summers (2012) kanë argumentuar se në një mjedis ekonomik ku hasim norma të ulëta të interesit politik fiskale ekspansioniste kanë të ngjarë të jenë një formë e vetëfinancimit. Në të vërtetë ka shumë dëshmi empirike dhe shkencore që potencojnë se recesionet kanë një efekt të përhershëm në nivelin e PBB-së në periudhat e ardhshme Cerra dhe Saxena (2008).

De Long dhe Summers (2012) përmendin se zyra e buxhetit të kongresit të SHBA-ve e njohin këtë fakt, dhe prandaj i ulin vlerësimet e tyre në lidhje me prodhimin potencial të ardhshëm atëherë kur prodhimi bie nën mesataren potenciale gjatë një viti.

Një numër i madh i studimeve empirike kanë gjetur dëshmi që ekziston një marrëdhënie ndërmjet borxhit publik dhe rritjes ekonomike, me konkretisht sipas pjesës dërmuese të këtyre studimeve potencohet se kjo lidhje ndryshe është një raport jo-linear në mes të borxhit publik dhe rritjes ekonomike, si dhe karakterizohet nga prania e një pragu ose kufiri të caktuar ku çdo tejkalim i këtij pragu ose kufiri mund të sjell impakt negativ mbi rritjen ekonomike, ndërsa shfrytëzimi i borxhit publik deri në atë masë që nuk e tejkalon këtë prag ose kufi optimal rezultatet do të jenë në dobi të rritjes dhe zhvillimit ekonomik.

Ndërkohë që marrëdhëniet jo-lineare dhe efektet e pragut mund të lindin edhe nga prania e shtrëngimit të borxhit publik Krugman (1988), Sachs (1989), mirëpo nuk është edhe shumë e qartë, por disa argumente të cilat e potencojnë një lehtësi të madhe të bartjes ose transferimit të borxhit në ekonomitë e vendeve të zhvilluara ku shumica e mbajtësve dhe shfrytëzuesve të borxhit publik janë banor rezident, dhe për këtë arsye nuk paraqet ndonjë problem të transferimi i jashtëm i borxhit publik. Sipas Greiner (2012a), në analizën e tij tregon një strukturë të tillë ku borxhi publik është tërësisht i parëndësishëm, si dhe tregon një lidhje jo-lineare në raport mes borxhin publik dhe rritjes ekonomike, duke potencuar që rritja mund të vjen si rezultat i rritjes së normës së taksimit.

Ai pastaj tregon se lejimi i një politike më të përgjithshme dhe liberale në raport me borxhin publik, çon në një marrëdhënie monotone dhe negative në mes të borxhit publik dhe rritjes së qëndrueshme të shtetit. Greiner (2011, 2012b) gjithashtu argumenton se efekti në rritje i borxhit publik varet nga prania e ngurtësimeve të pagave si një nga proceset me të rëndësishme ekonomike. Në veçanti, Greiner (2011) tregon se në një model pa ngurtësim (ngurtësimi i pagave) në prani të kërkesës elastike të punës, atëherë borxhi publik ka një efekt negativ në procesin e punësimit, si dhe ndikon në uljen e investimeve dhe rritjes ekonomike.

Në praninë e ngurtësimeve të pagave, dhe rritjes së papunësisë borxhi publik nuk ka efekt mbi alokimin e burimeve, mirëpo çka vlen të potencohet është se mund të ketë një efekt pozitiv nëse përdoret për të financuar produktivitetin e investimeve. Feldstein thekson se rritja e nivelit të borxhit publik ulë kursimet në një ekonomi që është në rritje e sipër. Një nga kritikët e Barros, Buchanan (1976) tha se kjo pyetje u ngrit nga Ricardo dhe u përpunua nga De Viti. Disa nga argumentet e Buchanan kundër idesë së Barros lidhur me dështimin e tij për të krahasuar ndikimet diferenciale të tatimit dhe çështjes së borxhit në rritjen ekonomike.

Pavarësisht nga qasja e zgjedhur, ideja se nuk ka drekë falas në ekonomi është pranuar gjerësisht, pasi që shlyerja e ardhshme e kredive aktuale mund të çojë në mënyrë të pashmangshme në një ulje të nivelit të investimeve, dhe rrjedhimisht në uljen e rritjes ekonomike. Nëse një deficit buxhetor do të financohet pjesërisht ose tërësisht, duke shmangur kursimet e familjeve ose kompanive ndaj sektorit publik, atëherë investimet dhe shpenzimet e gjeneruara nga sektori publik do të bëhen në kurriz të investimeve dhe shpenzimeve që mund të ishin bërë nga sektori privat, në mungesë të ndërhyrjes së qeverisë Friedman (1971).

Barro (2009) gjatë një analize shkencore arriti në përfundimin se koeficienti i politikës fiskale do të ishte i pavlefshëm, ose i parëndësishëm në raport me rritjen ekonomike. Sipas gjetjeve të këtij studimi theksohet se mungesa e efikasitetit dhe shtrembërimet e shkaktuara nga ndërmarrjet publike në ekonomi duhet të merren parasysh, sepse ato janë komponentë mjaft të rëndësishme të zhvillimit ekonomik.

Ndërsa Taylor (2012) gjatë hulumtimeve të bëra pretendon se nëse normat e rritjes së PBB-së do të ishin pozitive, dhe me të larta se sa normat reale të interesit, atëherë një masë e tillë shtrënguese do të bëhej e panevojshme për të rritur qëndrueshmërinë e borxhit publik. Rezultatet e kësaj analize kanë treguar se deficitin primar federal dhe financimi neto i qeverisë u ballafaquan me një evolucion ekspansionist gjatë periudhave të recesionit ekonomik në shumë vende.

Kjo dëshmoi rolin kundër-ciklik ndaj politikës fiskale. Andaj mund të themi se një tkurrje e PBB-së reale prej 1% gjatë një tremujori mund të ndikoj drejtpërdrejtë në rritjen e raportit të borxhit publik ndaj PBB-së për kokë banori për 0.7%. Dallimi kryesor është se një nivel i lartë i raportit të borxhit publik ndaj PBB-së konsiderohet si rezultat i një niveli të ulët të rritjes ekonomike.

Sipas këtyre gjetjeve shohim se vendet të cilat ballafaqohen me probleme në aspektin e zhvillimit ekonomik, dhe nuk reflektojnë progres sa i përket rritjes ekonomike kanë tendenca të rritjes së nivelit të borxhit publik. Këto janë analizuar mirë edhe në studimin shkencor të bërë nga autorët Reinhart dhe Rogoff (2010). Një rritje eventuale e normës së rritjes ekonomike në SHBA nga 2.7% në vitin 2011 në 3.7% në 2012, do të reduktonte deficitin primar nga 8.3% në 6.8% të PBB-së, duke ndikuar kështu në ndryshimin ose lëvizjen e trendit të raportit të borxhit publik ndaj PBB-së për kokë banori në SHBA.

Një numër i konsiderueshëm ekonomistësh mendojnë dhe besojnë se stimulimi i rritjes ekonomike përmes aplikimit të një normë të ulët të interesit, mund të ndikojë drejtpërdrejtë dhe në mënyrë thelbësore në trajtimin efektiv të qëndrueshmërisë së borxhit publik, do të thotë çdo ulje e normës së interesit mund të afektojë në zvogëlimin e shfrytëzimit të borxhit publik.

Collingnon dhe Mundschenk gjithashtu mbështetën këtë pikëpamje shkencore në vitin (1999), duke u fokusuar në qëndrueshmërinë e politikave fiskale, dhe borxhit publik të vendeve të Bashkimit Evropian.

Të dy autorët me lartë pohojnë se ky model duhet të marrë parasysh edhe qëndrueshmërinë fiskale, të siguruar nga aplikimi i politikave të duhura fiskale, si dhe evoluimin e normës së inflacionit si pasoje e rritjes së nivelit absolut të borxhit publik, ndërsa rritja e borxhit publik vjen si arsyeje e evoluimit të deficitit korrent (deficiti primar plus norma nominale e interesit).

Qka është shumë me rëndësi dhe që duhet të potencohet është që të rifillojë rritja ekonomike me një trend dhe nivel me të lartë se sa normat reale të interesit, dhe kjo është e mundur vetëm nëse realizohet përmes menaxhimit dhe stabilizimit të deficitit afatshkurtër me anë të politikave shtrënguese dhe efektive. Këto gjetje mjaft interesante dhe kredibile janë bërë nga autorët si në vijim Collignon dhe Mundschenk (1999), Taylor et al(2012).

Mirëpo sa i përket disa studimeve të tjera empirike të bëra nga autori Schclarek (2014) në analizën e tij shkencore që është potencuar edhe me lartë disa herë në rishikimin e literaturës përdori një mostër prej 24 vendeve industriale, me të dhëna mesatare për shtatë periudha pesëvjeçare ndërmjet viteve 1970 e gjer me tani.

Mirëpo nga gjetjet dhe konkludimet e tij ky autor nuk gjene ndonjë lidhje të rëndësishme midis borxhit publik dhe rritjes ekonomike në vendet e industrializuara. Për dallim nga Reinhart dhe Rogoff (2010) të cilët kanë konstatuar se rritja e nivelit eventual të borxhit publik nën pragun optimalmund të ndikojë pozitivisht në rritjen ekonomike, ndërsa rritja e borxhit publik mbi nivelin e duhur (pragun optimal), mund të ndikojë negativisht duke frenuar kështu rritjen dhe zhvillimin ekonomik të vendeve në përgjithësi.

Pas këtyre studimeve mjaft kredibile dhe signifikante të themi, Lof dhe Malinen (2014) nuk gjejnë ndonjë dëshmi për ndonjë efekt të fuqishëm në mes të borxhit publik dhe rritjes ekonomike, madje edhe nëse kemi nivele të larta të borxhit publik prap nuk ka ndonjë ndikim të caktuar në rritjen ekonomike. Ndërsa Woo dhe Kumar (2015), në studimin e tyre janë munduar të analizojnë edhe faktor të tjerë ose variabla të cilat kanë efekt të caktuar në rritjen ekonomike të vendeve.

Po ashtu Baum et al. (2013) në analizën e tij shkencore zbulon diçka te njëjtë që mund të krahasohet edhe me studimet të bëra nga Checherita, ku sipas të gjeturave të tij konstatohet se niveli i ulët i borxhit publik mund të ndikoj pozitivisht në rritjen ekonomike, si dhe konstaton se borxhi publik në periudhat afatshkurtër ka tendence të ndikimit pozitiv në rritjen ekonomike të vendeve.

Në të kundërt studimet shkencore të bëra nga Dreger and Reimers (2013) e bazojnë analizën e tyre në dallimin midis periudhave të borxhit publik, me konkretisht duke bërë dallimin në mes të borxhit publik të qëndrueshëm, si dhe borxhit publik jo të qëndrueshëm.

Ata erdhën në përfundim se borxhit publik mund të ndikoj negativisht në rritjen ekonomike gjatë periudhave kur borxhi publik është i qëndrueshëm p.sh në vendet e Unionit Evropian.

Këto studime janë të unifikuara dhe të zgjeruara nga Antonakakis (2014), i cili përmes metodave ekonometrike, konkretisht analizës së regresionit linear të bazuar nga seritë e të dhënave panel, analizon dhe shqyrton lidhjen në mes të qëndrueshmërisë së borxhit publik, si dhe ndikimin i tij në rritjen ekonomike të vendeve.

Për më tepër studimi i bërë nga Égert (2015) paraqet disa prova empirike që sugjerojnë se pragu ose kufiri i borxhit publik prej 90% nuk është një numër magjik, sepse pragu mund të jetë edhe më i ulët dhe mund të ndryshojë nga vendi në vend, si dhe nga mostrat e ndryshme.

Ky autor ka analizuar kufirin e borxhit publik tek një mostër prej 11 vendeve Evropiane, ku është munduar të paraqes lidhjen ose marrëdhënien në mes të borxhit publik dhe rritjes ekonomike, duke potencuar prapun se deri në cilin nivel efekti i borxhit publik do të jetë pozitiv në rritjen ekonomike të vendeve Evropiane.

Puig dhe Rivero (2015) konstatojnë se borxhi publik ka një efekt negativ në rritjen ekonomike nëse pragu i borxhit publik është midis 56% dhe 103%, çdo tejkalim i këtij pragu ndikon negativisht në rritjen ekonomike të vendeve.

Modeli i tillë tregon se borxhi publik mund të ndikojë në kërkesën agregate, duke rritur prodhimin në periudhën afatshkurtër, por i zë vendin kapitalit që rezulton pastaj me një rënie të prodhimit në periudhat afatgjata.

Kur prodhimi është me i madh nga kapaciteti i tij, efekti pozitiv afatshkurtër i deficitit buxhetor është menduar të jetë shumë i lartë. Por në periudhat afatgjata, ulja e kursimeve publike ka rezultuar me një deficit të lartë buxhetor, një gjë e tillë nuk mund të këtë ndikim të caktuar në rritjen e kursimeve private.

Një situatë e cila karakterizohet me kursime të reduktuara në kuadër të ekonomisë kombëtare, mund të ndikojë në uljen e investimeve totale si në vend, po ashtu edhe jashtë vendit.

Kjo situatë ndikon negativisht në GDP-në dhe GNP-në. Në anën tjetër investimet e huaja direkte do të kenë një efekt negativ në zvogëlimin e të ardhurave Elmendorf dhe Mankiw (1999).

Emëruesi i përbashkët nga situata e dhëne më sipër mund të përforcohet nga prania e taksave deformuese. Efekti negativ i rritjes së borxhit publik mund të jetë edhe më i madh në prani të pasigurisë së politikave të ndryshme, apo pritjeve të konfiskimit në të ardhmen konkretisht nëpërmjet inflacionit dhe shtypjes financiare Cochrane (2011a) dhe Cochrane (2011b).

Buchanan (1958) dhe Meade (1958), më vonë Modigliani (1961) kishin argumentuar teoritë e tyre, duke konkluduar se grumbullimi i borxhit kombëtar ka efekt mbi rritjen e normave të interesit në periudhat afatgjatë, sepse tendenca e kapitalit privat është e madhe për rritjen e produktit marginal, gjithashtu borxhi kombëtar konsiderohet si një barrë tatimore për brezat e ardhshëm.

Po ashtu vlejnë të ceket se kemi ca studime të cilët kanë përcaktuar disa kanale që mund të kenë një efekt negativ mbi rritjen ekonomike në periudhat afatmesme dhe ato afatgjatë Gale dhe Orszag (2003), Baldacci dhe Kumar (2010).

Nëpërmjet normave të interesit mund të ndikohet negativisht në akumulimin e kapitalit dhe rritjen ekonomike Barro 1979 dhe Dorsey (1994), të cilët kanë nxjerrë në pah tatimin deformues që mund të jetë në të ardhmen në situata më ekstreme Burnside (2001) dhe Hemming (2003) ku tregojnë se kriza e rritjes së borxhit mund të jetë një faktor i cili mund të prodhojë krizë të valutave në institucione bankare si dhe ato financiare.

Studimet teorike dhe empirike tregojnë që vendet që kanë rritje të borxhit publik përballen zakonisht me pasiguri ekonomike. Fernald dhe Matoba (2009) argumentojnë se PBB-ja ra në SHBA kryesisht për shkak se punësimi shënojë një rënie drastike, dhe përdorimi i stokeve të kapitalit u zvogëluan.

3.3.Evidenca Empirike në vendet në Zhvillim

Me lartë trajtuam evidencën empirike mbi borxhin publik në vendet e zhvilluara, ndërsa tani tek kjo pjesë do të paraqesim shqyrtimin empirik të borxhit publik në vendet në zhvillim e sipër (vendet në tranzicion). Gjatë shqyrtimit të literaturës empirike të kjo pjesë mund të vërejmë se nuk ka edhe shumë studime cilësore që trajtojnë efektin e borxhit publik mbi rritjen ekonomike në vendet në zhvillim, sidomos tek vendet e Ballkanit Perëndimor ku ka shumë pak studime të tilla, ose më mirë të themi fare. Andaj më poshtë do të mundohemi ti paraqesim disa nga studimet kryesore që trajtojnë borxhin publik tek vendet në zhvillim.

Në një studim shkencor të bërë nga Uzun (2012) mund të vërejmë se autori përdori modelin auto-regresiv me vonesa të shpërndara për të hetuar lidhjen në mes të borxhit publik dhe rritjes ekonomike për vendet në Tranzicion, gjatë periudhës kohore 1991-2009. Autori në fjalë arriti në përfundimin se ekziston një lidhje pozitive në mes të borxhit publik dhe rritjes ekonomike në periudhat afat-gjata tek vendet në zhvillim, me konkretisht vendet në tranzicion. Maana (2008) trajtojë ndikimin ekonomik të borxhit të brendshëm të ekonomisë së Kenias. Studiuesi në fjalë përdori metodën e katrorëve të vegjël ‘OLS’ duke përdorur të dhëna vjetore për periudhën 1996-2007. Gjetjet treguan se rritja e borxhit të brendshëm ka një efekt pozitiv mbi rritjen ekonomike të këtij vendi. Mirëpo duhet potencuar numërin e vëzhgimeve, ku në këtë studim shkencor nuk është edhe shumë i lartë, dhe një gjë e tillë tregon një signifikançë jo të madhe shkencore të kësaj analize.

Gjithashtu një studim tjetër i bërë në lidhje me ndikimin e borxhit të brendshëm publik në rritjen ekonomike në Pakistan, paraqet disa gjetje mjaft interesante i bërë nga Sheikh (2010). Të dhënat në këtë studim janë marrë gjatë periudhës kohore 1972-2009. Në këtë studim autori ka përdorur një metodologji mjaft të varfër, duke mos përdorur metoda dhe modele të avancuara ekonometrike. Të gjeturat kryesore të këtij studimi potencojnë që ekziston një lidhje negative në mes të borxhit publik dhe rritjes ekonomike.

Autori në fjalë argumenton këtë konstatim duke u bazuar tek shpenzimet jo produktive të cilat pengojnë rritjen ekonomike. Gjithashtu në harmoni të plotë me këtë studim është Calderon dhe Fuentes (2013) të cilët nëpërmjet të dhënave dhe serive kohore panel, erdhën në përfundim se nuk ekziston ndonjë lidhje në mes të borxhit publik dhe rritjes ekonomike, duke konstatuar kështu që rritja e nivelit të borxhit publik ndikon negativisht në rritjen ekonomike.

Mirëpo si gjetje e rëndësishme në këtë studim ishte matja dhe vlerësimi i ndikimit të faktorëve strukturor të lidhur me cilësinë e institucioneve, dhe zhvillimin e tregjeve financiare. El Mahdz dhe Torayeh (2009) gjatë analizës së tyre shkencore erdhën në përfundim se rritja e nivelit të borxhit publik të brendshëm ndikon negativisht në rritjen ekonomike. Këto gjetje autorët në fjalë argumentojnë se nëse rritet kërkesa për fonde shtesë nga ana e qeverisë së një vendi mund të qojë në rritjen e normave të interesit në tregjet financiare, të cilat ndikojnë pastaj në rritjen e kostove të investimeve të reja private.

Ahmad Mousa dhe Shawawreh (2017) kanë analizuar borxhin publik dhe rritjen ekonomike, ku nëpërmjet këtij studimi është analizuar ndikimi i borxhit publik në rritjen ekonomike në Jordani, gjatë periudhës kohore 2000-2015. Në këtë studim është përdorur një metodologji gjithëpërfshirëse, ndërsa testimi i të dhënave është bërë përmes metodës ekonometrike, me konkretisht përmes analizës së regresionit linear. Sipas rezultateve të fituara nga ky hulumtim shohim se rritja e përgjithshme e borxhit publik, me theks të veçantë borxhit të jashtëm ndikon negativisht mbi rritjen ekonomike të Jordanisë.

Pegkas (2018) analizon efektet e borxhit publik dhe rritjes ekonomike nëpërmjet bruto produktit të brendshëm. Studimi është realizuar nëpërmjet aplikimit të metodës së regresionit linear, duke ndërtuar kështu modelin ekonometrik, ku në anën e djathtë të ekuacionit ka disa ndryshore të kontrollit të rritjes ekonomike, të cilat përfshijnë investimet, konsumin privat, konsumin publik, lirinë tregtare, si dhe indeksin e rritjes së popullsisë. Ky studim empirikisht analizon lidhjen e borxhit publik me PBB-në, dhe përcaktuesve të tjerë ekonomik të tilla si; investimet, konsumin privat, konsumi publik, lirinë tregtare, si dhe indeksin e rritjes së popullsisë

Rezultatet tregojnë se të gjitha variablat në periudhën afatgjatë kanë afektuar pozitivisht në rritjen ekonomike të Greqisë, me përjashtim të borxhit publik dhe rritjes së popullsisë. Gjithashtu duke përdorur modelet e thyerjeve strukturore ky autorë gjenë dëshmi në favor të një marrëdhënie negative midis borxhit publik dhe rritjes ekonomike. Përfundimi kryesor i rezultateve ishte se kriza në Greqi kishte filluar shumë më herët se sa kriza e fundit globale.

Në studimin e Drine dhe Nabi (2010) shohim se metodologjia e përdorur në këtë studim është bazuar më shumë tek modelet ekonometrike. Gjatë hulumtimit autorët përdorën të dhënat e serive kohore në formë të panelit për 27 vendeve në zhvillim gjatë periudhës kohore 1970-2005.

Gjetjet në këtë studim tregojnë se një rritje e borxhit publik të jashtëm redukton efikasitetin e prodhimit vendor. Gjithashtu, rezultatet e këtij studimi tregojnë se marrëdhënia në mes të investimeve dhe prodhimit është pozitive, duke konstatuar kështu që rritja eventuale e investimeve ndikon pozitivisht në rritjen e prodhimit. Anyanwu dhe Erhijakpor (2004) kanë studiuar ndikimin e borxhit në rritjen ekonomike të Nigerisë gjatë periudhës kohore 1970-2003. Studimi raportoi se borxhi publik ka një ndikim negativ në rritjen ekonomike.

Gjithashtu edhe El-Mahdi dhe Torayeh (2009) kanë hetuar marrëdhëniet në mes të borxhit publik dhe rritjes për ekonomike të Egjiptit, duke përdorur të dhëna që mbulojnë periudhën kohore 1981-2006. Rezultatet kryesore në këtë studim tregojnë një lidhje negative në mes të borxhit dhe rritjes ekonomike, duke konstatuar që rritja eventuale e borxhit ndikon në masë të madhe negativisht në frenimin e zhvillimit ekonomik.

Ogunmuyiwa (2011) vlerësoi efektin e borxhit në rritjen ekonomike të Nigerisë nga 1970-2007. Rezultatet zbuluan një marrëdhënie të dobët dhe të parëndësishme midis borxhit dhe rritjes ekonomike në përgjithësi. Shah dhe Shahida (2012) kanë hetuar efektin e borxhit publik mbi rritjen ekonomike të Bangladeshit për periudhën 1980-2012 dhe nuk kanë gjetur ndonjë ndikim të mundshëm të borxhit publik tek ecuria e rritjes ekonomike.

Gjithashtu edhe një studim tjetër jep rezultate të njëjta sa për sa i përket ndikimit të borxhit publik, Tchereni (2013) i cili analizoi efektin e borxhit publik mbi rritjen ekonomike të Malavit gjatë periudhës kohore nga 1975 deri më 2003. Ata raportuan një marrëdhënie negative ndërmjet borxhit dhe rritjes ekonomike në Malavi, duke potencuar se rritja e borxhit mund të ketë pasoja të dëmshme në zhvillimin ekonomik.

Gjithashtu, disa studime të caktuara empirike kërkonin të përcaktojnë dhe shpjegojnë marrëdhëniet midis borxhit publik dhe rritjes ekonomike në vende të ndryshme, duke u përqëndruar në modele të ndryshme ekonometrike, të cilat kishin për qëllim përcaktimin e pragut ose të kufirit optimal të borxhit publik, duke treguar se deri në cilën kufi rritja e borxhit publik ndikon pozitivisht në rritjen ekonomike. Sepse edhe studimet me lartë nga autorët paraprak kanë bërë definimin e pragut të borxhit publik, si dhe kanë përcaktuar së pragu ose kufiri i përdorimit tek vendet e zhvilluara është shumë më i lartë se sa tek vendet në zhvillim e sipër, me konkretisht vendet që janë në tranzicion ekonomik.

Gjithashtu edhe Cuestas (2014) argumenton se rritja e borxhit qeveritar mund të ndikojë negativisht në raport me PBB-në, gjithashtu sipas këtij studimi thuhet se rritja eventuale e borxhit qeveritar pretendon të këtë lidhje jo-lineare me rritjen ekonomike, duke shpjeguar se rritja e borxhit nuk mund të jap impuls pozitiv mbi rritjen ekonomike.

Atique dhe Malik (2012) në studimin e tyre shkencor shqyrtuan ndikimin e borxhit të brendshëm, dhe të borxhit të jashtëm mbi rritjen ekonomike të Pakistanit gjatë periudhës kohore (1980-2010), duke përdorur një qasje empirike të bashkë integritit të të dhënave si dhe testimin e tyre përmes analizës së korrelacionit.

Rezultatet treguan një ndikim negativ të borxhit publik mbi rritjen ekonomike të Pakistanit, duke potencuar se rritja e borxhit publik si brenda ashtu edhe jashtë nuk jap efekt pozitiv në rritjen ekonomike. Për dallim nga autorët e tjerë Bader dhe Magableh (2009) gjatë një analize shkencore kanë identifikuar përcaktuesit e borxhit publik në Jordani, duke përdorur testin e “Kointegritit Johansen” për periudhën kohore (1980-2004). Studimi zbuloi se hendeku i kursimit, deficitit buxhetor, kursi real i këmbimit, si dhe rrjedha e ndihmës së huaj ishin përcaktuesit kryesorë të borxhit publik.

Ahmed (2015) ka analizuar ndikimin e borxhit të jashtëm në rritjen ekonomike të Irakut gjatë periudhës kohore (1980-2014) duke përdorur disa nga metodat me të përdorura ekonometrike, me konkretisht nëpërmjet OLS-së në formë regresionit të shpërndarë. Rezultatet treguan një ndikim negativ të borxhit të jashtëm në raport ndaj PBB-së në periudhën afatshkurtër dhe afatgjatë.

Me konkretisht rritja eventuale e borxhit publik si në periudhën afatshkurtër si në afatgjatë ndikon negativisht në rritjen ekonomike. Boboye dhe Ojo (2012) kanë analizuar efektin e borxhit të jashtëm mbi rritjen ekonomike në Nigeri. Autorët kanë përdorur metodën e regresionit të thjeshtë me shumë pak observacione dhe të dhëna. Gjetjet në këtë studim treguan një efekt negativ të borxhit të jashtëm mbi të ardhurat e vendit, dhe të ardhurat për kokë banori.

Karagol (2002) shqyrtoi marrëdhëniet midis rritjes ekonomike dhe borxhit të jashtëm publik në Turqi për periudhën kohore 1956-1996. Studimi tregoi një marrëdhënie negative midis borxhit të jashtëm dhe rritjes ekonomike në periudhën afatgjatë. Autori në fjalë trajtojë ndikimin e borxhit publik tek norma reale afatgjatë e rritjes së PBB-së, duke marrë parasysh një mostër prej 24 vendeve në zhvillim gjatë një periudhe prej gati 200 vjet (1790- 2010).

Rezultatet e fituara nga ky studim po thuhet janë të ngjashme me ato të studimeve paraprake, sipas këtyre të dhënave potencohet se një prag i rritjes së borxhit publik deri në 90% të PBB-së mund të ketë ndikim pozitiv mbi rritjen ekonomike. Ky proces mund të ketë efekt në periudha afatshkurtra, ndërsa në periudha afatgjatë efektet e borxhit janë cilësuar si negative, duke e frenuar në mënyrë sistematike rritjen dhe zhvillimin ekonomik të këtyre vendeve.

Në studimin e realizuar nga autorët Dinca dhe Sorin Dinca (2015) janë bërë disa konstatime në lidhje me borxhin publik dhe rritjen ekonomike, duke i potencuar vështirësitë për të hetuar marrëdhënien në mes të borxhit publik dhe rritjes ekonomike. Gjithashtu vlejnjë të theksohet se ky debat është ngritur dhe është diskutuar nga shume autorë, si dhe shkolla të ndryshme shkencore. Në këtë hulumtim shkencor është analizuar lidhja në mes të borxhit publik dhe rritjes ekonomike në një mostër prej 10 vendeve evropiane ende në zhvillim të tilla si : Bullgaria, Republika Çeke, Estonia, Letonia, Lituania, Hungaria, Polonia, Rumania, Sllovenia, si dhe Republika Sllovaqe.

Hulumtimi në fjalë është realizuar duke përdorur modelin e regresionit të rritjes përmes inkuadrimit të 10 variablove të pavarura të tilla si në vijim : borxhi bruto i qeverisë si pjesë e PBB-së, liria ekonomike, norma e rritjes së popullsisë, norma nominale e interesit afatshkurtër, formimi i kapitalit fiks bruto, investimet fikse qeveritare, kursimet kombëtare bruto, të ardhurat e qeverisë, si dhe produktiviteti i punës.

Megjithatë një studim i bërë Schclarek (2004) potencon se nuk ka gjetur ndonjë korrelacion, ose ndonjë lidhje jo-lineare në mes të borxhit publik dhe rritjes ekonomike për vendet në zhvillim. Përkundrejt këtij sfondi të lartëpërmendur studimet e fundit të bëra nga Bosworth dhe Collins (2003) sugjerojnë se është më mirë të përqendrohet në një grup bazë të variablove shpjeguese, që janë të lidhura në vazhdimësi me variablat e rritjes ekonomike.

Duke përdorur të dhënat në formë të serive panel, përmes shfrytëzimit të metodës ekonometrike OLS (Metoda e Katrorëve të Vegjël) të modifikuar plotësisht, Ying et al. (2014) analizojnë vendet e ASEAN, ku erdhi në përfundim se aplikimi i procesit të globalizmit ekonomik ndikon pozitivisht në rritjen ekonomike. Megjithatë një grup autorëve në gjetjet e tyre kanë treguar se globalizimi social ka një ndikim negativ mbi rritjen ekonomike, ndërkohë që globalizimi politik ka pasur poashtu një efekt negativ, mirëpo jo të rëndësishëm në rritjen ekonomike p.sh në dekadën e fundit në Rumani.

Autori theksoi gjithashtu rëndësinë e madhe të IHD-ve si një mjet për të siguruar efikasitetin e tregtisë së jashtme, gjithashtu aplikimi dhe prania e tyre ndikon drejtpërdrejt në rritjen ekonomike të vendeve. Gjithashtu një numër i konsiderueshëm i studimeve dhe i hulumtimeve kohën e fundit kanë trajtuar disa çështje të rëndësishme ekonomike. Me konkretisht në këto studime është trajtuar raporti në mes të rritjes ekonomike, deficiteve buxhetore, borxhit publik, si dhe normave të interesit nga autorët Blanchard (1984), Chalk, (2000), Rankin dhe Roffia (2003), Schclarek (2004), Gale dhe Orsza (2004), Reinhart dhe Rogoff (2010), Taylor et al (2012), Egert (2013), Pescatori et al (2014).

Rezultatet e studimeve me lartë është mire të krahasohen me autorët Reinhart dhe Rogoff (2010) ku në studimet e tyre shkencore morën rezultate të rëndësishme në këtë fushë ekonomike. Gjetjet e tyre treguan se lidhja mes borxhit të qeverisë dhe rritjes reale ekonomike të PBB-së është një lidhje mjaft e dobët në një raport më të vogël se 90% e borxhit në raport me PBB-në. Sipas tyre nëse borxhi publik rritet deri tek pragu 90%, atëherë normat mesatare të rritjes kanë tendencë të rënies për 1%, ndërsa edhe rritja mesatare ekonomike mund të zvogëlohet edhe më shumë.

Për më tepër, studimi i tyre shkencor zbuloi se vendet në zhvillim kishin një prag më të ulët të borxhit të jashtëm (publik dhe privat), i cili zakonisht ishte në valutë të huaj. Kur ky nivel i borxhit publik tejkalon 60% të PBB-së, rritja vjetore ekonomike mund të influencohet duke u zvogëluar për afro 2%. Këto rezultate kanë ngritur debate të shumta, veçanërisht në mjedisin politik të vendimmarrjes, shoqërisë civile, si dhe tek mediat.

Irons dhe Bivens (2010), si dhe Pescatori et al. (2014) në studimet e tyre shkencore diskutojnë rëndësinë e pragut të borxhit publik i cili është 90%, dhe i cili është përmendur në studimet shkencore të bëra nga Reinhart dhe Rogoff (2010). Ata pretendojnë se rreziku nuk vjen nga mungesa e mjeteve për të mbështetur deficitet buxhetore dhe borxhin publik, mirëpo rreziku vjen nga mungesa e veprimeve politike të shkaktuara nga deficitet buxhetore, si dhe ngritja e shqetësimeve në lidhje me destinimin e fondeve të huazuara.

Deficitet aktuale buxhetore qartë ndikojnë negativisht mbi normat e interesit në periudhat eardhshme, këto gjetje shkencore janë analizuar dhe studiuar edhe nga autorët Gale dhe Orszag (2004). Qeveritë janë të detyruara të mbështetësin rritjen e nivelit të kredive, si në tregun vendor gjithashtu edhe në atë të huaj, për të financuar deficitet aktuale buxhetore.

Kjo në anën tjetër, ndikon në kërkesën për rritje të kapitalit përmes kredive, duke vendosur presione të vazhdueshme në rritjen e normës së interesit, dhe ky proces mund të çon në një rënie të normave të kursimit dhe të investimeve në sektorin privat Reinhart dhe Rogoff (2010).

Në studimin e tij Schclarek (2004) arriti në përfundimin se një lidhje e rëndësishme midis borxhit publik dhe rritjes ekonomike nuk mund të trajtohet dhe identifikohet në vendet të cilat janë të zhvilluara shumë ekonomikisht, sepse përqindja e borxhit publik në këto vende është shumë e lartë, mirëpo edhe zhvillimi ekonomik është shumë i madh. Për vendet të cilat janë ende zhvillim, nivelet më të ulëta të borxhit të jashtëm publik shoqërohen me ritme më të larta të rritjes ekonomike. Ndërsa e kundërt me këtë fenomen është se borxhi i jashtëm privat nuk afekton, ose më mirë të themi nuk ka ndikim në procesin e rritjes ekonomike.

Buiter (2010) pohon se në SHBA, deficitin primar duhet të reduktohet rreth 8% e PBB-së së përgjithshme atëherë kur norma reale e interesit, si dhe norma e rritjes ekonomike nuk mund të ndikohen nga mjetet e politikave qeveritare. Përndryshe, borxhi publik do të bëhet i paqëndrueshëm. Eberhardt dhe Presbitero (2015) në studimin e tyre hetojnë dhe analizojnë raportin e borxhit publik dhe rritjes ekonomike tek 118 vende të cilat janë ende në zhvillim e sipër.

Këta autorë argumentojnë se nuk ka dëshmi të besueshme për një prag të caktuar ose kufi optimalë përbashkët për borxhin publik në të gjitha vendet në përgjithësi. Me konkretisht sipas kësaj analize edhe një herë vërtetohet se pragu ose kufiri i borxhit publik ndryshon në varësi të shteteve, çka do të thotë çdo vend mund të ketë nivel ose prag të ndryshëm të shfrytëzimit të borxhit publik.

Kjo analize shkencore është vërtetuar edhe nga autorë të tjerë me karakter ndërkombëtar të cilët kanë potencuar se pragu ose kufiri i borxhit publik dallon dhe ndryshon tek vendet në përgjithësi. Sipas këtyre gjetjeve konstatohet se p.sh vendet e zhvilluara mund të përdorin nivele më të larta të shfrytëzimit të borxhit publik, dhe të kenë zhvillim dhe rritje ekonomike. Ndërsa tek vendet të cilat janë ende në zhvillim ose më mirë të themi në fazën e tranzicionit ekonomik pragu ose kufiri optimal i shfrytëzimit të borxhit publik është më i ulët se tek vendet e zhvilluara Mecinger dhe Verbic (2015).

Në rast se hyrja e kapitalit nuk është pafundësisht në formën elastike, atëherë paaftësia e qeverisë për të siguruar lëvizshmërinë përsosur të kapitalit, mund të afektojë në rënien e kursimeve kombëtare, si dhe mund të ushtrojë një presion mbi normat e interesit duke ndikuar drejtpërdrejt në rënien e investimeve të huaja neto Elmendorf dhe Mankiw (1999).

Vendet e Ballkanit Perëndimor përfaqësojnë një burim veçanërisht të mirë të dhënave për testimin e rëndësisë së institucioneve mbi rritjen ekonomike, sepse këto vende e filluan procesin e tranzicionit ekonomik me institucionet ekonomike me një diktaturë me të dobët. Për më tepër, në krahasim me vendet e tjera në zhvillim, këto vende filluan procesin e tranzicionit me rezervat relativisht të mëdha të kapitalit njerëzor. Kështu, dallimet në këtë ndryshore nuk duhet të luajnë një rol vendimtar.

Disa studime tjera kanë përdorur tregues të BERZH për të matur ndryshimin institucional të vendeve që janë në tranzicion. BERZH ka publikuar të dhëna vjetore të vendeve në tranzicion duke matur progresin e tyre sipas reformave të tregut. Kështu në vitet e vona të tranzicionit këto vende prodhojnë vlerësime mjaft homogjene për ekonomitë më të përparuara në tranzicion (p.sh., Shtetet Baltike dhe vendet e EQL).

Ato janë më të përshtatshme për të dalluar vendet të cilat kanë përparuar, gjithashtu dhe ato që nuk kanë pasur progres sa i përket aplikimit të reformave që i kërkon tregu. Megjithatë Heckelman dhe Stroup (2000, 2005) theksojnë se peshat në elementet e grumbulluara në një indeks të vetëm shpesh nuk reflektojnë ashtu si duhet në madhësinë efektit marginal që afektojnë rritjen ekonomike.

Ne besojmë se madhësia e shtetit është gjithashtu një përcaktues potencialisht i rëndësishëm i rritjes ekonomike, por e trajtojnë atë si një variabël të veçantë e jo si një komponent i lirisë ekonomike. Shumë nga shtetet e kontinentit Evropian u bënë pjesë e Unionit Evropian, 11 shtetet nga Evropa Qendrore dhe Lindore (CEE) u anëtarësuan në Bashkimin Evropian në vitin 2004, 2007, dhe 2011. Këto janë Bullgaria, Republika Çeke, Estonia, Kroacia, Letonia, Lituania, Hungaria, Poloni, Rumania, Sllovenia dhe Sllovakia. Kontabiliteti i rritjes ekonomike nënkupton dekompozimin e rritjes së prodhimit nga rritja e inputeve të prodhimit, si dhe shumës së përgjithshme të produktivitetit të faktorëve të mbetur.

Kontabiliteti i rritjes është shumë i rëndësishëm tek vendet e Evropës Lindore dhe Qendrore, pasi që ato kanë shfaqur rritje ekonomike të paqëndrueshme që nga mesi i viteve 1990. Këto vendet në përgjithësi kanë pasur rritje të fuqishme ekonomike nga mesi i viteve 1990 deri në vitin 2007, pastaj u ballafaquan me pengesa të thella gjatë krizës financiare globale në vitin 2008 dhe 2009.

Shumica e vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore kanë pasur rritje të shpejtë ekonomike, akumulim të shpejtë të kapitalit, si dhe deficite të mëdha të llogarisë korente në vitet para të krizës financiare globale. Krugman (1994) dhe Young (1995) në hulumtimet dhe studimet e tyre shkencore vunë në dukje se rritja shumë e shpejtë ekonomike prej 6-7 për qind në vit në ekonomitë e fuqishme të vendeve të Azisë Lindore para vitit 1997 erdhi kryesisht nga akumulimi i kapitalit, dhe jo nga rritja totale e produktivitetit të faktorëve të prodhimit.

Krugman (1994) e përdori këtë gjetje për të vënë në pikëpyetje qëndrueshmërinë afatgjatë të ecurisë së rritjes së ekonomive të këtyre vendeve, duke argumentuar se ato ishin të prekshme ndaj ndryshimeve në kushtet e financimit ndërkombëtar. Këto shqetësime u vërtetuan kur kriza aziatike shpërtheu në vitin 1997.

Ndërsa momenti kur kriza financiare globale preku vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore Bruto Prodhimi i Brendshëm kishte rënie prej 20%, kjo rënie ishte me e ndjeshme tek shtetet Baltike gjatë vitit 2008 dhe 2009, ndërsa Polonia ruajti ritme pozitive të rritjes ekonomike gjatë gjithë periudhës së krizës financiare. Një hap i parë drejt kuptimit të ngadalësimit të rritjes ekonomike të këtyre vendeve do të ishte të shqyrtimi i ritmit në mes të rritjes së kapitalit dhe produktivitetit total të faktorëve të prodhimit (Dimelis dhe Dimopoulou).

Një analizë e tillë mund të japë gjithashtu një tregues në lidhje me perspektivën e rritjes ekonomike në vitet në vijim. Rritja totale e produktivitetit të faktorëve është mbetja që mbetet kur efektet e faktorëve të tjerë që ndikojnë në rritjen ekonomike janë llogaritur. Rritja e produktivitetit të faktorëve mund të përfshijë edhe efektet në prodhimin e eksternaliteteve, si dhe ndryshimet në përbërjen sektoriale të prodhimit Easterly dhe Levine (2002), ose cilësia e politikave shtetërore në menaxhimin e ekonomisë Fischer (1993). Ne thjesht marrim rritjen e produktivitetit të faktorëve të prodhimit si pjesë e rritjes ekonomike, që nuk përcaktohet nga ndryshimet në punësim ose në kapitalin fizik të shfrytëzuar.

Megjithatë, shumica e vendeve të BE-së përjetuan recesion ekonomik gjatë viteve 1986-1991, dhe rritja e produktivitetit të faktorëve të prodhimit u ngadalësua në përgjithësi. Vanags dhe Bems (2005) gjatë një studimi shkencor kanë trajtuar disa nga shtetet Baltike gjatë viteve 1996-2003. Autorët konkludojnë se dinamika e rritjes ekonomike të shteteve baltike në fazën e hershme të tranzicionit i ngjante atyre të vendeve të mëdha evropiane gjatë epokës së ‘bretton woods’ por jo ato të ekonomive të fuqishme Aziatike, që ndryshe ju është referuar si “ tigrat aziatik”.

Arratibel et al. (2007) konstaton se rritja e produktivitetit të faktorëve të prodhimit kontribuoi shumë në rritjen e PBB-së, më shumë se sa akumulimi i kapitalit gjatë procesit të rritjes ekonomike në tetë vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore që ju bashkuan BE-së në vitin 2004. Megjithatë ky autor argumenton se rëndësia e akumulimit të kapitalit mund të nënvlerësohet, duke qenë se investimi mund të promovojë shpikjen e inovacioneve dhe transferimin e njohurive inovative.

Rapacki dhe Prochniak (2009) kanë trajtuar rritjen ekonomike tek 27 vendet evropiane në tranzicion gjatë viteve 1990-2003. Ata llogarisin seritë e kapitalit duke përdorur metodën e inventarit të përhershëm, mirëpo kapitali fillestar përcaktohet thjesht duke përcaktuar raportin në mes të kapitalit dhe prodhimit. Ku ndërveprimet ndërmjet strukturave sociale, politike, dhe ekonomike prodhuan një rrymë të re të njohurive dhe inovacioneve, në teknologjinë e ngushtë të prodhimit të mallrave dhe shërbimeve.

3.4.Përmbledhje e Përgjithshme

Për të përmbledhur aspektin teorik dhe empirik të rishikimit të literaturës që trajtuam me lartë mund të vërejmë se shumë autorë dhe studime të caktuara tentojnë të ju japin përgjigjeje pyetjeve kërkimore dhe hipotezave të paraqitura në fillim të këtij studimi. Për çdo studim dhe hulumtim shkencor është i domosdoshëm rishikimi i literaturës, sepse përmes rishikimit bëhet i mundur një vështrim i përgjithshëm mes informatave të cilat i posedojmë dhe i atyre që nuk i njohim. Gjithashtu rishikimi na ndihmon të krijojmë një pasqyrë të caktuar se si duhet të zhvillohet dhe organizohet studimi duke u bazuar tek metodat, mënyrat e organizimit, gjetjet, kontributet shkencore e tjera.

Me konkretisht nëpërmjet rishikimit të literaturës gjatë këtij studimi jam munduar që të shoh qasjen e trajtimit të borxhit publik dhe rritjes ekonomike tek vendet e zhvilluara si dhe vendet në zhvillim (tranzicion ekonomik) përmes studiuesve të ndryshëm.

Literatura e shqyrtuar implikon tre grupe studiuesve që trajtojnë efektin e borxhit publik dhe rritjes ekonomike. Në grupin janë paraqitur disa studime të autorëve të cilët kanë definuar prapun e borxhit publik dhe pohojnë se rritja e mundshme e borxhit publik ndikon pozitivisht në rritjen ekonomike.

Mirëpo çka është shumë me rëndësi të potencohet është sepse këta hulumtues kanë definuar, ose më mirë të themi kanë përcaktuar prapun e borxhit publik, që nënkupton se rritja e borxhit publik deri tek pragu i caktuar mund të afektojë pozitivisht në rritjen ekonomike.

Sipas tyre ekziston një dallim i pragut në mes të vendeve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim, që do të thotë tek vendet e zhvilluara pragu i borxhit publik është shumë më i lartë se sa tek vendet në zhvillim, nga të dhënat e këtyre studimeve mund të shohim se pragu i borxhit publik sillet nga 80% deri në 95% në vendet e zhvilluara.

Ndërsa tek vendet ende në zhvillim ose më mirë të themi në tranzicion ekonomik pragu i borxhit publik sillet prej 40% deri në 50%. Çdo rritje eventuale e borxhit publik mbi prapun e përcaktuar më lartë mund të ndikojë negativisht në rritjen ekonomike të vendeve të zhvilluara si dhe atyre në zhvillim (Jernej Mencinger Aleksander Aristovnik , Miroslav Verbic (2015), Checherita dhe Rother (2010), Reinhart dhe Rogoff (2010), Afonso dhe Alves (2015).

Në grupin e dytë të autorëve tek rishikimi i literaturës shohim studime të caktuara të cilat mohojnë se borxhi publik mund të jap impuls pozitiv në rritjen ekonomike. Sipas këtyre studimeve shohim se rritja e mundshme e borxhit publik ndikon negativisht në rritjen ekonomike, si në vendet e zhvilluara po ashtu edhe tek ato në zhvillim. Tek disa autorë të këtij grupi shohim edhe disa ndarje ose klasifikime të mundshme rreth borxhit publik dhe efektit të tij në rritjen ekonomike.

Ku sipas tyre borxhit publik mund të afektojë ndonjë rritje të vogël ekonomike në periudhat afatshkurtra, mirëpo efekti i tij në periudhat afatgjata është negativ, duke frenuar kështu rritjen ekonomike të vendeve.

Mirëpo kemi edhe nga ata të cilët pohojnë se rritja e borxhit publik ndikon negativisht në rritjen ekonomike si në periudhat afatshkurtra si dhe në ato afatgjata (Ugo Panizza dhe Andrea F. Presbitero (2013), Cochrane (2011), Lof dhe Malinen (2014), Sheikh (2010), Calderon dhe Fuentes (2013), El Mahdz dhe Torayeh (2009). Gjithashtu tek rishikimi i literaturës vërejmë disa studime të cilat në mënyrë absolute pohojnë se rritja eventuale e borxhit publik ndikon drejtpërdrejtë në stimulimin e rritjes ekonomike të vendeve në përgjithësi.

Disa nga këto studime potencojnë se borxhi publik mund të jap impuls pozitiv në rritjen ekonomike në periudhat afatshkurtra, ndërsa disa tjerë pohojnë se rritja e borxhit publik mund të ndikon pozitivisht në rritjen ekonomike tek periudhat afatgjata Uzun (2012), Lainà (2011), Reinhart dhe Rogoff (2010) dhe Pattillo (2011), Wigger (2009), Greiner (2012), Taylor (2012).

Nëse i referohemi studimeve më lartë mund të vërejmë divergjenca të caktuara në mes të grupeve të autorëve që trajtojnë efektet e borxhit publik tek rritja ekonomike. Shumica e këtyre studiuesve kanë përdorur metodat të avancuara ekonometike të tilla si: analiza e regresionit (OLS) e cila e injoron strukturën e të dhënave panel, si dhe metodat të cilat bazohen tek seritë e të dhënave në formë të panelit të tilla si Fixed Effects, Random Effects, dhe 'GMM' Metoda.

Duke shqyrtuar dhe analizuar këto studime kam krijuar një vështrim të përgjithshëm për sa i përket shfrytëzimit të metodave ekonometrike. Në fillim të studimit unë kam parashtruar pyetjet kërkimore dhe hipotezat, të cilat tentojnë të shpjegojnë definimin e pragut të borxhit publik dhe rritjes ekonomike tek vendet e Ballkanit Perëndimor, Evropës Lindore, si dhe vendet e Evropës Qendrore. Si dhe përcaktimin e kufirit optimal ku do të shpjegohet se si ndikon rritja e borxhit publik deri në këtë kufi, dhe tejkalimin e mundshëm i cili pastaj mund të ndikojë negativisht në rritjen ekonomike të vendeve në tranzicion të Evropës.

Nga studimet më lartë shohim disa studiues të cilët kanë përcaktuar dhe definuar pragu e borxhit publik tek vendet e zhvilluara si dhe ato në zhvillim (Jernej Mencinger Aleksander Aristovnik, Miroslav Verbic (2015), Checherita dhe Rother (2010), Reinhart dhe Rogoff. Prandaj edhe tek rishikimi mund të shohim se çdo studim që është paraqitur lidhet drejtpërdrejtë me organizimin e temës që jam duke e trajtuar, definimin e problemit, pyetjeve kërkimore, si dhe hipotezave.

4. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

4.1. Metodologjia

Për të realizuar këtë studim shkencor të disertacionit të doktoratës, si dhe për ti mbështetur konstatimet të cilat janë ngritur në fillim të këtij studimi do të përdori metoda dhe modele të avancuara shkencore. Gjatë hartimit të këtij punimi do të përdorim një metodologji gjithëpërfshirëse, duke zbatuar metoda të ndryshme kërkimore-shkencore, të cilat janë realizuar kryesisht nëpërmjet leximit të literaturës, vëzhgimit, dhe mendimit kritik nga ku informacionet janë zgjedhur sipas vlefshmërisë së tyre nga autorë të ndryshëm të huaj dhe vendor, si dhe subjekteve tjera që janë pjesë e kërkimit, apo kanë qenë të kyçur në situata nga të cilat është synuar të nxirren përfundime, si dhe të arrihet deri te zgjidhja e problemit. Për konfirmimin e besueshmërisë të hipotezave do të përdorim metoda të ndryshme me qëllim që rezultatet të kenë një signifkancë të lartë shkencore, ku disa prej tyre janë përdorur tek pjesa e parë dhe pjesa e dytë e hulumtimit, ndërsa tani tek kjo pjese do te bazohemi ne përdorimin e metodave dhe teknikave ekonometrike, te cilat do te mundohem ti paraqesim dhe ti trajtojmë ne vijim.

Ekonometria është aplikimi i metodave statistikore në të dhënat ekonomike për të dhënë përmbytje empirike në marrëdhëniet ekonomike (Pesaran ,1987). Më saktësisht, është "analiza sasiore e fenomeneve aktuale ekonomike bazuar në zhvillimin e teorisë dhe vëzhgimit, të lidhura me metodat e përshtatshme të përfundimit. Metoda ekonomterike si procedurë e hulumtimit shfrytëzohet analiza e përmbytjes, mbledhja e të dhënave për karakteristikat e ndryshme. Metodat ekonometrike janë përdorur duke shfrytëzuar të dhënat nga viti 1995 deri në vitin 2017. Mirëpo në të gjitha modelet ekonometrike të analizuar për vendet në tranzicion të Evropës janë punuar nëpërmjet qasjes “unbalanced data” nga viti 1995- 2017 , ndërsa tek përcaktimi i pragut të borxhit publik “threshold” jam shkuar nëpërmjet të dhënave të balancuara “balanced data “ duke filluar nga viti 2000. Për të hetuar dhe studiuar ndikimin e borxhit publik në rritjen ekonomike të vendeve të Evropës që janë në Tranzicion, kam përdorur disa nga metodat dhe modelet mjaft të avancuara shkencore si: OSL (metoda e katrorëve të vegjël), Fixed Effects, Random Effects, Taylor-Hausamn Test, si dhe një metodë mjaft të avancuar GMM (generalized method of moments). Modeli Pooled OLS, rasti më i thjeshtë i përdorimit të të dhënave dhe informacioneve në formën gjatësore, realizohet duke injoruar strukturën panel të te dhënave.

Ndërsa tek modelet Fixed dhe Random Effect dallimi kryesor qëndron nëse efekti i pa vërtetuar individual numëron elemente që janë të lidhura (korrelacion) me regresorët në modelin ekonometrik, jo nëse këto efekte janë rastësorë (stochastic) ose jo (Green (2008,p.183). Modeli Fixed Effects nuk është në korrelacion me modelin Random Effects. Përdorimi i “Fixed Effects” bëhet sa herë që jemi të interesuar të bëjmë një analizë sa i përket ndikimit të variablave që mund të ndryshojnë me kalimin e kohës. Efektet fikse trajtojnë marrëdhëniet në mes parametrave të parashikuara, dhe rezultateve të variablave brenda një njësie të caktuar, që mund të përfshijë (vend, person, biznes, shtet, ose ndonjë instituicion tjetër). Ndërsa në statistikë modelin “Random Effects”, gjithashtu i njohur si modeli i komponentëve të ndryshimit, është një lloj modeli hierarkik linear. Ky model supozon se të dhënat po analizohen në koordinim me një hierarki të mostrave të ndryshme, dallimet e të cilave lidhen me atë hierarki të lartë cekur.

Për të testuar dhe argumentuar se cila nga metodat me lartë paraqesin rezultate më të besueshme dhe të rëndësishme do të përdorim vlerësuesin Hausman Taylor-IV, i cili kombinon aspektet e dobishme të dy vlerësuesve, pra “Fixed Effects” dhe “Random Effects”. Si dhe metodën e përgjithësuar të momenteve (GMM). Modeli dinamik i panelit (GMM) është i përdorur për të testuar marrëdhëniet midis borxhit publik ndaj PBB-së për koke banori, si dhe variablave tjera të pavarur tek vendet në tranzicion të Evropës. Unë kam përdorur vlerësuesin GMM nga Arellano dhe Bond (1991), Blundell dhe Bond (1998), Blundell, Bond dhe Windmeijer (2000) pasi është vlerësues i duhur. Gjithashtu metoda GMM na lejon të kontrollojmë problemin e paragjykitimit të endogjenitetit të shkaktuar nga ndikimi i kundërt që rrjedh nga PBB-ja për kokë banori tek borxhi dhe PBB-ja, si dhe tek variablat e tjera shpjeguese. Ndërsa përcaktimi i pragut të borxhit publik është bërë duke u bazuar në metodën bootstrapp-montecarlo, metoda “bootstrap” bazohet në mbi 2000 simulime të përdorura.

Në vijim do të mundohem që secilën nga metodat e përmendura ti trajtojmë në formë më të detajuar, duke paraqitur disa nga karakteristikat kryesore të tyre, si dhe mënyrën e përdorimit në aspektin ekonomik. Variablat e integruara në modelet ekonometrike do të shfrytëzohen për të mbështetur hipotezat dhe konstatimet e hulumtimit, i cili paraqet ndikimin e borxhit publik mbi rritjen ekonomike të vendeve evropiane në tranzicion gjatë periudhës kohore 1995-2017. Variablat që janë vendosur janë: gdp-ja (gdp per capita), public debt (borxhi publik), eksport (eksporti), final consum (konsumi përfundimtar), bruto saving (kursimet bruto), current account balance (bilanci i llogarisë korrente), government expenditures (shpenzimet qeveritare).

4.2. Specifikimi i modelit të regresionit të thjeshtë linear

Nëpërmjet metodës së regresionit të thjeshtë linear, dhe nëpërmjet aplikimit të metodës së katrorëve të vegjël (OLS), do të testojmë ndikimin e borxhit publik në rritjen ekonomike të vendeve evropiane në tranzicion. Objektivi themelor i regresionit është llogaritja ose parashikimi i vlerës mesatare të një variable Y (variabla e varur) bazuar në vlerat e variablës tjetër (variabla e pa varur) X (Hoechle, The Stata Journal, faqe.1-31).

Andaj, specifikimi i modelit të regresionit linear tredimensional është si vijon:

$$Y = B_1 + B_2 X_1 + B_3 + \mu_i \text{ Ekuacioni (4.1)}$$

Y - paraqet variablën e varur (variabla që sqarohet, regresanti, endogjenës, e parashikuar etj), në rastin tonë të hulumtimit si variabël e varur është rritja ekonomike e paraqitur nëpërmjet PBB-së për kokë banori.

X - paraqet variablën e pavarur (regresori, exogjen, që parashikon etj).

B_1 , B_2 dhe B_3 thiren prametra ose koeficientet e vlerësimit; ku B_1 është parametri i konstantës, kurse B_2 dhe B_3 janë parametrat e vlerësimit të variablës së pavarur .

μ_i është variabla stokastike ose erorr term, i cili përmban të gjitha faktorët ose variablat që nuk janë paraparë në model dhe është variabël random e pa observuar e cila merr vlera pozitive dhe negative. Gabimi stokastik tregon se ka edhe faktorë tjerë që kanë impakt tek variabla e varur që në rastin tonë konkret është rritjen ekonomike e shprehur nëpërmjet (gdp percapita).

Kjo tregon se variabla e varur plotësisht nuk sqarohet ose nuk na jep informata nga variablat e pavarura. Ndryshe komponenta stokastike paraqet pjesën e pa sqaruar të modelit ekonometrik (Baum, Stata Press, 2006).

4.3.Vlerësimi i metodës (OLS)

Ekuacioni i regresionit është ekuacion që definon raportet në mes të dy variablave dhe shfrytëzohet për të vlerësuar variablen e varur (Y) të bazuar në variablen e pavarur (X).

Variabla e varur (Y) është variabla e projektuar, apo e vlerësuar që kërkohet të parashikohet ose të shpjegohet me anën e një variable tjetër. Variabla e pavarur (X) është variabla që siguron bazën për vlerësim. Me anë të kësaj variable bëhet parashikimi ose shpjegimi i variablit të varur.

Thjeshtësia e këtij modeli rrjedh nga supozimi për termin error: që supozohet së $\varepsilon \sim N(0, \sigma^2)$. Me fjalë të tjera, duke e ditur vlerën e termit error i cili në model nuk sqaron asgjë në lidhje me variablat tjera (distribuími i termit error është i pavarur nga variablat tjerë), si dhe observimet e termit error janë të pa korreluara me njëra tjetrën (Hoechle, The Stata Journal, faqe.1-31). Pas shqetësimeve të përmendura nga modeli klasik i regresionit linear, vlerësimi efikas mund të arrihet duke përdorur metodën e katrorëve të vegjël (OLS). Edhe përkundër paragjyqimeve të shumta, ngjashëm si në studimet e tjera edhe në këtë studim të dhënat e grumbulluara do të vlerësohen edhe me disa metoda tjera të regresionit si fixed effect, random effect, hausman taylor, gmm, si dhe përcaktimi i pragut nëpërmjet bootstrapp-montecarlo.

4.4.Modeli Pooled OLS

Rasti më i thjeshtë i përdorimit të dhënave dhe informacioneve në formën gjatësore realizohet duke injoruar strukturën panel tek të dhënave. Pasi të dhënat janë të organizuara nga njësitë vendimmarrëse, atëherë modeli mund të shkruhet si vijon:

$$Y = X\beta + \varepsilon \text{ Ekuacioni(4.2)}$$

Në këtë rast, për një 'X' të dhënë, nuk ka asnjë korrelacion midis observacioneve. Me fjalë të tjera, supozohet që observacionet individuale me kalimin e kohës janë observacione nga individ të ndryshëm. Një qasje e tillë mund të jetë e arsyeshme, për shembull në rastet kur madhësia e mostrave ndër-sektorale (cross-sectional) do të thotë është e vogël. Gjithsesi, duke mos e integruar strukturën panel të dhënave, atëherë ky proces shpjen në rezultate që nuk janë të përshtatshme në të shumtën e rasteve. Megjithatë, si supozimet rreth çrregullimit plotësojnë ato të modelit klasik të regresionit linear, vlerësimi me rezultate më të efektshme mund të arrihet duke përdorur OLS (Cancado, 2005, faqe.19).

Pavarësisht paragjyimeve të saj të mundshme, vlerësuesi Pooled OLS do të përdorët në këtë studim shkencor , pra ngjashëm edhe me studime të tjera të aplikuara, si një fillim për analizat empirike, ku rezultatet e tij do të krahason me rezultatet nga modelet që janë më të përshtatshme për analizën e të dhënave.

4.5. Modelet Fixed dhe Random Effect

Duke marrë në konsideratë modelin e mëposhtëm:

$$Y_{it} = X_{it}\mu + E_{it} \quad \text{Ekuacioni (4.3)}$$

Gjithashtu, duke marrë në konsideratë se "Error Term" i cili ka strukturën si në vijim:

$$E_{it} = \alpha_i + \eta_{it} \quad \text{Ekuacioni (4.4)}$$

Termi i parë i dekompozimit njihet si një efekt specifik-individual, dhe pjesa e dytë korrespondon me termin e zakonshëm të njohur si “common stochastic error term”, për shembull tek modelet klasike që përdorin regresion linear. Në këtë formulim, pjesa e parë mund të ndryshojë tek individët ose njësitë tjera, pra në rastin tonë konkret vendeve, mirëpo është konstant përgjatë tërë kohës, kjo pjesë mund të jetë në lidhje ose korrelacion me variablat sqaruese, ose nuk mund të jetë në korrelacion me to. Pjesa e dytë karakterizohet në mënyrë arbitrare përgjatë tërë kohës dhe vendeve. Ky formulim është mënyra më e thjeshtë e të kuptuarit të idesë se dy observacioneve që vijnë nga i njëjti vend, dhe janë më shumë se sa observacionet që vijnë nga dy vende të ndryshme (Cancado, 2005, faqe.20).

Dallimi thelbësor ndërmjet Fixed Effects dhe Random Effects qëndron nëse efekti i pa vërtetuar individual numëron elemente që janë të lidhura (korrelacion) me regresorët e tjerë që ndodhen në modelin ekonometrik (Green, 2008, faqe.183). Modeli Fixed Effects nuk është në korrelacion me modelin Random Effects . Nga rrjedh që në modelin Fixed Effects, supozohet të jenë “n” parametra të panjohura që duhen trajtuar në vlerësimet ekonometrike, ndërsa në rastin e modelit Random Effects trajtohet si një diagram me një shpërndarje mesatare “ μ ”, si dhe me një variancë të pavarur nga variablat shpjeguese në model.

Për të parë se cila nga këto dy metoda do të ofrojë rezultate me të përshtatshme dhe me argumentuese, ne do të përdorim edhe testin dhe vlerësuesin e Hausman-Taylor IV, i cili ofron alternativë për sa i përket këtyre qasjeve të lartë përmendura (Bartels, 2009)⁷.

Modeli Fixed Effects

Përdorimi i efekteve fikse bëhet sa herë që jemi të interesuar të bëjmë një analizë për sa i përket ndikimit të variablave që mund të ndryshojnë me kalimin e kohës. Efektet fikse trajtojnë marrëdhëniet në mes parametrave të parashikuara, dhe rezultateve të variablave brenda një njësie të caktuar, që mund të përfshijë (vend, person, ndërmarrje, institucion etj). Çdo njësi ka karakteristikat e saj të veçanta të cilat kanë mundësi të ndikojnë tek variablat e parashikuara, ose të cilat nuk mund të ndikojë tek ato variabla.

Për shembull, duke supozuar një mashkull apo femër se si mund të ndikojë tek një opinionin për një çështje të caktuar, ose një sistem i mirëfilltë ekonomik mund të ndikojë pozitivisht në rritjen e tregtisë, dhe e cila pastaj shpien drejtpërdrejtë në rritjen e PBB-së (produktit të brendshëm bruto), ose praktikat produktive të një biznesi mund të ndikojnë në rritjen e çmimit të aksioneve të saj. Në ekonometri dhe statistikë modeli “Fixed Effects” është një model statistikor që përfaqëson sasitë e vrojtura në drejtim të variablave shpjeguese, dhe të cilat trajtohen sikur njësi fikse, dhe jo të rastësishme. Për dallim nga modelet “Random Effects, si dhe “Mixed Effects”, në të cilat disa ose të gjitha nga variablat shpjeguese trajtohen sikurse rrjedhojë e rastit.

Po të krahasojmë këtë me përcaktimet biostatistike, ku biostatisticientët përdorin efektet "fikse" dhe "të rastit" për t'iu referuar popullsisë mesatare, dhe efekteve të subjekteve specifike (aty ku këto të fundit në përgjithësi janë supozuar të jenë të panjohura, apo variabla latente). Në të shumtën e rasteve, struktura e njëjtë e modelit që zakonisht është një model regresioni linear, mund të trajtohet me njërën prej këtyre metodave të përmendura me lartë. Mirëpo prapë varet nga pikëpamjet e hulumtuesit se cilën nga këto teknika do të zgjedh për të testuar të dhënat dhe variablat në modelin ekonometrik (Greene, 2011 dhe Diggle, Heagerty, Patrick, Liang, Zeger, Scott, 2002 dhe Fitzmaurice, Laird, Ware, James H, faqe.326-328, 2004).

⁷ Shenim: Beyond “Fixed Versus Random Effects”: A framework for improving substantive and statistical analysis of panel, time-series cross-sectional, and multilevel data” / Brandom Bartels

Po ashtu vlen të theksohet se vlerësimet konsistente të parametrave shitesë nuk mund të merren për bazë. Edhe pse nuk mund të llogarisim në vazhdimësi, megjithatë ne mund të llogarisim parametrat e mbetura në vazhdimësi. Për tu bërë kjo, regresioni merr këtë formë:

$$y = x\beta + f\alpha + \eta \text{ Ekuacioni (4.5)}$$

Ku ky ekuacion paraqet matricën që bën grumbullimin e “n” variablaeve, d.m.th. ato variabla të cilat janë korelacione për çdo vend. Avantazhi i modelit “Fixed Effects” është largimi apo heqja e heterogjenitetit specifik individual (individual-specific heterogeneity), duke marrë në konsideratë ekuacionet si në vijim:

$$y = X_i + B + \alpha_i + \eta_i$$

$$y_\mu - y_i = (X_\mu X_i)b + (\eta_\mu + \eta_i)$$

$$BW - (XM_f X)XM_{ff} \text{ Ekuacioni (4.6)}$$

Përderisa heterogjeniteti i pa vëzhgueshëm është i kontabilizuar, ka një pengesë bazike për aq kohë sa vlerësuesi përdor vetëm variacione përbrenda observacioneve individuale. Kjo mund të jetë problematike në qoftë se ekzistojnë shpjegime të ashtuquajtura "time in variant". Kur përdorim efektet fikse supozojmë se diçka brenda individit mund të ndikojë, ose mund të kemi paragjykim në rezultatin e variablaeve të cilat kemi nevojë për ti kontrolluar. Kjo është arsyeja pas supozimit se korrelacioni midis variablaeve tek njësia ekonomike mund të parashikohet gabimisht. Një tjetër supozim i rëndësishëm i modelit të efekteve fikse është se karakteristikat gjatë tërë kohës janë të pandryshuara, gjithashtu janë unike për individin, dhe nuk duhet të lidhen me karakteristikat e tjera individuale. Çdo subjekt është i ndryshëm, pra termi gabimit të njësisë se caktuar është konstante (e cila kap karakteristikat individuale) që nuk duhet të lidhen me të tjerët. Nëse kushtet e gabimit (error term) tek efektet fikse nuk janë të përshtatshme, atëherë ato mund të ndikojnë që konkluzionet të cilat fitohen nëpërmjet modeleve ekonometrike të mos jenë të sakta, dhe si pasojë e këtij procesi kemi nevojë për të modeluar këtë marrëdhënie edhe njëherë (Gardiner, Joseph, Luo, Lee Anne, fq.221-239, 2009 dhe Ramsey, Schafer, 2002 dhe Colin, Trivedi, Pravin, fq. 717-19, 2005).

Ekuacioni për modelin e Efekteve Fikse bëhet:

$$Y_{it} = \beta_1 X_{it} + \alpha_i + \mu_{it} \quad \text{Ekuacioni (4.7)}$$

Ku kemi:

α_i ($i = 1 \dots n$) Është ndërpres i panjohur për secilin entitet,

- Është variabla e varur,

i – Entitet,

t - Koha,

X_i - Përfaqëson një variabël të pavarur,

β_i - Është koeficienti ,

μ_i - Është termi gabim,

Pasqyra kryesore është se në qoftë se variabla e pa shënuar nuk ndryshon me kalimin e kohës, atëherë si rezultat çdo ndryshim në variablen e varur duhet të jetë për shkak të ndikimeve të ndryshme nga këto karakteristika fikse (Stock dhe Watson, 2003, fq.289-290).

Në rastin e të dhënave të serive kohore interpretimi i koeficienteve beta do të jetë për një vend të caktuar, kur X ndryshon gjatë kohës nga një njësi në tjetrën, ndërsa Y rritet atëherë zvogëlohet njëra nga njësitë β (Bartels, Brandom, Stony Brook University, 2008).

Një tjetër mënyrë për të parë modelin e efekteve fikse është duke përdorur ndryshoret binare atëherë ekuacioni për modelin e Efekteve Fikse bëhet si më poshtë :

$$Y_{it} = \beta_0 + \beta_1 X_{1it} + \dots + \beta_k X_{kit} + \gamma_2 E_2 + \dots \gamma_n E_n + \mu_{it} \quad \text{Ekuacioni (4.8)}$$

Ku kemi:

y_{it} – Është variabël e varur , ku i = entitet dhe t = koha,

x_k -Paraqet variablen pavarur ,

β_k - Është koeficienti ,

μ_{it} -Është gabimi,

e_n - Ato subjekte që janë në numra binarë (dummies), kemi $n-1$ subjekte të përfshira në model, γ_2 Është koeficienti binar (subjektet në model).

Të dy ekuacionet të cilat i trajtuam me lartë janë ekuivalente njëra me tjetrën. X është i njëjtë nga njëri entitet në tjetrin, po ashtu edhe tek ekuacioni me lartë të rezultatet kanë të njëjtin burim të dhënave duke paraqitur një variable të pashënuar që ndryshon tek të gjitha parametrat që janë në model, por jo gjatë gjithë kohës së vrojtimit (Stock dhe Watson, 2003, fq.280).

Efektet Fikse në Modelit e Regresionit:

$$Y_{it} = \beta_0 + \beta_1 X_{1it} + \dots \beta_k X_{kit} + \gamma_2 E_2 + \dots \gamma_n E_n + \delta_2 T_2 + \dots \delta_t T_t + \mu_{it} \text{ Ekuacioni (4.9)}$$

Ku kemi:

Y_{it} - Është variabla e varur , ku i -Entitet , dhe t – Koha,

X_k - Paraqet variable e pavarur,

B_k - Është koeficienti,

μ_{it} - Është termi i gabimit Error ,

e_n - Paraqet subjektet që janë në numra binar (dummies) , ku kemi $n-1$ subjekte të përfshira,

γ_2 - Është koeficienti për regresantin binar (subjektet),

T_t - Është koha e ndryshueshme kështu që ne kemi $t-1$ periudhat kohore,

δ - Është koeficienti për regresantin.

Modeli Random Effects

$$y = X_{it}\beta + \varepsilon_{it}$$

Ku $\varepsilon_{it} = \alpha_{it} + \eta_{it}$ **Ekuacioni (4.10)**

Arsyeja e përdorimit të modelit “Random Effects” është sepse ndryshon nga modeli i “Fixed Effects”, sepse variacioni i të gjitha subjekteve të përfshira supozohet të jetë i rastësishëm, dhe nuk është në korrelacion me variablat e parashikuara, si dhe me variablat e tjera të pavarura të përfshira në modelin ekonometrik (Green 2008, p.183). Nëse kemi një variabël të varur në model, atëherë ju duhet të përdorni modelin e efekteve të rastit. Në statistikë modeli “Random Effects”, gjithashtu i njohur si modeli i komponentëve të ndryshimit, është një lloj modeli hierarkik linear. Ky model supozon se të dhënat po analizohen në koordinim me një hierarki të mostrave të ndryshme, dallimet e të cilave lidhen me atë hierarki të lartë cekur.

Një avantazh i efekteve të rastit është që ju mund të përfshini gjatë gjithë kohës variablat e pandryshueshme (p.sh. gjinore), ndërsa në modelin e efekteve fikse këto variabla janë të absorbuara nga modeli. Në këtë rast supozimi kryesor që dallon këtë model nga modeli “Fixed Effects” është sepse tek modeli ‘Random Effects’ efektet specifike të vendeve (shteteve, ose njësisve tjera të përfshira në model) janë efekte të pandryshuara gjatë tërë kohës në vëzhgim. Po ashtu, vlen të theksohet se është më i dobishëm, që të jetë më eksplisit në lidhje me dy pjesët e “Termit Error” (Laird dhe James, faqe.963-974,1982).

$$E[\eta_{it}X] = E[\alpha_{it}X] = 0$$

Ekuacioni (4.11)

$$E\eta_{it}X = \sigma\eta,$$

$$E\alpha_{it}X = \sigma\alpha,$$

$$E[aX] = 0, \eta,$$

$$E[\alpha_{ia}jX] = 0, per" I" \pm " j".$$

Modeli “Random Effects” në një far mënyrë merr në konsideratë faktin se “t” observacionet në “n” vende nuk janë të njëjta si observacionet në “nt” të vendeve të ndryshme.

Më pas modeli llogaritet si vijon: se pari duke nxjerr një vlerësues të matricës së kovariancës të termit “error” , dhe së dyti duke përdorur strukturën e kovariancës në vlerësuesin “ β ”. Nëse komponentët e variancës janë të njohura, atëherë vlerësuesi “GLS”, konkretisht “Random Effects” mund të zbatohet pa vështirësi. Megjithatë zakonisht nuk ndodh kështu, pasi që vlerësimet e variancës së panjohur janë të nevojshme për testimin e modeleve.

Vlerësuesit konsistent mund të fitohen si shuma të modifikuara, ku një mënyrë e përshtatshme e gabimeve të formave katrore vjen nga dy vlerësues të ndryshëm, të njohur si "vlerësues ndërmjetës " dhe "brenda vlerësues" (Joseph, Luo, Roman, Anne, faqe.221-239, 2009)

4.6.Modeli Hausman Taylor-IV

Me lartë trajtuam modelet e regresionit “Fixed Effects” dhe “Random Effects” në organizimin e hulumtimeve me modele ekonometrike, ku trajtuam disa argumente dhe fakte se pse këto metoda përdoren gjatë studimeve shkencore, ku sipas shume argumenteve karakterizohen si metoda mjaft inovative për realizimin e hulumtimeve në shkencat ekonomike.

(Hausman dhe Taylor , 1981), sugjerojnë një zgjidhje duke kombinuar aspektet e dobishme të të dy vlerësuesve, pra “Fixed Effects” dhe “Random effects”, të cilët i trajtuam me herët.

Metoda e quajtur “ Hausman-Taylor” është një teknikë e njohur si "Instrumental-Variable"⁸, që përdor vetëm informacionet që gjenden tashmë në model, për të eliminuar efektet e lidhjeve reciproke ndërmjet vendeve si dhe "Error Termin", ndryshe nga preventivuesi.

Sipas qasjes “Fixed Effects”, nuk kërkon eliminimin e variablave shpjeguese që variojnë përgjatë kohës "time-variant" (Cancado, faqe. 25, 2005).

⁸ Shënim:Kjo teknike në të shumtën e rasteve është përdorur në analizat e regresionit kur supozimi standard, për sa i përket variablave shpjegues nuk janë në korelacion me komponentët e pashpjegueshëm. Në këto raste, regresioni i zakonshëm linear nuk do të japte vlersime të qëndrueshme.

Testi bën të mundur vlerësimin e signifkancës ose më mirë të themi të besueshmërisë së një preventivuesi kundrejt një preventivuesi tjetër, duke treguar cili është me i besueshmëm dhe cili duhet të largohet nga modeli ekonometrik.

Sipas (Hausman dhe Taylor ,1981) modeli i Ekuacionit mund të shkruhet si në vijim:

$$y_{it} = X_{it} + \beta + Z_{iy} + \alpha_i + \eta_i \text{ Ekuacioni (4.12)}$$

Në këtë formulim, të gjitha efektet individuale shënohen si janë vërejtur. Hausman dhe Taylor, sugjerojnë që të bëhet ndarja e 'X' dhe 'Z' në dy grupe të variablave si më poshtë:

$$X = [X_1 : X_2] \text{ dhe } Z = [Z_1 : Z_2]$$

Ku: X_1 është “ ηx_{k1} ”

X_2 është “ ηx_{k2} ”

Z_1 është “ ηx_{g2} ”

Z_2 është “ ηx_{g2} ” dhe $\eta -_{nt}$

Atëherë , Modeli merr formën si në vijim:

$$y_{it} = X_{1it} + b_1 + X_{2it} + \alpha_i + Z_{it}y_i + Z_{2i}y_2 + \alpha_i + \eta_{it}$$

$$Y = (Y_1, Y_2)$$

$$B = (B_1, B_2) \quad \text{Ekuacioni (4.13)}$$

$$Y = (Y_1, Y_2)$$

Tipari dallues i këtij modeli gjendet tek supozimet mbi korrelacionin ndërmjet efekteve specifike-individuale, dhe grupe të regresorëve që 'variojnë' dhe që 'nuk variojnë'.

Katër grupe të variablave të observuar janë përcaktuar në këtë model si në vijim:

X_{1it} është k_1 variabla që variojnë përgjatë kohës dhe nuk janë në korrelacion me α_i ,

Z_{1it} është variabla që nuk variojnë përgjatë kohës dhe nuk janë në korrelacion me α_i ,

X_{2it} është variabla që variojnë përgjatë kohës dhe janë në korrelacion me α_i ,

Z_{2it} është variabla që nuk variojnë dhe janë në korrelacion me α_i .

Strategjia nga Hausman dhe Taylor funksionon duke përdorur informatat që tashmë gjenden në modelin ekonometrik, pra për variablat problematike “ X_{2it} ” dhe “ Z_{2it} ”.

Ata pra propozuan qasjen “IV-Instrumental Variable”, ku variablat e mëposhme janë përdorur si instrumente: $X_{1it}, Z_{1it}, X_{2it}, Z_{2it}$

Poashtu, në modelin e tyre supozimet sa u përket "random terms" (termave të rastit) në model janë:

$$E[\eta_{it} | X_{1it}, Z_{1it}] = 0 \text{ sepse } E[\eta_{it} | X_{2it}, Z_{2it}] = 0$$

$$Var[\eta_{it} | X_{1it}, Z_{1it}, X_{2it}, Z_{2it}] = \sigma_\eta^2$$

$$Cov[a_i, \eta_{it} | X_{1it}, Z_{1it}, X_{2it}, Z_{2it}]$$

$$Var[a_i, \eta_{it} | X_{1it}, Z_{1it}, X_{2it}, Z_{2it}] = \sigma^2 = \sigma_a^2 + \sigma_\eta^2$$

$$Corr[a_i, \eta_{it}, a_{it}, \eta_{it} | X_{1it}, Z_{1it}, X_{2it}, Z_{2it}] = \sigma = \sigma_\eta^2 / \sigma^2$$

Nga ku kuptohet se variablat ekzogjene, dmth variablat që nuk janë në korrelacion shërbejnë si instrumente të tyre.

Modeli i propozuar nga "Hausman dhe Taylor" është gjithmonë konsistent dhe efikas. Për më tepër, një avantazh i fortë i kësaj qasje, dhe që e dallon nga qasjet tjera është se nuk duhet të përdoren instrumente të jashtme për të vlerësuar modelin ekonometrik.

4.7.Hausman Test

4.7.1. Zgjedhja mes Fixed Effects, Random Effects dhe Hausman-Taylor-IV

Mënyra më përgjithësisht e pranuar e zgjedhjes në mes "Fixed Effects" dhe "Random Effects" është duke përdorur Hausman Test (1978). Për më tepër "The Hausman Test" mund të përdoret gjithashtu për vendimin nëse "Hausman-Taylor IV" është më i përshtatshëm për tu aplikuar.

Hausman test është një test statistikor që në ekonometri bën të mundur testimin e hipotezave të emëruar nga Jerry A. Hausman. Testi bën të mundur vlerësimin e signifikancës së një preventivuesi kundrejt një preventivuesi tjetër. Gjithashtu, ndihmon në vlerësimin nëse një model statistikor korrespondon me të dhënat.

Marë në konsideratë modelin linear $Y = \beta X + e$ ku ' y ' është njëtrajtshme (univariate) dhe ' X ' është vektor i regresorit, ' b ' është një vektor i koeficientëve dhe ' e ' është 'error term', atëherë kemi dy matës për ' b ': b_0 dhe b_1 '. Sipas hipotezës zero, që të dy këto matës janë konsistent, mirëpo ' b_1 ' është efikas (pra, ka variancë më të vogël), ndërsa sipas hipotezës alternative, ' b_0 ' është konsistent ndërsa ' b_1 ' nuk është konsistent.

Atëherë, statistika vijon:

$$H = (b_1 - b_0)'(Var(b_0) - Var(b_1)) + b_1 \dagger b_0 \quad \text{Ekuacioni(4.14)}$$

Ku ' $\dagger$ ' nënkupton "Moore-Penrose pseudoinverse", ku në matematikë dhe në veçanti algjebër lineare, një pseudoinverse ' A^+ ' e një matrice ' A ', është një përgjithësim i/e matricës inverse.

'Hausman test' bën të mundur testimin e hipotezës zero nga koeficientët e vlerësuar nga preventivuesi më efikas "random effects" janë të njëjta me ato të vlerësuara nga preventivuesi më konsistent, pra 'fixed effects'.

Në qoftë se 'Hausman Test' jep rezultate me p-vlera insignifikante, pra ' $\text{Prob} > \chi^2$ ' më e madhe se '0.05', atëherë është më i përshtatshëm të përdorët modeli 'Random Effects', ndërsa nëse i njëjti test nuk jep rezultate signifikante, atëherë duhet përdorur 'Fixed Effects'. E njëjta logjikë vlen edhe gjatë përdorimit të "Hausman Test" në vendosjen në mes të modelit 'Fixed Effects' dhe 'Hausman-Taylor'. Në këtë rast, 'Hausman Test' teston hipotezën zero, nëse koeficientët e vlerësuar nga preventivuesi më efikas "HT-IV" janë të njëjta me ato të vlerësuar nga preventivuesi më konsistent "Fixed Effects". Pra, nëse ato janë p-vlera insignifikante, atëherë 'Hausman Taylor-IV' është konsistent dhe njëkohsisht efikas, ndërsa preventivuesi "Fixed Effects" është konsistent, mirëpo jo edhe aq efikas. Statistikisht, 'Fixed Effects' është gjithmonë një gjë e arsyeshme për të bërë me panel data pasi që gjithmonë jep rezultate të qëndrueshme, mirëpo mund të mos jetë modeli më efikas për tu përdorur.

Random Effects do të jep p-vlera më të mira për arsyje se është një preventivues më efikas, pra mund të përdorët nëse është e justifikueshme statistikisht. "Hausman-Taylor" është më konsistent dhe njëkohsisht efikas, duke qenë zgjedhja më e mirë po të krahasojmë me modelet 'Fixed Effects dhe Random Effects'.

Pra, 'Hausman Test' bën të mundur kontrollimin e një modeli më efikas kundrejt një modeli më pak efikas, por njëkohsisht është konsistent për tu siguruar se modeli më efikas jep rezultate më të qëndrueshme dhe signifikante.

4.8. Metoda e përgjithshme e momenteve (GMM Method)

Çka është shumë më rëndësi është të përshtatim një metodë vlerësimi, ku zbatimi i së cilës nuk kërkon vënien e kufizimeve shtesë në procesin e gjenerimit të të dhënave përtej atyre që nënkuptohen nga modeli ekonomik. Shumë shpesh kufizimet e nënkuptuara që burojnë nga teoria ekonomike marrin formën e asaj që do t'i referohemi si “metoda e përgjithësuar e momentit”. Metoda e përgjithësuar e momenteve (GMM) është një metodë statistikore ekonometrike që kombinon të dhënat e vëzhguara ekonomike me informacionin në kushtet e momentit, për të prodhuar vlerësime të parametrave të panjohura brenda një modeli ekonometrik (Hansen, 1982).

Momentin që ne posedojmë këto njohuri shtesë të këtyre parametrave, mund të kthehemi dhe të ndërtojmë konkluzione mbi pyetjet e parashtruara që janë në interes për ne. Metoda GMM (Generalized Method Of Moments), në ekonometri dhe statistikë metoda e përgjithësuar e momenteve është një metodë gjenerike për vlerësimin e parametrave në modelet statistikore.

Metoda kërkon që një numër i caktuar i kushteve të momentit të specifikohen në modelin ekonometrik, këto kushte janë funksione të parametrave të modelit dhe të dhënave, të tilla që pritja e tyre është zero. Metoda “GMM” pastaj minimizon një normë të caktuar të mesatareve të mostrave të kushteve të momentit. Metoda “GMM” është një metodë shumë e avancuar ekonometrike, sidomos në rastet kur nxjerrim informacione përmes modeleve ekonomike. GMM u zhvillua nga Lars Peter Hansen në vitin 1982 duke e përcaktuar si metodën e “Përgjithshme të Momenteve”, e cila ishte prezantuar për herë të parë nga Karl Pearson në vitin 1894. Hansen u nderua me çmimin nobel për ekonominë në vitin 2013 për këtë zhvillim (Krueger, fq. 979–1014, 1991)

Shembulli 1 - Metoda e Thjeshtë e Vlerësuesit të Momenteve ‘GMM’

Për të treguar një shembull shumë të thjeshtë, supozoni që shpërndarja e popullsisë ka një mesatare të panjohur të shprehur më μ , dhe variancë të barabartë ku sipas formulës shprehet si në vijim : $E[X_i] = \mu$ **Ekuacioni (4.15)**

$\{x_i: i = 1, 2, \dots, n\}$ është një mostër e pavarur dhe e shpërndarë në mënyrë identike nga shpërndarja e përshkruar më parë.

Pastaj mesatarja e mostrës është $x = \frac{1}{n} \sum_{i=1}^n x_i$

Është shembulli analog i mesatares së popullatës $E[x_i]$. Duke shfrytëzuar këtë parim analogjik, metoda e përgjithësuar e momenteve (MM) $E[x_i] = \mu$ na jep këtë situatë si në vijim:

$$x = \frac{1}{n} \sum_{i=1}^n x_i = \mu . \quad \text{Ekuacioni (4.16)}$$

Shembull.2 - Metoda e Momentit Vlerësues

Lë të supozojmë që jemi duke e vëzhguar një mostër si në vijim $\{x_i: i=1,2,\dots,n\}$ nga e cila ne duam të vlerësojmë një vektor të parametrave të panjohur $\theta \in \mathbb{R}^p$ me vlerën e vërtetë θ_0 .

Nëse $f(x_i, \theta)$ është një funksion në vazhdimësi dhe vazhdimisht i derivueshëm $\mathbb{R}^p \rightarrow \mathbb{R}^q$, dhe që është funksion i θ , atëherë $E[f(x_i, \theta)]$ janë deri në pa kufi për i dhe θ . Pastaj kushtet e vlerësuesit të momentit janë $E[f(x_i, \theta_0)] = 0$ (Angrist dhe Krueger, 1991).

Momentet korresponduese të mostrës janë

dhënë nga:

$$f_n(\theta) = \frac{1}{n} \sum_{i=1}^n f(x_i, \theta) \quad \text{Ekuacioni (4.17)}$$

Metoda e vlerësuesit të momenteve ' θ_0 ' është e bazuar në momentet e popullsisë $E[f(x_i, \theta)]$ dhe është zgjidhja për sistemin e ekuacioneve $f_n(\theta) = 0$

Nëse $q = p$, atëherë për një vektor të parametrave të panjohur θ kushtet e momentit të popullsisë $E[f(x_i, \theta_0)] = 0$ përfaqësojnë një sërë ekuacionesh me parametra të panjohura.

Shembulli.3 Metoda e Katrorëve të Vegjël (OLS)

Duke marrë në konsideratë Modelin e Regresionit Linear

$$Y_i = x_i \beta_0 + \mu_i \quad \text{Ekuacioni (4.18)}$$

Ku ' x_i ' është vektor i modeli ' p ', ndërsa β_0 është vlera e vërtetë e ndonjë indikatorit të caktuar tek variabla e panjohur β , dhe μ_i është term i gabimit ekzogjen, ku paraqet indikatorët e tjerë të cilët nuk janë përfshirë në model mirëpo mund të kenë efekt tek parametri i pavarur i modelit. Në këtë pjesë kusht dhe objektiv kryesor është popullsia e momentit $E[f(x_i, \theta_0)] = 0$ e cila shëndrrohet $E[x_i \mu_i] = E[x_i (y_i - x_i' \beta_0)] = 0$

Dhe pastaj kushtet e momentit të mostrës na jap këtë rezultat si në vijim:

$$x = \frac{1}{n} \sum_{i=1}^n x_i = \mu_i = \frac{1}{n} \sum_{i=1}^n x_i (y_i - x_i' \beta_o) = 0 \text{ Ekuacioni (4.19)}$$

Kështu vlerësuesi (MM) β_0 fitohet nëpërmjet β , dhe që zgjidh këtë sistem të ekuacioneve lineare 'p', si dhe është e barabartë me vlerësuesin OLS Standard.

Shembulli 4. Variablat Instrumentale (IV)

Nëse në shembullin me lartë, me konkretisht tek metoda e katrorëve të vegjël ne lejuam që u_i të jetë e asocuar, ose më mirë të themi e lidhur në modelin x_i , ne mund të shprehim kushtet e momentit të popullsisë në drejtim të supozimit të ekzogjenitetit tek variablat instrumentale. Kushtet tona të popullsisë momentale janë dhënë nga $E[z_i u_i] = E[z_i (y_i - x_i' \beta_0)] = 0$

Dhe kushtet e momentit në raste janë dhënë si në vijim:

$$x = \frac{1}{n} \sum_{i=1}^n z_i (y_i - x_i' \beta_o) = 0 \text{ Ekuacioni (4.20)}$$

Ashtu si më parë që e theksuam, vlerësuesi MM i β_0 është dhënë nga β dhe zgjidh sistemin e ekuacioneve lineare 'p', dhe ky rezultat tregon se vlerësuesi standard IV është gjithashtu një vlerësues i tipit MM.

Vlerësuesi i metodës GMM

Në këtë pjesë do të rikujtojmë se kushtet e momentit të popullsisë përfaqësojnë informata të nënkuptuara nga disa teori ekonomike. Është shumë e natyrshme që ne duam të përdorim më shumë informacionin të cilin e kemi në dispozicion (Hall, 2005). Fatkeqësisht vlerësuesi GMM nuk mund të inkorporojë më shumë momente sesa parametrat (Hansen, 1982).

Shembulli.5. Motivimi i Vlerësuesit GMM

Duke e shqyrtuar rastin e Shembullit 1. Vini re se vlerësimi ynë bazohej vetëm në momentin e parë të shpërndarjes. Sipas kësaj besojmë dhe mund të pretendojmë se mostra aktuale është rezultat i tërheqjes formë të pavarur ‘n’ me parametër të shpërndarjes λ . Kështu gjendja e re (shtesë) e momentit të popullsisë bazuar në momentin e dytë të papërpunuar është:

$$E[X_1^2] - \lambda^2 - \lambda = 0 \text{ Ekuacioni (4.21)}$$

Vlerësuesi MM i ‘ λ ’ duhet të kënaqë sistemin e ekuacioneve të bazuara në momentet e mostrës.

Tani ne kemi dy kushte momentale, si dhe një parametër të panjohur, që do të thotë ne nuk kemi një zgjidhje të përgjithshme për ‘ λ ’. Mund të përdorim vetëm numra ‘p’ të momentit për të vlerësuar parametrat aktual, por duke hedhur poshtë q-p (> 0) momentet shtesë, dhe si rrjedhojë do të humbasim informacionet që ishin prezent gjatë atyre kushteve (Hansen, Heaton, Yaron, 1996).

Mjetet e duhura për të përmirësuar këtë situatë u prezantuan në literaturën e ekonometrisë të publikuar nga (Hansen, 1982) në artikullin e tij të famshëm që quhet “GMM”. Ideja që është prapa vlerësuesit GMM, është se nëse është e pamundur të zgjedhet sistemi i ekuacioneve të parashikuara nga kushtet e momentit të mostrës, ne ende mund të kemi një vlerësim të këndit θ , që sjell momentet e mostrës sa më afër zeros që është e mundur

Shembulli.5. Metoda e Përgjithshme e Vlerësuesve të Momenteve

Le të supozojmë se kushtet tek ky shembull aktual janë përmbushur, dhe ne kemi një mostër të aktualisht të monitorueshme $\{x_i : i = 1, 2, \dots, n\}$

nga e cila ne duam të vlerësojmë një vektor të parametrave të panjohur $\theta \in \Theta \subseteq \mathbb{R}^p$ me vlerën e vërtetë θ_0 .

Le të jetë $E[f(x_i, \theta)]$ një grup 'q' i momenteve të popullsisë $f_n(\theta)$ homologë përkatës të mostrës paraprake.

Definimi i kritereve të funksionit $Q_n(\theta)$ si në vijim:

$$Q_n(\theta) = f_n'(\theta) W_n f_n(\theta) \quad \text{Ekuacioni (4.22)}$$

Pastaj vlerësuesi GMM i θ_0 është dhënë nga:

$$\theta_0 = \arg \min Q_n(\theta)$$

Në thelb vlerësuesi i GMM është një metodë dhe mënyrë e përshtatshme për të shfrytëzuar informacionin nga forma përgjithshme e kushteve të momentit të popullsisë, atëherë kur numri i kushteve të momentit është i barabartë me numrin e parametrave të panjohur $GMM = MM$.

Kur $q > p$ atëherë vlerësuesi i momenteve GMM është në vlerën θ , e cila është më e afërt për zgjidhjen e kushteve të momentit të mostrës, $Q_n(\theta)$ është matja e afërsisë me zero.

Nën disa kushte të mjaftueshme, vlerësuesi i GMM siç jepet tek shembulli paraprak është i qëndrueshëm dhe shpërndahet normalisht. Kushtet e momentit të popullsisë japin informacion rreth parametrave të panjohur.

Cilësia dhe metoda e shfrytëzimit të këtyre informacioneve janë vendimtare në disa aspekte. Së pari, lind një pyetje e natyrshme rreth mjaftueshmërisë së informacionit që gjendet në momentin e kushteve nëse është e mjaftueshme që vlerësimi të jetë "i suksesshëm" (Hansen dhe Singleton, 1982).

Funksionet e Panelit Dinamik: Variablat Instrumentale në Ndarje dhe Nivele

Metoda e parë për trajtimin e problemit të endogjenitetit përdor variablat instrumentale të marra nëpërmjet vonesave të variablave endogjene. Në varësi të përdorimit nga ana e vlerësuesit, këto vonesa mund të aplikohen në diferenca ose nivele të ndryshme. Ndarjet midis këtyre dy metodave do të shprehen në ekuacionet e mëposhtme:

Instrumentet në diferenca:

$$X_{(t-n)} - X_{(t-(n-1))} \quad \text{Ekuacioni (4.23)}$$

Instrumentet në nivele:

$$X_{(t-n)}$$

Përdorimi i instrumenteve në ndarje ose nivele shprehet sipas ekuacioneve të mëposhtme:

Ekuacionet në diferenca:

$$\Delta Y_{t-1}; Y_{t-(n-1)} = Y_{t-n} \quad \text{Ekuacioni (4.24)}$$

Ekuacionet në nivele:

$$Y_t = T_{t-1}; Y_{t-(n-1)} = Y_{t-n} \quad \text{Ekuacioni (4.25)}$$

Ku, Y_{t-n} është instrument i $Y_{t-(n-1)}$

Duke marrë parasysh ndërtimin e instrumenteve në të dhënat e panelit dinamik, është e mundur të përcaktohen disa vlerësues: E para u zhvillua nga Arellano dhe Bond në vitin 1991 (Arellano dhe Bond 1991). Ajo njihet si diferenca GMM, sepse ky vlerësues përdor si instrumente vonesat në dallime. Një vlerësues i tretë u zhvillua nga (Roodman, 2006).

Ajo quhet “xtabond2”. Ky vlerësues ndjek të njëjtën logjikë si sistemi GMM, por paraqet më shumë opsione në përdorimin e instrumenteve. Përveç kësaj, “xtabond2” na lejon të punojmë veçmas endogjenitetin e variablave të varur ose të pavarura.

Siç kemi përmendur, sistemi GMM përdor instrumente në nivele dhe dallime. Ekuacionet që lejojnë llogaritjen e saj janë si më poshtë:

Ekuacionet në diferenca dhe nivele - sistem GMM:

$$Y_{it} = \alpha_{i,t-1} + \beta X_{it} + \varepsilon_{it}$$

$$\varepsilon_{it} = \mu_i + \nu_{it}$$

Ekuacioni(4.26)

$$E(\mu_i) = E(\nu_{it}) = E(\mu_i \nu_{it}) = 0$$

Y_{it} është variabla e varur (individuale) në “t” (periudhën kohore)

X_{it} është variabla e pa varur (individuale) në “t” (periudhën kohore)

Vlerësimi i të dhënave të panelit dinamik. Një qasje praktike për të kryer panele të gjata.

Termi i gabimit ε_{it} ka dy komponente ortogonale: μ_i = Fixed Effects,

ν_{it} =idiosyncratic shocks

Shfrytëzimi i GMM në vlerësim ka dy çështje kryesore: përhapja e instrumenteve dhe auto korrelacioni serial i gabimeve. Këto dy çështje do të jenë më të larta kur paneli i përdorur do të përbëhet nga një mostër me një periudhë të gjatë kohore, si dhe një numër të reduktuar të individëve.

Përhapja e instrumenteve i referohet ekzistencës së një niveli më të lartë të instrumenteve. Kjo do të shkaktonte shumëfishim të modelit si pasojë e gjenerimit të variablave instrumentale në diferenca dhe nivelet (me përjashtim të vlerësuesit të Arellano dhe Bond).Për të kontrolluar nëse numri i instrumenteve është i përshtatshëm dhe ai nuk prodhon mbizotërim, ekzistojnë dy teste në dispozicion: testi Sargan dhe test Hansen (Labra dhe Torrecillas, fq.35-37, 2018).

Vlerësimi i Modeleve Dinamike duke përdorur të dhënat makro dhe panelet e gjata

Të dhënat e panelit janë pjesë e teknikave në dispozicion për të testuar modele ekonometrike nga bazat e të dhënave të formuara nga një numër i vogël individësh të vëzhguar për një kohë të gjatë. Megjithatë, kohëzgjatja e T (kohës) dhe N (individëve) mund të ndryshojë gjatë analizës së studimit, si dhe mund të sjellë rezultate të pakorrigjuara në vlerësime. Prandaj për t'u marrë me gjatësinë e N dhe T , disa autorë kanë vënë në dukje disa ide që mund të ndihmojnë në trajtimin e këtyre dallimeve. Autorët e mëparshëm propozojnë trajtimin e ekuacioneve nga njësitë e ndryshme të kryqëzimit si një sistem të ekuacioneve të regresionit në dukje të palidhur (SURE) dhe më pas vlerësojnë sistemin nga teknikat GLS (Pesaran 2006). Veçanërisht kur N është relativisht më i vogël në krahasim me T , dhe gabimi është i pa-korreluar.

Për N dhe T të mëdha disa autorë propozojnë që të kufizojnë matricën e kovariancës së gabimit duke përdorur një specifikim të përbashkët të faktorëve të pa vëzhguar (Hoechle 1933, Phillips dhe Sul 2003). Megjithatë, disa gabime ekonometrike ndodhin kur N është më i madh se T . Për këtë arsye (Pesaran 2006) propozoi të zbatoje vlerësuesin e përbashkët të efekteve (CCE) kur N dhe T tentojnë të rriten në pafundësi. Përdorimi i numrit të madh të individëve në periudhat e shkurtra kohore është lloji më i zakonshëm i të dhënave në analizën e paneleve dinamike. Ajo quhet ndryshe si panele të shkurtra, mirëpo literatura aktuale nuk specifikon një numër të individëve (n) ose kohës (t) për të klasifikuar panelet për një kohë të gjatë ose kohe të shkurtër. Megjithatë disa autorë kanë treguar rregullin e mëposhtëm, ku një ' n ' i përshtatshëm mund të jetë më i madh se 100, ndërsa ' t ' nuk duhet të kalojë 15 periudha, dhe ideale duhet të jetë më vogël se 10 nëse objektivi është që të vlerësojë modelet dinamike me të dhënat e panelit (Roodman 2009). Kur ne përpiqemi të vlerësojmë modelet dinamike me panele të konfirmuara ' n ' relativisht me të vogla ($n < 100$) dhe ' t ' të mëdha ($t > 15$), duke përdorur vonesat e variablave si instrumente të termave endogjene, atëherë ne ' nd ' mund të përjetojë ndryshime të tjera për shkak të strukturës së të dhënave të panelit dhe mënyrës së gjenerimit të variablave instrumentale. Ky fakt është shkaktuar nga përfshirja e vonesave të variablave endogjene si instrumente (s), të cilat duhet të jenë në lidhje me regresorin endogjen dhe $E(\mu | \chi) = 0$. Kjo alternativë e instrumenteve (vonesat e variablave endogjene) zgjidh problemin që ndërron një instrument të përshtatshëm për regresorët endogjenë.

(Anderson dhe Hsiao 1981, Arellano dhe Bond 1991, Arellano dhe Bover 1995) kanë demonstruar rëndësinë e vonesave si instrumente me rëndësi të veçantë për të vlerësuar dinamikën e modeleve ekonometrike. Megjithatë, kur përdoren të dhënat në panele të gjata një pengesë e rëndësishme shfaqet nëpërmjet përhapjes së instrumenteve (Roodman 2009). Kjo është për shkak se numri i instrumenteve që do të gjenerohen lidhet direkt me gjatësinë e panelit (numrin e periudhave). Gjatë testimit të të dhënave në këtë studim unë kam përdorur vlerësuesin GMM nga Arellano dhe Bond (1991), Blundell dhe Bond (1998), Blundell, Bond dhe Windmeijer (2000) pasi është vlerësues i duhur. Gjithashtu metoda GMM na lejon të kontrollojmë problemin e paragjykitit të endogjenitetit të shkaktuar nga ndikimi i kundërt që rrjedh nga PBB-ja për kokë banori tek borxhi dhe PBB-ja, si dhe tek variablat e tjera shpjeguese. Besueshmëria e vlerësuesit të GMM varet nga vlefshmëria e grupeve të tij. Për të adresuar këtë çështje përdorim dy teste të sugjeruara nga Arellano dhe Bond (1991), Arellano dhe Bover (1995), dhe Blundell dhe Bond (1997). Për shembull, për një ndryshore me $t = 5$, numri i instrumenteve të mundshme (është 12 nga ekuacione në difference, dhe 3 nga ekuacionet në nivele) atëherë kur ne përdorim metodologjinë e GMM. Në rastin e ekuacioneve në difference, numri i instrumenteve është i përcaktuar me poshtë:

Funksioni :

$$\Delta Y_{it} = \delta \Delta Y_{i(t-1)} + \Delta \varepsilon_{it}$$

Instrumentet :

$$Y_{i1}, Y_{i2}, \dots, Y_{it-2}$$

Nëse ka një ose më shumë variabla endogjene, numri i instrumenteve rritet edhe më shumë, pasi çdo regresor është i instrumentalizuar nga njohuritë dhe nivelet e tyre (përmes teknikave GMM). Kjo përhapje e instrumenteve, fillimisht u pa si e favorshme, pasi që ajo rriti efikasitetin e vlerësuesit (Arellano dhe Bond 1991), megjithatë, ajo shkakton një ndryshim të versionit brenda modelit, kryesisht kur numri i gradave të lirisë është i vogël, p.sh. kur ka pak individë të përfshirë në mostër. Prandaj, duke qenë se paneli rritet në periudha dhe zvogëlon numrin e individëve, atëherë probabiliteti i krizës së tepërt mund të rritet (Labra dhe Torrecillas, fq.38-40, 2018).

4.9. Modelet Threshold

Modeli i pragut (threshold) përshkruan karakterin kërcyes ose ndërprerjen strukturore në marrëdhëniet ndërmjet variablave në modelin ekonometrik (Andrews dhe Guggenberger, fq. 721–762, 2009).

Ky lloj i modelit është i popullarizuar tek serite kohore jo lineare, një shembull i tillë është modeli auto -regresiv i pragut “TAR” (Tong ,1983).

Ky model mund të kapë shumë fenomene ekonomike, nëpërmjet këtij modeli mund të përcaktojmë edhe pragu e borxhit publik, ku deri në cilën masë rritja e borxhit publik mund te ndikojë pozitivisht ne rritjen ekonomike.

Single-Threshold Model (Pragu Individual)

Me poshtë mund të shohim modelin threshold individual:

$$y_{it} = \mu + X_{it}(q_{it} < \gamma)\beta_1 + X_{it}(q_{it} \geq \gamma)\beta_2 + \mu_i + e_{it} \text{ Ekuacioni (4.27)}$$

Variabla q_{it} është variabla që paraqet pragu (threshold), dhe γ është parametri i pragut që ndan ekuacionin në dy regjime nëpërmjet koeficienteve β_1 dhe β_2 . Parametri μ_i paraqet efektin individual, ndërsa e_{it} paraqet një shqetësim tek modeli. Atëherë ne modelin mund ta shkruajmë si në vijim:

$$y_{it} = \mu + X_{it}(q_{it}, \gamma)\beta + \mu_i + e_{it}$$

$$X_{it}(q_{it}, \gamma) = \begin{cases} x_{it}I(q_{it} < \gamma) \\ x_{it}I(q_{it} \geq \gamma) \end{cases}$$

Duke marrë në konsideratë y , vlerësues me i zakonshëm është β

$$\hat{\beta} = \{X^*(\gamma)' X^*(\gamma)\}^{-1} \{X^*(\gamma)' y^*\}$$

Ku y^* dhe X^* janë devijime brenda grupit. Shuma e mbetur e shesheve (RSS) është e barabartë me e^*e^* . Për të vlerësuar γ , mund të kërkohet mbi një nëngrup të pragut të variabëlave q_{it} , si dhe vlerësuesi i γ është vlera që minimizon “RSS”, dhe që është:

$$\hat{\gamma} = \arg \min S_1(\gamma)$$

Nëse γ është e njohur, atëherë modeli nuk është i ndryshëm nga modeli linear i zakonshëm. Por nëse γ është e panjohur, ekziston një problem i parametrave të dëmtimit, gjë që e bën shpërndarjen e vlerësuesit γ jo standarde.

(Hansen ,1999) provoi se $\hat{\gamma}$ është një vlerësues i qëndrueshëm për γ , dhe ai argumentoi se mënyra më e mirë për të provuar $\gamma = \gamma_0$ është të formojë intervalin e besimit duke përdorur metodën "no-rejection region", nëpërmjet formulës statistikore si në vijim:

$$LR_1(\gamma) = \frac{\{LR_1(\gamma) - LR_1(\hat{\gamma})\}}{\hat{\sigma}^2} \underline{\Pr} \varepsilon$$

$$\Pr ((\chi < \varepsilon) = (1 - e^{-\frac{\chi}{2}})^2 \quad \textbf{Ekuacioni (4.28)}$$

Duke pasur parasysh nivelin e rëndësisë α , kufiri i poshtëm korrespondon me vlerën maksimale në serinë “LR”, e cila është më e vogël se α kuantile, ndërsa kufiri i sipërm korrespondon me vlera minimale në serinë LR, e cila është më e vogël se sa α kuantile.

α kuantile mund të llogaritet në të kundërtën e funksionit në ekuacionin me lartë, me konkretisht (Ekuacionit.2):

$$c(\alpha) = -2 \log(1 - \sqrt{1 - \alpha})$$

Multiple-Thresholds Model (Pragu i Shumëfishtë)

Nëse ka pragje të shumta (që nënkuptojnë regjime të shumëfishta), ne i përshtatemi modelit në mënyrë të vazhdueshme (Bai, fq.315-352, 1997).

Për shembull, ne përdorim modelin e pragut të dyfishtë, që do të paraqesim në vijim:

$$y_{it} = \mu + X_{it}(q_{it} < \gamma_1)\beta_1 + X_{it}(\gamma_1 \leq q_{it} < \gamma_2)\beta_2 + X_{it}(q_{it} \geq \gamma_2)\beta_3 + \mu_i + e_{it}$$

Këtu, γ_1 dhe γ_2 janë pragjet që ndajnë ekuacionin në tre regjime nëpërmjet koeficienteve $\beta_1, \beta_2, \beta_3$

Ne duhet të llogarisim këtë $(N \times T)^2$ duke përdorur metodën e kërkimit në rrjet metodë, e cila është e pamundur në praktikë.

Sipas studiuesve (Bai, 1997) dhe (Bai dhe Perron, 1998), vlerësuesi vijues është i qëndrueshëm, kështu që ne vlerësojmë pragjet si më poshtë:

Modeli i pragut individual mund të fitohet nëpërmjet vlerësuesit γ_1 dhe RSS

$$S_1 = (\hat{\gamma})$$

Duke pasur parasysh $\hat{\gamma}$, pragu dytësor dhe intervalet konfidenciale janë si në vijim:

$$\hat{\gamma}_2^r = \arg \min \{S_2^r(\gamma_2)\}$$

$$S_2^r = S\{\min(\hat{\gamma}_1, \hat{\gamma}_2) \max(\hat{\gamma}_1, \hat{\gamma}_2)\}$$

$$LR_2^r = \frac{\{S_2^r(\hat{\gamma}_2) - S_2^r(\hat{\gamma}_2^r)\}}{\hat{\sigma}_{22}^2}$$

$\hat{\gamma}_2^r$ është efikas, mirëpo $\hat{\gamma}_1^r$, ne vlerësojmë prapun e pare si në vijim:

$$\hat{\gamma}_1^r = \arg \min \{S_1^r(\gamma)\}$$

$$S_1^r = S\{\min(\gamma 1, \hat{\gamma} 2) \max(\gamma 1, \hat{\gamma} 2)\}$$

$$LR_1^r(\gamma 1) = \frac{\{S_1^r(\gamma 1) - S_1^r(\hat{\gamma}_1^r)\}}{\hat{\sigma}_{21}^2}$$

Testi i efektit të prapun është gjithashtu një proces vijues, domethënë nëse ne hedhim poshtë hipotezën e pavlefshme në një model të prapun të vetëm (individual), atëherë duhet ta provojmë modelin e dyfishtë të prapun. Hipoteza e pavlefshme është një model i prapun të vetëm, dhe hipoteza alternative është një model me dy prapje. Statistikisht “F” është ndërtuar si në vijim:

$$F_2 = \frac{\{S_1(\hat{\gamma} 1) - S_2^r(\hat{\gamma}_2^r)\}}{\hat{\sigma}_{22}^2}$$

Dizajni i modelit “bootstrapping” është pothuajse i njëjtë me modelin e prapun individual. Tek pjesa e tretë me lartë ne gjenerojmë një seri të re nën H_0 DGP ku

$$y_{it}^* = X_{it}^* \beta_S + v_{it}^* .$$

Vlerësuesi β_S është vlerësues në një model të prapun të vetëm (individual), domethënë nën DGP të H_a , duke përdorur vlerat e parashikuara. Për modelet me më shumë se dy parametra të prapun, procesi është i ngjashëm. (Chan ,1993 dhe Hansen, 1999) tregojnë se varësia e vlerësimit dhe përfundimit të β në vlerësimin e prapun nuk ka rëndësi asimptotike të rendit të parë. Kështu β mund të vazhdojë të jap informacione dhe konkluzione për shkak se γ është dhënë.

4.10. Të dhënat dhe strategjia e vlerësimit

Në këtë studim do të analizojmë marrëdhëniet në mes të borxhit publik dhe rritjes ekonomike, në mostër përfshihen vendet Evropiane që janë në fazën e tranzicionit. Me konkretisht krahasimi i vendeve në tranzicion të Evropës qendrore me vendet e Evropës lindore, si dhe me vendet e Ballkanit Perëndimor. Të dhënat gjatë kësaj periudhe i konsideroj të kenë qenë më të sintetizuara për arsye se nëse do të kisha përdorur të dhëna për vite më të vonshme, konsideroj se do të kishin ndikuar negativisht në kualitetin e hulumtimit.

Burimet kryesore të të dhënave kanë qenë; Banka Botërore, Banka Evropiane për Ndërtim dhe Zhvillim (EBRD), Banka Qendrore Evropiane, si dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar. Mirëpo gjatë analizës së bërë rrjeteve të data bazave më të dhëna numerike shohim se ekziston një mungesë e madhe për indikatorët makroekonomik për vendet që janë në zhvillim, sidomos tek vendet e Evropës që janë në tranzicion. Mungesa me e theksuar e të dhënave shihet tek vendet në tranzicion të Ballkanit Perëndimor. Literaturën empirike të cilën e kam shfrytëzuar në këtë studim është zhvilluar shumë kohët e fundit, por shumica e këtyre autorëve janë vënë në pikëpyetje, për shkak të gjetjes së kufirit ose pragut optimal ku mbi të cilin rritja e borxhit publik do të afektojë negativisht në rritjen ekonomike tek vendet evropiane në tranzicion.

Po ashtu çka është shumë e rëndësishme të potencohet është që modelet e regresionit ju kanë mundësuar studiuesve të analizojnë kanalet përmes të cilave rritja ekonomike influencohet nga një gamë e gjerë e variablave shpjeguese, hulumtuesit mundohen të përcaktojnë ndryshimin e rritjes ekonomike dhe zhvillimin e saj gjatë gjithë kohës. Nëse i referohemi literaturës ekonomike dhe argumenteve të trajtuara me herët mund të potencojmë se kostot ekonomike dhe sociale të krizave financiare mund të jenë shumë të larta në ato vende të cilat ballafaqohen me rritje të nivelit të borxhit publik për të financuar aktivitetet tregtare si p.sh vendet Evropiane në tranzicion të cilave ju referuam me lartë në këtë studim. Tek këto vende si rezultat i gjithë kësaj ekonomia ballafaqohet me rënie të PBB-së, në krahasim me vendet e zhvilluara të cilat kanë një stabilitet dhe qëndrueshmëri të madhe ekonomike, ku pragu i kufirit optimal (threshold) i borxhit publik është shumë i lartë tek këto vende, ku sipas disa studimeve të bëra sillet prej 80% deri tek 95%, në raport me vendet në tranzicion ku pragu i borxhit publik sipas studimeve të bëra shihet të jetë prej 40% deri në 60%. Që do të thotë këto vende mund të përdorin borxhin publik deri në këtë kufi të lartë-cekur dhe përsëri të posedojnë rritje dhe zhvillim ekonomik.

4.11. Vlerësimi i modeleve

Metodat më të përdorura për trajtimin e lidhjes ndërmjet variablave që kam trajtuar në hulumtimin e disertacionit të doktoratës janë: OLS, Fixed Effects, Random Effects, Hausman Taylor, GMM, si dhe Bootstrapp-Montecarlo. Metodën e regresionit të thjeshtë do të përdorim duke e ndërtuar modelin e regresionit linear, i cili është i aftë të parashikojë vlerën e variables së varur në këtë studim, me konkretisht të paraqes ndikimin e variables së pa varur (borxhi publik) mbi rritjen ekonomike (gdp per capita) tek vendet në tranzicion të Evropës. Të dhënat do të testohen edhe nga metodat tjera statistikore. Panel data është një metodë statistikore, e përdorur gjerësisht në shkencat shoqërore, epidemiologji, si dhe ekonometri që merret me observimin e të dhënave gjatë dy dimensioneve atë: “Cross Sectional dhe Times Series” (Lahiri, 1995). Teknikat e regresionit të të dhënave panel u lejojnë hulumtuesve për të përfutur nga dy lloje të informacioneve të përfaqësuara në “Cross Sectional dhe Time Series Data”.

Modelet e përmendura më lartë që do të përdoren për testimin e të dhënave janë edhe “Fixed Effects” dhe “Random Effects”. Statistikisht “Fixed Effects” është gjithmonë një gjë e arsyeshme për të bërë me panel data, pasi që gjithmonë jep rezultate të qëndrueshme, mirëpo mund të mos jetë gjithmonë modeli më efikas për tu përdorur në trajtimin e modeleve ekonometrike. Ndërsa “Random Effects” do të jep ‘P’ vlera më të mira për arsye se është një preventivues më efikas, pra mund të përdoret nëse është e justifikueshme statistikisht. “Hausman-Taylor” është më konsistent dhe njëkohësisht efikas, duke qenë zgjedhja më e mirë po të krahasojmë me modelet “Fixed Effects dhe Random Effects”.

Duke përmbledhur dy vlerësuesit e prezantuar më lartë, pra “Fixed Effects” dhe “Random effects”, që të dy janë modele të dizajnuara për të trajtuar një strukturë të veçantë të të dhënave gjatësore ose të dhënave të serive ‘Panel’, ku heterogjeniteti i pa vëzhgueshëm individual është marrë parasysh në të dy modelet. Vlerësimi ndërmjet modeleve në fjalë, është nëse efektet specifike individuale që variojnë përgjatë kohës janë në korrelacion ose nuk janë në korrelacion me regresorët. Gjithashtu mund të hasim shumë gabime në matjen e variablave “X” si dhe ndryshimeve endogjene të “X”, të cilat mund të shpijnë në rezultate të njëanshme edhe me preventivuesin “Fixed Effects”. Për derisa disa nga variablat shpjeguese (të pavarura) të përdorura në modelin e paraqitur gjatë këtij studimi shkencor, supozohen të jenë endogjene, andaj modelet “Fixed Effects” dhe

"Random Effects" janë përdorur vetëm për qëllime krahasimore, që përmes tyre të fitohen rezultate efektive dhe të përshtatshme për të operuar me to . Për të hetuar se cila nga këto metoda paraqet rezultate me të besueshme përdorim testin "Hausman" i cili është një test kryesisht statistikor që në ekonometri bën të mundur testimin e hipotezave, dhe është zhvilluar nga Jerry A. Hausman. Testi Hausman bën të mundur testimin e hipotezës zero, të koeficienteve të vlerësuar nga preventuesi më efikas "Random Effects" janë të njëjta më ato të vlerësuara nga preventivuesi më konsistent, pra "Fixed effects". Prandaj për të parë se cila nga këto teknika ekonometrike të shfrytëzuara prodhojnë rezultate me signifikançë me lartë do të përdorim edhe modelin e "Hausman-Taylor-IV", dhe do të mundohem që në mënyrë sa me efektive dhe efektive t'i shfrytëzoj të dhënat e fituara nga ky model, dhe të ofrojë rezultate argumentuese se si ndikon rritja eventuale e borxhit publik tek vendet evropiane në tranzicion. Për dallim nga metodat që i potencuam me lartë, gjatë këtij studimi do të përdorim edhe metodën e vlerësimit "GMM", e cila dallon nga metodat e lartë përmendura.

Në ekonometri dhe në statistikë mund të përdorim metodën e përgjithshme të vlerësuesve të momenteve "GMM", e cila është një metodë gjenerike për vlerësimin e parametrave në modelet statistikore. Zakonisht ajo zbatohet në kontekstin e modeleve semi-parametrike. Gjatë testimit do të përdorim vlerësuesin GMM nga Arellano dhe Bond (1991), Blundell dhe Bond (1998), Blundell, Bond dhe Windmeijer (2000) pasi është vlerësues i duhur. Gjithashtu metoda GMM na lejon të kontrollojmë problemin e paragjykitimit të endogjenitetit të shkaktuar nga ndikimi i kundërt që rrjedh nga PBB-ja për kokë banori tek borxhi dhe PBB-ja, si dhe tek variablat e tjera shpjeguese. Për të trajtuar problemin e endogjenitetit kam përdorur variablat instrumentale (IV) ose dy hapat e vlerësuesit GMM instrumental (IV). Ky instrument ka përparësinë që të mos ketë një efekt të drejtpërdrejtë kauzal në shkallën e rritjes, nëse supozohet se nuk ka efekte midis niveleve të borxhit publik për vendet në tranzicion të Evropës. Besueshmëria e vlerësuesit të GMM varet nga vlefshmëria e grupeve të tij. Për të adresuar këtë çështje përdorim dy teste të sugjeruara nga Arellano dhe Bond (1991), Arellano dhe Bover (1995), dhe Blundell dhe Bond (1997). Ndërsa përcaktimin e pragut të borxhit publik tek vendet evropiane në tranzicion do të bëjmë nëpërmjet qasjes "threshold" duke u bazuar në vlerësuesin "bootstrap- montecarlo" e cila bazohet në një numër të lartë të simulimeve, mbi 2000 simulime.

5. Rezultatet Empirike

Në këtë kapitull të disertacionit të doktoratës do të paraqesim rezultatet empirike të punuara nëpërmjet disa qasjeve ekonometrike të tilla si OLS, Fixed Effects, Random Effects, Hausman-Taylor, GMM, si dhe metoda Bootstrap-Montecarlo. Arsyeja e shumëllojshmërisë së përdorimit të këtyre modeleve ekonometrike është sepse rezultatet e fituara duhet të pasqyrojnë një besueshmëri të lartë statistikore. Në pjesën me lartë ne kemi përshkruar të gjitha qasjet ekonometrike të cilat do të përdoren gjatë analizës së të dhënave. Siç e kemi potencuar tek kapitulli i metodologjisë burim i të dhënave do jenë Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar. Ndërsa periudha e analizës empirike në vendet në tranzicion të Evropës përfshijnë periudhën kohore 1995 deri në vitin 2017, dhe që paraqet një periudhe mjaft të madhe kohore me mbi 20 vite. Përpos variables së varur, të gjitha variablat e tjera të pavarura në këtë hulumtim empirik janë të shprehura në % të GDP-së. Mirëpo tek të gjitha modelet ekonometrike të punuara për vendet në tranzicion të Evropës unë i kam punuar nëpërmjet qasjes “unbalanced data” ku vërejmë divergjenca në raport me vitet, mirëpo kjo vetëm sa për të rritur numrin e observacioneve brenda modeleve. ”. Ndërsa tek përcaktimi i pragut të borxhit publik “threshold” tek vendet në tranzicion të Evropës Qendrore, Lindore, si dhe vendet e Ballkanit Perëndimor jam shkuar nëpërmjet të dhënave të balancuara “balanced data “ duke filluar nga viti 2000.

Rezultatet e paraqitura me poshtë nëpërmjet Tabelave 5.2, 5.4, dhe 5.6 tregojnë se të gjitha metodat e llogaritura në panelet dinamike janë modeluar mirë, pasi që koeficientet e PBB-së reale të mbetura janë statistikisht të rëndësishme. Për më tepër Testi-Sargan bën identifikimin e kufizimeve në prani të hetero-skedasticitetit me t-vlerën e shoqëruar e cila shqyrton vlefshmërinë e variablave instrumentale të pranuar si instrumente të shëndetshme për të gjitha ekuacionet e vlerësuar. Prandaj, rezultatet nga vlerësuesi GMM vërtetojnë konstatimin se variablat instrumentale nuk lidhen me grupin e mbetjeve. Si rezultat, testet Arellano - Bond testi AR (1) dhe AR (2) me t-vlera të shoqëruara refuzohen në rendin e parë, ndërsa ato pranohen në rendin e dytë, i cili konfirmon se nuk ka auto korrelacion në rendin e dytë midis termit të gabimeve. Intervalet e besimit (CI) të pikës së kthimit të borxhit gjenerohen përmes metodës “bootstrapping” e cila bazohet në një shpërndarje normale.

Metoda “bootstrap-montecarlo” bazohet në simulimet e përdorura të cilat nxjerrin koeficientet të cilët llogarisin piken kthyesë të përdorimit të borxhit publik “turning point”.

Në tabelat e vendosura me poshtë janë vendosur edhe pragjet “threshold”, ku deri në cilën kufi vendet mund të përdorin borxhin publik (vendet e Evropës Qendrore, Lindore, si dhe ato të Ballkanit Perëndimor). Mirëpo interpretimi me i detajuar do të bëhet në pjesën e fundit të rezultateve empirike, ku dhe do të mbështetën hipotezat e ngritura në fillim të këtij studimi të cilat parashikojnë pragu e përdorimit të borxhit publik tek vendet në tranzicion të Evropës.

Në këtë punim doktrate kemi parashtrua këto hipoteza:

HIPOTEZA 1: Rritja e Borxhit Publik në vendet e Evropës Qendrore mbi pragu 75% deri në 85% ndikon negativisht në rritjen ekonomike në raport me PBB-në.

HIPOTEZA 2: Rritja e Borxhit Publik në vendet e Evropës Lindore mbi pragu 65% deri në 75% ndikon negativisht në rritjen ekonomike në raport me PBB-në.

HIPOTEZA 3: Rritja e Borxhit Publik në vendet e Ballkanit Perëndimor mbi pragu 55% deri në 65% ndikon negativisht në rritjen ekonomike në raport me PBB-në

.

HIPOTEZA 4: Borxhi Publik ka gjasa të ndikon pozitivisht në rritjen ekonomike përmes Investimeve Publike në raport me PBB-në.

5.1. Modelet ekonometrike për vendet në tranzicion të Evropës Qendrore

5.1.1. Të dhënat nga hulumtimi empirik

Të dhënat empirike të cilat janë përdorur për t'i testuar variablat tek vendet në tranzicion të Evropës Qendrore përfshijnë periudhën kohore nga viti 1995-deri në vitin 2017. Ndërsa burimi i të dhënave ka qenë Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar, për t'i vlerësuar me konkretisht të dhënat atëherë mund ti shohim tek **Shtojca.1** në fund të këtij studimi. Për të hetuar lidhjen në mes të borxhit publik dhe rritjes ekonomike, ne kemi ndërtuar modelet ekonometrike të cilat përfshijnë disa qasje, duke filluar nga OLS (Analiza e thjeshtë e regresionit), Fixed Effects (Efektet Fikse), Random Effects (Efektet e Rastit), Hausman-Taylor, si dhe vlerësuesi GMM (Metoda e Përgjithshme e Momenteve), të cilat janë harmoni edhe me disa studime empirike të cilat trajtojnë ndikimin e borxhit publik tek vendet e zhvilluara si dhe vendet në zhvillim të tilla si : (Checherita dhe Rother (2010), Mencinger, Aristovnik, Verbic (2015).

Nëpërmjet këtyre modeleve do të mundohemi të shohim efektin e borxhit publik mbi rritjen ekonomike, duke u bazuar në gdp-në (gdp per capita) e cila në këtë hulumtim tregon rritjen ekonomike dhe është variabël e varur, (debt) dhe (debt square) të cilat paraqesin borxhin publik, dhe se bashku me disa variabla të tjera kontrolluese janë vendosur si variabla të pavarura. Të gjitha variablat e pa varura në këtë hulumtim empirik janë të shprehura në përqindje të PBB-së.

Sipas të dhënave të paraqitura në Tabelën 5.2 mund të shohim rezultatet nga të gjitha modelet e përdorura në këtë hulumtim empirik, të cilat paraqesin ndikimin e borxhit publik në rritjen ekonomike të vendeve në tranzicion të Evropës Qendrore, ku variabël e varur është vendosur gdp-ja (gdp per capita), ndërsa debt (borxhi publik), debt square (borxhi i vendosur në katror), exsport (eksporti), final_consum (shpenzimet e konsumit), bruto_saving (kursimet bruto), current account (llogaria aktuale), si dhe final_government_expenditure (shpenzimet qeveritare) janë vendosur si variabla të pavarura. Interpretimi i rezultateve empirike do të behet nëpërmjet vlerësuesit GMM, ose me mire të themi sipas modelit të fundit tek Tabela 5.2, kjo sepse të dhënat e fituara nga ky vlerësues shihen të jenë me të besueshme.

5.1.2. Rezultatet empirike

Tabela 5. 1:Përshkrimi statistikor i variablave ekzogjene dhe endogjene në vendet e Evropës

Variablat	OBS	Std.Dev	Min	Max
Gdp	156	4.4008	-14.56	13.08
Gdplag	155	4.4150	-14.56	13.08
Debt	152	19.7692	3.7	85.7
Debt_Square	161	1613.61	0	7344.49
Exsport	161	16.5663	22.09	86.54
Final_Consum	161	5.9088	65.48	91.44
Bruto_Saving	156	4.4891	10.46	30.46
Current_Account	161	4.9391	-21.07	7.9
Final_Government_Expenditure	161	1.8613	15.76	25.88

Qendrore

Burimi: Kalkuluar nga Autori

Tabela 5. 2:Rezultatet nga analiza e regresionit në vendet e Evropës Qendrore

Variablat	OLS Model (1)	Fixed Effects Model (2)	Random Effects Model (3)	Hausman- Taylor Model (4)	GMM IV Model (5)
Gdp_Lag T-Statistics				0.1327* (1.45)	-0.1799*** (-2.48)
Debt T-Statistics	0.0072 (0.17)	0.0889** (1.64)	0.0072 (0.17)	0.0646* (1.23)	0.1338** (1.53)
Debt_Square T-Statistics	-0.0783 (-0.14)	- 2.7332*** (-2.44)	-0.07832 (-0.14)	-1.7183** (-1.68)	-5.2434*** (-3.61)
Export T-Statistics	0.0332* (1.13)	0.0968** (1.61)	0.0332* (1.13)	0.0834* (1.43)	0.2709*** (4.07)
Final_Consum T-Statistics	0.1116 (0.76)	-0.0898 (-0.29)	0.1116 (0.76)	0.1228 (0.45)	0.5842** (1.93)
Bruto_Saving T-Statistics	0.0984 (0.51)	0.2827 (0.96)	0.0984 (0.51)	0.2456 (0.87)	0.7142*** (2.50)
Current_Account T-Statistics	- 0.4500*** (-4.13)	-0.3858*** (-2.75)	- 0.4500*** (-4.13)	- 0.3600*** (-2.47)	-0.5862*** (-4.45)
Final_Government_Exp T-Statistics	-0.6901*** (-3.11)	-0.1449 (-0.43)	-0.6901*** (-3.11)	-0.3735* (-1.22)	-0.7222** (-1.96)
Constant T-Statistics	3.22 (0.18)	15.75 (0.48)	3.22 (0.18)	-3.92 (-0.13)	-- --

Observation	146	146	146	145	138
Arellano - Bond test for AR (1)	--	(1.97)	--		(1.97)
Arellano - Bond test for AR (2)	--	(-3.47)	--		(-3.47)
Sargan Test	--	-	-		(280.79)
$\chi^2(56)_{prob.}$					
Turning Point 95% CI bootstrap - normal-based CI					81.60 (45;82)

Burimi: Kalkuluar nga Autori

Shënim: Gdp-ja nënkupton prodhimin e brendshëm bruto për kokë banori (annual %), dhe në këtë studim është vendosur si variabël e varur. Interpretimi i rezultateve do të bëhet përmes qasjes GMM. Besueshmëria dhe signifikanca do të bazohen nëpërmjet koeficientit t-statistics, ku parametrat 1 deri në 1.5 rezultati është signifikant më *, parametrat 1.5 deri në 2 është **, si dhe mbi 2 më ***. Testi Sargan tregon vlerën e koeficientit t-value për hipotezën e pavlefshme të vlefshmërisë së instrumenteve të përdorura (rezultati i marrë nga hapat e dytë). AR (1) dhe AR (2) janë vlerat e besueshmërisë për qëllim të parë dhe të dytë të auto korrelacionit të gabimeve. Ndërsa intervalet e besimit (CI) të pikës së kthimit të borxhit gjenerohen përmes metodës “bootstrap-montecarlo” bazuar në një shpërndarje normale, që ndryshe njihet si “threshold”, ku me konkretisht në këtë studim paraqet pragun e përdorimit të borxhit publik.

Tabela 5.2 tregon rezultatet nga analiza e regresionit. Duke aplikuar teknika të ndryshme ekonometrike, rezultatet e regresionit tregojnë se të gjitha modelet kanë pothuajse të njëjtat parametra në lidhje me raportin e borxhit publik ndaj rritjes së PBB-së për kokë banori tek vendet në tranzicion të Evropës Qendrore. Për më tepër mund të vërejmë se testi Sargan bën të mundur identifikimin e kufizimeve në prani të heteroskedasticitetit me p-vlerën e shoqëruar e cila shqyrton vlefshmërinë e variablave instrumentale që janë pranuar si instrumente të shëndetshëm për të gjitha qasjet ekonometrike të vlerësuar. Prandaj, rezultatet nga vlerësuesi i GMM vërtetojnë hipotezën se variablat instrumentale nuk lidhen me grupin e mbetjeve. Si rezultat, testet Arellano - Bond testi AR (1) dhe testi AR (2) me vlera të shoqëruara refuzohen në rendin e parë, mirëpo pranohen në rendin e dytë ku dhe konfirmohet që nuk ka auto korrelacion në rendin e dytë ndërmjet termit të gabimeve. Pjesë e rëndësishme e këtij studimi është pika e kthimit të borxhit publik që përcaktohet përmes kufirit “threshold”, ku rëndësi të veçantë do të kushtojmë në pjesën e fundit të analizës

empirike. Interpretimi i rezultateve në këtë pjesë do të bëhet nëpërmjet vlerësuesit GMM, për shkak të besueshmërisë me të madhe në raport me modelet tjera ekonometrike.

Sipas Tabelës 5.2 shohim se rritja eventuale e raportit të borxhit publik ndaj PBB-së për 1% tek vendet në tranzicion të Evropës Qendrore mund të ndikojë pozitivisht në periudhat afat-shkurtër për 0.133%, sipas t-statistikës ky koeficient është statistikisht i besueshëm. Ndërsa borxhi i vendosur në katror ndikon negativisht në rritjen ekonomike për -5.243% tek vendet në tranzicion të Evropës Qendrore, gjithashtu ky koeficient ka besueshmëri shumë të lartë sipas t-statistikës. Për më tepër mund të vërejmë se borxhi i vendosur në katror (borxhi^2) në raport me PBB-në pasqyron një ndikim jo-linear, dhe kjo prodhon një marrëdhënie konkave (në formë të U-së e përmbysur) midis borxhit publik dhe rritjes ekonomike, dhe qënënkupton se borxhi publik mund të ndikojë pozitivisht në rritjen ekonomike në nivelet fillestare, mirëpo tejkalimi mbi pragun optimal i borxhit publik tek (U-ja e përmbysur) jap pastaj efekte negative mbi rritjen ekonomike. Këto rezultate janë harmoni të plotë me shumë studime empirike të cilat janë bërë në fushën e borxhit publik dhe rritjes ekonomike (Checherita dhe Rother (2010), Mencinger, Aristovnik, Verbic (2015), Baum dhe Rogoff 2010), Reinhart dhe Rogoff (2010). Sipas rezultateve vërejmë se eksporti ndikon pozitivisht në rritjen ekonomike në vendet në tranzicion të Evropës Qendrore, me konkretisht nëse eksporti rritet për 1% atëherë do të ndikon në rritjen ekonomike për 0.270%, përndryshe ky koeficient ka një besueshmëri shumë të lartë statistikore, ky rezultat është në harmoni të plotë edhe me teorinë ekonomike e cila potencon se rritja e eksporti ndikon pozitivisht në zhvillimin ekonomik.

Gjithashtu rritja e shpenzimeve të konsumit final ndikon pozitivisht në rritjen ekonomike, ku nëse konsumi final rritet për 1% atëherë ndikon për 0.584% në rritjen ekonomike, sipas t-statistikës ky koeficient është statistikisht i besueshëm. Ndërsa edhe rritja e kursimeve bruto ndikon pozitivisht në rritjen ekonomike për 0.714%, ku sipas tabelës me lartë shohim se ky koeficient ka një besueshmëri shumë të lartë statistikore, ky rezultat është në përputhje të plotë me teorinë e rritjes ekonomike të bërë nga studiuesit Harrod dhe Solow, të cilët argumentuan ndikimin pozitiv të kursimeve bruto në rritjen ekonomike në periudhën afatgjatë. Mirëpo efekt negativ vërehet të ketë llogaria rrjedhëse, ku rritja eventuale e saj për 1% ndikon negativisht në rritjen ekonomike për -0.586%, përndryshe ky rezultat ka besueshmëri shumë të lartë statistikore. Për më tepër sipas vlerësuesit GMM shohim se shpenzimet qeveritare pasqyrojnë koeficient negativ, çka do të thotë se rritja e tyre prej 1% ndikon negativisht në rritjen ekonomike të vendeve në tranzicion të Evropës Qendrore për -

0.722%, gjithashtu ky koeficient ka besueshmëri statistikore. Rezultati është në përputhje me rezultatet e studimeve të bëra nga (Elmendorf dhe Mankiw, 1999).

5.2. Modelet ekonometrike për vendet në tranzicion të Evropës Lindore

5.2.1. Të dhënat nga hulumtimi empirik

Të dhënat empirike të cilat janë përdorur për t'i testuar variablat tek vendet në tranzicion të Evropës Lindore përfshijnë kryesisht periudhën kohore nga viti 1995-deri në vitin 2017, mirëpo nëse ndalemi dhe i shikojmë në formë të konkretizuar tek **Shtojca.2** vërejmë se tek disa vende të caktuara kemi mungese të dhënave për vitet me te hershme të kësaj analize. Të dhënat për realizimin e këtij testimi janë bazuar kryesisht nëpërmjet burimeve të Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar. Gjithashtu duhet potencuar se ngjashëm edhe me vendet me larte, për te hetuar lidhjen në mes të borxhit publik dhe rritjes ekonomike, ne kemi ndërtuar disa qasje të caktuara ekonometrike të cilat përfshijnë disa teknika kryesore duke filluar nga OLS (Analiza e thjeshtë e regresionit), Fixed Effects (Efektet Fikse), Random Effects (Efektet e Rastit), Hausman-Taylor, si dhe vlerësuesi GMM (Metoda e Përgjithshme e Momenteve). Përdorimin e këtyre qasjeve ekonometrike mund të vërejmë edhe tek shumë studime shkencore të cilat kanë studiuar borxhin publik në raport me rritjen ekonomike (Baum dhe Rogoff 2010, Reinhart dhe Rogoff 2010, Checherita dhe Rother (2010), Mencinger, Aristovnik, Verbic (2015).

Nëpërmjet këtyre modeleve do të mundohemi të shohim efektin e borxhit publik mbi rritjen ekonomike, duke u bazuar në Gdp-në (gdp per capita) e cila në këtë hulumtim tregon rritjen ekonomike dhe është variabël e varur, si dhe (debt) e cila paraqet borxhin publik dhe se bashku me disa variabla të tjera kontrolluese janë vendosur si variabla të pavarura. Të gjitha variablat e pa varura në këtë hulumtim empirik janë të shprehura në përqindje të PBB-së. Sipas të dhënave të paraqitura në Tabelën 5.4 mund ti shohim rezultatet nga të gjitha qasjet ekonometrike të përdorura në këtë testim, të cilat paraqesin ndikimin e borxhit publik në rritjen ekonomike të vendeve në tranzicion të Evropës Lindore, ku variabël e varur është vendosur gdp-ja (gdp per capita), ndërsa debt (borxhi publik), debt square (borxhi i vendosur në katror), exsport (eksporti), final_consum (shpenzimet e konsumit), bruto_saving (kursimet bruto), current account (llogaria aktuale), si dhe final_government_expenditure (shpenzimet qeveritare) janë vendosur si variabla të pavarura. Interpretimi i rezultateve empirike në këtë testim do të bëhet duke u bazuar në metodën GMM, për shkak të besueshmërisë me të madhe në raport me modelet tjera ekonometrike.

5.2.2. Rezultatet empirike

Tabela 5. 3:Përshkrimi statistikor i variablave ekzogjene dhe endogjene në vendet e Evropës

Variablat	OBS	Std.Dev	Min	Max
Gdp	160	4.7781	-14.42	12.95
Gdplag	159	4.7930	-14.42	12.95
Debt	142	22.933	8.4	136
Debt_Square	142	1.1158	4.2564	9.8253
Exsport	160	16.8582	22.86	96.3
Final_Consum	160	11.6901	61.62	116.81
Bruto_Saving	160	5.0296	4.99	32.79
Current_Account	161	5.3079	-25.75	10.66
Final_Government_Expenditure	160	3.0117	11.63	28.81

Lindore

Burimi: Kalkuluar nga Autori

Tabela 5. 4:Rezultatet nga analiza e regresionit në vendet e Evropës Lindore

Variablat	OLS Model (1)	Fixed Effects Model (2)	Random Effects Model (3)	Hausman- Taylor Model (4)	GMM IV Model (5)
Gdp_Lag T-Statistics				0.1441** (1.72)	-0.1538** (-1.78)
Debt T-Statistics	-0.0356 (-0.77)	0.0192 (-0.35)	-0.0356 (-0.77)	-0.0311 (-0.65)	-0.0466 (-0.71)
Debt_Square T-Statistics	-0.6817 (-0.72)	-0.8790 (-0.85)	-0.6817 (-0.72)	-0.5011 (-0.52)	-2.0436** (-1.48)
Export T-Statistics	0.0205 (0.83)	0.0399* (1.05)	0.0205 (0.83)	0.0183 (0.71)	0.1703*** (2.59)
Final_Consum T-Statistics	0.0411* (1.12)	0.1191* (1.04)	0.0411* (1.12)	0.0431* (1.05)	0.0958 (0.48)
Bruto_Saving T-Statistics	0.2524*** (2.48)	0.4294*** (2.73)	0.2524*** (2.48)	0.2460*** (2.28)	0.5631*** (2.77)
Current_Account T-Statistics	-0.0956* (-1.29)	-0.1805** (-1.78)	-0.0956* (-1.29)	-0.0892* (-1.10)	-0.1426* (-1.33)
Final_Government_Exp T-Statistics	-0.0120 (-0.09)	-0.0142 (-0.08)	-0.0120 (-0.09)	-0.0268 (0.18)	0.0745 (0.31)
Constant T-Statistics	0.14 (0.02)	-10.66 (0.71)	0.14 (0.02)	-2.45 (-0.31)	-- --
Observation	140	140	140	139	132
Arellano - Bond test for AR (1)	--	(-4.75)	--		(-4.75)
Arellano - Bond test	--	(-2.16)	--		(-2.16)

for AR (2)					
Sargan Test	--	-	-		(148.46)
$\chi^2_{(56)prob.}$					
Turning Point					71.90
95% CI bootstrap - normal-based CI					(71;72)

Burimi: Kalkuluar nga Autori

Shënim: Gdp-ja nënkupton prodhimin e brendshëm bruto për kokë banori (annual %), dhe në këtë studim është vendosur si variabël e varur. Interpretimi i rezultateve do të bëhet përmes qasjes GMM. Besueshmëria dhe signifikanca do të bazohen nëpërmjet koeficientit t-statistics, ku parametrat 1 deri në 1.5 rezultatet janë signifikante më *, parametrat 1.5 deri në 2 janë më **, si dhe mbi 2 më ***. Testi Sargan tregon vlerën e koeficientit t-value për hipotezën e pavlefshme të vlefshmërisë së instrumenteve të përdorura (rezultati i marrë nga hapat e dytë). AR (1) dhe AR (2) janë vlerat e besueshmërisë për qëllim të parë dhe të dytë të auto korrelacionit të gabimeve. Ndërsa intervalet e besimit (CI) të pikës së kthimit të borxhit gjenerohen përmes metodës “bootstrap-montecarlo” bazuar në një shpërndarje normale, që ndryshe njihet si “threshold”, ku me konkretisht në këtë studim paraqet pragun e përdorimit të borxhit publik.

Tabela 5.4 paraqet rezultatet nga analiza e regresionit. Duke aplikuar teknika të ndryshme ekonometrike, rezultatet e regresionit tregojnë se të disa nga modelet kanë pothuajse të njëjtat parametra në lidhje me raportin e borxhit publik ndaj rritjes së PBB-së për kokë banori tek vendet në tranzicion të Evropës Lindore. Për më tepër mund të vërejmë tek këto vende se testi Sargan bën të mundur identifikimin e kufizimeve në prani të heteroskedasticitetit me p-vlerën e shoqëruar e cila shqyrton vlefshmërinë e variablave instrumentale që janë pranuar si instrumente të shëndetshëm për të gjitha qasjet ekonometrike të vlerësuar. Prandaj, rezultatet nga vlerësuesi i GMM vërtetojnë hipotezën se variablat instrumentale nuk lidhen me grupin e mbetjeve. Si rezultat, testet Arellano - Bond testi AR (1) dhe testi AR (2) me vlera të shoqëruara refuzohen në rendin e parë, mirëpo pranohen në rendin e dytë ku dhe konfirmohet që nuk ka auto korrelacion në rendin e dytë ndërmjet termit të gabimeve. Pjesë e rëndësishme e kësaj table është pika e kthimit të borxhit publik që përcaktohet përmes kufirit “threshold”. Interpretimi i rezultateve do të bëhet nëpërmjet vlerësuesit GMM, për shkak të besueshmërisë dhe signifikancës me të lartë.

Nëpërmjet Tabelës 5.4 shohim se rritja eventuale e raportit të borxhit publik ndaj PBB-se për 1% tek vendet në tranzicion të Evropës Lindore ndikon negativisht në rritjen ekonomike për -0.046%, mirëpo ky koeficient nuk posedon një besueshmëri statistikore. Për të rritur edhe më shumë signifkancën e rezultateve ne kemi vendosur borxhin publik në katror.

Ku sipas të dhënave nga tabela shohim se borxhi i vendosur në katror ndikon negativisht në rritjen ekonomike për -2.043 % tek vendet në tranzicion të Evropës Lindore, gjithashtu ky koeficient ka besueshmëri shumë të lartë sipas t-statistikës. Për më tepër mund të vërejmë se borxhi i vendosur në katror (borxhi^2) në raport me PBB-në pasqyron një ndikim jo-linear, dhe kjo prodhon një marrëdhënie konkave (në formë të U-së e përmbysur), midis borxhit publik dhe rritjes ekonomike, që nënkupton sa me pak borxh ndikimi mund të jetë pozitiv, ndërsa tejkalimi i pragut tek (U-ja) e përmbysur jap efekte negative në rritjen ekonomike.

Këto rezultate janë harmoni të plotë më shumë studime empirike të cilat janë bere në fushën e borxhit publik dhe rritjes ekonomike (Checherita dhe Rother (2010), Mencinger, Aristovnik, Verbic (2015), Baum dhe Rogoff 2010, Reinhart dhe Rogoff 2010).

Sipas rezultateve në tabelën me lartë vërejmë se eksporti ndikon pozitivisht në rritjen ekonomike tek vendet në tranzicion të Evropës Lindore, me konkretisht nëse eksporti rritet për 1% atëherë do të ndikon pozitivisht në rritjen ekonomike për 0.170%, përndryshe ky koeficient ka besueshmëri shumë të lartë statistikore, ky rezultat është në harmoni të plotë edhe me teorinë ekonomike e cila potencon se rritja e eksporti ndikon pozitivisht në zhvillimin ekonomik.

Gjithashtu koeficient pozitiv ka paraqitur edhe shpenzimet e konsumi final në raport me PBB-në, ku nëse konsumi final rritet për 1% atëherë do të afektojë për 0.095% në rritjen ekonomike. Ndërsa rritja e kursimeve bruto poashtu ndikon pozitivisht në rritjen ekonomike për 0.563%, ku sipas tabelës me lartë shohim se ky koeficient ka një besueshmëri shumë të lartë statistikore.

Ky rezultat është në përputhje të plotë me teorinë e rritjes nga studiuesit Harrod dhe Solow, të cilët argumentuan ndikimin pozitiv të kursimeve bruto në rritjen ekonomike në periudhën afatgjatë. Nga të dhënat me lartë në këtë hulumtim shohim se llogaria rrjedhëse ka pasqyruar koeficient negativ në raport me PBB-në, ku rritja eventuale e saj për 1% ndikon negativisht në rritjen ekonomike për -0.142%, ky koeficient është statistikiisht i besueshëm.

Ndërsa sipas vlerësuesit GMM shohim se shpenzimet qeveritare kanë dhënë koeficient pozitiv në raport me PBB-në, çka do të thotë se rritja e tyre prej 1% ndikon pozitivisht në rritjen ekonomike në vendet në tranzicion të Evropës Lindore për 0.074%. Rezultati është në përputhje me rezultatet e (Adam and Bevan (2005), Cohen (1993), Elmendorf and Mankiw (1999).

5.3. Modelet ekonometrike për vendet në tranzicion të Ballkanit Perëndimor

5.3.1. Të dhënat nga hulumtimi empirik

Të dhënat empirike të cilat janë përdorur për t'i testuar variablat tek vendet në tranzicion të Ballkanit Perëndimor përfshijnë kryesisht periudhën kohore nga viti 1995-deri në vitin 2017. Edhe gjatë kësaj analize shohim se ka një diskrepancë në raport me të dhënat, sepse tek disa vende të Ballkanit Perëndimor mungojnë të dhënat për vite te caktuara. Kjo mund të arsyetohet edhe për shkak të proceseve ekonomike dhe politike që kanë kaluar dhe po kalojnë këto vende. Të dhënat janë marrë nëpërmjet Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar. Gjithashtu duhet potencuar se ngjashëm edhe me vendet me lartë, për të testuar lidhjen në mes të borxhit publik dhe rritjes ekonomike, ne kemi ndërtuar modelet ekonometrike të cilat përfshijnë disa nga teknikat kryesore duke filluar nga OLS (Analiza e thjeshtë e regresionit), Fixed Effects (Efektet Fikse), Random Effects (Efektet e Rastit), Hausman-Taylor, si dhe vlerësuesi GMM (Metoda e Përgjithshme e Momenteve).

Mirëpo gjatë analizimit të literaturës empirike shohim se ka shumë pak studime të cilat trajtojnë ndikimin e borxhit publik në rritjen ekonomike të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Sipas të dhënave të paraqitura në Tabelën 5.6 mund të shohim rezultatet nga të gjitha qasjet ekonometrike të përdorura në këtë testim, të cilat paraqesin ndikimin e borxhit publik në rritjen ekonomike të vendeve në tranzicion të Ballkanit Perëndimor, ku variabël e varur është vendosur gdp-ja (gdp per capita), ndërsa debt (borxhi publik), debt square (borxhi i vendosur në katror), exsport (eksporti), final_consum (shpenzimet e konsumit), bruto_saving (kursimet bruto), current account (llogaria aktuale), si dhe final_government_expenditure (shpenzimet qeveritare) janë vendosur si variabla të pavarura. Të gjitha variablat e pa varura në këtë hulumtim empirik janë të shprehura në raport me PBB-në. Interpretimi i rezultateve empirike në këtë testim do të bëhet duke u bazuar në vlerësuesin GMM.

5.3.2. Rezultatet Empirike

Tabela 5. 5:Përshkrimi statistikor i variablave ekzogjene dhe endogjene në vendet e Ballkanit

Variablat	OBS	Std.Dev	Min	Max
Gdp	128	4 9.5293	-11.83	92.12
Gdplag	127	9.5662	-11.83	92.12
Debt	106	25.8040	9.8	224.8
Debt_Square	106	1.0179	4.5647	10.830
Exsport	126	10.5429	5.61	55.4
Final_Consum	125	10.6220	80.79	138.53
Bruto_Saving	119	18.1786	-8.3	180.22
Current_Account	121	19.5395	-194.55	13.96
Final_Government_Expenditure	119	5.1149	9.45	39.28

Perëndimor

Burimi: Kalkuluar nga Autori

Tabela 5. 6:Rezultatet nga analiza e regresionit në vendet e Ballkanit Perëndimor

Variablat	OLS Model (1)	Fixed Effects Model (2)	Random Effects Model (3)	Hausman- Taylor Model (4)	GMM IV Model (5)
Gdp_Lag T-Statistics				-0.0483 (-0.47)	-0.2273*** (-2.46)
Debt T-Statistics	0.0130 (0.45)	0.0387* (1.12)	0.0130 (0.45)	0.0292 (0.83)	0.0280 (0.74)
Debt_Square T-Statistics	0.5917 (0.73)	-1.5207* (-1.19)	-0.5917 (-0.73)	-0.7754 (-0.66)	-1.5080 * (-1.04)
Export T-Statistics	-0.0003 (-0.01)	-0.0494 (0.78)	0.0003 (-0.01)	-0.0168 (-0.31)	0.0934 (0.96)
Final_Consum T-Statistics	0.1608*** (2.15)	0.1545** (1.56)	0.1608*** (2.15)	0.1485** (1.58)	0.2275*** (2.05)
Bruto_Saving T-Statistics	0.3195*** (3.36)	0.3526*** (3.51)	0.3195*** (3.36)	0.338*** (3.36)	0.5096*** (4.04)
Current_Account T-Statistics	-0.2167*** (-3.45)	-0.1877*** (-2.64)	- 0.2167*** (-3.45)	-0.222*** (-3.04)	-0.2806*** (-3.07)
Final_Government_Exp T-Statistics	-0.0043 (-0.04)	-0.1776 (-0.90)	0.0043 (0.04)	-0.0515 (-0.32)	-0.0132 (-0.06)
Constant T-Statistics	-24.49** (1.98)	-4.77 (0.29)	-24.49** (1.98)	-11.11 (-0.69)	-- --
Observation	102	140	140	139	96

Arellano - Bond test for AR (1)	--	(-1.93)	--		(-1.93)
Arellano - Bond test for AR (2)	--	-(1.97)	--		-(1.97)
Sargan Test	--	-	-		(121.92)
$\chi^2_{(56)prob.}$					
Turning Point					58.20
95% CI bootstrap - normal-based CI					(57;64)

Burimi: Kalkuluar nga Autori

Shënim: Gdp-ja nënkupton prodhimin e brendshëm bruto për kokë banori (annual %), ku në këtë studim është vendosur si variabël e varur. Interpretimi i rezultateve do të bëhet përmes qasjes GMM. Besueshmëria dhe signifikanca do të bazohen nëpërmjet koeficientit t-statistics, ku parametrat 1 deri në 1.5 rezultatat janë signifikante më *, parametrat 1.5 deri në 2 janë më **, si dhe mbi 2 më ***. Testi Sargan tregon vlerën e koeficientit t-value për hipotezën e pavlefshme të vlefshmërisë së instrumenteve të përdorura (rezultati i marrë nga hapat e dytë). AR (1) dhe AR (2) janë vlerat e besueshmërisë për qëllim të parë dhe të dytë të auto korrelacionit të gabimeve. Ndërsa intervalet e besimit (CI) të pikës së kthimit të borxhit gjenerohen përmes metodës “bootstrap-montecarlo” bazuar në një shpërndarje normale, që ndryshe njihet si “threshold”, ku me konkretisht në këtë studim paraqet pragun e përdorimit të borxhit publik.

Në Tabelën 5.6 janë paraqitur rezultatet nga analiza e regresionit. Duke aplikuar teknika të ndryshme ekonometrike, rezultatet e regresionit tregojnë se të disa nga modelet kanë pothuajse të njëjtat parametra në lidhje me raportin e borxhit publik ndaj rritjes së PBB-së për kokë banori në vendet e Ballkanit Perëndimor. Për më tepër mund të vërejmë se testi Sargan bën të mundur identifikimin e kufizimeve në prani të heteroskedasticitetit me p-vlerën e shoqëruar e cila shqyrton vlefshmërinë e variablave instrumentale që janë pranuar, si instrumente të shëndetshëm për të gjitha qasjet ekonometrike të vlerësuar. Prandaj, rezultatet nga vlerësuesi i GMM vërtetojnë hipotezën se variablat instrumentale nuk lidhen me grupin e mbetjeve. Si rezultat, testet Arellano - Bond testi AR (1) dhe testi AR (2) me vlera të shoqëruara refuzohen në rendin e parë, mirëpo pranohen në rendin e dytë ku dhe konfirmohet që nuk ka auto korrelacion në rendin e dytë ndërmjet termit të gabimeve.

Pjesë e rëndësishme e kësaj tabele është pika e kthimit të borxhit publik që përcaktohet përmes kufirit “threshold “. Interpretimi i rezultateve në këtë testim empirik do të bëhet nëpërmjet vlerësuesit GMM, për shkak të besueshmërisë dhe signifikancës me të lartë. Nëpërmjet Tabelës 5.6 mund të vërejmë se rritja eventuale e raportit të borxhit publik ndaj PBB-së për 1% në vendet në tranzicion të Ballkanit Perëndimor mund të ndikojë pozitivisht në rritjen ekonomike për 0.028% gjatë periudhave afat-shkurtra. Që të kemi rezultate më të besueshme në raport mes borxhit publik dhe rritjes ekonomike ne kemi vendosur borxhin në katror ngjashëm edhe me vendet e trajtuara me lartë. Ku sipas të dhënave nga Tabela 5.6 shohim se borxhi i vendosur në katror ndikon negativisht në rritjen ekonomike për -1.508 % në vendet e Ballkanit Perëndimor, gjithashtu ky koeficient është statistikisht i besueshëm.

Për më tepër mund të vërejmë se borxhi i vendosur në katror (borxhi^2) në raport me PBB-në pasqyron një lidhje jo-lineare, dhe kjo prodhon një marrëdhënie konkave (në formë të U-së e përmbysur) midis borxhit publik dhe rritjes ekonomike, dhe qënënkupton se borxhi publik mund të ndikojë pozitivisht në rritjen ekonomike në nivelet fillestare, mirëpo tejkalimi mbi pragun optimal i borxhit publik tek (U-ja e përmbysur) jap pastaj efekte negative mbi rritjen ekonomike. Këto rezultate janë harmoni të plotë me shumë studime empirike të cilat janë bërë në fushën e borxhit publik dhe rritjes ekonomike.

Si dhe me Teorinë Keysiane që thekson se niveli i ulët i borxhit publik mund të çojë në rritjen ekonomike, por negativisht mund të ndikojë niveli i lartë i borxhit publik i cili mund të karakterizohet me rritjen e tatimit, rënien e investimeve, si dhe rritjen e shpenzimeve të konsumit. Gjithashtu ky rezultat i dhënë me lartë mund të krahasohet edhe me studimin e bërë nga Mencinger, Aristovnik, Verbic (2015), ku sipas studimit shohim se rritja e raportit të borxhit mund të ndikojë pozitivisht në rritjen ekonomike në vendet e zhvilluara si dhe ato në zhvillim, mirëpo negativisht ndikon borxhi i vendosur në katror tek dy grupet e vendeve të analizuara, këtu vihet në pah edhe diferenca e pragut në mes të vendeve të zhvilluara si dhe vendeve në zhvillim e sipër.

Sipas rezultateve me lartë vërejmë se eksporti ndikon pozitivisht në rritjen ekonomike në vendet e Ballkanit Perëndimor, me konkretisht nëse eksporti rritet për 1% atëherë do të ndikon në rritjen ekonomike për 0.093%. Gjithashtu koeficient pozitiv kanë shfaqur edhe shpenzimet e konsumi final në raport me PBB-në, ku nëse shpenzimet e konsumit rriten për 1% atëherë do të ndikojnë për 0.227% në rritjen ekonomike, ky rezultat është shumë i besueshëm statistikisht.

Gjithashtu edhe rritja e kursimeve bruto ndikon pozitivisht në rritjen ekonomike për 0.509%, ku sipas tabelës me lartë shohim se ky koeficient ka besueshmëri shumë të lartë statistikore. Ky rezultat është në përputhje të plotë me teorinë e rritjes nga studiuesit Harrod dhe Solow, të cilët argumentuan ndikimin pozitiv të kursimeve bruto në rritjen ekonomike në periudhën afatgjatë.

Llogaria rrjedhëse ka shfaqur koeficient negativ në raport me PBB-në, ku rritja eventuale e saj për 1% ndikon negativisht në rritjen ekonomike për -0.280%, ky koeficient është statistikisht shumë i besueshëm. Ndërsa shpenzimet qeveritare kanë dhënë koeficient negativ në raport me PBB-në, çka do të thotë se rritja e tyre prej 1% ndikon negativisht në rritjen ekonomike të vendeve të Ballkanit Perëndimor për -0.013%. Rezultati është në harmoni edhe me studimet e bëra nga (Adam and Bevan (2005), Cohen (1993), Elmendorf and Mankiw (1999).

5.4.Përcaktimi i pragut të borxhit publik tek vendet në tranzicion të Evropës Qendrore

5.4.1. Të dhënat nga hulumtimi empirik

Nga të dhënat e prezantuara në Tabelën 5.7 mund të shohim testimin e pragut të përdorimit të borxhit publik tek vendet në tranzicion të Evropës Qendrore. Ky testim është bërë duke u bazuar në vlerësuesin “bootstrapping” metode kjo e cila bazohet në një shpërndarje normale. Metoda “bootstrap-montecarlo” bazohet nëmbi 2000 simulimet e përdorura të cilat nxjerrin koeficientet dhe llogarisin pikën kthyesë të përdorimit të borxhit publik në raport me PBB-në . Burim i të dhënave për realizimin e këtij testimi ka qenë Banka Botërore si dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar. Ndërsa periudha e analizës së përcaktimit të pragut të borxhit publik në vendet në tranzicion të Evropës Qendrore përfshijnë periudhën kohore 2000-2017nëpërmjet të dhënave të balancuara. Modeli i pragut (threshold) përshkruan karakterin kërcyes ose ndërprerjen strukturore në marrëdhëniet ndërmjet variablave në modelin ekonometrik. Ky model mund të kapë shumë fenomene ekonomike, nëpërmjet këtij modeli mund të përcaktojmë pikën kthyesë, ku deri në cilin kufi rritja e raportit të borxhit ndaj PBB-së mund të ndikojë pozitivisht, si dhe definimi i pikës kthyesë ku borxhi publik mund të ndikoj negativisht ndaj PBB-së. Ka disa punime me kredibilitet të lartë shkencor të cilat janë munduar të përcaktojnë qështjen e pragut të borxhit publik në raport me PBB-në si p.sh (Checherita dhe Rother (2010), Reinhart dhe Rogoff (2010), Mencinger, Aristovnik, Verbic (2015).

5.4.2. Rezultatet empirike

Tabela 5. 7:Përcaktimi i pikës kthyesë (Turning Point) tek vendet në tranzicion të Evropës Qendrore

Threshold estimator (level = 95):							
model	Threshold		Lower		Upper		
Th-1	81.60		40.50		82.30		
Threshold effect test (bootstrap = 50) :							
Threshold	RSS	MSE	Fstat	Prob	Crit10	Crit5	Crit1
Single	0.0000	0.0000	-72.16	1.0000	122.77	158.79	340.86

Burimi: Kalkuluar nga Autori

Pjesë e rëndësishme e këtij studimi është pika e kthyesë e raportit të borxhit publik ndaj PBB-së. Rezultatet në Tabelën 5.7 tregojnë se pika e kthyesë e efektit të borxhit publik ndaj PBB-së varion nga 40% deri në 82%, më saktë pika e kthimit (turning point) është 81.60%. Një rritje e raportit të borxhit publik ndaj PBB-së mbi këtë prag optimal do të ketë një efekt negativ në rritjen ekonomike të vendeve në tranzicion të Evropës Qendrore.

Nëpërmjet rezultatit të dhënë shohim se pika kthyesë është 82%, çka nënkupton se rritja e borxhit publik mbi këtë kufi ndikon negativisht në rritjen ekonomike të vendeve në tranzicion të Evropës Qendrore. Andaj duke ju referuar rezultateve të shfaqura në Tabelën 5.7 e mbështesim **Hipotezën 1** të dhënë në fillim të këtij studimi, e cila është në përputhje të plotë edhe me Teorinë Keynesiane e cila parasheh që niveli i ulët i borxhit publik mund të çojë në rritje ekonomike, mirëpo negativisht mund të ndikojë niveli i lartë i borxhit publik i cili mund të karakterizohet me rritje të taksave, rënie të investimeve, si dhe rritjen e shpenzimeve të konsumit. Gjithashtu këto rezultate kanë ngjashmëri dhe përputhje me studimet e bëra nga (Kumar dhe Woo (2010), Checherita dhe Rother (2010), Reinhart dhe Rogoff (2010), Mencinger, Aristovnik, Verbic (2015), Cecchetti et al. (2011).

5.5.Përcaktimi i pragut të borxhit publik tek vendet në tranzicion të Evropës Lindore

5.5.1. Të dhënat nga hulumtimi empirik

Sipas të dhënave të paraqitura në Tabelën 5.8 mund të shohim testimin e pragut të përdorimit të borxhit publik në raport me PBB-në tek vendet në tranzicion të Evropës Lindore. Ky hulumtim është bërë duke u bazuar në vlerësuesin “bootstrapping” metodë kjo e cila bazohet në një shpërndarje normale. Metoda “bootstrap-montecarlo” bazohet tek mbi 2000 simulimet e përdorura të cilat nxjerrin koeficientet dhe llogarisin piken kthyesë të përdorimit të borxhit publik në raport me PBB-në. Të dhënat të cilat janë përdorur për të përcaktuar pragun e borxhit publik janë marrë nëpërmjet Bankës Botërore si dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar. Periudha e testimit përfshijnë të dhënat nga viti 2000- deri në vitin 2017 nëpërmjet të dhënave të balancuara, për vendet në tranzicion të Evropës Lindore.

Modeli i pragut (threshold) përshkruan karakterin kërcyes ose ndërprerjen strukturore në marrëdhëniet ndërmjet variablave në modelin ekonometrik (Andrews dhe Guggenberger, 2009). Ky model mund të kapë shumë fenomene ekonomike, nëpërmjet këtij modeli mund të përcaktojmë piken kthyesë, ku deri në cilin kufi rritja e raportit të borxhit ndaj PBB-së mund të ndikojë pozitivisht, si dhe përcaktimi i pikës kthyesë ku borxhi publik mund të ndikojë negativisht ndaj PBB-së. Përcaktimi dhe definimi i pragut të borxhit publik tek vendet në tranzicion të Evropës Lindore është bërë duke u bazuar nëpërmjet “single threshold” (Hansen ,1999).

5.5.2. Rezultatet empirike

Nëpërmjet Tabelës 5.8 me poshtë ne do të përcaktojmë pragun optimal të përdorimit të borxhit publik në raport me PBB-në tek vendet në tranzicion të Evropës Lindore, çka do të thotë se deri në cilin kufi rritja borxhit publik mund të ndikojë pozitivisht në rritjen ekonomike, si dhe kur tejkalimi i këtij kufiri optimal mund të ndikojë negativisht në rritjen ekonomike të këtyre vendeve.

Tabela 5. 8:Përcaktimi i pikës kthyesë (Turning Point) tek vendet në tranzicion të Evropës Lindore

Threshold estimator (level = 95):							
model	Threshold		Lower		Upper		
Th-1	71.90		71.1		72.0		
Threshold effect test (bootstrap = 50) :							
Threshold	RSS	MSE	Fstat	Prob	Crit10	Crit5	Crit1
Single	980.68	11.53	20.99	0.0000	9.76	10.88	15.49

Burimi: Kalkuluar nga Autori

Rezultatet në Tabelën 5.8 tregojnë se pika e kthyesë e ndikimit të borxhit publik ndaj PBB-së varion nga 71.1% deri në 72.0%, më saktë pika e kthimit (turning point) është 71.90%. Një rritje e raportit të borxhit publik ndaj PBB-së mbi këtë prag optimal prej 71.90% do të ketë një efekt negativ në rritjen ekonomike të vendeve në tranzicion të Evropës Lindore.

Nëpërmjet rezultatit të dhënë shohim se pika kthyesë është 71.90%, çka nënkupton se rritja e borxhit publik mbi këtë kufi ndikon negativisht në rritjen ekonomike të vendeve në tranzicion të Evropës Lindore. Andaj duke ju referuar rezultateve të shfaqura në Tabelën 5.7 ne e mbështesim **Hipotezën 2** të dhënë në fillim të këtij studimi.

E cila njëkosishtë është ne përputhje me Teorinë Keynesiane, si dhe me disa studime empirike të bëra në fushën e borxhit publik ku rezultatet pothuajse janë të krahasueshme me (Checherita dhe Rother (2010), Mencinger (2010)).

5.6.Përcaktimi i pragut të borxhit publik tek vendet në tranzicion të Ballkanit

Perëndimor

5.6.1. Të dhënat nga hulumtimi empirik

Duke ju referuar të dhënave të paraqitura në Tabelën 5.9 mund të shohim testimin e pragut të borxhit publik në raport me PBB-në tek vendet e Ballkanit Perëndimor . Ky hulumtim është bërë duke u bazuar në vlerësuesin “bootstrapping” metode kjo e cila bazohet në një shpërndarje normale.

Metoda “bootstrap-montecarlo” bazohet tek mbi 2000 simulimet e përdorura të cilat nxjerrin koeficientet dhe llogarisin pikën kthyesë të përdorimit të borxhit publik në raport me PBB-në. Të dhënat të cilat janë përdorur për të përcaktuar pragun e borxhit publik janë marrë nëpërmjet Bankës Botërore si dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar. Periudha e analizës përfshijnë të dhënat nga viti 2000- deri në vitin 2017 nëpërmjet të dhënave të balancuara, për vendet e Ballkanit Perëndimor. Modeli i pragut (threshold) përshkruan karakterin kërcyes ose ndërprerjen strukturore në marrëdhëniet ndërmjet variablave në modelin ekonometrik (Andrews dhe Guggenberger, 2009). Përcaktimi dhe definimi i pragut të borxhit publik tek vendet e Ballkanit Perëndimor është bërë duke u bazuar nëpërmjet “single threshold” (Hansen, 1999). Nëse i referohemi literaturës empirike shohim se nuk ka studime të mirëfillta të cilat trajtojnë çështjen e përcaktimit të pragut të borxhit publik në raport me PBB-në tek vendet e Ballkanit Perëndimor, dhe të cilat definojnë se deri në cili kufi rritja eventuale e borxhit publik mund të ndikojë pozitivisht në rritjen ekonomike.

5.6.2. Rezultatet empirike

Nëpërmjet Tabelës 5.9 me poshtë ne do të përcaktojmë pragun optimal të përdorimit të borxhit publik në raport me PBB-në tek vendet në tranzicion të Ballkanit Perëndimor, çka do të thotë se deri në cilin kufi rritja borxhit publik mund të ndikojë pozitivisht në rritjen ekonomike, si dhe kur tejkalimi i këtij pragu optimal mund të ndikojë negativisht në rritjen ekonomike.

Tabela 5. 9: Përcaktimi i pikës kthyesë (Turning Point) tek vendet në tranzicion të Ballkanit Perëndimor

Threshold estimator (level = 95):							
model	Threshold		Lower		Upper		
Th-1	58.20		57.40		64.75		
Threshold effect test (bootstrap = 50) :							
Threshold	RSS	MSE	Fstat	Prob	Crit10	Crit5	Crit1
Single	0.0000	0.000	-79.83	1.0000	65.10	131.67	167.186

Burimi: Kalkuluar nga Autori

Rezultatet në Tabelën 5.9 tregojnë se pika e kthyesë e efektit të borxhit publik ndaj PBB-së varion nga 57.40% deri në 64.75%, më saktë pika e kthimit (turning point) është 58.20%. Një rritje e raportit të borxhit publik ndaj PBB-së deri në këtë prag optimal prej 58.20% do të ketë një ndikim pozitiv në rritjen ekonomike në vendet në tranzicion të Ballkanit Perëndimor. Nëpërmjet rezultatit të dhënë shohim se pika kthyesë është 58.20%, çka nënkupton se rritja e borxhit publik mbi këtë prag ndikon negativisht në rritjen ekonomike të vendeve në tranzicion të Ballkanit Perëndimor. Andaj duke ju referuar rezultateve të shfaqura në Tabelën 5.8 ne e mbështesim **Hipotezën 3** të dhënë në fillim të këtij studimi, ku rezultatet e fituara janë në përputhje me disa studime empirike të bëra nga (Melecki (2007), Pinkowski (2017), Mencinger, Aristovnik, Verbic (2015)).

5.7. Lidhja mes borxhit publik dhe investimeve publike

5.7.1. Të dhënat nga hulumtimi empirik

Të dhënat empirike të cilat janë përdorur për të hetuar lidhjen në mes të borxhit publik dhe investimeve publike në vendet në tranzicion të Evropës përfshijnë periudhën kohore nga viti 1995-deri në vitin 2017. Ndërsa burimi i të dhënave do të jetë Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar, për t'i vlerësuar me konkretisht të dhënat atëherë mund ti shohim tek **Shtojca.4** në fund të këtij studimi shkencor.

Për të testuar ndikimin e borxhit publik në rritjen ekonomike nëpërmjet investimeve publike, ne kemi ndërtuar modelet ekonometrike të cilat përfshijnë disa qasje, duke filluar nga OLS (Analiza e thjeshtë e regresionit), Fixed Effects (Efektet Fikse), Random Effects (Efektet e Rastit), Hausman-Taylor, si dhe vlerësuesi GMM (Metoda e Përgjithshme e Momenteve), të cilat janë harmoni edhe me studime tjera empirike të cilat mundohen të shpjegojnë ndikimin e borxhit publik në rritjen ekonomike nëpërmjet disa kanaleve të caktuara, ku ndër to janë edhe investimet publike (Checherita dhe Rother (2010)). Sipas të dhënave të paraqitura në Tabelën 5.10 mund t'i shohim rezultatet nga të gjitha qasjet ekonometrike të përdorura në këtë hulumtim empirik, të cilat paraqesin lidhjen në mes të borxhit publik dhe investimeve publike.

Ku variabël e varur është vendosur final_government_expenditure (që ndryshe paraqet shpenzimet për investime publike), ndërsa debt (borxhi publik), debt square (borxhi i vendosur në katror), exsport (eksporti), final_consum (shpenzimet e konsumit), bruto_saving (kursimet bruto), current account (llogaria aktuale), si dhe gdp-në (gdp per capita) janë vendosur si variabla të pavarura. Të gjitha variablat në këtë hulumtim empirik janë të shprehura në përqindje të PBB-së. Interpretimi i rezultateve empirike do të behet nëpërmjet vlerësuesit GMM, ose me mire të themi sipas modelit të fundit tek Tabela 5.10, kjo sepse të dhënat e fituara nga ky vlerësues shihen të jenë me të besueshme.

5.7.2. Rezultatet empirike

Tabela 5. 10: Rezultatet nga analiza e regresionit në vendet në tranzicion të Evropës

Variablat	OLS Model (1)	Fixed Effects Model (2)	Random Effects Model (3)	Hausman- Taylor Model (4)	GMM IV Model (5)
Final_gov_ex_Lag1 T-Statistics				0.6650*** (13.19)	0.3865*** (4.47)
Gdp T-Statistics	-0.095*** (-3.11)	-0.0098 (-0.43)	- 0.0951*** (-3.11)	- 0.0995*** (-6.01)	-0.0733*** (-4.14)
Debt T-Statistics	-0.031*** (-2.05)	-0.0213** (-1.51)	0.0318 (-2.05)	-0.0050 (0.52)	0.0116 (0.61)
Debt_Square T-Statistics	0.046 (0.22)	0.3102* (-1.04)	0.0465 (0.22)	-0.0911 (-0.47)	-0.4039*** (-1.26)
Export T-Statistics	- 0.0350*** (3.22)	- 0.0554*** (-3.68)	- 0.0350*** (-3.22)	-0.0147* (1.37)	-0.0118 (-0.76)
Final_Consum T-Statistics	-0.1080** (-2.00)	0.0516 (0.63)	- 0.1080** (-2.00)	-0.0087 (0.17)	0.0992** (1.54)

Bruto_Saving	-	-	-0.2122***	-	-0.1351***
T-Statistics	0.2122*** (3.08)	0.3450*** (4.87)	(-3.08)	0.1117*** (2.16)	(-2.17)
Current_Account	0.1097***	0.1460***	0.1097***	0.0205	0.0518**
T-Statistics	(2.63)	(4.13)	(2.63)	(0.78)	(1.70)
Constant	35.43***	24.88***	35.43	11.38**	--
T-Statistics	(5.78)	(2.97)	(5.78)	(1.99)	--
Observation	146	146	146	145	139
Arellano - Bond test for AR (1)	--	(-1.55)	--		(-1.55)
Arellano - Bond test for AR (2)	--	(-0.98)	--		(-0.98)
Sargan Test	--	-	-		(142.90)
$\chi^2_{(56)prob.}$					

Burimi: Kalkuluar nga Autori

Shënim: Final government expenditure nënkupton shpenzimet qeveritare dhe tregon investimet publike ku në këtë tabelë është vendosur si variabël e varur. Interpretimi i rezultateve do të bëhet përmes qasjes GMM. Besueshmëria dhe signifikanca do të bazohen nëpërmjet koeficientit t-statistics, ku parametrat 1 deri në 1.5 rezultatet janë signifikante më *, parametrat 1.5 deri në 2 janë më **, si dhe mbi 2 më ***. Testi Sargan tregon vlerën e koeficientit t-value për hipotezën e pavlefshme të vlefshmërisë së instrumenteve të përdorura (rezultati i marrë nga hapat e dytë). AR (1) dhe AR (2) janë vlerat e besueshmërisë për qëllim të parë dhe të dytë të auto korrelacionit të gabimeve

Ndërsa nëse bazohemi tek rezultatet e dhëna nga analiza e regresionit (Tabela 5.10) për vendet në tranzicion të Evropës, si dhe nga interpretimi i tyre nëpërmjet vlerësuesit GMM vërejmë lidhjen e mundshme në mes të borxhit publik dhe investimeve publike. Ku me konkretisht në Tabelën 5.10 shohim se borxhi publik ndikon pozitivisht në investimet publike për 0.011%. Ndërsa nga rezultatet shohim se borxhi publik i vendosur në katror ndikon negativisht tek investimet publike, qka do të thotë rritja e borxhit në katror për 1% ndikon negativisht tek investimet publike për -0.403%, ky rezultat ka besueshmëri statistikore. Nga rezultatet shohim se rritja eksportit ndikon negativisht tek investimet publike për -0.011%, ndërsa konsumi final ndikon pozitivisht tek investimet publike për 0.099%.

Rezultat ky i cili ka besueshmëri statistikore. Rritja e kursimeve bruto për 1% ndikon negativisht në shpenzimet për investime publike për -0.135%. Ndërsa rritja e raportit të llogarisë aktuale ndikon pozitivisht tek investimet publike për 0.051%, gjithashtu ky koeficient është statistikisht i besueshëm. Sipas këtyre rezultateve shohim se borxhi publik mund të ndikojë pozitivisht në rritjen ekonomike nëpërmjet investimeve publike tek vendet në tranzicion të Evropës, me konkretisht tek vendet e Evropës Qendrore, Evropës Lindore, si dhe vendet e Ballkanit Perëndimor. Kjo mund të pasqyrohet nëpërmjet efektit të investimeve publike, ku vendet në tranzicion mund të rrisin nivelin e borxhit publik duke investuar në projekte publike të cilat pastaj mund të nxisin prodhimin dhe rritjen ekonomike, andaj duke u bazuar në rezultatet e dhëna nga vlerësuesi “GMM” në Tabelën 5.10 ne mbështesim **Hipotezën 4** të ngritur në fillim të këtij studimi. Rezultatet e cekura më lartë mund të krahasohen edhe me studimin e bërë nga (Checherita dhe Rother, 2010) ku në kërkimet e tyre empirike kanë analizuar ndikimin e borxhit publik në rritjen ekonomike, në një mostër prej dymbëdhjetë vendeve të Eurozonës përmes kanaleve të mëposhtme të tilla si: investimet publike, investimet private, niveli i përgjithshëm i produktivitetit, si dhe normat reale dhe ato nominale të interesit. Sipas rezultateve të analizuara shohim se pika kthyesë e borxhit publik nëpërmjet këtyre kanaleve tek 12 vendet eurozonës është nga 90% deri në 100, rezultate këto të cilat kanë një besueshmëri shumë të lartë statistikore.

Sipas (Checherita dhe Rother, 2010) kanalet përmes të cilave borxhi publik ka mundësi të ndikoj pozitivisht në shkallën e rritjes ekonomike duket se janë: investimet publike, investimet private, niveli i përgjithshëm i produktivitetit, si dhe normat reale dhe ato nominale të interesit. Sipas studimit në fjalë shohim se nëse borxhi publik është nën pragu 90% deri 100% mund të ndikoj pozitivisht në rritjen ekonomike, duke treguar se intervalet e kthimit të borxhit publik për dy kanalet e para (investimet publike dhe investimet private) duket se janë shumë më të ulëta se sa pragu prej 90% deri 100%. Autorët kanë dhënë një shpjegim mjaft të qartë se si mund të ndikoj borxhi publik nëpërmjet investimeve publike, do të thotë rritja e deficiteve të akumuluar nga e kaluara mund të ndikoj pozitivisht në rritjen ekonomike nëse ato deficite përdoren për të financuar investimet publike prodhuese. Megjithatë me një pikë kthese e pragut që varion nga 45% e PBB-së deri në 68% të PBB-së mund të ndikojë negativisht në investimet publike. Lidhja negative midis borxhit publik dhe investimeve publike mund të shpjegohet me faktin se qeveritë në përpjekjet e tyre për konsolidim buxhetor priren të ulin shpenzimet e alokuara për investime publike, përfshirë mirëmbajtjen e infrastrukturës publike Tanzi(2002).

6. Përfundimi

Nëpërmjet strukturës së paraqitur me lartë shohim se qëllimi kryesor ishte të trajtohet ndikimi i borxhit publik në rritjen ekonomike të vendeve evropiane në tranzicion, me konkretisht vendet në tranzicion të Evropës Qendrore, Evropës Lindore, si dhe vendet e Ballkanit Perëndimor. Gjatë studimit kemi bërë përpjekje të paraqesim në radhë të parë edhe strukturën e borxhit publik tek vendet në tranzicion të Evropës. Çka është shumë me rëndësi që duhet të potencohet është se nëpërmjet këtij studimi kemi përcaktuar, ose më mirë të themi kemi definuar prapun optimal të përdorimit të borxhit publik në raport me PBB-në tek vendet në tranzicion të Evropës. Duke ju referuar literaturës teorike, si dhe asaj empirike kemi vërejtur se ekziston një dallim në mes të vendeve në tranzicion të Evropës për sa i përket praput optimal të borxhit publik ndaj PBB-së. Andaj sipas studimeve shohim se vendet të cilat janë me të zhvilluara kanë nivel me të lartë të raportit të borxhit publik ndaj PBB-së, në krahasim me vendet të cilat ballafaqohen me një zhvillim të brishte ekonomik.

Për të realizuar këtë hulumtim, si dhe për ti mbështetur konstatimet të cilat janë ngritur në fillim të këtij studimi kemi përdorur metoda dhe modele të avancuara shkencore. Me konkretisht kemi përdorur një metodologji gjithëpërfshirëse, duke zbatuar metoda të ndryshme kërkimore-shkencore, të cilat janë realizuar kryesisht nëpërmjet leximit të literaturës, vëzhgimit, dhe mendimit kritik ku nga informacionet janë zgjedhur sipas vlefshmërisë së tyre nga autorë të ndryshëm të huaj dhe vendor, si dhe subjekteve tjera që janë pjesë e kërimit, apo kanë qenë të kyçur në situata nga të cilat është synuar të nxirren përfundime, si dhe të arrihet deri te zgjidhja e problemit. Për konfirmimin e besueshmërisë të hipotezave kemi përdorur metoda të ndryshme me qëllim që rezultatet të kenë një signifikançë të lartë shkencore. Metoda narrative na ka mundësuar analiza të ndryshme të treguesve të ndryshëm dhe duke bërë sintetizimin e rezultateve dhe dhënies së përgjigjeve të hulumtimit shkencor. Me shfrytëzimin e metodës narrative është fituar njohuri për gjendjet, raportet dhe dinamikën e ndryshimeve që e determinojnë problematikën që është objekt studimi. Metoda narrative na ka ndihmuar që të zbulojmë komponentët përbërëse të dukurive të studiara, pastaj do të vërtetohen raportet kuantitative dhe do të shihet ndikimi i tyre në tërësi.

Pastaj metoda krahasuese e cila është një ndër metodat që më së shumti përdoret gjatë analizave të treguesve të ndryshëm makroekonomik në periudha të ndryshme kohore. Rezultate më të sakta kemi arritur duke i krahasuar indikatorët makroekonomik të cilët lidhen direkt me borxhin publik, të shteteve në periudha të ndryshme me qëllim që ti gjejmë shkaqet dhe arsyet e devijimeve dhe shmangieve të të dhënave të prezantuara. Ndërsa testimin e të dhënave e kemi bërë duke u bazuar në metodat ekonometrike. Metoda ekonometrike është përdorur duke shfrytëzuar të dhënat nga viti 1995 deri më 2017. Për të hetuar dhe studiuar ndikimin e borxhit publik në rritjen ekonomike të vendeve evropiane që janë në tranzicion, kemi përdorur disa metoda ekonometrike të tilla si në vijim: OLS (metoda e katrorëve të vegjël), nëpërmjet metodës së regresionit të thjeshtë linear, dhe nëpërmjet aplikimit të metodës së katrorëve të vegjël (OLS), kemi testuar ndikimin e borxhit publik në rritjen ekonomike të vendeve evropiane në tranzicion. Kemi përdorur modelet Fixed Effects dhe Random Effects, ku dallimi thelbësor ndërmjet tyre qëndron nëse efekti i pa vërtetuar individual numëron elemente që janë të lidhura (korrelacion) me regresorët e tjerë që ndodhen në modelin ekonometrik (Green, 2008, faqe.183). Model tjetër që është përdorur për testimin e të dhënave është modeli i Hausman-Taylor. Hausman dhe Taylor sugjerojnë një zgjidhje duke kombinuar aspektet e dobishme të të dy vlerësuesve, pra “Fixed Effects” dhe “Random effects”.

Metoda e quajtur “Hausman-Taylor” është një teknikë e njohur si “Instrumental-Variable”, që përdor vetëm informacionet që gjenden tashmë në model, për të eliminuar efektet e lidhjeve reciproke ndërmjet vendeve si dhe “Error Term”, ndryshe nga preventivuesi. Interpretimi i rezultateve tek të gjitha vendet në tranzicion të Evropës është bërë nëpërmjet vlerësuesit GMM. Metoda e përgjithësuar e momenteve (GMM) është një metodë statistikore ekonometrike që kombinon të dhënat e vëzhguara ekonomike me informacionin në kushtet e momentit, për të prodhuar vlerësime të parametrave të panjohur brenda një modeli ekonometrik. Ndërsa përcaktimi i pragut të borxhit publik tek vendet në tranzicion të Evropës është bërë përmes qasjes “threshold” duke përdorur metodën “bootstrap-montecarlo”. Metoda “bootstrap” bazohet në mbi 2000 simulimet e përdorura të cilat nxjerrin koeficientet dhe llogarisin pikën kthyesë të përdorimit të borxhit publik në raport me PBB-në.

Si çdo studim tjetër shkencor, edhe ky studim ka disa kufizime të caktuara. Gjatë testimit të dhënave në modelin ekonometrik, nuk kemi pasur mundësi të inkuadrojmë të gjitha variablat të cilat lidhen me borxhin publik dhe rritjen ekonomike, të tilla si: investimet publike, investimet private, investimet e huaja, normat e interesit, si dhe instrumentet e politikës fiskale. Organizimi i disertacionit të doktoratës është punuar i ndare në kapituj dhe seksione, ku secili prej tyre mundohet të jap shpjegime të hollësishme në lidhje me temën e trajtuar, dhe të gjitha këto nëpërmjet tabelave, figurave, grafikeve, ekuacioneve, si dhe formulave statistikore. Çka është shumë me rëndësi që duhet të potencohet gjatë këtij studimi është bërë dallimi në mes të vendeve në tranzicion të Evropës, sepse pragu i ndikimit të borxhit publik ndryshon. Ku me konkretisht tek vendet në tranzicion të Evropës Qendrore, pragu ose kufiri i rritjes së borxhit publik është shumë me i lartë se sa tek vendet tjera në tranzicion të Evropës, si p.sh vendet e Evropës Lindore dhe vendet e Ballkanit Perëndimor, ku do ti vërejmë edhe tek gjetjet të cilat janë të vendosura më poshtë në këtë pjesë.

Në fillim kemi vendosur strukturën e borxhit publik në vendet evropiane në tranzicion. Ku fillimisht kemi vendosur një pasqyrë makro-ekonomike të vendeve evropiane në tranzicion ekonomik, duke filluar nga vendet në tranzicion të Evropës Qendrore, Evropës Lindore, si dhe atyre të Ballkanit Perëndimor. Tek ky raport jemi munduar ti paraqesim nëpërmjet figurave dhe grafikave disa nga parametrat kryesor të studimit të tilla si : produkti i brendshëm bruto, eksporti, shpenzimet e konsumit, kursimet bruto, bilanci i llogarisë aktuale, si dhe shpenzimet qeveritare. Gjithashtu në pjesën e parë të studimi kemi paraqitur edhe strukturën e borxhit publik për vendet në tranzicion të Evropës (Evropës Qendrore, Lindore, si dhe vendet e Ballkanit Perëndimor). Të gjitha rezultatet janë vendosur në tabela dhe grafika, të shprehura në vlera monetare dhe në përqindje për të gjitha vendet me radhe.

Në **Pjesën e Fundit** të disertacionit të doktoratës, konkretisht tek rezultatet empirike kam paraqitur gjetjet kryesore të këtij studimi, nepermjet interpretimit të rezultateve të modeleve ekonometrike të tilla si OLS, Fixed Effects, Random Effects, Hausman-Taylor, GMM, si dhe Bootstrapping. Arsyeja e shumëllojshmërisë së përdorimit të këtyre modeleve ekonometrike është sepse rezultatet e fituara duhet të pasqyrojnë një besueshmëri të lartë statistikore. Burim i të dhënave kanë qenë Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar. Ndërsa periudha e analizës empirike mbi vendet në tranzicion të Evropës përfshijnë periudhën kohore 1995 deri në vitin 2017, dhe që paraqet një periudhë mjaft të madhe kohore me mbi 20 vite.

Në këtë kapitull fillimisht janë testuar të gjitha qasjet ekonometrike të përmendura me lartë për të gjitha vendet në tranzicion të Evropës, duke filluar nga ato të Evropës Qendrore, Evropës Lindore, si dhe vendet e Ballkanit Perëndimor. Interpretimi i rezultateve është bërë duke u bazuar vetëm në qasjen e vlerësuesit GMM, sepse nga studimet e bëra cilësohet si një metodë me kredibilitet të lartë shkencor, ku rezultatet që rrjedhin nga kjo metodë kanë një besueshmëri të madhe statistikore. Ndërsa përcaktimi dhe definimi i pragut të borxhit publik tek vendet në tranzicion të Evropës, është bërë duke u bazuar në qasjen “threshold” e cila përpunon të dhënat përmes metodës “Bootstrap-Montecarlo”.

Të dhënat empirike të cilat janë përdorur për t’i testuar variablat tek vendet në tranzicion të **Evropës Qendrore** përfshijnë periudhën kohore nga viti 1995-deri në vitin 2017. Sipas të dhënave të paraqitura në këtë hulumtim shkencor mund t’i shohim rezultatet nga të gjitha modelet e përdorura, të cilat paraqesin ndikimin e borxhit publik në rritjen ekonomike të vendeve në tranzicion të Evropës Qendrore. Sipas rezultateve vërejmë se rritja eventuale e raportit të borxhit publik ndaj PBB-së për 1% tek vendet në tranzicion të Evropës Qendrore mund të ndikojë pozitivisht në periudhat afat-shkurtër për 0.133%, sipas t-statistikës ky koeficient është statistikisht i besueshëm. Ndërsa borxhi i vendosur në katror ndikon negativisht në rritjen ekonomike për -5.243% tek vendet në tranzicion të Evropës Qendrore, gjithashtu ky koeficient ka besueshmëri shumë të lartë sipas t-statistikës. Për më tepër mund të vërejmë se borxhi i vendosur në katror (borxhi^2) në raport me PBB-në pasqyron një ndikim jo-linear, dhe kjo prodhon një marrëdhënie konkave (në formë të U-së e përmbysur) midis borxhit publik dhe rritjes ekonomike, dhe qënënkupton se borxhi publik mund të ndikojë pozitivisht në rritjen ekonomike në nivelet fillestare, mirëpo tejkalimi mbi pragun optimal i borxhit publik tek (U-ja e përmbysur) jap pastaj efekte negative mbi rritjen ekonomike.

Sipas rezultateve vërejmë se eksporti ndikon pozitivisht në rritjen ekonomike në vendet në tranzicion të Evropës Qendrore, me konkretisht nëse eksporti rritet për 1% atëherë do të ndikon në rritjen ekonomike për 0.270%, përndryshe ky koeficient ka një besueshmëri shumë të lartë statistikore, ky rezultat është në harmoni të plotë edhe me teorinë ekonomike e cila potencon se rritja e eksporti ndikon pozitivisht në zhvillimin ekonomik. Gjithashtu rritja e shpenzimeve të konsumit final ndikon pozitivisht në rritjen ekonomike, ku nëse shpenzimet e konsumi final rriten për 1% atëherë ndikon për 0.584% në rritjen ekonomike, sipas t-statistikës ky koeficient është statistikisht i besueshëm.

Ndërsa edhe rritja e kursimeve bruto ndikon pozitivisht në rritjen ekonomike me 0.714%, ku sipas rezultateve shohim se ky koeficient ka një besueshmëri shumë të lartë statistikore, ky rezultat është në përputhje të plotë me teorinë e rritjes ekonomike të bërë nga studiuesit (Harrod dhe Solow), të cilët argumentuan ndikimin pozitiv të kursimeve bruto në rritjen ekonomike në periudhën afatgjatë. Mirëpo efekt negativ vërehet të ketë llogaria rrjedhëse, ku rritja eventuale e saj për 1% ndikon negativisht në rritjen ekonomike për -0.586%, përndryshe ky rezultat ka besueshmëri shume të lartë statistikore. Për më tepër sipas vlerësuesit GMM shohim se shpenzimet qeveritare pasqyrojnë koeficient negativ, çka do të thotë se rritja e tyre prej 1% ndikon negativisht në rritjen ekonomike të vendeve në tranzicion të Evropës Qendrore për -0.722%, gjithashtu ky koeficient ka besueshmëri statistikore. Rezultati është në përputhje me rezultatet e studimeve të bëra nga (Elmendorf dhe Mankiw, 1999). Rezultatet e këtij kapitulli tregojnë se pika e kthyesë e efektit të borxhit publik ndaj PBB-së varion nga 40% deri në 82%, më saktë pika e kthimit (turning point) është 81.60%. Një rritje e raportit të borxhit publik ndaj PBB-së mbi këtë prag do të ketë një efekt negativ në rritjen ekonomike të vendeve në tranzicion të Evropës Qendrore. Nëpërmjet rezultatit të dhënë shohim se pika kthyesë është 82%, çka nënkupton se rritja e borxhit publik mbi këtë kufi ndikon negativisht në rritjen ekonomike të vendeve në tranzicion të Evropës Qendrore. Andaj duke ju referuar rezultateve të shfaqura me lartë e mbështesim **Hipotezën e Parë** e cila pohon se: **Rritja e Borxhit Publik në vendet e Evropës Qendrore mbi pragun 75% deri në 85% ndikon negativisht në rritjen ekonomike në raport me PBB-në.** Ky konstatim është në përputhje të plotë edhe me Teorinë Keynesiane. Gjithashtu këto rezultate kanë ngjashmëri dhe përputhje me studimet e bëra nga (Kumar dhe Woo (2010), Checherita dhe Rother (2010), Reinhart dhe Rogoff (2010), Mencinger, Aristovnik, Verbic (2015), Cecchetti et al. (2011).

Të dhënat empirike të cilat janë përdorur për t'i testuar variablat tek vendet në tranzicion të **Evropës Lindore** përfshijnë kryesisht periudhën kohore nga viti 1995-deri në vitin 2017. Sipas të dhënave të paraqitura mund ti shohim rezultatet nga të gjitha qasjet ekonometrike të përdorura në këtë testim, të cilat paraqesin ndikimin e borxhit publik në rritjen ekonomike të vendeve në tranzicion të Evropës Lindore. Duke ju referuar rezultateve shohim se rritja eventuale e raportit të borxhit publik ndaj PBB-se për 1% tek vendet në tranzicion të Evropës Lindore ndikon negativisht në rritjen ekonomike me -0.046%, mirëpo ky koeficient nuk posedon besueshmëri statistikore. Për të rritur me shumë signifkancën e rezultateve ne kemi vendosur borxhin publik në katror.

Ku sipas të dhënave të fituara shohim se borxhi i vendosur në katror ndikon negativisht në rritjen ekonomike me -2.043 % tek vendet në tranzicion të Evropës Lindore. Gjithashtu ky koeficient ka besueshmëri shumë të lartë sipas t-statistikës. Sipas rezultateve të paraqitura vërejmë se eksporti ndikon pozitivisht në rritjen ekonomike tek vendet në tranzicion të Evropës Lindore, me konkretisht nëse eksporti rritet për 1% atëherë do të afekton në rritjen ekonomike për 0.170%, përndryshe ky koeficient ka besueshmëri shumë të lartë statistikore, ky rezultat është në harmoni të plotë edhe me teorinë ekonomike e cila potencon se rritja e eksporti ndikon pozitivisht në zhvillimin ekonomik. Gjithashtu koeficient pozitiv ka paraqitur edhe shpenzimet e konsumit final në raport me PBB-në, ku nëse shpenzimet e konsumi final rriten për 1% atëherë do të afektojnë për 0.095% në rritjen ekonomike. Ndërsa rritja e kursimeve bruto ndikon pozitivisht në rritjen ekonomike me 0.563%, ku sipas rezultateve të prezantuara shohim se ky koeficient ka një besueshmëri shumë të lartë statistikore. Nga të dhënat me lartë shohim së llogaria rrjedhëse ka pasqyruar koeficient negativ në raport me PBB-në, ku rritja eventuale e saj për 1% ndikon negativisht në rritjen ekonomike për -0.142%, ky koeficient është statistikisht i besueshëm.

Ndërsa sipas vlerësuesit GMM shpenzimet qeveritare kanë dhënë koeficient pozitiv në raport me PBB-në, çka do të thotë se rritja e tyre prej 1% ndikon pozitivisht në rritjen ekonomike të vendeve në tranzicion të Evropës Lindore për 0.074%. Rezultati është në përputhje me rezultatet e (Adam and Bevan (2005), Cohen (1993), Elmendorf and Mankiw (1999)). Rezultatet tregojnë se pika e kthyesë e efektit të borxhit publik ndaj PBB-së varion nga 71.1% deri në 72.0%, më saktë pika e kthimit (turning point) është 71.90%. Një rritje e raportit të borxhit publik ndaj PBB-së mbi këtë prag prej 71.90% do të ketë një efekt negativ në rritjen ekonomike të vendeve në tranzicion të Evropës Lindore.

Nëpërmjet rezultatit të dhënë shohim se pika kthyesë është 71.90%, çka nënkupton se rritja e borxhit publik mbi këtë kufi ndikon negativisht në rritjen ekonomike të vendeve në tranzicion të Evropës Lindore. Andaj duke ju referuar rezultateve të shfaqura nëpërmjet modeleve ekonometrike kemi mbështetur **Hipotezën e Dytë** e cila pohon se: **Rritja e Borxhit Publik në vendet e Evropës Lindore mbi pragun 65% deri në 75% ndikon negativisht në rritjen ekonomike në raport me PBB-në.** E cila njëkosishtë është në përputhje me Teorinë Keynesiane, si dhe me disa studime empirike të bëra në fushën e borxhit publik ku rezultatet pothuajse janë të krahasueshme me (Checherita dhe Rother (2010), Mencinger (2010)).

Të dhënat empirike të cilat janë përdorur për t'i testuar variablat tek vendet në tranzicion të **Ballkanit Perëndimor** përfshijnë kryesisht periudhën kohore nga viti 1995-deri në vitin 2017. Duke ju referuar rezultateve nga analiza ekonometrike mund të vërejmë se rritja eventuale e raportit të borxhit publik ndaj PBB-së për 1% tek vendet në tranzicion të Ballkanit Perëndimor mund të ndikojë pozitivisht në rritjen ekonomike me 0.028% gjatë periudhave afat-shkurtra. Ku sipas të dhënave shohim se borxhi i vendosur në katror ndikon negativisht në rritjen ekonomike me -1.508 % në vendet e Ballkanit Perëndimor, gjithashtu ky koeficient është statistikisht i besueshëm. Sipas rezultateve vërejmë se eksporti ndikon pozitivisht në rritjen ekonomike në vendet e Ballkanit Perëndimor, me konkretisht nëse eksporti rritet për 1% atëherë do të ndikon në rritjen ekonomike për 0.093%. Gjithashtu koeficient pozitiv ka shfaqur edhe shpenzimet e konsumit final në raport me PBB-në, ku nëse shpenzimet e konsumit final rriten për 1% atëherë do të ndikojnë për 0.227% në rritjen ekonomike, ky rezultat është shumë i besueshëm statistikisht. Gjithashtu edhe rritja e kursimeve bruto ndikon pozitivisht në rritjen ekonomike me 0.509%, ku sipas rezultateve shohim se ky koeficient ka besueshmëri shumë të lartë statistikore. Llogaria rrjedhëse ka shfaqur koeficient negativ në raport me PBB-në, ku rritja eventuale e saj për 1% ndikon negativisht në rritjen ekonomike për -0.280%, ky koeficient është statistikisht shumë i besueshëm. Po ashtu shpenzimet qeveritare kanë dhënë koeficient negativ në raport me PBB-në, çka do të thotë se rritja e tyre prej 1% ndikon negativisht në rritjen ekonomike të vendeve të Ballkanit Perëndimor për -0.013%.

Rezultati është në harmoni edhe me studimet e bëra nga (Adam and Bevan (2005), Cohen (1993), Elmendorf and Mankiw (1999)). Rezultatet e shfaqura gjatë të këtij kapitulli tregojnë se pika e kthyesë e efektit të borxhit publik ndaj PBB-së varion nga 57.40% deri në 64.75%, më saktë pika e kthimit (turning point) është 58.20%. Një rritje e raportit të borxhit publik ndaj PBB-së mbi këtë prag prej 58.20% do të ketë një ndikim negativ në rritjen ekonomike të vendeve në tranzicion të Ballkanit Perëndimor. Andaj duke ju referuar rezultateve të shfaqura nëpërmjet modeleve ekonometrike kemimbështetur **Hipotezën e Tretë** e cila pohon se: **Rritja e Borxhit Publik në vendet e Ballkanit Perëndimor mbi pragun 55% deri në 65% ndikon negativisht në rritjen ekonomike në raport me PBB-në.** Ku rezultatet e fituara janë në përputhje me disa studime empirike (Melecki (2007), Pinkowski (2017), Mencinger, Aristovnik, Verbic (2015)). Të dhënat empirike të cilat janë përdorur për të hetuar lidhjen në mes të **borxhit publik dhe investimeve publike** të vendeve në tranzicion të Evropës përfshijnë periudhën kohore nga viti 1995-deri në vitin 2017.

